



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)**

**DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK**

**QERSHOR 2023**

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3-4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-8
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	9-12

**II. HYRJA**

1. Objekti i auditimit.....	12
2. Qëllimi i auditimit.....	13
3. Identifikimi i çështjes.....	13
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	13
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	13
6. Kriteret e vlerësimit.....	14
7. Standardet e auditimit.....	14
8. Metodatat e auditimit.....	14-15
9. Dokumentimi i auditimit.....	15

**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	16
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.....	16
2.1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.....	16-37
2.2. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit.....	37-74
2.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	74-105
2.4. Prokurimet e fondeve publike.....	105-172
2.5. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të MFK.....	172-177
2.6. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditivin e mëparshëm.....	177-179

**IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....179-194**

**V. ANEKSE.....194**

**VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT.....194**

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1176/1, datë 13.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, nga data 10.01.2023 deri më 14.04.2023, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022, u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë.

Grupi i auditimit, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit mbi aktivitetin financiar dhe të përputhshmërisë së veprimtarisë së DSHTD-së, auditoi drejtimet kryesore, në auditimin e pasqyrave financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe mbi auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat për qarkullim e dokumentacionit, procedurat e qiradhënies, procedurat e prokurimeve, procedurat për pagesat dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e pronave të shtetit shqiptar në administrim të DSHTD dhe shpenzimet vjetore, të financuara nga Buxheti i DSHTD-së.

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik (DSHTD) është person juridik, publik, në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që ushtron veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjen shtetërore”.

Sa më sipër, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik vepron mbi bazën ligjore të mëposhtme:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr.44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”.
- Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr.285 datë 19.05.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”;
- VKM nr.840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, i ndryshuar;
- VKM nr.450 datë 16.06.2005 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, i ndryshuar;
- VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar;
- Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike” i ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Udhëzim Nr. 2 datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”;
- Udhëzim nr. 6, datë 3.9.1992, Për zbatimin e ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për Ndërmarrjet

*Shtetërore*”;

- Statuti i miratuar nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme në Janar 2011 sipas shkresës me nr. prot. 1842, datë 17.02.2011;

- Rregullore e Brendshme miratuar me VKD nr. 12, dt. 29.06.2018.

Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synimin e mirëpërdorimit të fondeve publike.

## 2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raporti n Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi rezultoi se për procedurat e prokurimit të realizuara jashtë territorit të RSH-së, mungon një bazë ligjore rregullatore e miratuar mbi realizimin e tyre. Me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 4, datë 10.06.2022 është miratuar udhëzimi për kryerjen e procedurave për punimet jashtë vendit, por referuar nenit 29 të Ligjit nr. 90/2012 “Për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore” është ministri përgjegjës ai që miraton rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës.	158-172	<b>I Lartë</b>	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të dërgojë pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse, “Udhëzimin mbi realizimin e procedurave të prokurimit jashtë territorit të RSH”, me qëllim rishikimin dhe miratimin nga ministri të aktit, duke synuar formalizimin e procedurës dhe ndarjen e qartë të roleve e përgjegjëseve për të gjithë aktorët në proces, që janë në varësi të MEPJ.
2	1. Gjatë vitit 2020 është regjistruar në aktivet afatgjata vlera prej 125,184,658 lekë e cila i korrespondon 10 apartamenteve në R., të cilat kanë kaluar nga MEPJ në administrim të DSHTD-së, sipas urdhrit të përbashkët nr. 613 datë 21.12.2020 të MEPJ dhe nr. 529/5 datë 21.12.2020 të DSHTD. Nga dokumentacioni u evidentua se gjatë viteve të kaluara në këto apartamente janë kryer punime ndërtimi duke ndryshuar konfigurimin dhe sipërfaqen e tyre. Nga auditimi rezultoi se grupi i punës i ngritur nga DSHTD gjatë vitit 2022, për kryerjen e vlerësimeve dhe verifikimeve fizike të këtyre apartamenteve, ka kryer vlerësime vetëm për pesë nga dhjetë apartamentet e kaluara në administrim. 2. Rezultoi se për vitin 2020, 2021 dhe 2022 institucioni nuk disponon inventar të detajuar të godinave të cilat ndodhen jashtë Shqipërisë. DSHTD ka regjistruar vlerën fillestarë të	37-74	<b>I Lartë</b>	DSHTD të marrë masa për kryerjen e vlerësimeve fizike për të gjitha apartamentet në R., të cilat kanë kaluar nga MEPJ në administrim të DSHTD – së me qëllim përcaktimin e vlerës së saktë të tyre. DSHTD të marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit për të gjitha godinat të cilat janë në administrim të saj. Institucioni të marrë masa për kryerjen e rivlerësimit të objekteve në përputhje me SKK 5: Aktive Afatgjata Materiale. DSHTD të marrë masa për hartimin e një analize të

	<p>godinës, por pa specifikuar elementët specifik të cilët janë pjesë e saj. Gjithashtu investimet e kryera në këto godina i janë shtuar godinës vetëm në vlerë totale dhe jo sipas zërave të punimeve të kryera. Kjo situatë krijon problematika në përcaktimin e pjesëve takuese të godinës që i përkasin DSHTD dhe ato që i përkasin trupave diplomatik. Gjithashtu për shkak të mungesës së një detajimi të saktë krijohen vështirësi në përcaktimin e investimeve apo punimeve të mirëmbajtjes të cilat janë detyrim i DSHTD-së.</p> <p>3. Gjatë vitit 2020 DSHTD ka kryer rivlerësime të objekteve. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka zgjedhur metodën e rivlerësimit për të matur vlerën e kategorisë së “ndërtesave”, dhe ka kryer rivlerësimin e disa prej tyre, por jo për të gjitha aktivet e përfshira në këtë kategori. Konkretisht janë rivlerësuar objektet me nr. pasurie 6/a; 6/b; 6/c; 6/d; 6/e dhe 6/f. Kjo mënyrë rivlerësimi nuk është në përputhje me SKK 5: Aktive Afatgjata Materiale, pika 24 dhe 25 i cili kërkon që nëse një aktiv afatgjatë rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e aktiveve afatgjata materiale të cilës ai i përket”. Bazuar në sa më sipër, sqarohet se DSHTD-ja nuk ka bërë rivlerësim tërësor për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale, por vetëm për një pjesë të tyre, për arsye të pamundësisë ekonomike dhe logjistike (një pjesë e ndërtesave janë Ambasadat e RSH jashtë vendit).</p> <p>4. Grupi i auditimit rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022, norma e amortizimit për kategorinë e aktiveve nuk është aplikuar në përputhje me normat e përcaktuara. DSHTD ka llogaritur amortizim për ndërtesat në masën 2% të vlerës së asetit në fillim të vitit ushtrimor, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar i cili përcakton se kosto e ndërtesave amortizohet me normën 5%</p>			<p>mirë strukturuar kosto – përfitimit për argumentimin e përlllogaritjes së amortizimit të ndërtesave në nivelin 2% dhe jo në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar.</p>
3	<p>Vendosja e kriteve jo në përputhje me objektin e prokurimit në procedurat e prokurimit me blerje të vogël, si më poshtë: - Procedura Blerje materiale izoluese 2020: Në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë në disa zëra është përdorur emri i markës "M" përmendja e markës është një kriter kufizues, për arsye se nuk janë përdorur fjalët “ose ekuivalent”.</p> <p>- Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadës Bullgare 2021: Kriteret e vendosura nga KPVV janë kriteret kufizuese pasi kërkohen licenca të cilat janë në fushën e projektimit dhe nuk kanë</p>	74-90	<b>I Lartë</b>	<p>Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël të marrë masa për hartimin e kriteve në mënyrë jo diskriminuese apo orientuese, në mënyrë që të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të OE, si dhe të nxitë pjesëmarrjen dhe konkurrencën ndërmjet tyre.</p>

	<p>objektin e prokurimit i cili është Përkthim.</p> <p>Licencat e kërkuara janë si më poshtë: 3/a: Projektme objekteve civile- industriale – turistike prej murature e skelet beton arme në 5 kate. 4/a: Projektim të instalimeve hidro-termosanitare. 4/c: Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. 4/j: Projektim të rrjeteve të telefonisë citofonisë, fonisë, internet, TV, Access kontrolli, cctv, sisteme alarmi, sisteme detektimi të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.</p> <p>- Procedura FV Kondicionerë 2022: Vendosija e kriterit “Sigurimin e kontratës në shumën 10% të vlerës së kontratës me TVSh” është në kundërshtim me Ligj nr.162/2020 për prokurimin publik neni 83 pika 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.</p> <p>- Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar të prokuruar nga Institucioni për vitin 2020 dhe 2021, KPVV ka vendoset si kriter “OE duhet të ketë në staf 3 punonjës të pajisur me certifikata I.” kriteri i mësipërm është një kriter i sforcuar dhe ka ngushtuar konkurrencën e OE për pasojë në të gjithë procedurat e audituar rezulton fitues i njëjti OE.</p>			
4	<p>Nga auditimi rezultoi se në kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet e huaja (trupi diplomatik/ organizatave ndërkombëtare), për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qirave nuk janë vendosur kamatëvonesat përkatëse. Kamatë vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vlerës së qirasë është 29,700.39 Euro.</p> <p>Kontrata me nr.1182/1 prot datë 17.12.2019, KQPH/V-01.2020- A.R.F.Gj-001. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 29,105.87 €.</p> <p>Kontrata me nr. 1067/1 datë 04.11.2019, KQPH-12.2019- A.R.F.Gj-059. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 314 €.</p> <p>Kontrata KQPH/V-05.2020-A.R.F. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 280.52 €.</p>	90-105	<b>I Lartë</b>	Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën 29,700.39 Euro.
5	<p>DSHTD ka aplikuar derdhjen e 30% të të ardhurave të krijuar nga qiraja vetëm nga “subjektet vendase”, me pretendimin se, meqenëse procedura e dhënies me qira e parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të</p>	90-105	<b>I Lartë</b>	Titullari i DSHTD të marrë masat për ngritjen e një grupi pune për hartimin dhe propozimin për miratim të një akti nënligjor që do të

	<p>mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk mund të aplikohet për trupin diplomatik apo organizatat e tjera ndërkombëtare, rrjedhimisht, as derdhja e detyrimit 30% nuk duhet të aplikohet. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk e parashikon konceptin e subjektit vendas apo subjektit të huaj, kjo ndarje është bërë nga vetë DSHTD për efekt lehtësie në administrimin e procedurave. DSHTD nuk rezulton të ketë kërkuar asnjëherë rishikimin e këtij akti, me qëllim përjashtimin nga detyrimi për zbatim të procedurave të qiradhënies, në rastet kur pala qiramarrëse është pjesë e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë.</p>			<p>formalizojë procedurat e qiradhënies kur pala qiramarrëse është trup diplomatik i akredituar/organizatë ndërkombëtare, ku të standardizohen ndër të tjera edhe (i) komunikimi periodik me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi nevojat e akomodimit të trupit diplomatik, si dhe (ii) detyrimet e DSHTD përgjatë kohëzgjatjes së kontratës (monitorimi i kontratës, ngrohja nëpërmjet kaldajës, punimet e ndryshme mirëmbajtëse, etj.).</p>
6	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik, rezultuan parregullsi në përcaktimin e kriterëve për kualifikim, dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të cilat kanë kufizuar konkurrencën, duke mos nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, si më poshtë. “Pllaka të ndryshme”, 2020: Kriteri mbi disponimin e një mjet në pronësi apo të marrë me qira, kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, në të cilat automjeti nuk do të ishte i nevojshëm gjatë gjithë kohës, njësia e prokurimit duhet të mjaftohej duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave. “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, 2020: Referuar kriterëve të licencimit të OE, lidhur me licencën për kategorinë: NS-12 “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”. Kriter i vendosur është në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Kriteri për inxhinier mekanik, të pajisur me licencë individuale (të vlefshme) me kategori 12/a, në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.1.2008. “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, 2020: Hartimin e fondit limit me analizat e çmimeve respektive, mungon në dokumentacionin e llogaritjes së fondit limit. Kriteri mbi certifikimin stafit teknik Inxhinier Ndërtimi, Specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, e vërtetuar me certifikatë përkatëse (të vlefshme), kriter i vendosur diskriminues në kundërshtim me profilin arsimor sipas Nenit 10, pika 1a, të VKM nr.312, datë 5.5.2010.</p>	105-158	<b>I Lartë</b>	<p>Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik, të marrë masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mosfavorizuar operatorë ekonomik të caktuar.</p>

	<p>Kriteret mbi Ekspert zjarrfikës, Inxhinierin Mekanik dhe Inxhinierin elektrik, si dhe mbi disponimin e auto betoniere, auto pompë betoni, pompë suvatimi, helikopter nivelimi nuk përputhet me natyrën e punimeve, në kundërshtim me nenin 26, Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. “Hapje pusi uji + impiant klorifikimi te Ambasada Bullgare”, 2021: Kriteri për Inxhinier Shpimi 1, kriteri diskriminues duhet të përfshiheshin profilet e diplomimit siç specifikohet në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar, lidhja 4, gjithashtu në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.1.2008. Kriteri mbi disponimin e Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, Autovinç, në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.</p>			
7	<p>Në objektin “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare” nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë 132,906 lekë me tvsh, veprime në kundërshtim me kontratën me nr. 697/3, datë 08.09.2020 lidhur midis DSHTD dhe BOE “D” &amp; “H”.</p>	105-158	<b>I Lartë</b>	<p>Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 132,906 lekë me tvsh nga BOE “D” &amp; “H”, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 697/3, datë 08.09.2020, me objekt “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të DSHTD.</p>
8	<p>Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadës Bullgare 2021. Përkthimi i projektit nuk është në veprimtarinë e DSHTD pasi në VKM Nr.840, datë 17.12.2004 Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik. Pika 2/a citon: Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë.</p>	74-90	<b>I Lartë</b>	<p>Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të fondeve të buxhetit të Institucionit në vlerën 294,000 lekë me TVSh për procedurën “Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare”.</p>



### III. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, u konstatua se:

- Procedurat e prokurimit të realizuara jashtë territorit të RSH-së, mungon një bazë ligjore rregullatore e miratuar mbi realizimin e tyre. Me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 4, datë 10.06.2022 është miratuar udhëzimi për kryerjen e procedurave për punimet jashtë vendit, por referuar nenit 29 të Ligjit nr. 90/2012 “Për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore” është ministri përgjegjës ai që miraton rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se: 1. Gjatë vitit 2020 është regjistruar në aktivet afatgjata vlera prej 125,184,658 lekë e cila i korrespondon 10 apartamenteve në R., të cilat kanë kaluar nga MEPJ në administrim të DSHTD – së, sipas urdhrin të përbashkët nr. 613 datë 21.12.2020 të MEPJ dhe nr. 529/5 datë 21.12.2020 të DSHTD. Nga dokumentacioni u evidentua se gjatë viteve të kaluara në këto apartamente janë kryer punime ndërtimi duke ndryshuar konfigurimin dhe sipërfaqen e tyre. Nga auditimi rezultoi se grupi i punës i ngritur nga DSHTD gjatë vitit 2022, për kryerjen e vlerësimeve dhe verifikimeve fizike të këtyre apartamenteve, ka kryer vlerësime vetëm për pesë nga dhjetë apartamentet e kaluara në administrim. 2. Rezultoi se për vitin 2020, 2021 dhe 2022 institucioni nuk disponon inventar të detajuar të godinave të cilat ndodhen jashtë Shqipërisë. DSHTD ka regjistruar vlerën fillestarë të godinës, por pa specifikuar elementët specifik të cilët janë pjesë e saj. Gjithashtu investimet e kryera në këto godina i janë shtuar godinës vetëm në vlerë totale dhe jo sipas zërave të punimeve të kryera. Kjo situatë krijon problematika në përcaktimin e pjesëve takuese të godinës që i përkasin DSHTD dhe ato që i përkasin trupave diplomatik. Gjithashtu për shkak të mungesës së një detajimi të saktë krijohen vështirësi në përcaktimin e investimeve apo punimeve të mirëmbajtjes të cilat janë detyrim i DSHTD – së. 3. Gjatë vitit 2020 DSHTD ka kryer rivlerësime të objekteve. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka zgjedhur metodën e rivlerësimit për të matur vlerën e kategorisë së “ndërtesave”, dhe ka kryer rivlerësimin e disa prej tyre, por jo për të gjitha aktivet e përfshira në këtë kategori. Konkretisht janë rivlerësuar objektet me nr. pasurie 6/a; 6/b; 6/c; 6/d; 6/e dhe 6/f. Kjo mënyrë rivlerësimi nuk është në përputhje me SKK 5: Aktive Afatgjata Materiale, pika 24 dhe 25 i cili kërkon që nëse një aktiv afatgjatë rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e aktiveve afatgjata materiale të cilës ai i përket”. Bazuar në sa më sipër, sqarojmë se DSHTD-ja nuk ka bërë rivlerësim tërësor për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale, por vetëm për një pjesë të tyre, për arsye të pamundësisë ekonomike dhe logjistike (një pjesë e ndërtesave janë Ambasadat e RSH jashtë vendit). 4. Grupi i auditimit rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022, norma e amortizimit për kategorinë e aktiveve nuk është aplikuar në përputhje me normat e përcaktuara. DSHTD ka llogaritur amortizim për ndërtesat në masën 2% të vlerës së asetit në fillim të vitit ushtrimor, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar i cili përcakton se kosto e ndërtesave amortizohet me normën 5%.

- Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit në procedurat e prokurimit me blerje të vogël, si më poshtë: Procedura Blerje materialë izoluese 2020: Në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë në disa zëra është përdorur emri i markës "M." përmendja e markës është një kriter kufizues, për arsye se nuk janë përdorur fjalët “ose ekuivalent”. Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadës Bullgare 2021: Kriteret e vendosura nga KPVV janë kriterë kufizuesë pasi kërkohen licenca të cilat janë në fushën e projektimit dhe nuk kanë objektin e prokurimit i cili është Përkthim. Procedura FV Kondicionerë 2022: Vendosja e kriterit “Sigurimin e kontratës në shumën 10% të vlerës së kontratës me TVSh” është në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 për prokurimin publik neni 83 pika 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar të prokuruar nga Institucioni për vitin 2020 dhe 2021, KPVV ka vendoset si kriter “OE duhet të ketë në staf 3 punonjës të pajisur me certifikata I.” kriteri i mësipërm është një kriter i sforcuar dhe ka ngushtuar konkurrencën e OE për pasojë në të gjithë procedurat e audituar rezulton fitues i njëjti OE.

- Nga auditimi rezultoi se në kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet e huaja (trupit diplomatik/ organizatave ndërkombëtare), për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qirave nuk janë vendosur kamatëvonesat përkatëse. Kamatë vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vlerës së qirasë është 29,700.39 Euro.
- DSHTD ka aplikuar derdhjen e 30% të të ardhurave të krijuar nga qiraja vetëm nga “subjektet vendase”, me pretendimin se, meqenëse procedura e dhënies me qira e parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk mund të aplikohet për trupin diplomatik apo organizatat e tjera ndërkombëtare, rrjedhimisht, as derdhja e detyrimit 30% nuk duhet të aplikohet. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk e parashikon konceptin e subjektit vendas apo subjektit të huaj, kjo ndarje është bërë nga vetë DSHTD për efekt lehtësie në administrimin e procedurave.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik, rezultuan parregullsi në përcaktimin e kritereve për kualifikim, dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të cilat kanë kufizuar konkurrencën, duke mos nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik.
- Në objektin “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare” nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë 132,906 lekë me tvsh, veprime në kundërshtim me kontratën me nr. 697/3, datë 08.09.2020 lidhur midis DSHTD dhe BOE “D” & “H”.
- Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare 2021. Përkthimi i projektit nuk është në veprimtarinë e DSHTD pasi në VKM Nr.840, datë 17.12.2004 Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik. Pika 2/a citon: Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

## OPINIONI I AUDITIMIT

### Opinion mbi pasqyrat financiare (i modifikuar)

Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare për vitin 2020; 2021 dhe 2022 për Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik.

Në kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të Subjektit, për vitin ushtrimor nga 01.01.2020-31.12.2020, 01.01.2021 – 31.12.2021; 01.01.2022 – 31.12.2022 të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 12003<sup>1</sup>, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik, shprehim një **opinion të modifikuar**<sup>2</sup> për llogaritë vjetore të subjektit Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të

<sup>1</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomalitë materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

<sup>2</sup> Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3.5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.”.

përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2022.

#### **Baza për opinionin e modifikuar:**

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI-t, të zbatueshme nga KLSH). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit të modifikuar (ISA 700; ISSAI 705). Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ndikuar në dhënien e opinionit të modifikuar, referuar çështjeve të mëposhtme:

a) Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik nuk ka kryer inventarizimin fizik të gjitha godinave të cilat janë në administrim të saj dhe nuk ka përditësuar vlerat e tyre në Pasqyrat financiare të subjektit.

b) Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik nuk ka zbatuar normën e amortizimit për kategorinë e aktiveve në përputhje me normat e përcaktuara. DSHTD ka llogaritur amortizim për ndërtesat në masën 2% të vlerës së asetit në fillim të vitit ushtrimor, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar i cili përcakton se kosto e ndërtesave amortizohet me normën 5%.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik**

Strukturat drejtuese të subjekti Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objekti i auditimit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

#### **Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i Modifikuar/ kualifikuar)<sup>3</sup>**

Në përputhje me programin e auditimit, grupi i auditimit ka audituar përputhshmërinë mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, mbi zbatimin e legjislacionit për realizimin, ekzekutimin dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, për të vlerësuar nëse çdo aspekt

<sup>3</sup> Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, vendimin nr. 24, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.2. **Konkluzionet/ opinionet e kualifikuara:** Kur audituesi ka raste mospërputhesh materiale por jo të përhapura, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të modifikuar: Në rastin e angazhimit me siguri të arsyeshme, që informacioni mbi çështjen dhe objektin e auditimit është përgatitur në çdo aspekt material në përputhje me kriteret e vlerësimit.

material, është në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin mbi të cilën ushtron veprimtarinë DSHTD, të përshkruar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, ku është siguruar evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, shprehur në vlerën e dëmeve ekonomike prej 263,724 lekë me tvsh dhe shpenzimeve të konsideruara pa efektivitet prej 162,278,339 lekë dhe 33,749.9 euro.

#### **Baza për kufizimin e sigurisë të opinionit të përputhshmërinë**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë” si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, Kodi Etik i KLSH miratuar me vendimin nr. 56, datë 30.04.2015. Dokumentacioni administrativ, procedurat prokuruese, janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të vendimmarrjes nga DSHTD, me kriteret e parashikuara.

Nga auditimi i përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i DSHTD, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatuan edhe disa të meta e parregullsi, të konsideruara ***materiale dhe jo të përhapura, për të cilën japim opinion të kualifikuar.***

#### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:**

Drejtimi i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

#### **Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të DSHTD, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues të personave me liri të kufizuar.

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. Hyrja.**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1176/1, datë 13.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik, nga data 10.01.2023 deri më 14.04.2023, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B. B. (përgjegjës grupi),
2. A. Z., anëtar,
3. A. Xh., anëtar.

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

**1. Objekti i auditimit** është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.

**2. Qëllimi i auditimit** është, vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve.

### **3. Identifikimi i çështjes:**

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik (D.SH.T.D) është person juridik, publik, në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që ushtron veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjen shtetërore”. Objekti i veprimtarisë së DSHTD-së është administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, pronë shtetërore të ndodhura në territorin e R.SH-së dhe jashtë saj, të cilat janë nën përgjegjësi administrimi nga kjo drejtori. Siguron kushte të përshtatshme qëndrimi dhe ushtrimi të veprimtarisë së Trupit Diplomatik të akredituar në RSH-së, si dhe trupit diplomatik të RSH-së të akredituar jashtë vendit.

Plotësimi i kërkesave për mjedise pune dhe ambiente komode banimi për Përfaqësitë e huaja dhe Trupin Diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë si Ambasada e Gjermanisë, Ambasada e Francës, Ambasada e Republikës Popullore të Kinës, Ambasada Bullgare, Ambasada e Republikës Sllovaqe, zyra e përfaqësimit të Ambasadës Algjeriane, në godinat pronë e shtetit shqiptar të administruara nga DSHTD-ja, në rrugën “Skënderbej”.

Plotësimi i kërkesave për mjedise pune të organizatave, projekteve dhe fondacioneve të huaja, të rëndësishme, të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, siç janë: UN Women, Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë (DIHA), USAID, Swiss Contact, Fondacioni Mary Ward Loreto. Si dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e ambasadave (godinat) pronë e shtetit shqiptar në administrim të DSHTD-së në New York, Uashington, Stokholm, Bruksel, Athinë dhe Romë.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1176/1, datë 13.01.2023.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik është përgjegjëse për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, procedurat e qiradhënies, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e pronave të shtetit shqiptar në administrim të DSHTD.

### **5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të DSHTD-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit, ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbytjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **6. Kriteret e vlerësimit:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr.44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”;
- Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njërive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr.285 datë 19.05.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”;
- VKM nr.840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, i ndryshuar;
- VKM nr.450 datë 16.06.2005 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, i ndryshuar;
- VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar;
- Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike” i ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Udhëzim Nr.2 datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”;
- Udhëzim nr. 6, datë 3.9.1992, Për zbatimin e ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”;
- Statuti i miratuar nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme në Janar 2011 sipas shkresës me nr. prot. 1842, datë 17.02.2011;
- Rregullore e Brendshme miratuar me VKD nr. 12, dt. 29.06.2018.

## **7. Standardet e Auditimit**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;
- ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë;
- Libri Jeshil i GAO-s;
- ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”.
- Manuali i auditit financiar dhe të Përputhshmërisë.

## **8. Metodatat e auditimit**

Auditimi ynë përfshin përputhshmërinë e aktivitetit të DSHTD, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të

buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, procedurat e qiradhënies, procedurat e prokurimeve dhe investimeve duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e pronave të shtetit shqiptar në administrim të DSHTD.

## **9. Dokumentimi i auditimit**

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë është realizuar, në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), mbështetur në ISSAI-n 10 “*Deklarata e Meksikës*”, mbi Pavarësinë e (SAI), si dhe ISSAI 30 Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së si dhe Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017, e ndryshuar me Vendimin nr.63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

Grupi i audituesve, *për të realizuar objektin e auditimit*, për dhënien e opinionit financiar dhe të përputhshmërisë e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik u fokusua mbi zbatimin në mbështetje të kuadri rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat mbi zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, procedurat e qiradhënies, prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e pronave të shtetit shqiptar në administrim të DSHTD, në zbatim të Ligjit organik të KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Ligjit 10296, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.*”, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Ligji nr.162/2020 datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, “*Për Ndërmarrjet Shtetërore*”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, VKM nr.285 datë 19.05.2020 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar; VKM nr. 918, datë 29.12.2014 “*Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike*”, VKM nr.840, datë 17.12.2004 “*Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik*”, i ndryshuar; VKM nr.450 datë 16.06.2005 “*Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik*”, i ndryshuar, VKM nr.54, datë 05.02.2014 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore*”, i ndryshuar, Udhëzimin e APP-së nr. 2, datë 27.01.2015 “*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik*”, udhëzimin e APP-së nr. 2 datë 08.01.2018 “*Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike*” i ndryshuar.

### **III. PËSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin**

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik (D.SH.T.D) është person juridik, publik, në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që ushtron veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjen shtetërore”. Objekti i veprimtarisë së DSHTD-së është administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive të luajshme dhe të paluajshme, pronë shtetërore të ndodhura në territorin e R.SH-së dhe jashtë saj, të cilat janë nën përgjegjësi administrimi nga kjo drejtori. Siguron kushte të përshtatshme qëndrimi dhe ushtrimi të veprimtarisë së Trupit Diplomatik të akredituar në RSH-së, si dhe trupit diplomatik të RSH-së të akredituar jashtë vendit.

Plotësimi i kërkesave për mjedise pune dhe ambiente komode banimi për Përfaqësitë e huaja dhe Trupin Diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë si Ambasada e Gjermanisë, Ambasada e Francës, Ambasada e Republikës Popullore të Kinës, Ambasada Bullgare, Ambasada e Republikës Sllovaqe, zyra e përfaqësimit të Ambasadës Algjeriane, në godinat pronë e shtetit shqiptar të administruara nga DSHTD-ja, në rrugën “Skënderbej”.

Plotësimi i kërkesave për mjedise pune të organizatave, projekteve dhe fondacioneve të huaja, të rëndësishme, të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, siç janë: UN Women, Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë (DIHA), USAID, Swiss Contact, Fondacioni Mary Ward Loreto. Si dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e ambasadave (godinat) pronë e shtetit shqiptar në administrim të DSHTD-së në New York, Uashington, Stokholm, Bruksel, Athinë dhe Romë.

#### **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

##### **2.1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, u konstatua se: Bazuar në Ligjin nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, neni 10, pika 1, në Statutin e DSHTD-së, neni 11, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik paraqet raportin mbi realizimin e treguesve ekonomik-financiar dhe pasqyrat financiare për vitin 2020, si më poshtë:

Veprimtaria ekonomiko-financiare e DSHTD-së, gjatë vitit 2020 është shoqëruar me dokumentacionin përkatës, i cili është evidentuar dhe azhornuar në programin financiar duke paraqitur të dhënat periodike dhe vjetore të llogarive kontabël të DSHTD-së.

Mbyllja e llogarive vjetore është bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, në ligjet fiskale dhe në udhëzuesin nr.2, datë 04.02.2014 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal” të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore” Pasqyrat financiare 2020 të DSHTD-së, janë verifikuar dhe certifikuar nga eksperti kontabël, z. L. K., si përfaqësues i shoqërisë së auditimit “I.”, i miratuar nga MEPJ me shkresën nr. prot 1525/1, dt. 19.03.2021, protokolluar me nr. prot 112/1, dt. 19.03.2021, me raportin final të dorëzuar në DSHTD me nr. prot.112/4, datë 30.06.2021.

Me shkresën nr. 889 datë 29.08.2016, është miratuar Udhëzimi metodik për shqyrtimin, hartimin dhe miratimin e planit ekonomik financiar të DSHTD-së, ku përcaktohen se planifikimi i programit do të bëhen në tre rrafshë, plan afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër. Për çdo vit janë hartuar plan masash dhe detyrat për çdo sektor për realizimin e planit vjetor dhe afatet. Rezulton se janë hartuar plane strategjike afatmesme dhe afatgjata.

##### **Planifikimi i buxhetit 2020**

- Me urdhër të Drejtorit të DSHTD nr. 217, dt. 24.09.2019 është ngritur grupi i punës për planifikimin e treguesve ekonomik – financiar për vitin 2020.
- Me shkresën nr. Prot. 920, dt. 24.09.2019 është miratuar nga Drejtori i DSHTD plani i masave për hartimin e planit ekonomik – financiar për vitin 2021.
- Në vijim DSHTD i ka kërkuar informacion misioneve diplomatike në lidhje me kërkesat e tyre për investime dhe shërbime, konkretisht:
  1. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Itali me shkresën nr. prot. 972, dt. 01.10.2019.



2. Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian me shkresën nr. prot. 973, dt. 01.10.2019.
  3. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi me shkresën nr. prot. 974, dt. 01.10.2019.
  4. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Stokholm me shkresën nr. prot. 975, dt. 01.10.2019.
  5. Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri me shkresën nr. 977, dt. 01.10.2019
  6. Ambasadës së Republikës Franceze në Shqipëri me shkresën nr. 980, dt. 01.10.2019
  7. Ambasadës së Republikës së Sllovakisë në Shqipëri me shkresën nr. 978, dt. 01.10.2019
  8. Ambasadës së Republikës së Bullgarisë në Shqipëri me shkresën nr. 981, dt. 01.10.2019
  9. Ambasadës së Republikës së Greqisë në Shqipëri me shkresën nr. 976, dt. 01.10.2019
  10. Ambasadës së Republikës së Popullore të Kinës në Shqipëri me shkresën nr. 982, dt. 01.10.2019
  11. Zyrës së Përfaqësimit të Ambasadës Algjeriane në Shqipëri me shkresën nr. 979, dt. 01.10.2019.
- Në vijim të kërkesave të DSHTD – së, 7 prej subjekteve të mësipërme kanë paraqitur kërkesat e tyre për investime dhe shërbime mirëmbajtje për godinat e Ambasadave dhe të banesave.
  - DSHTD nga ana e saj ka organizuar inspektime nga grupet e punës për të vlerësuar nevojën për investime në objektet që kanë depozituar kërkesa si dhe duke u bazuar në historikun e godinës ka përcaktuar investimet që do të merren përsipër.
  - Sektori i administratës dhe zbatimit nëpërmjet specialistëve preventivues, për investimet që vendosen për t'u kryer në godinat brenda vendit, si dhe bazuar në manualin teknik, ka hartuar preventivat, ka llogaritur bazën materiale dhe orët e punës për investimet dhe mirëmbajtjen për godinat brenda vendit që do të kryhen me punëtorët e DSHTD.
  - Gjithashtu departamentet e administratës së DSHTD – së kanë depozituar kërkesat e tyre në lidhje me shpenzimet administrative, lëndë djegëse, për riparim dhe mirëmbajtje automjesh, furnitura dhe shërbime të ndryshme, si dhe gjithë zërat e tjerë të shpenzimeve të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes.
  - Me urdhër të Drejtorit nr. 261, dt. 03.12.2019 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, përllogaritjen fondin limit për çdo grup malli dhe përcaktimin e procedurave të prokurimit publik.
  - Grupi i punës me shkresën nr. 1157/3, dt. 19.12.2019 dhe shkresën nr. 1157/4, dt. 19.12.2019 ka përcjellë procesverbalet mbi testimin e tregut, përllogaritjen fondin limit për çdo grup malli dhe përcaktimin e procedurave të prokurimit publik.
  - Me urdhër të Drejtorit nr. 238, dt. 07.11.2019 është ngritur grupi i punës për studimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve të vëna në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaja. Në vijim grupi i punës me shkresën nr. 1085/1, dt. 18.11.2019 ka paraqitur pranë Drejtorit të DSHTD – së informacionin mbi tarifën e dhënies me qira të objekteve në administrim të DSHTD – së.
  - Sektori i planifikimit dhe financës me shkresën nr. 1085/2, dt. 20.11.2019 ka paraqitur në Këshillin Drejtues relacionin për miratimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve në administrim të DSHTD – së.
  - Me vendim të KD nr. 29, dt. 20.11.2019 janë miratuar tarifën e dhënies me qira të objekteve në administrim të DSHTD – së për vitin 2020.

**Gjetje 1:** Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk i është drejtuar Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së New York dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Uashington me kërkesat mbi nevojat e tyre për investime në godinat ku ushtrojnë veprimtarinë. DSHTD ka planifikuar fonde për këto godina duke u bazuar në historikun e tyre dhe jo në nevojat reale për investime dhe mirëmbajtje.

**Gjetje 2:** Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Itali me shkresën 1228/1, dt. 27.12.2019 ka depozituar në DSHTD kërkesën për punime shtesë në godinën e Ambasadës dhe apartamenteve të diplomatëve. Kjo kërkesë është bërë pas përfundimit të procesit të planifikimit të planit ekonomik

financiar për vitin 2020, duke krijuar vështirësi për DSHTD – në për kryerjen e procedurave verifikuese nga institucioni mbi nevojën për këto investime si dhe koston e tyre.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 16.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Prendimet e Subjektit:** Plani ekonomik-financiar 2020 është miratuar me VKD nr.1, dt 06.01.2020. Në këtë plan, për Ambasadën e R.SH në Romë, është parashikuar një fond për investime prej 90,000 €, duke u bazuar në fazën e dytë të zbatimit të projektit të miratuar sipas preventivave të paraqitura nga “A.”, si dhe në nevojën për disa punime shtesë bazuar në shkresën me nr. prot. 1228/1, dt. 27/12/2019. Këto punime nuk ishin përfshirë në preventivin paraprak të të gjitha fazave të projektit të paraqitur nga “A.”, por duke marrë parasysh edhe kërkesën nga ana e diplomatëve atje, për përfshirjen e këtyre punimeve shtesë në planin e investimeve të vitit 2020, u pa e arsyeshme të planifikohen bashkërisht me punimet e fazës së dytë të projektit. Si përfundim, vlera e plotë e investimeve për punimet e fazës së dytë të projektit të miratuar së bashku me punimet shtesë të kërkuara nga ana e diplomatëve atje, në godinën e Ambasadës Romë për vitin 2020, shkon në 90,000 €.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Komentet nga subjekti nuk e ndryshojnë gjendjen e evidentuar nga grupi auditues për periudhën e auditimit dhe observacioni **nuk merret në konsideratë.**

**Gjetje 1:** Grupet e punës të cilat kanë kryer inspektimet mbi nevojat për investime të godinave brenda dhe jashtë vendit në administrim të DSHTD – së nuk kanë paraqitur procesverbalet mbi konstatimet e tyre sa i përket verifikimit të kërkesave për investime.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Prendimet e Subjektit:** Grupet e punës së DSHTD, që inspektojnë nevojat për investime në godinat jashtë vendit, gjithmonë mbajnë një akt rakordim (procesverbal) midis dy palëve, ku shprehin dakordësinë për kryerjen e punimeve të detajuara me zëra, që kërkohen të kryhen nga Ambasada.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Observacioni i subjektit nuk paraqet dokumentacion shtesë për të argumentuar qëndrimin e tyre dhe për këtë arsye **nuk merret në konsideratë.**

### **Ndryshimet buxhetore për vitin 2020**

Gjatë vitit 2020 me Vendime të Këshillit Drejtues, janë bërë disa ndryshime në Planin ekonomik-financiar 2020, bazuar në nevojën për shpenzime dhe investime të domosdoshme, por të paparashikuara në fazën e hartimit të projekt planit. Konkretisht:

- Me VKD nr. 12, dt. 28.05.2020 është miratuar shtesë e fondit për provigjione për klientë dhe shpenzime gjyqësore;
- Me VKD nr. 19, dt. 01.09.2020 është miratuar fondi shtesë për mbulimin e shpenzimit për udhëtime, fjetje e dieta për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të MEPJ, që do të dërgohen me detyrë në New York për zhvillimin e pronës shtetërore të shtetit shqiptar, tokë truall dhe ndërtesë të ndodhur në Manhattan Upper East Side, sipas përcaktimeve të VKM nr.203, datë 26.02.2020 dhe të Urdhrit nr.208, datë 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ.

### **Realizimi buxhetor për vitin 2020:**

DSHTD me shkresën nr. prot. 776, dt. 22.09.2021 ka raportuar në MEPJ mbi realizimin e treguesve ekonomik – financiar dhe pasqyrave financiare për vitin 2020. Realizimi buxhetor për vitin 2020 paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1.

Në lekë

Drejtoria e Shërbimit Trupit Diplomatik				
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE VITI 2020				
Nr.	Emërtimi	Plani 2020	Fakti 2020	% realizuar
I	TE ARDHURAT	211,504,476	208,961,616	99%

1	Qira	190,807,014	191,955,344	101%
2	Prodhimi i AAM brenda vendit	18,537,832	13,977,426	75%
3	Te ardhura te tjera shërbime			
4	Te ardhurat nga interesat ,kursi këmb.	190,000	360,047	189%
5	Te ardhura te tjera financ (A.)	1,969,630	2,668,799	135%
<b>II</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>172,738,551</b>	<b>144,909,207</b>	<b>84%</b>
1	Paga personeli	40,100,000	39,719,016	99%
3	Sigurime shoqërore	6,700,000	6,480,300	97%
4	Sigurim objektsh (brenda dhe jashtë)	2,000,000	2,219,628	111%
5	Dokumentacion dhe Sigurim automjetesh	360,000	189,000	53%
6	Sigurim punonjësish	50,000	6,248	12%
7	Taksa vendore	7,000,000	6,984,585	100%
8	Tatime dhe taksa te tjera	100,000	43,220	43%
9	Udhëtime e dieta	4,524,000	3,842,604	85%
10	Energji	2,000,000	1,572,751	79%
11	detyrimi 30% i subjekteve vendase	2,500,000	2,559,803	102%
12	Poste, telefon, internet	900,000	618,945	69%
13	Materiale për invest. e mirëmb.	20,000,000	12,787,663	64%
14	Lende djegëse dhe karburant	20,000,000	18,523,376	93%
15	Shpenzime administrat + flet zyrt etj	240,000	133,550	56%
16	Mirëmbajtje e riparim ndryshme mjetesh	360,000	343,800	96%
17	Furnitura nëntrajtime dhe shërbime	5,150,000	3,687,442	72%
18	Shërbime bankare dhe këmbim valutor	1,000,000	438,336	44%
19	Amortizimi	50,000,000	37,742,638	75%
20	Konsumi i inventarit te imët	1,500,000	953,719	64%
21	Shpenzime publicitet, pritje, dhurata dhe festa zyrtare	600,000		0%
22	Mirëmbajtje e programit financiar	280,000	72,040	26%
23	Ekspert kontabël	640,000	637,200	100%
24	Të tjera	3,150,000	1,929,485	61%
25	Gjoha dhe dëmshpërblime		128,882	
26	Provizione për klientët dhe shp gjyqësore	3,234,551	3,186,976	99%
27	Rivlerësimi i pallatit Nr.57	350,000	108,000	31%
	<b>Fitimi (Humbja) para tatimit</b>	<b>38,765,925</b>	<b>64,052,408</b>	<b>165%</b>
	<i>Tatim Fitimi</i>	<i>5,814,889</i>	<i>10,105,240</i>	<i>174%</i>
	<b>Fitimi Neto (Humbja)</b>	<b>32,951,035</b>	<b>53,947,168</b>	<b>164%</b>

Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit

## Treguesit ekonomik –financiar të krahasuar me planin e vitit 2020 janë:

### a. Të ardhurat u realizuan 99%.

1- Të ardhurat, pjesën më të madhe të të cilave e zënë të ardhurat nga qiratë, janë realizuar në masën 101%.

Gjatë vitit 2020 janë zbatuar tarifat e qirasë bazuar në VKD nr. 29, datë 20.11.2019. Për disa subjekte ka pasur reflektim të tarifave të qirasë me qëllim unifikimin e këtyre tarifave për të gjithë subjektet qiramarrëse, miratuar me VKD nr. 15, datë 24.06.2020, si më poshtë:

- Tarifa e qirasë për subjektin M. shpk, për ambientin në katin përdhe të pallatit nr. x me sipërfaqe 77.7 m2 do të jetë 7 euro /m2 nga 4 euro/m që ishte.

- Tarifa e qirasë për subjektin "Sh.", për ambientin në katin përdhe të pallatit nr. x, me sip 108 m2, do të jetë 7 euro/ m2 nga 6 euro/ m2 që ishte.

- Tarifa e qirasë për subjektin U., për apartamentin nr. 29, 30,31, në pallatin nr. x, shkalla nr.x, do të jetë 6.5 euro/m2 për periudhën nga 01.09.2020 deri më 31.12.2020 dhe 7 euro/m2 për periudhën nga 01.01.2021 deri më 30.08.2021.

Tarifat e reja të qirasë kanë hyrë në fuqi në datat respektive të përfundimit të kontratave përkatëse.

Për vitin 2020 janë rinovuar në vazhdimësi 75 kontrata qiraje, ndërsa 8 kontrata qiraje nuk janë rinovuar, por janë lidhur kontrata të reja me subjekte të tjera.

2- Të ardhurat nga prodhimi i aktiveve afatgjata materiale paraqiten me realizim 75% ose në vlerë absolute 4,560,406 lekë më pak se planifikimi. Në mosrealizimin e të ardhurave sipas specialistëve të DSHTD-së kanë ndikuar:

a. Mos kryerja e investimeve të planifikuara në disa apartamente, për shkak të kufizimeve dhe masave shtrënguese nga pandemia e Covid 19, sidomos në 6-mujorin e parë 2020.

Konkretisht, përfaqësuesja e A.K., nëpërmjet një email-i elektronik të dërguar në datën 22.07.2020, me nr. prot.637 informon DSHTD se punimet e planifikuara në Planin e Investimeve të vitit 2020, në apartamentet e marra me qira nga diplomatët k., duhet të shtyhen për një periudhë tjetër më të përshtatshme, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia dhe në kuadër të masave parandaluese për përhapjen e Covid 19.

Në apartamentet që përdoren nga A.K. ishin planifikuar investimet si më poshtë vijon:

- Apartamenti 4/1/8 vlera e investimit të planifikuar 2,572,405 lekë
- Apartamenti 4/1/16 vlera e investimit të planifikuar 2,572,405 lekë
- Apartamenti 8/1/7 vlera e investimit të planifikuar 1,594,977 lekë

Gjatë 6-mujorit të dytë 2020 DSHTD-ja i përdori fondet e planifikuara për apartamentet e listuara më sipër për të kryer investime në disa apartamente të cilat nuk ishin përfshirë në planin vjetor të shpenzimeve, konkretisht:

- Apartamentet 6.2.15 dhe 8.3.27, me fondin e planifikuar për apartamentin 4.18 prej 2,572,405 lekë.

b. Prokurimi i materialeve që u përdorën për të kryer investimin, në vlera më të vogla se sa ishin planifikuar.

**Gjetje 3:** Konstatohet se mosrealizimi i plotë i të ardhurave nga prodhimi i AAM për shkak të prokurimit të materialeve në vlera më të vogla nga sa ishin planifikuar është një fenomen që përsëritet vit pas viti në DSHTD. Gjithashtu në raportin e fundit të auditimit të KLSH-së është evidentuar se për vitin 2018 dhe 2019 mosrealizimi i të ardhurat nga AAM është ndikuar nga fakti se vlerat e materialeve janë parashikuar në nivele më të ulëta se fakti.

3- Të ardhura nga interesat dhe kursi i këmbimit në vlerën 360,047 lekë, përfaqëson fitim/humbjen nga kursi valutator.

4- Të ardhura të tjera financiarë kanë superuar parashikimin dhe kanë një realizim prej 135%. Kjo situatë vjen për arsye se gjatë vitit financiar 2020, shoqëria e sigurimit A. ka rimbursuar DSHTD-së shumën 2,668,799 lekë, si pjesë e marrëveshjes për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i Nëntorit 2019 në godinat pronë e DSHTD-së të cilat kanë qenë të siguruara në këtë kompani.

#### **b. Shpenzimet u realizuan në masën 84 % në krahasim me planin.**

-Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit janë realizuar në masën 99% dhe 97% respektivisht. DSHTD në vitin 2020 ka 58 punonjës.

- “Shpenzime për sigurime objektësh (brenda dhe jashtë vendit)” janë realizuar në masën 111%. Shkak i tejkalimit të shpenzimit në vlerë absolute 219,628 lekë është kryesisht ndryshimi i kursit të këmbimit për siguracionet e objekteve të cilat ndodhen jashtë vendit.

- Shpenzimet për sigurime automjetësh dhe paraqiten me realizim të ulët konkretisht 12 % për shkak se sipas institucionit është planifikuar me rezervë për shkak se siguracionet e mjeteve janë të ndryshueshme gjatë viteve.

- Shpenzimet për sigurime punonjësish paraqiten me realizim të ulët konkretisht 12 % për shkak se ky zë përfaqëson shpenzimet e planifikuara për mbulimin e siguracionit të jetës dhe shëndetit të punonjësve të DSHTD – së të cilët shkojnë me shërbim jashtë vendit në kuadër të zbatimit të punimeve në godinat e Ambasadave të R.SH jashtë vendit. Në kushtet e pandemisë Covid – 19 gjatë vitit 2020 nuk janë realizuar pjesa më e madhe e punimeve të planifikuara në godinat jashtë vendit dhe si rrjedhojë nuk ka qenë e nevojshme të kryhej sigurimi i punonjësve jashtë vendit.

- Tatime dhe taksa të tjera mbulon shpenzimin për taksat vjetore të automjeteve të DSHTD – së dhe paraqiten me realizim të ulët, konkretisht 43% për arsye se planifikohet me rezerve për shkak se taksat e mjeteve janë të ndryshueshme gjatë viteve.

- Zëri “Udhëtime e dieta” ka pasur një planifikim fillestar në vlerën 2,000,000 lekë, por pas ky fond është shtuar me VKD nr.19, dt. 01.09.2020 duke kapur vlerën 4,524,000 lekë.

Kjo shtesë është kryer për efekt të mbulimit të shpenzimeve për udhëtime, fjetje e dieta për anëtarët

e Komisionit të Vlerësimit të MEPJ, të cilët do të dërgohen me detyrë në New York për zhvillimin e pronës shtetërore të shtetit shqiptar, tokë truall dhe ndërtesë të ndodhur në Manhattan Upper East Side, sipas përcaktimeve të VKM nr.203, datë 26.02.2020 dhe të Urdhrit nr.208, datë 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ.

Realizimi i këtij zëri është 85%, për shkak të mospërdorimit të plotë të fondit si rezultat i moskryerjes së investimeve në godinat e Ambasadave të R.SH jashtë vendit, për shkak të pandemisë Covid 19.

- Realizimi i shpenzimit për energjinë elektrike paraqitet i moderuar në masën 79%.

- “Detyrimi 30% i subjekteve vendase” ka një realizim 102% nga 2,500,000 lekë i planifikuar në 2,559,042 lekë i realizuar. Tejkalimi i planifikimit vjen si rrjedhojë e rritjes së numrit të subjekteve vendase si subjekte qiramarrëse gjatë vitit 2020. Konkretisht gjatë vitit 2020 subjektet vendase janë paraqitur në tabelë 1 aneksin III. Konstatohet një mospërputhje në vlerën 10,800 lekë ndërmjet vlerës së raportuar në raportin e realizimit të treguesve ekonomiko-financiar kryesor për vitin 2020 dhe vlerës së derdhur në buxhetin e shtetit për shkak të një klasifikimi në klasën e gabuar të shpenzimeve të vlerës 10,800 lekë në sistemin e kontabilitetit.

- Zëri “Materiale për investim dhe mirëmbajtje” ka një mosrealizim në vlerë absolute në masën 7,212,337 lekë duke shënuar një realizim faktik rreth 12.8 milion lekë nga 20 milion lekë të planifikuara, ose 64%. Kjo për shkak se nuk janë kryer investimet e planifikuara në disa apartamente për shkak të kufizimeve dhe masave shtrënguese nga pandemia e Covid 19, sidomos në 6-mujorin e parë 2020; si dhe si rrjedhojë e prokurimit të materialeve që u përdorën për të kryer investimin, në vlera më të vogla se sa ishin planifikuar.

- Shpenzimet për lëndë djegëse dhe karburant kanë një realizim rreth 18,523,376 lekë nga 20 milion lekë të planifikuar ose 1,476,624 lekë më pak se planifikimi. Realizimi i këtij shpenzimi në masën 93% ka ardhur kryesisht si rezultat i uljes së çmimit të bursës sipas Reuters për lëndët djegëse në kushtet e pandemisë Covid 2019, pasi sasia e konsumuar është pothuaj në trendin historik të konsumit vjetor.

Gjatë viti 2020 janë konsumuar **69,500 litra** nga OE “T.”, e cila bazuar në Akt marrëveshjen me nr. prot. 467/5, dt. 27.12.2019 “Marrje në ruajtje mall solar” ka lëshuar faturën tatimore me nr.312 dt. 27.12.2019 për sasinë totale 69,500 lt në vlerën 10,682,845 lekë me tvsh, paguar me disa këste sipas blerjeve si më poshtë:

- 14,400 litra në vlerën 2,213,424 lekë me dt. 15.01.2020
- 14,400 litra në vlerën 2,213,424 lekë me dt. 27.01.2020
- 14,400 litra në vlerën 2,213,424 lekë me dt. 11.02.2020
- 14,400 litra në vlerën 2,213,424 lekë me dt. 02.03.2020
- 11,900 litra në vlerën 1,829,149 lekë me dt. 17.03.2020

Gjatë vitit 2020 janë blerë nga OE “R.” 135,000 litra solar bazuar në kontratën me nr. prot 334/6 dt. 05.05.2020 përkatësisht nga:

**65,850 litra** sipas faturave si më poshtë vijon:

- Fatura me nr. 96, dt. 12.05.2020 për 13,700 litra në vlerën 1,304,498 lekë likuiduar me dt. 18.05.2020
- Fatura me nr. 132 dhe 133, dt. 27.07.2020 për 16,000 litra në vlerën 1,793,568 lekë likuiduar me dt. 30.07.2020
- Fatura me nr. 194, dt. 06.11.2020 për 13,700 litra në vlerën 1,462,289 lekë likuiduar me dt. 10.12.2020
- Fatura me nr. 10, dt. 14.12.2020 për 15,050 litra në vlerën 1,620,343 lekë likuiduar me dt. 17.12.2020
- Fatura me nr. 28.12.2020 për 7,400 litra në vlerën 820,512 lekë likuiduar me dt. 29.12.2020
- Fatura me nr. 7, dt. 29.12.2020 për 69,150 litra në vlerën 7,664,033 leke me tvsh nga OE “R.” bazuar ne Akt marrëveshjen me prot nr.1047/1 dt. 29.12.2020 "Marrje në ruajtje lëndë djegëse....", e likuiduar gjatë vitit 2021.

**Konstatim 2:** Gjatë auditimit konstatohet se në kontratën e furnizimit me lëndë djegëse solar me nr. prot 334/6 dt. 05.05.2020 me OE “R.”, gjendja e mbetur e solarit, e pa lëvruar në fund të kontratës përkatësisht 69,150 litra është faturuar nga operatori ekonomik me një faturë të vetme në fund të vitit 2020 në faturën nr. 7, datë 29.12.2020 në vlerën 7,664,033 lekë bazuar në aktmarrëveshje midis DSHTD dhe Kontraktuesit, për sasinë e palëvruar të lëndës djegëse nga operatori dhe të pa marrë ende në dorëzim nga DSHTD.

- Shpenzime publicitet, pritje, dhurata dhe festa zyrtare nuk janë realizuar për shkak se praktika është anuluar.

- Shpenzime “Të tjera” është e detajuar si më poshtë vijon. Realizimi i këtij zëri në nivelin 61.3% vjen si rezultat kryesisht i anulimit të udhëtimit turistik planifikuar të kryhej në vitin 2020 në vlerën 800.000 lekë.

Tabela nr. 2

	Në lekë		
	Plani 2020	Fakti 2020	% e realizimit
1-Blerje veshje pune edhe uniforma	240,000	166,800	69.5%
2- Rimbushje vjetore fikse zjarri e kontroll	100,000	96,000	96%
3-Udhëtim Turistik	800,000	0	0%
4-Shërbime higjeno-sanitare	180,000	117,780	65.4%
5-Mirëmbajtje e faqes zyrtare të DSHTD-së	120,000	109,200	91%
6-Lule sipas stinëve & Materiale për mirëmbajtje lulishteje	350,000	358,800	102.5%
7-Vinç prerje pemësh plus transport dispozicion	200,000	195,480	97.7%
8-Materiale të paparashikuara	960,000	864,018	90%
9-Tarifë pagese për depozitim mbeturinash	200,000	21,407	10.7%
<b>TOTALI</b>	<b>3,150,000</b>	<b>1,929,485</b>	<b>61.3%</b>

Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit

### **Investimet për objektet pronë e DSHTD-së jashtë vendit**

Me ndryshimet që iu bënë Planit të investimeve 2020 për objektet pronë e DSHTD jashtë vendit, me disa Vendime të Këshillit Drejtues të DSHTD-së, realizimi i investimeve në godinat jashtë vendit për 2020 paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3

Nr.	INVESTIMET NE AMBASADAT JASHTE VENDIT PER VITIN 2020	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT	Realizimi në %
		EURO	EURO	USD	USD	
1	Ambasada ne Rome	6,580	6,000			91.18 %
2	Ambasada ne Stokholm	5,000	1,500			30 %
3	Ambasada ne Bruksel	5,000				0 %
4	Ambasada ne Athine	25,000	28,556			114.22 %
5	Misioni i Përhershëm Rsh-së Pranë Okb-së New York			85,000	49,450	58.17 %
6	Ambasada ne Uashington			10,000		0 %
<b>TOTALI</b>		<b>41,580</b>	<b>36,056</b>	<b>95,000</b>	<b>49,450</b>	

Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit

Viti 2020 është viti kur pandemia Covid 19 pati ndikimin e saj më të madh duke sjellë mosrealizimin e investimeve të planifikuara në godinat jashtë vendit. Gjatë 2020 u bë i mundur kryerja e investimit të planifikuar vetëm në mesin e Ambasadës në Athinë, ndërsa në Itali investimi prej 90,000 euro i planifikuar për fazën e dytë të projektit 3 vjeçar, u anulua për shkak të mbylljes së vendit për shkak të pandemisë Covid - 19.

Fondi i investimit i anuluar për Ambasadën në Romë, u përdor për shtesën e Planit të investimit për mesin e Misionit New York, në kuadër të zhvillimit të pronës shtetërore të shtetit shqiptar, tokë truall dhe ndërtesë të ndodhur në Manhattan Upper East Side, sipas përcaktimeve të VKM nr.203, datë 26.02.2020 dhe të Urdhrit nr.208, datë 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ.

Gjatë vitit 2020, në saj të bashkëpunimit me MEPJ dhe Ambasadën në Romë, u bë i mundur sigurimi i dokumentit zyrtar të pronësisë së 10 apartamenteve në Romë, dhe me Urdhër të përbashkët nr. 613 datë 21.12.2020 të MEPJ dhe nr. 529/5 datë 21.12.2020 të DSHTD, u krye kalimi kapital i inventarit për apartamentet në Romë në emër të DSHTD-së, me vlerën kadastrale të

tyre 125,184,658 lekë, reflektuar kjo në aktivet afatgjata të DSHTD-së. Të detajuar investimet në godinat jashtë vendit paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr. 4

Nr.	Investimet ne Ambasadat jashtë vendit për vitin 2020	Objekti	Realizim	Realizim
			EURO	USD
I	Ambasada ne Rome	rinovim tualeti+eliminim lagështie ne zyrën e ambasadores	2,900	
		punime emergjente ne zyrën e konsullore ne godinën e ambasadës	3,100	
	<b>TOTALI</b>		<b>6,000</b>	
II	Ambasada ne Stokholm	pajisja me interfoni të zyrës së re konsullore në godinën e Ambasadës	1,500	
	<b>TOTALI</b>		<b>1,500</b>	
III	Ambasada ne Bruksel		0	
	<b>TOTALI</b>		<b>0</b>	
IV	Ambasada ne Athine	përmirësimi i sistemit elektronik te numrave te radhës ne ambasade dhe vendosja e stolave ndenjes dhe lodrave	4,319	
		punime ne godinën e ambasadës	24,179	
	<b>TOTALI</b>		<b>28,498</b>	
V	Misioni i Përhershëm Rsh-së Pranë Okb-së New York	Shërbimi i konsulencës ligjore për kryerjen e procedurave në lidhje me investimin për zhvillimin e pronës shtetërore tokë truall dhe ndërtesë në New York.		40,000
		punime ne ap.4B ne godinën e misionit		2,200
		riparimin e sistemit të ngrohjes në ndërtesën e Misionit		7,250
	<b>TOTALI</b>			<b>49,450</b>
VI	Ambasada R.Sh Uashington			0
	<b>TOTALI</b>			<b>0</b>

Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit

**Gjetje 4:** Grupi i auditimit konstatoi se kryesisht për objektet jashtë vendit parashikohen fonde për punime të cilat cilësohen si të paparashikuara ose emergjente duke u bazuar në historikun e godinave, fonde të cilat në pjesën më të madhe të rasteve nuk realizohen në nivelin e plotë të tyre. Kjo metodë planifikimi krijon pengesa në përdorimin eficient dhe efektiv të fondeve pasi i ngurtëson ato në punime të cilat nuk kanë probabilitet të lartë realizimi.

*Drejtorja e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD është e detyruar të planifikojë fonde për raste emergjente në kuadër të investimeve në godinat jashtë vendit, sepse është në objektin e veprimtarisë së DSHTD mirëmbajtja e këtyre godinave. Gjithashtu DSHTD, me statusin e ndërmarrjes shtetërore, e cila nuk operon me fonde buxhetore, por me fondet e veta, ka lirshmërinë që nëpërmjet vendimmarrjes në Këshillin Drejtues, të rialokojë gjatë vitit fonde të papërdorura nga një zë/objekt në tjetrin. Po me statusin e një ndërmarrje shtetërore që operon me fonde jo buxhetore, fondet e DSHTD trashëgohen në llogaritë e saj bankare nga një vit në tjetrin, dhe nuk digjen në fund të vitit si në rastin e fondeve buxhetore.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Observacioni i subjektit nuk paraqet dokumentacion shtesë për të argumentuar qëndrimin e tyre dhe për këtë arsye **nuk merret në konsideratë.**

### **2.1.2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të DSHTD-së për vitin 2021.**

Veprimtaria ekonomiko-financiare e DSHTD-së, gjatë vitit 2021 është shoqëruar me dokumentacionin përkatës, i cili është evidentuar dhe azhurnuar në programin financiar duke paraqitur të dhënat periodike dhe vjetore të llogarive kontabël të DSHTD-së.

Mbyllja e llogarive vjetore është bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, në ligjet fiskale dhe në udhëzuesin nr.2, datë 04.02.2014 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal” të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, Pasqyrat financiare 2021 të DSHTD-së, janë verifikuar dhe certifikuar nga eksperti kontabël, znj. G. A., i miratuar nga MEPJ me shkresën nr. prot 1512/1, datë 16.06.2022, protokolluar në DSHTD me nr. prot 86/1, datë 16.06.2022, bashkëlidhur me raportin final të dorëzuar në DSHTD me nr. prot.86/3, datë 26.07.2022.

#### **Planifikimi i buxhetit 2021**

- Me shkresën nr. Prot. 783, dt. 18.09.2020 është miratuar nga Drejtori i DSHTD plani i masave për hartimin e planit ekonomiko – financiar për vitin 2021.
- Me urdhër të Drejtorit të DSHTD nr. 225, dt. 18.09.2020 është ngritur grupi i punës për planifikimin e treguesve ekonomiko – financiar për vitin 2021.
- Me shkresën nr. Prot. 783/2, dt. 18.09.2020 është miratuar nga Drejtori i DSHTD udhëzimi metodik për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit ekonomiko – financiar për vitin 2021.
- Në vijim DSHTD i ka kërkuar informacion misioneve diplomatike në lidhje me kërkesat e tyre për investime dhe shërbime, konkretisht:
  1. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Itali me shkresën nr. prot. 784, dt. 18.09.2020
  2. Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian në Bruksel me shkresën nr. prot. 785, dt. 18.09.2020
  3. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Stokholm me shkresën nr. prot. 786, dt. 18.09.2020
  4. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi me shkresën nr. prot. 787, dt. 18.09.2020
  5. Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri me shkresën nr. 788, dt. 18.09.2020
  6. Ambasadës së Republikës Franceze në Shqipëri me shkresën nr. 789, dt. 18.09.2020
  7. Ambasadës së Republikës së Sllovakisë në Shqipëri me shkresën nr. 790, dt. 18.09.2020
  8. Ambasadës së Republikës së Bullgarisë në Shqipëri me shkresën nr. 791, dt. 18.09.2020
  9. Ambasadës së Republikës së Greqisë në Shqipëri me shkresën nr. 792, dt. 18.09.2020
  10. Ambasadës së Republikës së Popullore të Kinës në Shqipëri me shkresën nr. 793, dt. 18.09.2020
  11. Zyrës së Përfaqësisë së Ambasadës Algjeriane në Shqipëri me shkresën nr. 794, dt. 18.09.2020
  12. MEPJ me shkresën nr. prot. 344/3, dt. 07.10.2020.
- Në vijim të kërkesave të DSHTD, 9 prej 12 subjekteve të mësipërme kanë paraqitur kërkesat e tyre për investime dhe shërbime mirëmbajtje për godinat e Ambasadave dhe të banesave.
- DSHTD nga ana e saj ka organizuar inspektime nga grupet e punës për të vlerësuar nevojën për investime në objektet që kanë depozituar kërkesa si dhe duke u bazuar në historikun e godinës ka përcaktuar investimet që do të merren përsipër.
- Sektori i administratës dhe zbatimit nëpërmjet specialistëve preventivues, për investimet që vendosen për t’u kryer në godinat brenda vendit, si dhe bazuar në manualin teknik, ka hartuar preventivat, ka llogaritur bazën materiale dhe orët e punës për investimet dhe mirëmbajtjen për godinat brenda vendit që do të kryhen me punëtorët e DSHTD.
- Gjithashtu departamentet e administratës së DSHTD – së kanë depozituar kërkesat e tyre në lidhje me shpenzimet administrative, lëndë djegëse, për riparim dhe mirëmbajtje automjesh, furnitura dhe shërbime të ndryshme, si dhe gjithë zërat e tjerë të shpenzimeve të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes.



- Me urdhër të Drejtorit nr. 271, dt. 23.11.2020 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, përlllogaritjen fondin limit për çdo grup malli dhe përcaktimin e procedurave të prokurimit publik.
- Me urdhër të Drejtorit nr. 260, dt. 05.11.2020 është ngritur grupi i punës për studimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve të vëna në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaja. Në vijim grupi i punës me shkresën nr. 916/1, dt. 13.11.2020 ka paraqitur pranë Drejtorit të DSHTD – së informacionin mbi tarifat e dhënies me qira të objekteve në administrim të DSHTD – së.
- Sektori i planifikimit dhe financës me shkresën nr. 916/2, dt. 18.11.2020 ka paraqitur në Këshillin Drejtues relacionin për miratimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve në administrim të DSHTD – së.
- Me vendim të KD nr. 25, dt. 18.11.2020 janë miratuar tarifat e dhënies me qira të objekteve në administrim të DSHTD – së për vitin 2021.

**Gjetje 5:** Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk i është drejtuar Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së New Yorku, dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Uashington me kërkesa mbi nevojat e tyre për investime në godinat ku ushtrojnë veprimtarinë. DSHTD ka planifikuar fonde për këto godina duke u bazuar në historikun e tyre dhe jo në nevojat reale për investime dhe mirëmbajtje.

**Konstatim 3:** Grupet e punës të cilat kanë kryer inspektimet mbi nevojat për investime të godinave brenda dhe jashtë vendit në administrim të DSHTD – së nuk kanë paraqitur procesverbalet mbi konstatimet e tyre sa i përket verifikimit të kërkesave për investime.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Grupet e punës së DSHTD, që inspektojnë nevojat për investime në godinat jashtë vendit, gjithmonë mbajnë një akt rakordim (procesverbal) midis dy palëve, ku shprehin dakordësinë për kryerjen e punimeve të detajuara me zëra, që kërkohen të kryhen nga Ambasada.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Observacioni i subjektit nuk paraqet dokumentacion shtesë për të argumentuar qëndrimin e tyre dhe për këtë arsye **nuk merret në konsideratë.**

### **Ndryshimet Buxhetore**

Gjatë vitit 2021 me Vendime të Këshillit Drejtues, janë bërë disa ndryshime në Planin ekonomik financiar 2021, bazuar në nevojën për shpenzime dhe investime të domosdoshme, por të paparashikuara në fazën e hartimit të projekt planit. Konkretisht:

1. Me VKD nr. 1, dt. 27.01.2021 është miratuar shtesë e fondit për blerje lëndë djegëse solar;
2. Me VKD nr. 3, dt. 08.02.2021 është miratuar fondi shtesë prej për mbulimin e shpenzimit për përkthimin e projektit të rikonstruksionit të Ambasadës Bullgare.
3. Me VKD nr. 5, dt. 26.02.2021 është miratuar fondi shtesë prej 36,565 lekë për pajisjen më programin e fiskalizimit dhe mirëmbajtjen e tij.
4. Me VKD nr. 20, dt. 30.09.2021 është miratuar fondi shtesë prej 407,177 lekë për kryerjen e procesit të ekzaminimit të plotë për ashensorët.
5. Me VKD nr. 23, dt. 27.10.2021 është miratuar fondi shtesë prej 1,500,000 lekë për udhëtime dhe dieta.
6. Me VKD nr. 26, dt. 25.11.2021 është miratuar fondi shtesë prej 1,140,110 lekë për kryerjen e punimeve për procesin e ekzaminimit të ashensorëve.
7. Me VKD nr. 28, dt. 10.12.2021 është miratuar fondi shtesë prej 117,600 lekë për blerje artikuj dhe dhurata për Vitin e Ri.
8. Me VKD nr. 31, dt. 21.12.2021 është miratuar fondi shtesë prej 116,400 lekë për hartimin e studimit dhe projekt preventivin e sistemit të kamerave,
9. Me VKD nr. 6, dt. 10.03.2021 është miratuar fondi shtesë prej 1,192,520 lekë për investime në apartamentin 57.2.14

10. Me VKD nr.8, dt.13.04.2021 është miratuar riallokimi i fondit prej 1,985,874 lekë për investime nga apartamenti 6.1.3 në apartamentin 8.2.4
11. Me VKD nr.9, dt.20.04.2021 është miratuar fondi shtese prej 560,172 lekë për investime në apartamentin 8.2.3.
12. Me VKD nr.13, dt.14.06.2021 është miratuar fondi shtese prej 97,574 lekë për investime në Ambasadën Franceze;
13. Me VKD nr.20, dt.30.09.2021 është miratuar riallokimi i fondit prej 506,248 lekë për investime nga apartamenti 8.2.6 në apartamentin 8.1.7.
14. ME VKD nr.25, dt. 16.11.2021 është miratuar pakësim prej 7.073.695 i të ardhurave të planifikuara nga prodhimi i AAM brenda vendit për shkak të mosrealizimit të investimit në apartamentin 8.1.7; në apartamentin 8.3.39; në apartamentin 6.1.5 dhe në Ambasadën Franceze.

**Gjetje 6:** Grupi i auditimit konstatoi se për vitin 2021 shuma e ndryshimeve buxhetore në planifikimin e të ardhurave nga prodhimi i AAM brenda vendit, nuk përputhet me vlerën e paraqitur në planin përfundimtar të vitit 2021. Kjo për arsye se DSHTD në muajt e fundit të vitit ka kryer rishikime të planit buxhetor duke pakësuar nivelin e investimeve të cilat nuk priten të realizohen, dhe duke ulur në këtë mënyrë diferencën ndërmjet planifikimit dhe realizimit të zërave të buxhetit.

### **Realizimi buxhetor për vitin 2021:**

DSHTD me shkresën nr. prot. 936, dt. 06.10.2022 ka raportuar në MEPJ mbi realizimin e treguesve ekonomik – financiar dhe pasqyrave financiare për vitin 2021. Realizimi buxhetor, pas ndryshimeve, për vitin 2021 paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr.5

Në lekë

<b>Drejtoria e Shërbimit Trupit Diplomatik</b>						
<b>PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 2021</b>						
<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Plani fillestar 2021</b>	<b>Shtesa dhe pakësime</b>	<b>Plani përfundimtar 2021</b>	<b>Fakti 2021</b>	<b>% Realiz.</b>
<b>I</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>226,258,449</b>		<b>224,195,283</b>	<b>211,930,534</b>	95%
1	Qira	196,553,943		196,553,943	192,273,126	98%
2	Prodhimi i AAM brenda vendit	27,704,506	(2,063,166)	25,641,340	17,753,958	69%
3	Te ardhura te tjera shërbime					
4	Te ardhurat nga interesat	500,000		500,000	779,321	156%
5	Te ardhura te tjera financ. + dëmshp. nga A. +të tjera	1,500,000		1,500,000	1,124,129	75%
<b>II</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>168,472,249</b>	<b>4,196,971</b>	<b>172,669,220</b>	<b>150,384,391</b>	87%
1	Paga personeli	42,000,000		42,000,000	39,475,108	94%
3	Sigurime shoqërore	7,000,000		7,000,000	6,458,599	92%
4	Sigurim objektsh (brenda dhe jashtë)	2,000,000		2,000,000	2,335,240	117%
5	Dokumentacion dhe Sigurim automjetesh	360,000		360,000	282,635	79%
6	Sigurim punonjësish	50,000		50,000	8,666	17%
7	Taksa vendore	7,100,000		7,100,000	6,984,586	98%
8	Tatime dhe taksa te tjera	100,000		100,000	48,154	48%
9	Udhëtime e dieta	2,000,000	1,500,000	3,500,000	3,385,079	97%
10	Energji	2,000,000		2,000,000	1,668,824	83%
11	detyrimi 30% i subjekteve vendase	2,954,249		2,954,249	3,206,032	109%
12	Poste, telefon, internet	900,000		900,000	592,014	66%
13	Materiale për invest. e miremb.	22,000,000		22,000,000	13,732,703	62%
14	Lende djegëse dhe karburant	16,000,000	455,560	16,455,560	16,746,038	102%
15	Shpenzime administrat + flet zyrt etj	240,000		240,000	126,995	53%
16	Mirëmbajtje e riparim ndryshme mjetesh	360,000		360,000	360,000	100%

17	Furnitura nëntrajtime dhe shërbime	4,640,000	1,663,687	6,303,687	4,708,617	75%
18	Shërbime bankare dhe këmbim valutash e humbje nga kursi	1,000,000		1,000,000	4,292,129	429%
19	Amortizimi	50,000,000		50,000,000	40,259,997	81%
20	Konsumi i inventarit të imët	1,500,000		1,500,000	1,355,437	90%
21	Shpenzime publicitet, pritje, dhurata dhe festa zyrtare	300,000	117,600	417,600	44,590	11%
22	Mirëmbajtje e programit financiar	290,000	36,565	326,565	36,000	11%
23	Ekspert kontabël	640,000		640,000	637,200	100%
24	Të tjera	2,838,000	423,559	3,261,559	1,595,473	49%
25	Gjoha dhe dëmtshpërblime				7,092	
26	Provizione për klientët dhe shp gjyqësore	2,200,000		2,200,000	2,037,183	93%
	<b>Fitimi (Humbja) para tatimit</b>	<b>57,786,200</b>		<b>51,526,063</b>	<b>61,546,143</b>	119%
	Tatim Fitimi	8,997,930		8,058,909	9,538,563	118%
	<b>Fitimi Neto (Humbja)</b>	<b>48,788,270</b>	-	<b>43,467,154</b>	<b>52,007,580</b>	120%

Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit

### Treguesit ekonomik-financiar të krahasuar me planin e vitit 2021 janë:

#### c. Të ardhurat u realizuan 95%.

1- Të ardhurat, pjesën më të madhe të cilave e zënë të ardhurat nga qiratë, janë realizuar në masën 98%.

Gjatë vitit 2021 janë zbatuar tarifatat e qirasë bazuar në VKD nr. nr. 25, datë 18.11.2020, të cilat nuk kanë pasur ndryshime nga tarifatat e qirave të vitit 2020. Gjatë vitit 2021 janë lidhur rishtazi dhe rinovuar 80 kontrata qiraje dhe 11 kontrata qiraje nuk janë rinovuar.

2- Të ardhurat nga prodhimi i aktiveve afatgjata materiale paraqiten me realizim 69% ose në vlerë absolute 6,887,382 lekë më pak se planifikimi. Në mosrealizimin e të ardhurave sipas specialistëve të DSHTD-së kanë ndikuar:

c. Prokurimi i materialeve që u përdorën për të kryer investimin, në vlera më të vogla se sa ishin planifikuar e cila evidentohet dhe nga realizimi i zërit “Shpenzime për investime dhe mirëmbajtje” në masën 62%, si dhe nga realizimi i regjistrit të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve 2021 në masën rreth 70%.

d. Përdorimi me efikasitet dhe kursim i bazës materiale të përdorur gjatë fazës së zbatimit të rikonstruksionit të ambienteve në punimet që janë kryer në apartamentet dhe godinat brenda vendit për vitin 2021.

**Gjetje 7:** Konstatohet se mosrealizimi i plotë i të ardhurave nga prodhimi i AAM për shkak të prokurimit të materialeve në vlera më të vogla nga sa ishin planifikuar është një fenomen që përsëritet vit pas viti në DSHTD. Gjithashtu në raportin e fundit të auditimit të KLSH-së është evidentuar se për vitin 2018 dhe 2019 mosrealizimi i të ardhurave nga AAM është ndikuar nga fakti se vlerat e materialeve janë parashikuar në nivele më të ulëta se fakti.

3- Të ardhurat nga interesat përfaqësojnë interesat kreditorë të depozitës 300.000 euro në vlerë 185,561 lekë dhe interesat e depozitës 800.000 euro në vlerë 593,760 lekë.

4- Të ardhura të tjera financ + dëmtshp nga A. +të tjera 1,124,129 lekë përfaqësojnë rimbursimin e shoqëria e sigurimit A. për subjektin DSHTD në vlerën 883,452 lekë, si pjesë e marrëveshjes për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019 në godinat pronë e DSHTD-së të cilat kanë qenë të siguruar në këtë kompani; rimarrjen e provigjioneve në vlerën 174,597 leke dhe investimin e kryer në Ambasadën e Shqipërisë në Suedi në vlerën 66,080 lekë.

#### d. Shpenzimet u realizuan në masën 87 % në krahasim me planin.

-Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit janë realizuar në masën 94% dhe 92% respektivisht. DSHTD në vitin 2021 ka 58 punonjës.

-“Shpenzime për sigurime objektsh (brenda dhe jashtë vendit)” janë realizuar në masën 117%. Shkak i tejkalimit të shpenzimit në vlerë absolute 335,240 lekë është kryesisht ndryshimi i kursit të këmbimit për siguracionet jashtë vendit.

- Zëri "Udhëtime e dieta" paraqitet me realizim 97% dhe është i detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 6

Në lekë

Nr ref.	Lloji	Dt. Regj.	Nr. dok	Dt. Dok	Përshkrimi	Paguar
625		Transferime, udhëtime, dieta				LEK
<b>Gjendja me pare:</b>						<b>.00</b>
1055	FBT	17/06/2021	6/2021	24/05/2021	blerje 4 bileta udhëtimi për Bruksel te D.	290,752.00
1902	PAGESE	30/07/2021	5	25/05/2021	pag shp udhëtim e dieta Bruksel A.S.	146,870.23
1904	PAGESE	30/07/2021	7	25/05/2021	pag shp udhëtim e dieta Bruksel D.B.	143,300.04
1907	PAGESE	30/07/2021	6	25/05/2021	pag shp udhëtim e dieta Bruksel T.T.	143,792.48
1908	PAGESE	30/07/2021	8	25/05/2021	pag shp udhëtim e dieta Bruksel E.K.	143,792.48
1599	FBT	09/07/2021	23	24/06/2021	blerje 4 bileta për Stokholm te D.	375,600.00
2207	PAGESE	15/09/2021	13	28/06/2021	shp udhët e dieta Suedi G.V.	144,841.62
2208	PAGESE	15/09/2021	14	28/06/2021	shp udhët e dieta Suedi E.J.	143,364.90
2210	PAGESE	15/09/2021	15	28/06/2021	shp udhët e dieta Suedi A.K.	146,318.34
2211	PAGESE	15/09/2021	16	28/06/2021	shp udhët e dieta Suedi D.H.	144,595.50
3073	FBT	15/11/2021	81	01/11/2021	blerje bileta avioni Bruksel dt. 25-30 /10/2021 cope 3 te D.	305,610.00
3071	FBT	10/12/2021	85	05/11/2021	blerje bileta avioni Athine cope 3 dt. 2-5.11.21 te D.	183,396.00
3497	PAGESE	29/12/2021	24	05/11/2021	shp udhët e dieta Bruksel A.D. për proc e prokurim invest ne godine	167,982.10
3498	PAGESE	29/12/2021	23	05/11/2021	shp udhët e dieta Bruksel E.J. ,për kryerjen e proced te prokurimit për investimin ne godine	216,966.75
3499	PAGESE	29/12/2021	25	05/11/2021	shp udhët e dieta Bruksel I.B. për proc e prokur invest ne godine	164,335.60
3500	PAGESE	29/12/2021	26	08/11/2021	shp udhët e dieta Athine A.S.	83,244.84
3501	PAGESE	29/12/2021	27	08/11/2021	shp udhët e dieta Athine B.K.	90,611.64
3502	PAGESE	29/12/2021	28	08/11/2021	shp udhëtim e dieta Athine E.D.	77,719.74
3070	FBT	10/12/2021	94	15/11/2021	blerje 2 bileta avioni për Bruksel për dt. 10-12.11.21 te D.	96,900.00
3509	PAGESE	29/12/2021	31	15/11/2021	shp udh e dieta Bruksel E.Dh. marrje dorëz punime invest godine	87,542.14
3510	PAGESE	29/12/2021	32	15/11/2021	shp udhët e dieta Bruksel V.Sh. për marrje dorëzim punime invest ne godine	87,542.14
<b>Totali</b>						<b>3,385,078.54</b>

Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit

- Realizimi i shpenzimit për energjinë elektrike paraqitet i moderuar në masën 83%.

- "Detyrimi 30% i subjekteve vendase" ka një realizim 109% nga 2,954,249 lekë i planifikuar në 3,206,032 lekë i realizuar. Kjo për shkak të derdhjes së detyrimit të prapambetur 2 mujor të vitit 2020, të subjektit "W.", i cili e derdhi këtë detyrim në 2021, bazuar në akt marrëveshjen e bërë me DSHTD, sipas aktit normativ Nr.12 Datë 02.04.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", ku midis të tjerave citon që:

*"Të gjithë qiramarrësit, personat fizik/juridik.....nuk do të paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020. Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, në mënyrë proporcionale dhe të dakordësuar me qiradhënësin pas muajit maj 2020."*

Konkretisht gjatë vitit 2020 subjektet vendase janë paraqitur në tabelën 2 aneksin III.

- Zëri "Materiale për investim dhe mirëmbajtje" ka një mosrealizim në vlerë absolute në masën 8,267,297 lekë duke shënuar një realizim faktik rreth 13.7 milion lekë nga 22 milion lekë të planifikuara, ose 62%. Kjo si rrjedhojë e prokurimit të materialeve që u përdorën për të kryer investimet në godinat brenda vendit në vlera më të vogla se sa ishin planifikuar, si dhe përdorimit me efikasitet dhe kursim të bazës materiale të përdorur gjatë fazës së zbatimit të rikonstruksionit të ambienteve.

- Shpenzimet për lëndë djegëse dhe karburant kanë një kursim në vlerë absolute në masën 1,476,624 lekë duke shënuar një realizim rreth 18,5 milion lekë nga 20 milion lekë të planifikuara. Realizimi i këtij shpenzimi në masën 93% ka ardhur kryesisht si rezultat i uljes së çmimit të bursës sipas Reuters për lëndët djegëse në kushtet e pandemisë Covid 2019, pasi sasia e konsumuar është pothuaj në trendin historik të konsumit vjetor.

Gjatë viti 2021 janë konsumuar **69,150 litra** nga OE "R.", e cila bazuar në Akt marrëveshjen me nr. prot. 1047/1 dt. 29.12.2020 "Marrje në ruajtje mall solar" ka lëshuar faturën tatimore me nr.7 dt. 29.12.2020 për sasinë totale 69,150 lt në vlerën 7,664,033 lekë me tvsh, paguar me disa këste sipas blerjeve si më poshtë

- 5,200 litra në vlerën 576,326 lekë në dt. 17.02.2021
- 15,050 litra në vlerën 1,668,022 lekë në dt. 17.02.2021
- 15,050 litra në vlerën 1,668,022 lekë në dt. 08.03.2021
- 15,050 litra në vlerën 1,668,022 lekë në dt. 1.04.2021
- 15,050 litra në vlerën 1,668,022 lekë në dt. 12.04.2021
- 3,750 litra në vlerën 415,620 lekë në dt. 06.05.2021

Gjatë vitit 2021 janë blerë nga OE "T." **70,000 litra** solar bazuar në kontratën me nr. prot 382/3 dt. 18.05.2021 sipas faturave si më poshtë vijon:

- Fatura me nr. 974/2021 dt. 08.07.2021 për 14,000 litra në vlerën 1,909,684 lekë likuiduar me dt. 14.07.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Kontratën Nr.382/3, datë 18.05.2021 me objekt "Blerje/Furnizim lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës";
  - Marrëveshja Kuadër Nr.267/3, datë 20.04.2021 me objekt "Për kryerjen e furnizimit me lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës";
  - Urdhri i Drejtorit të DSHTD Nr. 152, datë 01.07.2021 "Mbi krijimin e komisioni të Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, objekt i procedurës së prokurimit, "Blerje/Furnizim lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1%, ndaj peshës.
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 08.07.2021;
  - Fatura e shitjes së OE "T." me Nr. 974/2021 datë 08.07.2021;
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.01, datë 08.07.2021
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura me nr. 1094/2021 dt. 10.09.2021 për 14,000 litra në vlerën 1,908,760 lekë likuiduar me dt. 10.09.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 10.09.2021;
  - Fatura e shitjes së OE "T." me Nr. 1094/2021 datë 10.09.2021;
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.02, datë 10.09.2021
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura me nr. 107/2021, dt. 11.11.2021 për 14,000 litra në vlerën 2,037,546 lekë likuiduar me dt. 18.11.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 11.11.2021;
  - Fatura e shitjes së OE "T." me Nr. 107/2021 datë 11.11.2021;
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.03, datë 11.11.2021
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse
- Fatura me nr. 267/2021 dt. 10.12.2021 për 14,000 litra në vlerën 2,021,726 lekë likuiduar me dt. 21.12.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Urdhri i Drejtorit të DSHTD Nr. 301, datë 09.12.2021 "Për ndryshimin e urdhrin nr. 152, datë 01.07.2021 "Mbi krijimin e komisioni të Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, objekt i procedurës së prokurimit, "Blerje/Furnizim lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1%, ndaj peshës"".
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 10.12.2021;
  - Fatura e shitjes së OE "T." me Nr. 267/2021 datë 10.12.2021;
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.04, datë 10.12.2021
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.

- Fatura me nr. 307/2021 dt. 28.12.2021 për 14,000 litra në vlerën 1,939,042 lekë likuiduar me dt. 30.12.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 28.12.2021;
  - Fatura e shitjes së OE "T." me Nr. 307/2021 datë 28.12.2021;
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.05, datë 28.12.2021
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse
- Shërbime bankare dhe këmbim valutor e humbje nga kursi i këmbimit ka superuar parashikimin dhe paraqitet me një realizim prej 429% ose 4,292,129 lekë për shkak të luhatjeve të konsiderueshme të kursit të këmbimit gjatë vitit 2021.
- “Furnitura, nën trajtime dhe shërbime” përfaqëson disa zëra shpenzimesh, dhe ka një realizim në masën 75%, ose në vlerë absolute 1,595,070 lekë më pak se parashikimi. Kjo situatë vjen kryesisht si rezultat i prokurimit të zërave të këtij grupi në vlerë më të ulët se fondi limit i parashikuar, por edhe si rezultat i përdorimit me efikasitet të materialeve, dhe minimizimit të shpenzimeve të tepërta.
- Shpenzime “Të tjera” është e detajuar si më poshtë vijon. Realizimi i këtij zëri në nivelin 49% vjen si rezultat i prokurimit të zërave të këtij grupi në vlerë më të ulët se fondi limit i parashikuar.

Tabela nr. 7

Në lekë

	Plani 2021	Fakti 2021	% e realizimit
1-Blerje veshje pune edhe uniforma	300,000	203,820	68%
2- Rimbushje vjetor fikse zjarri e kontroll	100,000	96,000	96%
3-Dezinfektim i ambienteve nga insektet	180,000	49,278	27%
4-Masa parandaluese anticovid	468,000	0	0%
5-Mirëmbajtje e faqes zyrtare të DSHTD-së	120,000	96,222	80%
6-Lule sipas stinëve & Materiale për mirëmbajtje lulishteje	360,000	133,744	37%
7-Shërbime me vinç	200,000	107,640	54%
8-Materiale të paparashikuara	960,000	369,422	38%
9-Tarife pagese për depozitim mbeturinash	150,000	128,947	86%
10 Përktim projekti Bullgar dhe studimi tarifës ngrohjes	423,559	410,400	97%
TOTALI	3,261,559	1,595,473	49%

Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit

- Shpenzime publicitet, pritje, dhurata dhe festa zyrtare parashikuar në vlerën 417,600 lekë paraqiten me realizim 44,590 lekë ose 11%. Duke krahasuar të dhënat e pasqyrave financiare rezultojnë se në fakt realizimi i këtij zëri është 114,970 lekë ose 27.5%. Konstatohet një mospërputhje ndërmjet këtyre vlerave për shkak të një klasifikimi të gabuar në sistemin e kontabilitetit të shpenzimit *shpërndarje dhurata për përfaqësitë diplomatike* në vlerën 70,380 lekë në llogarinë e materialeve ndihmëse.

**Gjetje 8:** Grupi i auditimit konstatoi se një pjesë e madhe e zërave të shpenzimeve kanë një realizim më të ulët se planifikimi për të njëjtën arsye, konkretisht për shkak të prokurimit të materialeve të zërave të këtij grupi në vlerë më të ulët se fondi limit i parashikuar. Pavarësisht se me urdhër të Drejtorit nr. 271, dt. 23.11.2020 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, përllogaritjen e fondit limit për çdo grup malli dhe përcaktimin e procedurave të prokurimit publik, konstatohet se vit pas viti zërat e shpenzimeve nuk realizohen në nivelin e parashikuar.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Gjatë fazës së planifikimit, përllogaritja e fondit limit del si mesatare e çmimi të vitit korrent, çmimit nga I. dhe çmimit nga testimi i tregut. Gjatë vitit pasardhës, në përgjithësi operatorët ekonomikë konkurrojnë me oferta më të ulëta se fondi limit, për arsye të ndryshimit të çmimit në treg në krahasim me çmimin e të njëjtit produkt në periudhën e mëparshme kur është përllogaritur fondi limit. Si rrjedhim, zërat e shpenzimeve nuk realizohen në nivelin e planifikuar bazuar në përllogaritjen e fondit limit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Komentet nga subjekti nuk e ndryshojnë gjendjen e evidentuar nga grupi auditues për periudhën e auditimit dhe observacioni **nuk merret në konsideratë**.

• **Investimet për objektet pronë e DSHTD-së jashtë vendit janë realizuar**

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, nuk është kryer investim në asnjë nga godinat, pronë e shtetit shqiptar në Ambasadat tona jashtë vendit, për shkak të kufizimeve të pandemisë Covid 19.

Me përmirësimin e kushteve të pandemisë gjatë 6 mujorit të dytë 2021, dhe me insistimin e DSHTD, në muajt e fundit të 2021 u kryen investime në godinat jashtë vendit, konkretisht në Misionin e R.SH në Bruksel, në Ambasadën RSH në Stokholm, dhe në Ambasadën e RSH në Athinë.

Investimi i planifikuar për tu kryer në godinën e Ambasadës së RSH në Romë, edhe këtë vit nuk arriti të realizohej duke u anuluar për herë të dytë dhe duke u shtyrë për vitin 2022. Një vlerë e vogël investimi, u krye vetëm në disa apartamente ku janë akomoduar diplomatët në Romë.

Me ndryshimet që iu bënë Planit të investimeve 2021 për objektet pronë e DSHTD jashtë vendit, me disa Vendime të Këshillit Drejtues të DSHTD-së gjatë 2021, realizimi i investimeve në godinat jashtë vendit për 2021 paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr.8

Nr.	Investimet ne Ambasadat jashtë vendit për vitin 2021	Objekti	Planifikim	Planifikim	Realizim	Realizim	Realizimi në %
			EURO	USD	EURO	USD	
I	Ambasada Ne Rome	punime ne apartamentin 22 te diplomateve,	€ 7,190		€ 6,580		
		punime ne Ap. 13+15 te diplomateve			€ 7,190		
	<b>Totali</b>		<b>€ 7,190</b>		<b>€ 13,770</b>		<b>191.52%</b>
II	Ambasada Ne Stokholm	Punime ne godinën e Ambasadës se R.SH ne Stokholm	€ 22,348		€ 12,896		
	<b>Totali</b>		<b>€ 22,348</b>		<b>€ 12,896</b>		<b>57.71%</b>
III	Ambasada ne Bruksel	Punime në godinën e Misionit te R.SH ne Bruksel	€ 20,000		€ 14,029		
	<b>Totali</b>		<b>€ 20,000</b>		<b>€ 14,029</b>		<b>70.15%</b>
IV	Ambasada ne Athine	Punime të nevojshme dhe të domosdoshme në godinën e Ambasadës së RSH-së në Athinë	€ 10,000		€ 9,955		
	<b>Totali</b>		<b>€ 10,000</b>		<b>€ 9,955</b>		<b>99.55%</b>
V	Misioni i Përhershëm RSH-së pranë OKB-së New York	punime emergjente për riparimin e dëmeve te shkaktuara nga ngrica ne apartamentet e godinës		\$ 20,000		\$10,050	
		punime emergjente për riparimin e dëmeve ne Ap.3B ne godinën e Misionit				\$ 2,250	
		punime ne Ap.3/ A dhe 1/A ne godinën e Misionit				\$ 4,000	
		punime ne Ap.1/ A ne godinën e Misionit				\$ 1,900	
	<b>Totali</b>			<b>\$ 20,000</b>		<b>\$18,200</b>	<b>91.00%</b>
VI	Ambasada R.SH Uashington			\$ 10,000		\$ -	
	<b>TOTALI</b>			<b>\$ 10,000</b>		<b>\$ -</b>	<b>0.00%</b>

Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit

**2.1.3 Mbi planifikimin e buxhetit të viti 2022**

- Me urdhër të Drejtorit të DSHTD nr. 238, dt. 22.09.2021 është ngritur grupi i punës për planifikimin e treguesve ekonomiko – financiar për vitin 2022.

- Me shkresën nr. Prot. 775/1, dt. 22.09.2021 është miratuar nga Drejtori i DSHTD plani i masave për hartimin e planit ekonomik – financiar për vitin 2021.
- Me shkresën nr. Prot. 775/2, dt. 22.09.2021 është miratuar nga Drejtori i DSHTD udhëzimi metodik për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit ekonomik – financiar për vitin 2021.
- Në vijim DSHTD i ka kërkuar informacion misioneve diplomatike në lidhje me kërkesat e tyre për investime dhe shërbime, konkretisht:
  1. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Stokholm me shkresën nr. prot. 840, dt. 29.09.2021.
  2. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi me shkresën nr. prot. 841, dt. 29.09.2021.
  3. Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Itali me shkresën nr. prot. 842, dt. 29.09.2021.
  4. Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian në Bruksel me shkresën nr. prot. 843, dt. 29.09.2021.
  5. Ambasadës së Republikës së Greqisë në Shqipëri me shkresën nr. 844, dt. 29.09.2021
  6. Ambasadës së Republikës së Sllovakisë në Shqipëri me shkresën nr. 845, dt. 29.09.2021
  7. Ambasadës së Republikës së Popullore të Kinës në Shqipëri me shkresën nr. 846, dt. 29.09.2021.
  8. Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri me shkresën nr. 847, dt. 29.09.2021.
  9. Ambasadës së Republikës Franceze në Shqipëri me shkresën nr. 848, dt. 29.09.2021.
  10. Ambasadës së Republikës së Bullgarisë në Shqipëri me shkresën nr. 849, dt. 29.09.2021.
- Në vijim të kërkesave të DSHTD, të gjitha subjektet kanë paraqitur kërkesat e tyre për investime dhe shërbime mirëmbajtje për godinat e Ambasadave dhe të banesave.
- DSHTD nga ana e saj ka organizuar inspektime nga grupet e punës për të vlerësuar nevojën për investime në objektet që kanë depozituar kërkesa dhe duke u bazuar dhe në historikun e godinës ka përcaktuar investimet që do të merren përsipër. Grupet e punës kanë paraqitur procesverbalet si më poshtë vijon:
  - Procesverbal me nr. prot. 844/2, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në godinën e Ambasadës Greke.
  - Procesverbal me nr. prot. 845/2, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në ambientet në administrim të Ambasadës Sllovaqe.
  - Procesverbal me nr. prot. 846/3, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në ambientet në administrim të Ambasadës Kineze.
  - Procesverbal me nr. prot. 847/2, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në godinën e Ambasadës dhe Rezidencës Gjermane.
  - Procesverbal me nr. prot. 848/2, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në godinën e Ambasadës Franceze.
  - Procesverbal me nr. prot. 975, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në apartamentin nr. 8.3.34
  - Procesverbal me nr. prot. 976, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në apartamentin nr. 8.3.28
  - Procesverbal me nr. prot. 977, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në apartamentin nr. 6.2.19
  - Procesverbal me nr. prot. 978, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në apartamentin nr. 6.1.10
  - Procesverbal me nr. prot. 979, dt. 08.11.2021 mbi konstatimin e punimeve të nevojshme në apartamentin nr. 8.3.40
- Sektori i administratës dhe zbatimit nëpërmjet specialistëve preventivues, për investimet që vendosen për t'u kryer në godinat brenda vendit, si dhe bazuar në manualin teknik, ka hartuar preventivat, ka llogaritur bazën materiale dhe orët e punës për investimet dhe mirëmbajtjen për godinat brenda vendit që do të kryhen me punëtorët e DSHTD.



- Sektori i administratës dhe zbatimit me shkresën nr. 775/4, dt. 15.10.2021 ka informuar Sektorin e planifikimit dhe financës në lidhje me historikun e investimeve të kryera në objektet në administrim të DSHTD – së për periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2020.
- Gjithashtu departamentet e administratës së DSHTD – së kanë depozituar kërkesat e tyre në lidhje me shpenzimet administrative, lëndë djegëse, për riparim dhe mirëmbajtje automjetesh, furnitura dhe shërbime të ndryshme, si dhe gjithë zërat e tjerë të shpenzimeve të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes.
- Me urdhër të Drejtorit nr. 296, dt. 02.12.2021 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, përlllogaritjen fondin limit për çdo grup malli dhe përcaktimin e procedurave të prokurimit publik.
- Me urdhër të Drejtorit nr. 258, dt. 22.10.2021 është ngritur grupi i punës për studimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve të vëna në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaja. Në vijim grupi i punës me shkresën nr. 928/4, dt. 19.11.2021 ka paraqitur pranë Drejtorit të DSHTD–së informacionin mbi tarifatat e dhënies me qira të objekteve në administrim të DSHTD – së.
- Me vendim të KD nr. 27, dt. 26.11.2021 janë miratuar tarifatat e dhënies me qira të objekteve në administrim të DSHTD – së për vitin 2022.

Planifikimi i të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve për vitin 2022 paraqitet si më poshtë vijon:

### **I. Plani i të Ardhurave për vitin 2022**

Të ardhurat e planifikuara për vitin 2022 janë në total **228,290,331** lekë, të ndara sipas zërave me poshtë:

1- Nga qiratë e objekteve të DSHTD-së, është planifikuar një e ardhur në vlerën prej 204,318,607 lekë e detajuar si më poshtë:

- Të ardhura nga qiratë e apartamenteve.....= 90,151,372 lekë.
- Të ardhurat nga qiratë e vilave.....= 103,343,380 lekë.
- Të ardhurat nga subjektet vendore.....= 10,823,855 lekë.

2- Nga prodhimi i AAM brenda vendit, bazuar në preventivat e hartuar për punimet e investimeve në godinat brenda vendit, të cilat administrohen nga DSHTD-ja. Janë planifikuara të ardhura në vlerën prej 22,971,724 lekë.

### **II. Plani i Shpenzimeve për vitin 2022**

Shpenzimet e planifikuara për vitin 2022 janë në total në vlerën 181,180,000 lekë, me një rritje në vlerë absolute rreth 12 milion lekë, kryesisht nga rritja e fondit të pagave në 2022, si rrjedhojë e ristrukturimit të ndërmarrjes. Zërat kryesorë të shpenzimeve janë si më poshtë vijon:

- Shpenzimet për pagat e punonjësve janë parashikuar në vlerën 52,000,000 lekë, nga 42,000,000 lekë të parashikuara në 2021, duke zënë rreth 28.7% të shpenzimeve totale.
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore janë parashikuar në vlerën 8,700,000 lekë.
- Shpenzimet për sigurimin e objekteve brenda dhe jashtë vendit, sigurim punonjësish dhe automjetesh janë parashikuar në vlerën rreth 3,000,000 lekë.
- Shpenzimet materiale për investime dhe mirëmbajtje janë parashikuar në vlerën 3,500,000 lekë, duke u bazuar te regjistri i prokurimeve 2022.
- Shpenzimet për lëndë djegëse dhe karburant janë parashikuar në vlerën 20,000,000 lekë, duke zënë rreth 12% të shpenzimeve totale të 2022. Shpenzimet e lëndës djegëse dhe karburantit janë bazuar në marrëveshjen kuadër Nr.267/3, dt. 20.04.2021 me objekt “Për kryerjen e furnizimit me lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”, të nënshkruar midis DSHTD-së dhe OE “T.”, si dhe në parashikimin e normativave të konsumimit të karburantit nga automjetet, dhe testimi i tregut për karburantin.
- Shpenzime furnitura nën trajtime & shërbime të ndryshme janë parashikuar në vlerën 8,180,000 lekë .

- Shpenzime të tjera rrjedhëse janë parashikuar në vlerën 10,630,000 lekë.
- Amortizimi dhe konsumi i inventarit të imët është parashikuar në vlerën 51,500,000 duke zënë rreth 29% të shpenzimeve totale të planifikuara gjatë 2022.
- Shpenzime për provizione për klientët e vjetër debitorë pa shprese arkëtimi (ish Ambasada Jugosllave) në vlerën 1,900,000 lekë.
- Taksa vendore dhe tatime të tjera është parashikuar në vlerën 7,300,000 lekë.
- Shpenzim për tarifën e ekspertit kontabël në vlerën 1,140,000 lekë.
- Detyrimi shtetëror në masën 30% të të ardhurave që burojnë nga kontratat e qirasë me subjektet vendase, i cili kalon për llogari të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, është parashikuar në vlerën rreth 3,300,000 lekë.

Fitimi neto i planifikuar për vitin 2022 është në vlerën **39,760,000** lekë.

### **III. Investimet e planifikuara për vitin 2022 të ndarë sipas strukturës janë si më poshtë:**

- Investimet dhe mirëmbajtje në godinat brenda vendit janë në vlerën 22,971,724 lekë.
- Makineri dhe pajisje në vlerën 4,100,000 lekë.
- Pajisje orendi në vlerën 1,700,000 lekë.
- Investime në godinat brenda vendit me të tretë në vlerën 4,100,000 lekë.
- Investime në godinat e ambasadave jashtë vendit në vlerën 30,000,000 lekë.

Investimet e planifikuara për vitin 2022, në vlerën 30,000,000 lekë, në godinat e Ambasadave të Republikës së Shqipërisë që administrojnë DSHTD-së jashtë vendit janë planifikuar si më poshtë:

#### **Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian Bruksel.**

Për vitin 2022 është parashikuar një fond për investime/mirëmbajtje prej 10,000 €, kryesisht për t'i paraprirë çdo lloj rasti apo nevojë emergjente që mund të lind gjatë vitit 2022, pasi në përgjigje të shkresës së DSHTD drejtuar Misionit, me nr. prot.843, dt. 29.09.2021 "Mbi planifikimin e investimeve dhe shërbimeve të vitit 2022", nga ana e Misionit nuk ka ardhur asnjë nevojë për punime investim/mirëmbajtje për vitin 2022.

#### **Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Stokholm.**

Për vitin 2022 është parashikuar një fond për investime/mirëmbajtje prej 10,000 €, kryesisht për t'i paraprirë çdo lloj rasti apo nevojë emergjente që mund të lind gjatë vitit 2022, pasi në përgjigje të shkresës së DSHTD drejtuar Ambasadës, me nr. prot.840, dt. 29.09.2021 "Mbi planifikimin e investimeve dhe shërbimeve të vitit 2022", nga ana e Ambasadës nuk ka ardhur asnjë nevojë për punime investim/mirëmbajtje për vitin 2022.

#### **Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë.**

Për vitin 2022 është parashikuar një fond për investime prej 65,000 €, bazuar në shkresën e Ambasadës së R.SH Athinë me nr. prot.937/14, dt. 09.12.2021 "Përcillen oferta për investime dhe shërbime për vitin 2022" për të kryer punime në kuadër të investimit në godinën e Ambasadës.

#### **Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë.**

Për vitin 2022 është parashikuar një fond total për investime prej 130,000 €, të ndarë në investime 120,000 €, bazuar në preventivin e fazës së dytë të projektit 3-vjeçar (i cili nuk u realizua gjatë 2020 dhe 2021 për shkak të pandemisë) dhe punimet shtesë të konstatuara në akt-rakordimin midis grupit të punës së DSHTD dhe titullarit të Ambasadës RSH në Romë më datë 24.11.2020, vlerë kjo e miratuar me VKD nr.28, dt. 28.12.2020, si dhe 10,000 € për punime emergjente që mund të dalin gjatë vitit 2022 për apartamentet që akomodohen diplomatët në Romë.

DSHTD-ja me VKD nr.25, dt. 16.11.2021, rishikoi treguesit e planit ekonomik-financiar 2021, ku midis të tjerash anuloi fondin 120,000 euro parashikuar në Planin ekonomik-financiar 2021 për kryerjen e fazës së dytë të projektit, dhe miratoi rialokimin e këtij fondi në Planin ekonomik-financiar 2022 dhe në Planin afatmesëm 2020-2022. Gjithashtu, Ambasada e R.SH në Romë, me shkresën e saj me nr. prot.885/4, datë 03.12.2021, kërkon që këto punime të realizohen gjatë vitit 2022.

#### **Misioni i Republikës së Shqipërisë në New York.**

Për vitin 2022 është parashikuar një fond për investime/mirëmbajtje prej 20,000 \$, kryesisht për t'i

paraprirë çdo lloj rasti apo nevoje emergjente që mund të lindë gjatë vitit 2022, duke marrë parasysh historikun e investimeve të viteve të fundit.

**Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Uashington.**

Për vitin 2022 është parashikuar një fond prej 10,000 \$ për çdo nevojë që mund të lind gjatë vitit.

**Plani i mirëmbajtjes është planifikuar në total në vlerën 5,750,000 leke të ndarë si më poshtë:**

Tabela nr. 9

Në lekë

Objekti	Vlera
Pallati Nr.4	1,000,000 lekë
Pallati Nr.6	1,000,000 lekë
Pallati Nr.8	1,500,000 lekë
Pallati Nr.57	100,000 lekë
Vila Nr.49	150,000 lekë
MEPJ	1,300,000 lekë
Ambasada Greke	150,000 lekë
Ambasada Gjermane	150,000 lekë
Rezidenca Ambasada Gjermane	100,000 lekë
Ambasada Franceze	150,000 lekë
Ambasada Bullgare	150,000 lekë

*Burimi: DSHTD; përpunoi grupi i auditimit*

**Gjetje 8:** Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk i është drejtuar Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së New Yorku, dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Uashingtoni me kërkesat mbi nevojat e tyre për investime në godinat ku ushtrojnë veprimtarinë. DSHTD ka planifikuar fonde për këto godina duke u bazuar në historikun e tyre dhe jo në nevojat reale të tyre.

**Gjetje 9:** Grupi i auditimit konstatoi se në planifikimin e investimeve për disa prej godinave jashtë vendit në administrim të DSHTD – së, parashikohen të njëjtat nivele fondesh pavarësisht se nga ana e Ambasadave nuk paraqiten kërkesa konkrete në lidhje me nevojat e tyre. Konkretisht Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian në Bruksel, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Stokholm, Misioni i Republikës së Shqipërisë në New York dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Uashington nuk kanë paraqitur kërkesa sa i përket investimeve apo punimeve që nevojitet të kryhen në këto godina përgjatë vitit 2022. Pavarësisht kësaj situate DSHTD ka alokuar vlera të caktuara për t’i paraprirë çdo lloj rasti apo nevoje emergjente që mund të lind gjatë vitit 2022, duke marrë parasysh historikun e investimeve të viteve të fundit, por pa pasur evidenca të mjaftueshme për të argumentuar përlllogaritjen e këtyre fondeve për godinat respektive.

Titulli i Gjetjes	Mbi hartimin, planifikimin dhe realizimin e Buxhetit të DSHTD
<b>Situata:</b>	<p><b>1.</b> Grupi i auditimit rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022, DSHTD nuk i është drejtuar Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së New Yorku dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Uashington me kërkesa mbi nevojat e tyre për investime në godinat ku ushtrojnë veprimtarinë. DSHTD ka planifikuar fonde për këto godina duke u bazuar në historikun e tyre dhe jo në nevojat reale për investime dhe mirëmbajtje.</p> <p><b>2.</b> Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Itali me shkresën 1228/1, dt. 27.12.2019 ka depozituar në DSHTD kërkesën për punime shtesë në godinën e Ambasadës dhe apartamentet e diplomatëve. Kjo kërkesë është bërë pas përfundimit të procesit të planifikimit të planit ekonomik financiar për vitin 2020, duke krijuar vështirësi për DSHTD – në për kryerjen e procedurave verifikuese nga institucioni mbi nevojën për këto investime si dhe koston e tyre.</p> <p><b>3.</b> Grupi i auditimit rezultoi se kryesisht për objektet jashtë vendit parashikohen fonde për punime të cilat cilësohen si të paparashikuara ose emergjente duke u bazuar në historikun e godinave, fonde të cilat në pjesën më të madhe të rasteve nuk realizohen në nivelin e plotë të tyre.</p>

	<p>Kjo metodë planifikimi krijon pengesa në përdorimin eficient dhe efektiv të fondeve pasi i ngurtëson ato në punime të cilat nuk kanë probabilitet të lartë realizimi.</p> <p><b>4.</b> Grupi i auditimit rezultoi se për vitet 2020 dhe 2021 realizimi i të ardhurave nga përdorimi i aktiveve afatgjata materiale paraqitet në nivele mesatare për shkak të prokurimit të materialeve në vlera më të vogla se sa ishin planifikuar. Ky argumentim për këtë kategori të ardhurash përsëritet vit pas viti në DSHTD. Gjithashtu në raportin e fundit të auditimit të KLSH-së është evidentuar se për vitin 2018 dhe 2019 mosrealizimi i të ardhurat nga AAM është ndikuar nga fakti se vlerat e materialeve janë parashikuar në nivele më të ulëta se fakti.</p> <p><b>5.</b> Grupi i auditimit rezultoi se për vitet 2020 dhe 2021 një pjesë e madhe e zërave të shpenzimeve kanë një realizim më të ulët se planifikimi për të njëjtën arsye, konkretisht për shkak të prokurimit të materialeve të zërave të këtij grupi në vlerë më të ulët se fondi limit i parashikuar. Pavarësisht se janë ngritur grupet e punës për testimin e tregut, përlllogaritjen fondin limit për çdo grup malli dhe përcaktimin e procedurave të prokurimit publik, konstatohet se vit pas viti zërat e shpenzimeve nuk realizohen në nivelin e parashikuar.</p> <p><b>6.</b> Grupi i auditimit rezultoi se për vitin 2021 shuma e ndryshimeve buxhetore në planifikimin e të ardhurave nga prodhimi i AAM brenda vendit, nuk përputhet me vlerën e paraqitur në planin përfundimtar të vitit 2021. Kjo për arsye se DSHTD në muajt e fundit të vitit ka kryer rishikime të planit buxhetor duke pakësuar nivelin e investimeve të cilat nuk priten të realizohen, dhe duke ulur në këtë mënyrë diferencën ndërmjet planifikimit dhe realizimit të zërave të buxhetit.</p> <p><b>7.</b> Për vitin 2022 grupi i auditimit rezultoi se në planifikimin e investimeve për disa prej godinave jashtë vendit në administrim të DSHTD – së, parashikohen të njëjtat nivele fondesh pavarësisht se nga ana e Ambasadave nuk paraqiten kërkesa konkrete në lidhje me nevojat e tyre. Konkretisht Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian në Bruksel, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Stokholm, Misioni i Republikës së Shqipërisë në New York dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Uashington nuk kanë paraqitur kërkesa sa i përket investimeve apo punimeve që nevojitet të kryhen në këto godina përgjatë vitit 2022. Pavarësisht kësaj shtate DSHTD ka alokuar vlera të caktuara për t'i paraprirë çdo lloj rasti apo nevoje emergjente që mund të lind gjatë vitit 2022, duke marrë parasysh historikun e investimeve të viteve të fundit, por pa pasur evidenca të mjaftueshme për të argumentuar përlllogaritjen e këtyre fondeve për godinat respective.</p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”.</li> <li>-VKM nr.840, datë 17.12.2004 “Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”;</li> <li>-VKM nr. 407, datë 18.6.2014 për një shtesë dhe ndryshim në Vendimin Nr. 840, Datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”;</li> <li>-VKM nr. 631, datë 15.9.2006, Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.840, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave “Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”;</li> <li>-Udhëzim nr. 6, datë 3.9.1992, Për zbatimin e ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”;</li> </ul>

	<p>-VKM nr. 469, dt. 3.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.</p> <p>-VKM.Nr.54. datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira”, i ndryshuar me VKM Nr.735, datë 05.11.2014; VKM Nr.445, datë 20.05.2015; VKM Nr.992, datë 09.12.2015; VKM Nr.229, datë 20.04.2016.</p> <p>-Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore në funksion të tyre.</p> <p>-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.</p> <p>-Statuti i miratuar nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme në Janar 2011 sipas shkresës me nr. prot. 1842, datë 17.02.2011</p> <p>-Rregullore e Brendshme miratuar me VKD nr. 12, dt. 29.06.2018</p>
<b>Ndikimi:</b>	Planifikimi jo efektiv krijon nevojën për rialokime të fondeve, si dhe rezulton me nivel të ulët realizimi të treguesve buxhetore.
<b>Shkaku:</b>	Planifikim jo efektiv i treguesve buxhetorë
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>1. Rekomandimi:</b>	DSHTD të bashkërendojë veprimet dhe koordinojë veprimtaritë me misionet diplomatike jashtë vendit të cilat ushtrojnë veprimtarinë në godinat në administrim të DSHTD-së, me qëllim hartimin dhe zbatimin e një buxheti të argumentuar e realist në drejtim të për investime apo punime mirëmbajtje në përputhje me afatet kohore të planifikimit të buxhetit.
<b>2. Rekomandimi:</b>	Institucioni të marrë masa për krijimin e një fondi të veçantë, për të gjitha godinat jashtë vendit, për punime emergjente apo të paparashikuara duke rritur në këtë mënyrë efikasitetin e procedurës së planifikimit të buxhetit.
<b>3. Rekomandimi:</b>	DSHTD të marrë masa për të kryer një planifikim efektiv të nivelit të fondeve të cilat do të përdoren për prokurime të materialeve, me qëllim të përdorimit sa më eficient të tyre.
<b>4. Rekomandimi:</b>	DSHTD të marrë masa që gjatë planifikimit buxhetor të parashikojë fonde për investime të cilat kanë probabilitet të lartë realizimi duke shmangur në këtë mënyrë praktikën e kryerjes së ndryshimeve buxhetore në fund të vitit.
<b>Afati zbatimit</b>	Menjëherë dhe në vijimësi

## 2.2. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE

Drejtorja e Shërbimit të Trupit Diplomatik është ndërmarrje shtetërore në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Funksionimi i saj kryhet në përputhje me ligjin nr. 7582 datë 13.07.1992 "Për Ndërmarrjet Shtetërore" dhe udhëzimin nr. 6 datë 13.03.1993 në zbatim të këtij ligji si dhe vendimin nr. 840 të Këshillit të Ministrave datë 17.12.2004 dhe vendimit 631 datë 15.09.2006 "Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit Diplomatik".

Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik është:

Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, prona shtetërore të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë. Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, pronë e shtetit shqiptar në shtete të tjera të cilat shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësive diplomatike.

Mënyra e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik,

përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre përcaktohet në statutin që miratohet nga Ministria e Punëve të Jashtme.

### **Pasqyrat financiare viti 2020**

#### ***Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore:***

Mbyllja e llogarive vjetore është kryer në datë 30.03.2021 dhe është bazuar në ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK), në ligjet fiskale dhe në udhëzuesin nr.2, datë 04.02.2014 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal”.

Pasqyrat financiare janë miratuar me vendim të KD nr. 7, dt. 30.03.2021, në përputhje me pikën 6 të VKM nr. 840, dt. 17.12.2024, ndryshuar me VKM nr. 631, dt. 15.09.2006. Me shkresën nr. 1525/1 prot., dt. 19.03.2021 është përcjellë në DSHTD shkresa e Ministrit të MEJP, për miratimin e emërimit të z. L.K. si ekspert kontabël për auditimin e llogarive vjetore të DSHTD. Në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, eksperti kontabël i emëruar nga MEJP ka kryer verifikimin e llogarive vjetore të vitit 2020. Raporti i ekspertit kontabël është protokolluar në DSHTD me nr. prot, 112/4, dt. 30.06.2021. Eksperti kontabël ka konkluduar me opinion me rezervë për pasqyrat financiarë të DSHTD për arsye se nuk ka arritur të verifikojë ekzistencën e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të arkëtueshme nga palët e lidhura, si dhe efektin e zhvlerësimit të këtyre llogarive në pasqyrat financiare.

#### ***Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2020 rezultoi:***

#### ***Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.***

#### **Aktivet afatshkurtra**

Gjendja e llogarive aktive afatshkurtra për vitin 2020, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2020-2019), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1

Në lekë

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019	Diferenca
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	67,085,128	56,825,869	10,259,259
Investime afatshkurtra	37,110,000	0	37,110,000
Llogari të arkëtueshme tregtare	10,893,686	13,575,090	-2,681,404
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	18,470,445	18,470,445	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	829,243	830,766	-1,523
Inventarë	32,100,353	31,914,352	186,001
Shpenzime të shtyra	1,697,940	0	1,697,940
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>168,186,795</b>	<b>121,616,522</b>	<b>43,464,739</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

**Aktive Afatshkurtra.** Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurtra dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve monetare” me “Investimet afatshkurtra”, “Llogarive të arkëtueshme”, Inventarëve dhe Shpenzimeve të shtyra. Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Mjete monetare me vlerë 67,085 mijë lekë e cila përfaqëson gjendjen në llogaritë bankare në datë 31.12.2020, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 2

Në lekë

Banka	Monedha	Gjendja
R. LEK	LEK	164,077
B. LEK	LEK	540,544
C. LEK	LEK	477,675
A. LEK	LEK	1,065,245
P. LEK	LEK	0
BAI	LEK	1,131,975
R. USD	USD	0

R. EURO	EUR	27,321,568
C. USD	USD	0
A. USD	USD	634,961
P. USD	USD	0
BAI në Dollarë	USD	0
B. EURO	EUR	495,901
C. EURO	EUR	338,462
A. EURO	EUR	15,361,661
BP. EURO	EUR	0
P. EURO	EUR	0
BAI ne Euro	EUR	19,553,059
Totali		67,085,127.37

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

2. Investime afatshkurtra në vlerë 37,110 mijë lekë përfaqëson një depozitë në euro në Bankën C. miratuar me VKD nr. 30, dt. 19.12.2019.

3. Llogaria të arkëtueshme tregtare në vlerë 10,894 mijë lekë, është krijuar duke mbledhur detyrimin e Ambasadës së ish – Jugosllave në vlerën 17,777 mijë lekë me gjendjen e klientëve më datë 31.12.21 pa përfshirë detyrimin e MEPJ, në vlerë 225 mijë lekë; dhe duke zbritur provigjonet e krijuara me vendim të Këshillit Drejtues nr. 28, dt. 28.12.2020 në vlerë 7,108 mijë lekë.

4. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura në vlerë 18,470 mijë lekë përfaqëson detyrimin që ka MEJP ndaj DSHTD-së. Ky detyrim rezultoi i mbartur nga viti 2008 dhe përfshin punime të kryera nga DSHTD për godinën e MEJP; shpenzime operative të vitit 2016 në Ambasadën në Uashington; si dhe shpenzime për dieta të kryera për llogari të MEPJ.

5. Të tjera llogari të arkëtueshme në vlerë 829 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar me 1,523 lekë, përfaqësojnë parapagime ndaj punonjësve në vlerën 199 mijë lekë; parapagime për Tatim Fitimin në vlerë 633 mijë lekë dhe të tjera në vlerë 2 mijë lekë.

Parapagimet ndaj punonjësve përfaqësojnë shpenzime telefonike të punonjësve të larguar nga institucioni të cilat janë kryer pas shkëputjeve të marrëdhënive të punës. DSHTD ka kryer pagesat për llogari të punonjësve si më poshtë vijon, pavarësisht se ato nuk ishin me pjesë e stafit të institucionit.

Tabela nr. 3

Në lekë

Emër	Monedha	Vlera	Viti
Sh. S.	LEK	13,028.00	2018
M. L.	LEK	40,683.00	2012-2013
S. P.	LEK	58.00	2018
V. B.	LEK	124,888.00	2014
L. P.	LEK	-505.00	
D. M.	LEK	3,526.00	2021
Y. T.	LEK	1,581.00	2021
O. B.	LEK	13,996.00	2019
H. V.	LEK	813.00	2019
Gj. S.	LEK	600.00	2018
Totali		198,668.00	

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

**Gjetje 1:** Në përputhje me SKK 2, pika 39 dhe 40 një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: (a) pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) e mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) pret të realizojë aktivin brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) aktivi është mjet monetar ose një ekuivalent i mjeteve monetare, i pa kufizuar për t'u përdorur për shkëmbim ose për të shlyer një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit. Njësia ekonomike duhet t'i klasifikojë të gjithë aktivet e tjera si afatgjata. Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk ka kryer klasifikimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e aktiveve afatshkurtra aktive të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti.

Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2, 39. Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur:

(a) ajo pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike;

Duke qenë se vlera e të arkëtueshmeve në shumën 194,066 lekë pritet të realizohet brenda afatit 12 mujor, dhe afati i realizimit është i pacaktuar, DSHTD ka vendosur që këtë shumë ta klasifikojë si aktiv afatshkurtër.

Kjo bazuar në guidën në përputhje me standardin 2 të kontabilitetit të përmirësuar, mbi bazën e të cilave është bërë plotësimi i pasqyrave.

a. Pasqyra e pozicionit financiar-udhëzues për plotësim.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Llogaria parapagime ndaj punonjësve rezulton e mbartur nga viti 2012, 2013, 2014, 2018 dhe 2019, pra nuk vlerat e arkëtueshme nuk janë realizuar brenda afatit 12 – mujor dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë**.

6. Inventarët në vlerën 32,100 mijë lekë, shtuar nga viti i kaluar me 186 mijë lekë, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr.4

Në lekë

Përshkrimi	Vlera
Materiale të tjera	2,412,442
Materialë ndihmës	15,457,968
Lëndë djegëse	8,738,332
Pjesë ndërrimi	46,000
Materiale të tjera	1,806,800
Inventar i imët	234,383
Inventar i imët ne përdorim	821,732
Mallra	1,936,923
Inventar i pa mbërritur ose tek të tretët	645,773
<b>Totali</b>	<b>32,100,352</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Materialet ndihmëse zënë peshën më të madhe të inventarëve dhe kryesisht përbëhen nga materiale konsumi hidraulike, elektrike, etj. të cilat nevojitet të zëvendësohen nga përdorimi i zakonshëm i godinës.

7. Shpenzime të shtyra në vlerë 1,698 mijë lekë, shtuar nga viti i kaluar me 1,698 mijë lekë, përfaqëson gjendjen e lëndës djegëse në fund të vitit ushtrimor sipas procesverbalit të mbajtur në datë 31.12.2021 nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Drejtorit të DSHTD – së nr. 236, dt. 16.09.2021.

### **Aktive Afatgjata**

Gjendja e llogarive aktive afatgjata për vitin 2020, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2020-2019), rezultojnë në vlerën 3,258,592 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 5,254 mijë lekë.

Tabela nr. 5

Në lekë

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019	Diferenca
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	3,263,845,227	3,138,469,460	125,375,767
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>	<b>3,263,845,227</b>	<b>3,138,469,460</b>	<b>125,375,767</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit



Tabela nr. 6

Në lekë

Toka	1,427,223,237
Ndërtesa	1,801,651,639
Kaldajat ne Ndërtesa	11,585,567
Kondicionerë	3,603,134
Instrumente dhe Vegla	1,607,465
Mjete transporti	2,235,578
Mobilje dhe pajisje zyre	1,090,781
Pajisje informative	1,775,965
Pajisje zyre	530,407
Te tjera	7,493,106
AA materiale ne proces	972,750
INVESTIME ne Misionin Shqiptar ne OKB ne NEW YORK	4,075,600
<b>Totali</b>	<b>3,263,845,227</b>

Të detajuara aktivet afatgjata materiale përbëhen nga:

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

1. Toka në vlerën 1,427,223 mijë lekë

2. Ndërtesa në vlerën 1,801,652 mijë lekë

- Gjatë vitit 2020, në saj të bashkëpunimit me MEPJ dhe Ambasadën në Romë, u bë i mundur sigurimi i dokumentit zyrtar të pronësisë së 10 apartamenteve Romë, dhe me Urdhër të përbashkët nr. 613 datë 21.12.2020 të MEPJ dhe nr. 529/5 datë 21.12.2020 të DSHTD, u krye kalimi kapital i inventarit për apartamentet në Romë në emër të DSHTD-së, me vlerën kadastrale të tyre 125,184,658 lekë, reflektuar kjo në aktivet afatgjata të DSHTD-së. Me Urdhër Nr. 163, datë 18.05.2022 me nr.448 prot. datë 18.05.2022 është ngritur grupi i punës për t'u dërguar me shërbim në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë, Itali, me qëllim ndër të tjera dhe verifikimin fizik në apartamentet. Grupi i punës ka paraqitur rezultatet e tyre në raportin me nr. prot. 448/4, datë. 31.05.2022. Gjatë verifikimit u konstatua se referuar informacionit nga DSHTD, apartamentet në pronësi të shtetit shqiptar janë ato me nr.13;14;15;16;19;20;21;22;23;24. Apartamenti nr.21 është ndarë midis Ap.nr.20 dhe 19 dhe Apartamenti Nr.14 është i ndarë ndërmjet Ap.nr.13 dhe 15 dhe si rrjedhojë nga 10 apartamente, me konfigurimin e ri aktualisht janë në dispozicion për përdorim 8 apartamente. Grupi i punës së DSHTD ka kryer verifikimet fizike në 5 prej apartamente dhe në 3 prej tyre, konkretisht në apartamentet nr. 13/14 dhe nr.23 dhe nr.16 nuk janë kryer verifikimet pasi rezidentët në këto ambiente nuk ishin të pranishëm.

**Gjetje 2:** Gjatë vitit 2020 është regjistruar në aktivet afatgjata vlera prej 125,184,658 lekë e 10 apartamenteve në Romë, të cilat kanë kaluar nga MEPJ në administrim të DSHTD – së, sipas urdhrat të përbashkët nr. 613 datë 21.12.2020 të MEPJ dhe nr. 529/5 datë 21.12.2020 të DSHTD. Grupi i auditimit konstatoi se regjistrimet në kontabilitet për këto aktive janë kryer vetëm për vlerën totale të 10 apartamenteve dhe jo duke detajuar vlerën specifike të secilës prej tyre. Gjithashtu grupi i punës së DSHTD – së i cili ka kryer verifikimet fizike në vitin 2022 në këto apartamente nuk ka kryer vlerësimet për të gjitha ambientet e banimit, por vetëm për pesë prej tyre.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD ka regjistruar në kontabilitet vlerën totale për 10 apartamente në Romë, por gjithashtu ka të regjistruar në evidence excel vlerën e detajuar të çdo apartamenti, sipas shkresës së ardhur nga MEPJ me nr. prot. 529/5 datë 21.12.2020.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Observacioni **merret pjesërisht në konsideratë** për arsye se rezulton e evidentuar vlera e secilit prej 10 apartamenteve, por verifikimet fizike janë kryer vetëm për pesë prej tyre.

**Gjetje 3:** Konstatohet se institucioni nuk disponon inventar të detajuar të godinave të cilat ndodhen jashtë Shqipërisë. DSHTD ka regjistruar vlerën fillestarë të godinës, por pa specifikuar elementët

specifik të cilët janë pjesë e saj. Gjithashtu investimet e kryera në këto godina i janë shtuar godinës vetëm në vlerë totale dhe jo sipas zërave të punimeve të kryera. Kjo situatë krijon problematika në përcaktimin e pjesëve takuese të godinës që i përkasin DSHTD dhe ato që i përkasin trupave diplomatik. Gjithashtu për shkak të mungesës së një detajimi të saktë krijohen vështirësi në përcaktimin e investimeve apo punimeve të mirëmbajtjes të cilat janë detyrim i DSHTD – së.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD gjatë vitit 2021, ka kryer inventarizimin e godinave jashtë për Ambasadën në Bruksel si dhe në Stokholm, ndërsa për Godinat e Ambasadeve të tjera, është në vijim duke marrë parasysh rekomandimet e KLSH. DSHTD ka kryer regjistrimin në kontabilitet të sasisë dhe vlerës totale fillestare për secilën godinë të Ambasadeve që ndodhen jashtë vendit, si dhe regjistron çdo vit shtesat e investimeve që realizohen në këto godina.

Gjithashtu DSHTD regjistron në mënyrë të detajuar në evidenca excel, investimet në godinat e Ambasadeve jashtë vendit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Komentet nga subjekti nuk e ndryshojnë gjendjen e evidentuar nga grupi auditues për periudhën e auditimit dhe observacioni **nuk merret në konsideratë**.

**Gjetje 4:** Gjatë vitit 2020 DSHTD ka kryer rivlerësime të objekteve. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka zgjedhur metodën e rivlerësimit për të matur vlerën e kategorisë së “ndërtesave”, dhe ka kryer rivlerësimin e disa prej tyre, por jo për të gjitha aktivet e përfshira në këtë kategori. Konkretisht janë rivlerësuar objektet me nr. pasurie 6/a; 6/b; 6/c; 6/d; 6/e dhe 6/f. Kjo mënyrë rivlerësimi nuk është në përputhje me SKK 5: Aktive Afatgjata Materiale, pika 24 dhe 25 i cili kërkon që nëse një aktiv afatgjatë rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e aktiveve afatgjata materiale të cilës ai i përket”. Bazuar në sa më sipër, sqarohet se DSHTD-ja nuk ka bërë rivlerësim tërësor për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale, por vetëm për një pjesë të tyre, për arsye të pamundësisë ekonomike dhe logjistike (një pjesë e ndërtesave janë Ambasadat e RSH jashtë vendit).

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD ka bërë rivlerësim të disa pronave dhe konkretisht të pallateve në rrugën “Skënderbej” dhe Bulevardi “Zogu I”, ndërsa për vilat e Ambasadeve brenda e jashtë vendit, nuk është bërë rivlerësim për arsye ekonomike e logjistike.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Komentet nga subjekti nuk e ndryshojnë gjendjen e evidentuar nga grupi auditues për periudhën e auditimit dhe observacioni **nuk merret në konsideratë**.

3. Kaldajat në ndërtesa në vlerën 11,586 mijë lekë;

4. Kondicionerë në ndërtesa në vlerën 3,603 mijë lekë;

5. Instrumente dhe Vegla në vlerën 1,607 mijë lekë përfaqësojnë pajisjet e punës të cilat përdoren nga teknikët e DSHTD – së për shërbimet e mirëmbajtjes dhe punimet të ndryshme.

6. Mjete transporti detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 7

Në lekë

	Përshkrimi	Njësia	Targa	Gjendje	Vlefte
	MJETET E TRANSPORTIT				LEKE
1	Volsvagen Pasat	cope	AA692MA	1.00	5,520,000
2	Autovetura Great Audi	cope	AA305EO	1.00	2,220,000
3	Kamionçina	cope	TR8321J	1.00	1,485,000
	Amortizim				-6,989,422
	<b>Totali</b>				<b>2,235,578</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

7. Mobilje dhe pajisje zyre në vlerën 1,091 mijë lekë përfaqësojnë mobilitet, orenditë, pajisjet elektroshtëpiake, etj. të cilat ndodhen në godinat në administrim të DSHTD – së.

9. Te tjera në vlerën 7,493 mijë lekë përfaqësojnë pajisje dhe instalime të tjera në godinat në administrim të DSHTD – së.

10. AA materiale në proces në vlerën 973 mijë lekë përfaqësojnë punimet në proces në godinat në administrim të DSHTD – së.

11. Investime në Misionin Shqiptar në OKB në New York në vlerën 4,076 mijë lekë përfaqëson pagesën prej 40,000 \$ të kryer për llogari të konsulentit ligjor në kuadër të zhvillimit të pronës shtetërore të shtetit shqiptar, tokë truall dhe ndërtesë të ndodhur në Manhattan Upper East Side, sipas përcaktimeve të VKM nr.203, datë 26.02.2020 dhe të Urdhrit nr.208, datë 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ.

Gjatë vitit 2020 janë kryer procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve me vlerë 955 mijë lekë. Me urdhër të Drejtorit nr. 272, dt. 27.11.2020 është ngritur komisioni për vlerësimin dhe asgjësimin e aktiveve që propozohen të hiqen nga përdorimi. Me shkresën nr. 962/2 prot., dt. 07.12.2020 sektori i planifikimit dhe financës ka përcjellë listën e aktiveve të propozuara për nxjerrjen jashtë përdorimit. Me shkresën nr. 962/4 prot., dt. 10.12.2020 grupi i punës ka përcjellë pranë Drejtorit të DSHTD informacionin dhe procesverbalin nr. 1, dt.10.12.2020 për vlerësimin e aktiveve të cilat do të nxirren jashtë përdorimit. Me shkresën nr. 962/5 prot., dt. 11.12.2020 sektori i planifikimit dhe financës i ka paraqitur Këshillit Drejtues relacionin për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në administrim të DSHTD – së. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 26, dt. 11.12.2020 është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të propozuara nga komisioni i vlerësimit të aktiveve.

### **Detyrimet afatshkurtra**

Gjendja e llogarive detyrime afatshkurtra për vitin 2020, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2020-2019), rezultojnë në vlerën 31,994 mijë lek, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 6,336 mijë lekë.

Tabela nr. 8

Në lekë

<b>DETYRIMET</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>Diferenca</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	10,977,037	13,901,124	-2,924,087
Detyrime tatimore	2,599,634	4,489,256	-1,889,622
Grante dhe të ardhurat të shtyra	3,928,808	11,982,660	-8,053,852
Provizione	4,134,511	2,099,960	2,034,551
Të tjera detyrime	10,353,988	5,856,764	4,497,224
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>31,993,978</b>	<b>38,329,764</b>	<b>-6,335,786</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Në mënyrë të detajuar detyrimet afatshkurtra janë si më poshtë vijon:

2. Llogari tregtare të pagueshme në vlerë 10,977 mijë lekë detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 9

Në lekë

Subjekti	Vlera
F.	140,934
H.	1,629,882
F.	214,500
S.	221,370
<b>PERSONA FIZIKE</b>	<b>33,985</b>
E.	155,040
GJ.	81,000
M.	13,097
A.	63,600
S.	210,412
D.	73,697
R.	78,360
G.H.	235,560

I.	90,960
K.	22,729
M.	47,880
R.	7,664,032
<b>Totali</b>	<b>10,977,038</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Llogaritë tregtare afatshkurtra përbëhen nga tre lloje debitorësh.

- Subjektet F., H.; S.; M. dhe R., kanë lëshuar faturat për kryerjen e shërbimeve në fund të vitin 2021 dhe likuidimi i tyre është mbartur në vitin pasardhës;
- Detyrimi ndaj subjekteve G.H. dhe K. përfaqëson garancinë e punimeve në masën 5% e mbajtur për riparimin e defekteve që mund të shfaqen pas përfundimit të punimeve;
- Detyrimi ndaj subjekteve të tjera janë të mbartura nga vit pas viti dhe për të cilat nuk janë kryer likuidimet.

**Gjetje 5:** Në përputhje me SKK 2, pika 41 dhe 42 një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur: (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) njësi ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit. Njësia ekonomike duhet t'i klasifikojë të gjithë detyrimet e tjera si afatgjata. Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk ka kryer klasifikimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e detyrimeve afatshkurtra detyrime të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2

41.Një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur:

- (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike;
- (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi;
- (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose
- (d) njësi ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit.

Duke qenë se vlera e detyrimeve afatshkurtra pritet të shlyhet brenda afatit 12 mujor, ose afati i shlyerjes është i pacaktuar, DSHTD ka vendosur që këto detyrime ti klasifikojë si Detyrime afatshkurtra.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Llogaria tregtare të pagueshme rezultojnë e mbartur nga vitet e kaluara si dhe në vitet në vijim, pra nuk vlerat e detyrimeve nuk është shlyer brenda afatit 12 – mujor dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë**.

3. Detyrimet tatimore në vlerë 2,600 mijë lekë i përbërë nga detyrimi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe Tatimi mbi të ardhurat personale të muajit Dhjetor 2020 të cilat paguhen në muajin pasardhës.

Tabela nr. 10

	Në lekë
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	901,142
Tatim mbi të ardhurat personale	202,308
Tatim mbi fitimin	1,496,184
Tatim mbi fitimin i mbartur	
<b>Totali</b>	<b>2,599,634</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

4. Grante dhe të ardhura të shtyra në vlerë 3,929 mijë lekë, e cila përfaqëson paradhëniet, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 11

Në lekë

Të ardhura të periudhave të ardhshme		Vlera Debi	Vlera Kredi
Gjendja Fillestare për Vitin 2020			11,982,660
qira (mars - dhjetor 20) +(janar -shkurt 21 ) ap 8/3/34 G. 12 muaj *1100.47=13205.64 euro			270,297
mbyllja e llog 488 për qiratë Janar - Qershor 20		9,974,964	
qira korrik - dhjetor 20 + janar - shkurt 21 ap 8/3/40 G. = 6* 1100+ 2*1100 euro			273,284
qira dhjetor 20+ janar+ shkurt 2021 ap 6/2/20 G.			260,106
qira dhjetor 20 + janar + shkurt 2021 ap 6/1/1 G.			283,435
qira dhjetor 20 + janar+ shkurt 2021 ap 6/1/2 G.			169,111
qira janar+ shkurt+ mars 2021 ap 8/2/7 G.			689,170
qira janar - dhjetor 2021 ap 8/3/28 A.S. 12muaj*1163.96=13967.52 euro			1,729,738
qira janar+ shkurt+ mars 2021 ap 6/1/4 G. 3 muaj*682.78=2048.34 euro			253,666
mbyllja e llog 488 për periudhën korrik- dhjetor v 2020		2,007,696	
	<b>Lëvizjet</b>	11,982,660	15,911,468
	<b>Gjendja</b>		<b>3,928,808</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

5. Provizione në vlerë 4,135 mijë lekë, e cila përfaqëson provizionet për çështjet gjyqësorë të krijuara me vendim të Këshillit Drejtues nr.1 dt. 06.01.2020 dhe VKD nr. 12. dt..28.05.2020.
6. Të tjera detyrime në vlerë 10,354 mijë lekë, e cila përfaqëson garancitë për kontratat e qirasë në vlerën 8,532 mijë lekë; detyrimin e DSHTD – së ndaj MFE në përputhje me VKM nr. 54, dt. 05.02.2014, “Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore”, pika 7, në vlerën 1,465 mijë lekë; dhe detyrime të tjera në vlerën 358 mijë lekë që përfaqëson pagën e muajit dhjetor të punonjësve e cila është kaluar në muajin pasardhës.

Për vitin 2020 DSHTD nuk ka detyrime afatgjata.

### **Kapitali**

Kapitali i DSHTD është në vlerën 3,400,038 mijë lekë dhe është i përbërë nga

Tabela nr. 12

Në lekë

DETYRIMET	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 20219	Diferenca
Kapitali i paguar	3,120,460,177	2,995,275,519	125,184,658
Rezerva statutore	202,382,700	168,407,100	33,975,600
Rezerva ligjore	5,486,470	3,059,641	2,426,829
Fondi i ndihmave te menjëhershme	3,897,561	2,320,732	1,576,829
Fondi i shpërblimit rezerve te punonjësve	9,514,340	2,233,856	7,280,484
Fonde te tjera	4,349,628	1,922,799	2,426,829
Rezultati i ushtrimit	53,947,168	48,536,571	5,410,597
<b>Totali</b>	<b>3,400,038,044</b>	<b>3,221,756,218</b>	<b>171,946,040</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Me vendim të Këshillit Drejtues nr.1, dt. 30.03.2021 është miratuar shpërndarja e fitimit të vitit 2019 në vlerën 48,537 mijë lekë, në përputhje me nenin 11.1 të ligjit Nr.7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore” si më poshtë vijon:

- 70% e fitimit ose vlera 33,976 lekë është kaluar në llogarinë Rezerva statutore
- 5% e fitimit ose vlera 2,427 mijë lekë është kaluar në llogarinë Rezerva ligjore
- 15% e fitimit ose vlera 7,280 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fondi i shpërblimit, në përputhje me ligjin Nr.7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, neni 13.1
- 5% e fitimit ose vlera 2,427 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fondi i ndihmës sociale

- 5% e fitimit ose vlera 2,427 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fonde të tjera

### **Pasqyra e Performancës**

Në përputhje me VKM nr. 840, dt. 17.12.2004 “Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, si dhe nenin 14 të Rregullores së Brendshme të DSHTD, burimet financiare të DSHTD janë:

- Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për Trupin Diplomatik të huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;
- Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për subjekte të treta, si dhe nga shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;
- Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera dytësore;
- Donacionet, vendase ose të huaja, të dhëna me miratimin paraprak të Ministrit të Punëve të Jashtme.

Gjendja e llogarive të të ardhurave për vitin 2020, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2020-2019), rezultojnë në vlerën 203,669 mijë lekë, shtuar nga viti i kaluar në vlerën 8,076 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar të ardhurat janë si më poshtë vijon:

Tabela nr. 13

Në lekë

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Ndryshimi</b>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	189,395,541	181,153,683	8,241,858
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	-	-	-
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar	13,977,426	14,725,789	-748,363
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	295,612	-286,644	582,256
<b>Total të ardhura</b>	<b>203,668,579</b>	<b>195,592,828</b>	<b>8,075,751</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

1. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit, përfshin të ardhurat nga qiratë e përfutuara nga godinat në administrim të DSHTD – së, detajuar në aneksin 2. Në total DSHTD ka në administrim 97 pasuri, nga të cilat për 81 prej tyre ka lidhur kontrata qiraje me misionet diplomatike dhe subjekte të treta të cilat gjenerojnë të ardhura; dhe për 16 prej tyre nuk arkëtohet qira për arsytet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 14

Në lekë

Nr.	Apartamenti	Kontrata Nr. Indeks	Subjektet	Data e fillimit	Data e mbarimit	Vlera e kontratës ALL/ muaj	Sipërfaqe	Çmimi /m2
1	Pall.8, Shk.3, Kati Përdhe	BOSH	BOSH				26.64	
2	4/1/1	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		92.27	
3	4/1/2	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		95.32	
4	4/1/3	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		121.69	
5	4/1/4	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		152.99	
6	4/1/11	BOSH	BOSH				121.69	8 €/m2
7	4/1/16	BOSH	BOSH			152.94		
8	4/1/17	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				92.27	
9	4/1/18	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				95.32	
10	4/1/19	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				121.69	
11	4/1/20	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				152.99	

12	8/2/2	F.R.	F.R.	F.R.	F.R.	F.R.	231	
13	8/3/35	Mpj/S.F.B.P.		22,12,2014	Dhjetor 2024		122.82	
14	8/3/36	Mpj//S.F.B.P.		22,12,2014	Dhjetor 2024		88.76	
15	vila nr. 57	A.K.	marrëveshje	marrëveshje				
16	Pall.6, Shk.1+2, Kati Përdhe	W.	Kontrate nr. 3241 prot, dt. 23.05.2013	259 + 89	23.05.2013	22.05.2023		145, 543

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

-Katër apartamentet në katin e parë të pallatit nr. 4, janë në përdorim të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik të cilat përdoren për zyra:

- Apartamenti 4.1.1
- Apartamenti 4.1.2
- Apartamenti 4.1.3
- Apartamenti 4.1.4

-Katër apartamentet në katin e fundit të pallatit nr. 4, janë në përdorim të A., bazuar në VKM Nr. 592, dt. 25.05.2009 "Për dhënien në përdorim të disa mjediseve A.të K. Sh. të E.", konkretisht:

- Apartamenti 4.1.17
- Apartamenti 4.1.18
- Apartamenti 4.1.19
- Apartamenti 4.1.20

-Apartamenti 8.2.2 është në përdorim të përkohshëm pa shpërblim, për Stafin e Sekretariatit të Zyrës Rajonale për B. R., bazuar në VKM Nr. 816, dt. 29.12.2017.

-Apartamenti 8.3.35 dhe Apartamenti 8.3.36, janë në përdorim nga Sekretariati i F.B.P., bazuar në VKM Nr. 856, datë 10.12.2014, i ndryshuar me Vendimin nr. 28, datë 22.01.2020.

-Marrëdhënia për objektin Vila nr. 57, në të cilën ushtron veprimtarinë e saj A.R.P.K., është e rregulluar me VKM – në nr. 67, dt. 28.01.2015 dhe Marrëveshjen mbi ofrimin e ndërsjellët të truallit dhe ambienteve të ambasadave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së R.P.K..

- Për subjektin W. është lidhur kontrata e qirasë me nr. 3241 rep., nr. 585 kol, datë 23.05.2013, midis shoqërisë "W." dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjetikes (METE). Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik si njësi monitoruese e kësaj kontrate qiraje, monitoron dhe ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratës në mbështetje të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Kreu VI "Monitorimi i Kontratave", si dhe Udhëzimit Nr. 13, datë 26.04.2018 "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar. Detyrimi mujor i kësaj kontrate qiraje arkëtohet nga subjekti qiramarrës për llogari të DSHTD-së.

2. Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar në vlerën 13,977 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar me 748 mijë lekë, përfaqësojnë investimet e kryera gjatë vitit 2020 në godinat në administrim të DSHTD. Investimet brenda vendit janë në vlerën 17,754 mijë lekë ndërsa 66 mijë lekë janë investuar në Ambasadën në Stokholm. Në kushtet kur DSHTD kryen me punonjësit dhe materialet e saj investimin atëherë vlera e investimit kontabilizohet në llogarinë e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

3. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit në vlerë 295,612 lekë, përfaqëson fitim/humbjen nga kursi valutor.

**Gjetje 6:** Në përputhje me SKK 2, shtojca 2 në Të ardhura të tjera të shfrytëzimit përfshihen "Të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale

ndryshimet në llogaritë/kërkesat e arkëtueshme dhe detyrimet për t'u paguar furnitorëve (nëse rezulton një humbje neto, ajo njihet në zërin "Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit"). Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit klasifikohen në llogarinë Të ardhurat dhe shpenzimet financiare, dhe jo në Të ardhura të shfrytëzimit.

Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2, 56 Shtojca 2 e SKK2 paraqet një numër minimal të zërave të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Përbërja e saktë e zërave të kësaj pasqyre varet nga aktivitetet e njësisë ekonomike dhe praktikës ndërkombëtare në fushën ku kjo njësi operon. Çdo njësi ekonomike duhet të japë në politikën dhe procedurat e saj kontabël përshkrime të hollësishme, se cilat të ardhura dhe shpenzime janë përfshirë në zërat përkatës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Njësia ekonomike duhet t'i përmbahet këtij klasifikimi në mënyrë të vazhdueshme dhe DSHTD këtë ka bërë, fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për neto, në mënyrë të vazhdueshme është klasifikuar tek "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit". Kjo bazuar në guidën në përputhje me standardin 2 të kontabilitetit e përmirësuar mbi bazën e të cilave është bërë plotësimi i pasqyrave.

b. Pasqyra e performancës sipas natyrës -udhëzues për plotësim.

Ne SKK e përmirësuar "Kompensimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (njohja në Shumën neto)" në paragrafin 60 pika (C): Fitim /humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në përputhje me SKK 2, shtojca 2 fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit klasifikohen në llogarinë Të ardhurat dhe shpenzimet financiare, dhe jo në Të ardhura të shfrytëzimit dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë.**

## Shpenzimet:

Tabela nr. 15

Në lekë

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Ndryshimi
<b>Lënda e parë materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime</b>	<b>-55,027,158</b>	<b>-52,547,676</b>	
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	-33,398,480	-31,623,024	1,644,851
2) Të tjera shpenzime	-21,628,678	-20,924,652	-1,654,567
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>-46,199,316</b>	<b>-45,440,089</b>	
1) Paga dhe shpërblime	-39,719,016	-39,064,416	-654,600
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	-6,480,300	-6,375,673	-104,627
<b>Zhvlerësim i aktiveve afatgjata materiale</b>	<b>0</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	<b>-37,742,638</b>	<b>-38,129,916</b>	<b>387,278</b>
<b>Shpenzime të tjera të shfrytëzimit</b>	<b>-3,315,858</b>	<b>-3,467,467</b>	<b>151,609</b>
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>2,668,799</b>	<b>1,706,074</b>	<b>962,725</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		-	-
Shpenzime të tjera financiare	2,668,799	1,706,074	962,725

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

- Lënda e parë, materiale të konsumueshme në vlerën 33,398 mijë lekë përfaqëson shpenzimet për blerje materiale të tjera, materiale ndihmëse, lëndë djegëse, inventar i imët dhe mallra dhe shërbime.
- Të tjera shpenzime në vlerë 21,629 mijë lekë përfaqëson shpenzimet për materialet, materiale ndihmëse, lëndë djegëse, energji, ujë, mallra dhe shërbime. Gjatë vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2020, rezultati neto nga nxjerrja jashtë përdorimit është përkatësisht 332,260 lekë për dalje jashtë përdorimit të inventarit dhe 621,460 lekë për dalje jashtë përdorimit të asetëve.
- Paga dhe shpërblime në vlerën 39,719 mijë lekë përfaqëson pagat e punonjësve për vitin 2020.



- Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore në vlerën 6,480 mijë lekë përfaqëson sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të paguara për punonjësit për vitin 2020.
- Shpenzimet e amortizimit në vlerën 37,743 mijë lekë janë llogaritur si më poshtë vijon:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	2%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

**Gjetje 7:** Grupi i auditimit konstatoi se norma e amortizimit për kategorinë e aktiveve nuk është llogaritur në përputhje me normat e përcaktuara në Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, neni 22. DSHTD ka llogaritur amortizim për ndërtesat në masën 2% të vlerës së asetit në fillim të vitit ushtrimor, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar i cili përcakton se kosto e ndërtesave amortizohet me normën 5%.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD-ja me VKD nr. 16, datë 30.08.2017 ka miratuar normën e amortizimit për godinat që administrohen në masën 2%, bazuar në analizën e Sektorit të Buxhetit dhe Financës në relacionin përkatës drejtuar KD me nr. prot.904/1, datë 29.08.2017 “Relacion për të ulur normën e amortizimit për godinat që administrohen nga DSHTD-ja”, me arsyetimin se: Nisur nga fakti se investimet dhe riparimet në ndërtesat e administruara nga DSHTD-ja janë të përvitshme dhe në një vlerë relativisht të lartë, si dhe duke patur parasysh gjendjen fizike të ndërtesave pas investimeve dhe riparimeve, norma e amortizimit tavan 5 % është jo reale për DSHTD-në, pra nuk pasqyron amortizimin real të ndërtesave që administrohen nga DSHTD-ja.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Relacioni i paraqitur nga subjekti për uljen e normës së amortizimit nuk paraqet argumente justifikues dhe nuk ka një analizë të strukturuar për përcaktimin e nivelit 2% si norma efektive e amortizimit dhe për pasojë observacioni **nuk merret në konsideratë**.

- Shpenzime të tjera të shfrytëzimit në vlerën 3,316 mijë lekë përfaqëson shpenzimet për gjoba dhe dëmshpërblime dhe provizionet e krijuara për zhvlerësimin e aktiveve.

- Shpenzimet të tjera financiare janë në vlerën pozitive prej 2,669 mijë lekë dhe përfaqësojnë rimbursimin nga shoqëria e sigurimit A. në shumën 2,560 mijë lekë, si pjesë e marrëveshjes për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019 në godinat pronë e DSHTD-së të cilat kanë qenë të siguruara në këtë kompani, kamatëvonesat e qiramarrësve të cilët kanë tejkalaru afatin e pagesës së qirasë; si dhe mbyllja e investimeve në Athinë.

Në fund të vitit ushtrimor 2020, DSHTD raporton fitim në vlerën 64,052 mijë lekë mbi të cilin paguhet vlera e tatueshme në masën 15% në përputhje me Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, neni 28.

## **Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare të vitit 2021**

### **Pasqyrat financiare viti 2021**

*Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.*

Mbyllja e llogarive vjetore është kryer në datë 30.03.2022 dhe është bazuar në ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK), në ligjet fiskale dhe në udhëzuesin nr.2, datë 04.02.2014 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal”.

Pasqyrat financiare janë miratuar me vendim të KD nr. 1, dt. 05.04.2022, në përputhje me pikën 6 të VKM nr. 840, dt. 17.12.2024, ndryshuar me VKM nr. 631, dt. 15.09.2006. Me shkresën nr. 1512/1

prot., dt. 16.06.2022 është përcjellë në DSHTD urdhri nr. 8239 prot., dt. 14.06.2022 i Ministrit të MEJP, nëpërmjet të cilit është emëruar znj. G.A. si eksperte kontabël për auditimin e llogarive vjetore të DSHTD. Në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, eksperti kontabël i emëruar nga MEJP ka kryer verifikimin e llogarive vjetore të vitit 2021. Raporti i ekspertit kontabël është protokolluar në DSHTD me nr. prot, 86/3, dt. 26.07.2022. Eksperti kontabël ka konkluduar me opinion me rezervë për pasqyrat financiare të DSHTD për arsye se nuk ka arritur të verifikojë ekzistencën e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të arkëtueshme nga palët e lidhura, si dhe efektin e zhvlerësimit të këtyre llogarive në pasqyrat financiare.

***Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 rezultoi:***

***Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.***

### **Aktivitet afatshkurtra**

Gjendja e llogarive aktive afatshkurtra për vitin 2021, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 16

Në lekë

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020	Diferenca
<b>AKTIVE</b>				
<b>Aktive afatshkurtra</b>				
Mjete monetare		60,324,178	67,085,128	(6,760,950)
Investime afatshkurtra		97,187,648	37,110,000	60,077,648
Llogari të arkëtueshme tregtare		10,072,723	10,893,686	(820,963)
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		18,470,445	18,470,445	
Të tjera llogari të arkëtueshme		955,757	829,243	126,514
Inventarë		21,538,383	32,100,353	(10,561,970)
Shpenzime të shtyra		3,102,400	1,697,940	1,404,460
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara				
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>211,651,534</b>	<b>168,186,795</b>	<b>43,464,739</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

**Aktive Afatshkurtra.** Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurtra dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve monetare” me “Investimet afatshkurtra”, “Llogarive të arkëtueshme”, Inventarëve dhe Shpenzimeve të shtyra.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Mjete monetare me vlerë 60,324 mijë lekë e cila përfaqëson gjendjen në llogaritë bankare në datë 31.12.2021, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 17

Në lekë

Banka	Monedha	Gjendja
R. LEK	LEK	1,646,738
B. LEK	LEK	28,465
C. LEK	LEK	1,117,996
I. LEK	LEK	330,597
BAI	LEK	352,039
R. EURO	EUR	29,179,780
I. USD	USD	5,681
B. EURO	EUR	374,489
C. EURO	EUR	46,087
I. EURO	EUR	7,704,527
BAI në Euro	EUR	19,537,718
Vlera monetare, në lekë	LEK	1
Vlera monetare, në monedha të huaja EUR	EUR	60
Xhirime të brendshme	LEK	
<b>Totali</b>		<b>60,324,177</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

2. Investime afatshkurtra në vlerë 97,188 mijë lekë përfaqëson një depozitë në euro në Bankën C. me VKD nr. 28, dt. 28.12.2020.
3. Llogaria të arkëtueshme tregtare në vlerë 10,073 mijë lekë, është krijuar duke mbledhur detyrimin e Ambasadës së ish – Jugosllave në vlerën 17,480 mijë lekë me gjendjen e klientëve më datë 31.12.21 pa përfshirë detyrimin e MEPJ, në vlerë 738 mijë lekë; dhe duke zbritur provigjonet e krijuara me vendim të Këshillit Drejtues nr. 28, dt. 28.12.2020 në vlerë 8,145 mijë lekë.
4. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura në vlerë 18,470 mijë lekë përfaqëson detyrimin që ka MEJP ndaj DSHTD-së. Ky detyrim rezulton i mbartur nga viti 2008 dhe përfshin punime të kryera nga DSHTD për godinën e MEJP; shpenzime operative të vitit 2016 në Ambasadën në Washington; si dhe shpenzime për dieta të kryera për llogari të MEPJ.
5. Të tjera llogari të arkëtueshme në vlerë 956 mijë lekë, shtuar nga viti i kaluar me 1267 mijë lekë, përfaqësojnë parapagimet e kryera ndaj punonjësve në vlerën 199 mijë lekë; parapagimet për Tatim Fitimin në vlerë 755 mijë lekë dhe të Tjera në vlerë 2 mijë lekë.
- Parapagimet ndaj punonjësve përfaqësojnë shpenzime telefonike të punonjësve të larguar nga institucioni të cilat janë kryer pas shkëputjeve të marrëdhënieve të punës. DSHTD ka kryer pagesat për llogari të punonjësve si më poshtë vijon, pavarësisht se ato nuk ishin me pjesë e stafit të institucionit.

Tabela nr. 18

Në lekë

Emër	Monedha	Vlera	Viti
Sh. S.	LEK	13,028.00	2018
M. L.	LEK	40,683.00	2012-2013
S. P.	LEK	58.00	2018
V. B.	LEK	124,888.00	2014
L. P.	LEK	-505.00	
D. M.	LEK	3,526.00	2021
Y. T.	LEK	1,581.00	2021
O. B.	LEK	13,996.00	2019
H. V.	LEK	813.00	2019
Gj. S.	LEK	600.00	2018
Totali		198,668.00	

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

**Gjetje 8:** Në përputhje me SKK 2, pika 39 dhe 40 një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: (a) pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) e mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) pret të realizojë aktivin brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) aktivi është mjet monetar ose një ekuivalent i mjeteve monetare, i pa kufizuar për t'u përdorur për shkëmbim ose për të shlyer një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit. Njësia ekonomike duhet t'i klasifikojë të gjithë aktivet e tjera si afatgjata. Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk ka kryer klasifikimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e aktiveve afatshkurtra aktive të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2, 39. Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur:

(a) ajo pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike;

Duke qenë se vlera e të arkëtueshmeve në shumën 194,066 lekë pritet të realizohet brenda afatit 12 mujor, dhe afati i realizimit është i pacaktuar, DSHTD ka vendosur që këtë shumë ta klasifikojë si aktiv afatshkurtër.

Kjo bazuar në guidën në përputhje me standardin 2 të kontabilitetit të përmirësuar, mbi bazën e të

cilave është bërë plotësimi i pasqyrave.

a. Pasqyra e pozicionit financiar-udhëzues për plotësim.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Llogaria parapagime ndaj punonjësve rezulton e mbartur nga viti 2012, 2013, 2014, 2018 dhe 2019, pra nuk vlerat e arkëtueshme nuk janë realizuar brenda afatit 12 – mujor dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë**.

6. Inventarët në vlerën 21,538,383 lekë, pakësuar nga viti i kaluar me 10,561,970 lekë, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 19

Në lekë

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Materiale te tjera	2,302,666
Materiale ndihmës	14,863,055
Lëndë djegëse	404,592
Pjesë ndërrimi	46,000
Inventar i imët ne përdorim	-
Mallra	3,297,318
Inventar i pa mbërritur ose tek të tretët	645,773
Materiale te tjera	- 21,021
Materiale ndihmese	-
Lende djegëse	-
Mallra për shitje	-
Zhvlerësimi i materialeve të tjera	-
<b>Totali</b>	<b>21,538,384</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Materialet ndihmëse zënë peshën më të madhe të inventarëve dhe kryesisht përbëhen nga materiale konsumi hidraulike, elektrike, etj. të cilat nevojitet të zëvendësohen nga përdorimi i zakonshëm i godinës.

7. Shpenzime të shtyra në vlerë 3,102 mijë lekë, shtuar nga viti i kaluar me 1,404 mijë lekë, përfaqëson gjendjen e lëndës djegëse në fund të vitit ushtrimor sipas procesverbalit të mbajtur në datë 31.12.2021 nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Drejtorit të DSHTD – së nr. 236, dt. 16.09.2021.

### **Aktive Afatgjata**

Gjendja e llogarive aktive afatgjata për vitin 2021, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultojnë në vlerën 3,258,592 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 5,254 mijë lekë.

Tabela nr. 20

Në lekë

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>Diferenca</b>
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	3,258,591,515	3,263,845,227	(5,253,712)
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>	<b>3,258,591,515</b>	<b>3,263,845,227</b>	<b>(5,253,712)</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Të detajuara aktivet afatgjata materiale përbëhen nga:

Tabela nr. 21

Në lekë

Toka	1,427,223,237
Ndërtesa	1,793,334,793
Kaldajat ne Ndërtesa	11,006,289
Kondicionerë	4,011,887
Instrumente dhe Vegla	1,972,305
Mjete transporti	5,448,463
Mobilje dhe pajisje zyre	1,543,281
Pajisje informative	1,517,100
Te tjera	7,564,610
AA materiale në proces	893,950
Investime në Misionin Shqiptar në OKB në NEW YORK	4,075,600

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

1. Toka në vlerën 1,427,223 mijë lekë
2. Ndërtesa në vlerën 1,793,335 mijë lekë detajuar në aneksin 3. Gjatë vitit 2021 DSHTD nuk ka kryer rivlerësime të objekteve.
3. Kaldajat në ndërtesa detajuar si më poshtë vijon

Tabela nr. 22

Në lekë

Përshkrimi	Njësia	Llogari inventar	Gjendja	Kosto	Vlefata
Kaldajat ne ndërtesa					
Kaldaje Solari komplet v 2018	cope	2132	1	1,356,000	1,356,000
Depozite Karburanti 10000 litërshe v 2018	cope	2132	1	598,800	598,800
Shkëmbyes nxehtësie për kaldaja v 2019	cope	2132	2	60,000	120,000
Depozita uji 1500 lit për kaldaja v 2019	cope	2132	2	72,000	144,000
Boljer 1500 lit për kaldaja v 2019	cope	2132	3	180,000	540,000
Kaldaje solari 350 kë v 2019 te pallati 8	cope	2132	1	1,500,000	1,500,000
Kaldajat ne ndërtesa	cope	2132	6	4,895,376	29,372,255
Amortizimi i akumuluar					(22,624,766)
		<b>Totali</b>			11,006,289

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

4. Kondicionerë në ndërtesa detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 23

Në lekë

Përshkrimi	Njësia	Llogari inventar	Gjendja	Kosto	Vlefata
MAGAZINA E VLERA VE NE PERDORIM					
Kondicioner 12 BTU	cope	2133	12	6,586	79,026
kondicioner viti 2000	cope	2133	3	174,250	522,750
kondicioner v 2003-2006	cope	2133	63	82,800	5,216,400
kondicioner v 2007	cope	2133	56	58,281	3,263,736
kondicioner v 2008	cope	2133	12	53,597	643,164
kondicioner v 2009	cope	2133	7	65,657	459,599
kondicioner v 2010	cope	2133	8	59,500	476,000
kondicioner v 2011	cope	2133	10	45,000	450,000
kondicioner v 2012	cope	2133	9	33,960	305,640
kondicioner v 2013	cope	2133	9	46,406	417,652
Kondicioner 12 btu V 2014	cope	2133	17	87,384	1,485,528
Kondicioner 18 btu v2014	cope	2133	2	145,200	290,400
Kondicioner 12 btu v 2015	cope	2133	8	87,384	699,072
Kondicioner 18 btu v 2015	cope	2133	1	145,200	145,200
KONDICIONER 12 BTU V 2016	cope	2133	20	77,868	1,557,360
KONDICIONER 18 btu viti 2016	cope	2133	3	133,140	399,420
KONDICIONER 12 BTU Inverter VITI 2018	cope	2133	15	70,396	1,055,934
KONDICIONER18 BTU Inverter viti 2018	cope	2133	4	104,358	417,432
Kondicioner 24 btu viti 2018	cope	2133	1	106,800	106,800
KONDICIONER9 BTUviti 2020	cope	2133	3	49,337	148,010

KONDITIONER12 BTU viti 2020	cope	2133	6	51,094	306,563
KONDITIONER 9BTU viti 2021	cope	2133	2	60,600	121,200
KONDITIONER 12BTU viti 2021	cope	2133	15	63,960	959,400
KONDITIONER 24BTU viti 2021	cope	2133	1	136,560	136,560
Amortizimi i akumuluar					<b>-15,650,959.00</b>
		<b>Totali</b>	<b>287</b>		4,011,887

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

5. Instrumente dhe Vegla në vlerën 1,972 mijë lekë përfaqësojnë pajisjet e punës të cilat përdoren nga teknikët e DSHTD – së për shërbimet e mirëmbajtjes dhe punimet të ndryshme.

6. Mjete transporti detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 24

Në lekë

Përshkrimi	Njësia	Llogari inventar	Gjendja	Kosto	Vleftha
Magazina e Vlerave ne Përdorim					
Autovetura Great Audi	cope	215	1	2,220,000	2,220,000
Kamionçina	cope	215	1	1,485,000	1,485,000
Ë Pasat	cope	215	1	5,520,000	5,520,000
Kamionçine Renault Master 3.5 TON me vinç blere VITI 2021	cope	215	1	3,660,000	3,660,000
Amortizim i akumuluar					(7,436,537)
		<b>Totali</b>	<b>4</b>		5,448,463

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

7. Mobilje dhe pajisje zyre në vlerën 1,543 mijë lekë përfaqësojnë mobiljet, orenditë, pajisjet elektroshtëpiake, etj. të cilat ndodhen në godinat në administrim të DSHTD – së.

9. Te tjera në vlerën 7,565 mijë lekë përfaqësojnë pajisje dhe instalime të tjera në godinat në administrim të DSHTD – së.

10. AA materiale në proces në vlerën 894 mijë lekë përfaqësojnë punimet në proces në godinat në administrim të DSHTD – së.

11. Investime në Misionin Shqiptar në OKB në New York në vlerën 4,076 mijë lekë përfaqëson pagesën prej 40,000 \$ të kryer për llogari të konsulentit ligjor në kuadër të zhvillimit të pronës shtetërore të shtetit shqiptar, tokë truall dhe ndërtesë të ndodhur në Manhattan Upper East Side, sipas përcaktimeve të VKM nr.203, datë 26.02.2020 dhe të Urdhrit nr.208, datë 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ.

Gjatë vitit 2021 janë kryer procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve me vlerë 1,282 mijë lekë. Me urdhër të Drejtorit nr. 299, dt. 07.12.2021 është ngritur komisioni për vlerësimin dhe asgjësimin e aktiveve që propozohen të hiqen nga përdorimi. Me shkresën nr. 1087/1 prot., dt. 17.12.2021 sektori i planifikimit dhe financës ka përcjellë listën e aktiveve të propozuara për nxjerrjen jashtë përdorimit. Me shkresën nr. 1087/3 prot., dt. 22.12.2021 grupi i punës ka përcjellë pranë Drejtorit të DSHTD informacionin dhe procesverbalin nr. 1, dt.22.12.2021 për vlerësimin e aktiveve të cilat do të nxirren jashtë përdorimit. Me shkresën nr. 1087/4 prot., dt. 23.12.2021 sektori i planifikimit dhe financës i ka paraqitur Këshillit Drejtues relacionin për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në administrim të DSHTD – së. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 32, dt. 23.12.2021 është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të propozuara nga komisioni i vlerësimit të aktiveve.

**Gjetje 9:** Konstatohet se institucioni nuk disponon inventar të detajuar të godinave të cilat ndodhen jashtë Shqipërisë. DSHTD ka regjistruar vlerën fillestarë të godinës, por pa specifikuar elementët specifik të cilët janë pjesë e saj. Gjithashtu investimet e kryera në këto godina i janë shtuar godinës vetëm në vlerë totale dhe jo sipas zërave të punimeve të kryera. Kjo situatë krijon problematika në përcaktimin e pjesëve takuese të godinës që i përkasin DSHTD dhe ato që i përkasin trupave diplomatik. Gjithashtu për shkak të mungesës së një detajimi të saktë mund të lindin vështirësi në përcaktimin e investimeve apo punimeve të mirëmbajtjes të cilat janë detyrim i DSHTD – së dhe cilat i takojnë qiramarrësit.

Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD gjatë vitit 2021, ka kryer inventarizimin e godinave jashtë për Ambasadën në Bruksel si dhe në Stokholm, ndërsa për Godinat e Ambasadeve të tjera, është në vijim duke marrë parasysh rekomandimet e KLSH. DSHTD ka kryer regjistrimin në kontabilitet të sasisë dhe vlerës totale fillestare për secilën godinë të Ambasadeve që ndodhen jashtë vendit, si dhe regjistron çdo vit shtesat e investimeve që realizohen në këto godina.

Gjithashtu DSHTD regjistron në mënyrë të detajuar në evidenca excel, investimet në godinat e Ambasadeve jashtë vendit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Komentet nga subjekti nuk e ndryshojnë gjendjen e evidentuar nga grupi auditues për periudhën e auditimit dhe observacioni **nuk merret në konsideratë**.

### **Detyrimet afatshkurtra**

Gjendja e llogarive detyrime afatshkurtra për vitin 2021, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultojnë në vlerën 21,636,201 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 10,358 mijë lekë.

Tabela nr. 25

Në lekë

<b>DETYRIMET</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>Diferenca</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	1,945,620	10,977,037	- 9,031,417
Detyrime tatimore	1,578,170	2,599,634	- 1,021,464
Grante dhe të ardhurat të shtyra	1,860,397	3,928,808	- 2,068,411
Provizione	4,099,960	4,134,511	- 34,551
Të tjera detyrime	12,152,054	10,353,988	1,798,066
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>21,636,201</b>	<b>31,993,978</b>	<b>- 10,357,777</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Në mënyrë të detajuar detyrimet afatshkurtra janë si më poshtë vijon:

2. Llogari tregtare të pagueshme në vlerë 1,945 mijë lekë detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 26

Në lekë

Subjekti	Vlera
H.	319,129.80
F.	214,500.00
S.	76,527.62
K.	204.20
<b>PERSONA FIZIKE</b>	<b>33,982.22</b>
E.	155,040.00
GJ.	81,000.00
A.A.SH.	11,545.00
M.	13,097.00
A.	63,600.00
S.	210,412.00
D.	73,697.00
R.	78,360.00
M.C.	64,362.80
I.	90,960.00
I.E.	12,264.00
A.C.	151,440.10
T.S.	18,000.00
S.	183,000.00
A.	60,858.00
K.H.	21,701.00
I.B.S.	11,940.00
<b>TOTALI</b>	<b>1,945,620.74</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Llogaritë tregtarë afatshkurtra përbëhen nga tre lloje debitorësh.

- Subjektet H.; S.; A.A.Sh.; I.E.; A.C. dhe T.S. kanë lëshuar faturat për kryerjen e shërbimeve në fund të vitin 2021 dhe likuidimi i tyre është mbartura në vitin pasardhës;
- Detyrimi ndaj subjekteve S., A., K.H. dhe I.B.S. përfaqëson garancinë e punimeve në masën 5% e mbajtur për riparimin e defekteve që mund të shfaqen pas përfundimit të punimeve.
- Detyrimi ndaj subjekteve të tjera janë të mbartura nga vit pas viti dhe për të cilat nuk janë kryer likuidimet.

**Gjetje 10:** Në përputhje me SKK 2, pika 41 dhe 42 një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur: (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) njësia ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit. Njësia ekonomike duhet t'i klasifikojë të gjithë detyrimet e tjera si afatgjata. Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk ka kryer klasifikimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e detyrimeve afatshkurtra detyrime të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2

41.Një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur:

- (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike;
- (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi;
- (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose
- (d) njësia ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit.

Duke qenë se vlera e detyrimeve afatshkurtra pritet të shlyhet brenda afatit 12 mujor, ose afati i shlyerjes është i pacaktuar, DSHTD ka vendosur që këto detyrime ti klasifikojë si Detyrime afatshkurtra.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Llogaria tregtarë të pagueshme rezultojnë e mbartur nga vitet e kaluara si dhe në vitet në vijim, pra nuk vlerat e detyrimeve nuk është shlyer brenda afatit 12 – mujor dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë**.

3. Detyrimet tatimore në vlerë 1,578 mijë lekë i përbërë nga detyrimi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe Tatimi mbi të ardhurat personale të muajit Dhjetor 2021 të cilat paguhet në muajin pasardhës.

Tabela nr. 27

Në lekë

Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	886,163
Tatim mbi të ardhurat personale	692,007
Tatim mbi fitimin	0
Tatim mbi fitimin i mbartur	0
<b>Totali</b>	<b>1,578,170</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

4. Grante dhe të ardhura të shtyra në vlerë 1,860 mijë lekë, e cila përfaqëson paradhëniet, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 28

Në lekë

Përshkrimi	Gjendja në monedhe llogari	
	Debi	Kredi
Të ardhura të periudhave të ardhshme		
<b>Gjendja me pare:</b>	<b>.00</b>	<b>3,928,807.00</b>



qira ap 8/1/9+8/1/10 qershor - dhjetor 2021 + janar - maj 2022 A.S.	.00	814,527.99
sa kthyer një pjese e shumës së paguar parapagim dhjetor 20 ap 8/3/28 A.S. pasi largohet nga ap	.00	-655,632.49
mbyllja e llog 486 e 488 nga viti 20 për shp e te ardh ne vitin 2021	3,273,174.51	.00
qira dhjetor21 + janar + shkurt 2022 ap 6/1/1 muaj 3*1144.36=3433.08	.00	277,324.20
qira dhjetor 21 + janar+ shkurt 2022 ap 6/1/2 G. 3 muaj *682.78=2048.34 euro	.00	165,464.91
qira dhjetor 21+ janar 2022 ap 6/1/3 G., muaj 2*1144.36=2288.72 euro	.00	138,662.10
qira dhjetor 21+ janar+shkurt + mars 2022 ap 6/2/20 G. 4 muaj*1050=4200 euro	.00	381,685.50
qira dhjetor 21+ janar 2022 ap 6/1/4 G. ,muaj 2 *682.78 =1365.56 euro	.00	82,732.45
<b>Lëvizja</b>	<b>3,273,174.51</b>	<b>1,204,764.66</b>
<b>Gjendja</b>	<b>.00</b>	<b>1,860,397.15</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

5. Provizione në vlerë 4,100 mijë lekë, e cila përfaqëson provizionet për çështjet gjyqësorë të krijuara me vendim të Këshillit Drejtues nr. 28, dt. 28.12.2020.
6. Të tjera detyrime në vlerë 12,152 mijë lekë, e cila përfaqëson garancitë për kontratat e qirasë në vlerën 10,446 mijë lekë; detyrimin e DSHTD – së ndaj MFE në përputhje me VKM nr. 54, dt. 05.02.2014, “Për Përcaktimin e Kriteve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore”, pika 7, në vlerën 1,541 mijë lekë; dhe detyrime të tjera në vlerën 165 mijë lekë që përfaqëson pagën e muajit dhjetor të punonjësve e cila është kaluar në muajin pasardhës.

Për vitin 2021 DSHTD nuk ka detyrime afatgjata.

## **Kapitali**

Kapitali i DSHTD është në vlerën 3,448,607 mijë lekë dhe është i përbërë nga:

Tabela nr. 29

Në lekë

<b>DETYRIMET</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>Diferenca</b>
Kapitali i paguar	3,120,460,177	3,120,460,177	0
Rezerva statutore	240,145,718	202,382,700	37,763,018
Rezerva ligjore	8,183,828	5,486,470	2,700,358
Fondi i ndihmave të menjëhershme	6,294,919	3,897,561	2,397,358
Fondi i shpërblimit rezerve të punonjësve	14,467,640	9,514,340	4,953,358
Fonde të tjera	7,046,986	4,349,628	2,697,358
Rezultati i ushtrimit	52,007,580	53,947,168	-1,939,588
<b>Totali</b>	<b>3,448,609,848</b>	<b>3,400,038,044</b>	<b>48,571,804</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 12, dt. 26.05.2021 është miratuar shpërndarja e fitimit të vitit 2020 në vlerën 53,947 mijë lekë, në përputhje me nenin 11.1 të ligjit Nr.7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore” si më poshtë vijon:

- 70% e fitimit ose vlera 37,763 mijë lekë është kaluar në llogarinë Rezerva statutore
- 5% e fitimit ose vlera 2,697 mijë lekë është kaluar në llogarinë Rezerva ligjore
- 15% e fitimit ose vlera 8,092 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fondi i shpërblimit, në përputhje me ligjin Nr.7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, neni 13.1
- 5% e fitimit ose vlera 2,697 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fondi i ndihmës sociale
- 5% e fitimit ose vlera 2,697 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fonde të tjera

## **Pasqyra e Performancës**

Në përputhje me VKM nr. 840, dt. 17.12.2004 “Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik”, si dhe nenin 14 të Rregullores së Brendshme të DSHTD, burimet financiare të DSHTD janë:

- a) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për Trupin Diplomantik të huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;
- b) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për subjekte të treta, si dhe nga shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;
- c) Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera dytësore;

ç) Donacionet, vendase ose të huaja, të dhëna me miratimin paraprak të Ministrit të Punëve të Jashtme

Gjendja e llogarive të të ardhurave për vitin 2021, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultojnë në vlerën 202,984 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 685 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar të ardhurat janë si më poshtë vijon:

Tabela nr. 30

Në lekë

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Ndryshimi
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	189,067,094	189,395,541	- 328,447
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimin në proces	-	-	0
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar	17,820,038	13,977,426	3,842,612
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	- 3,903,508	295,612	- 4,199,120
<b>Total të ardhura</b>	<b>202,983,624</b>	<b>203,668,579</b>	<b>- 684,955</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

1. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit, përfshin të ardhurat nga qiratë e përfutuara nga godinat në administrim të DSHTD – së, detajuar në aneksin 4. Në total DSHTD ka në administrim 97 pasuri, nga të cilat për 81 prej tyre ka lidhur kontrata qiraje me misionet diplomatike dhe subjekte të treta të cilat gjenerojnë të ardhura; dhe për 16 prej tyre nuk arkëtohet qira për arsyet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 31

Në lekë

Nr.	Apartamenti	Kontrata Nr. Indeks	Subjektet	Data e fillimit	Data e mbarimit	Vlera e kontratës ALL/ muaj	Sipërfaqe	Çmimi /m2
1	Pall.8, Shk.3, Kati Përdhe	BOSH	BOSH				26.64	
2	4/1/1	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		92.27	
3	4/1/2	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		95.32	
4	4/1/3	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		121.69	
5	4/1/4	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		152.99	
6	4/1/11	BOSH	BOSH				121.69	8 €/m2
7	4/1/16	BOSH	BOSH			152.94		
8	4/1/17	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				92.27	
9	4/1/18	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				95.32	
10	4/1/19	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				121.69	
11	4/1/20	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				152.99	
12	8/2/2	F.R.	F.R.	F.R.	F.R.	F.R.	231	
13	8/3/35	Mpj/S.F.B.P.		22,12,2014	Dhjetor 2024		122.82	
14	8/3/36	Mpj/S.F.B.P.		22,12,2014	Dhjetor 2024		88.76	
15	vila nr. 57	A.K.	marrëveshje	marrëveshje				
16	Pall.6, Shk.1+2, Kati Përdhe	W.	Kontrate nr. 3241 prot, dt. 23.05.2013	259 + 89	23.05.2013	22.05.2023		145, 543

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

-Katër apartamentet në katin e parë të pallatit nr. 4, janë në përdorim të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik të cilat përdoren për zyra:

- Apartamenti 4.1.1
- Apartamenti 4.1.2
- Apartamenti 4.1.3
- Apartamenti 4.1.4

-Katër apartamentet në katin e fundit të pallatit nr. 4, janë në përdorim të A., bazuar në VKM Nr. 592, dt. 25.05.2009 “Për dhënien në përdorim të disa mjediseve A. të K. Sh. të E.”, konkretisht:

- Apartamenti 4.1.17
- Apartamenti 4.1.18
- Apartamenti 4.1.19
- Apartamenti 4.1.20

-Apartamenti 8.2.2 është në përdorim të përkohshëm pa shpërblim, për Stafin e Sekretariatit të Zyrës Rajonale për B.R., bazuar në VKM Nr. 816, dt. 29.12.2017.

-Apartamenti 8.3.35 dhe Apartamenti 8.3.36, janë në përdorim nga S.F.B.P., bazuar në VKM Nr. 856, datë 10.12.2014, i ndryshuar me Vendimin nr. 28, datë 22.01.2020. (Bashkëlidhur VKM).

-Marrëdhënia për objektin Vila nr. 57, në të cilën ushtron veprimtarinë e saj A.R.P.K., është rregulluar me VKM – në nr. 67, dt. 28.01.2015 dhe Marrëveshjen mbi ofrimin e ndërsjellët të truallit dhe ambienteve të ambasadave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së R.P.K.

- Për subjektin W. është lidhur kontrata e qirasë me nr. 3241 rep., nr. 585 kol, datë 23.05.2013, midis shoqërisë "W." dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjetikes (METE). Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik si njësi monitoruese e kësaj kontrate qiraje, monitoron dhe ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratës në mbështetje të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Kreu VI "Monitorimi i Kontratave", si dhe Udhëzimit Nr. 13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar. Detyrimi mujor i kësaj kontrate qiraje arkëtohet nga subjekti qiramarrës për llogari të DSHTD-së.

2. Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar në vlerën 17,820 mijë lekë, rritur nga viti i kaluar me 3,843 mijë lekë, përfaqësojnë investimet e kryera gjatë vitit 2021 në godinat në administrim të DSHTD. Investimet brenda vendit janë në vlerën 17,754 mijë lekë ndërsa 66 mijë lekë janë investuar në Ambasadën në Stokholm. Në kushtet kur DSHTD kryen me punonjësit dhe materialet e saj investimin atëherë vlera e investimit kontabilizohet në llogarinë e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

3. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit në vlerë -3,904 mijë lekë, përfaqëson humbjen nga kursi valutor.

**Gjetje 11:** Në përputhje me SKK 2, shtojca 2 në Të ardhura të tjera të shfrytëzimit përfshihen “Të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet në llogaritë/kërkesat e arkëtueshme dhe detyrimet për t’u paguar furnitorëve (nëse rezulton një humbje neto, ajo njihet në zërin “Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit”)”. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit klasifikohen në llogarinë Të ardhurat dhe shpenzimet financiare, dhe jo në Të ardhura të shfrytëzimit.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2, 56 Shtojca 2 e SKK2 paraqet një numër minimal të zërave të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Përbërja e saktë e zërave të kësaj pasqyre varet nga aktivitetet e njësisë ekonomike dhe praktikës ndërkombëtare në fushën ku kjo njësi operon. Çdo

njësi ekonomike duhet të japë në politikat dhe procedurat e saj kontabël përshkrime të hollësishme, se cilat të ardhura dhe shpenzime janë përfshirë në zërat përkatës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Njësia ekonomike duhet t'i përmbahet këtij klasifikimi në mënyrë të vazhdueshme dhe DSHTD këtë ka bërë, fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për neto, në mënyrë të vazhdueshme është klasifikuar tek "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit". Kjo bazuar në guidën në përputhje me standardin 2 të kontabilitetit e përmirësuar mbi bazën e të cilave është bërë plotësimi i pasqyrave.

b. Pasqyra e performancës sipas natyrës -udhëzues për plotësim.

Ne SKK e përmirësuar "Kompensimi i te ardhurave dhe shpenzimeve (njohja ne Shumën neto)" në paragrafin 60 pika (C): Fitim /humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në përputhje me SKK 2, shtojca 2 fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit klasifikohen në llogarinë Të ardhurat dhe shpenzimet financiare, dhe jo në Të ardhura të shfrytëzimit dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë**.

### Shpenzimet:

Tabela nr. 32

Në lekë

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Ndryshimi
<b>Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime</b>	<b>-55,036,874</b>	<b>-55,027,158</b>	
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	-31,753,629	-33,398,480	1,644,851
2) Të tjera shpenzime	-23,283,245	-21,628,678	-1,654,567
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>-45,933,707</b>	<b>-46,199,316</b>	
1) Paga dhe shpërblime	-39,475,108	-39,719,016	243,908
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	-6,458,599	-6,480,300	21,701
<b>Zhvlërësim i aktiveve afatgjata materiale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	<b>-40,259,997</b>	<b>-37,742,638</b>	<b>-2,517,359</b>
<b>Shpenzime të tjera të shfrytëzimit</b>	<b>-2,044,275</b>	<b>-3,315,858</b>	<b>1,271,583</b>
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>1,837,372</b>	<b>2,668,799</b>	<b>- 831,427</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	779,322		779,322
Shpenzime të tjera financiare	1,058,050	2,668,799	-1,610,749

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

- Lënda e parë, materiale të konsumueshme në vlerën 31,754 mijë lekë përfaqëson shpenzimet për materialet, materiale ndihmëse, mallra dhe shërbime.

- Të tjera shpenzime në vlerë 23,283 mijë lekë detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 33

Në lekë

	Valuta	Vlera
Shpenzime të tjera		
Vlera kontabël e aktive afatgjata te shitura	LEK	821,732.00
Vlera kontabël e aktive afatgjata te shitura	LEK	109,725.00
Vlera kontabël e aktive afatgjata te shitura	LEK	31,883.00
Vlera kontabël për AA te tjera	LEK	22,087.92
Vlera kontabël e pajisjeve informative	LEK	33,165.00
Vlera kontabël e te tjerave	LEK	336,843.96
Blerje, energji, avull, ujë	LEK	1,668,823.60
Mirëmbajtje dhe riparime	LEK	3,774,706.75
Sigurime	LEK	2,530,905.61
Të tjera	LEK	2,554,915.64
Transferime, udhëtime, dieta	LEK	3,385,078.54
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	LEK	592,014.49
Shpenzime për shërbimet bankare	LEK	388,620.27
Taksa dhe tarifa vendore	LEK	6,984,586.00
Taksa e regjistrimit	LEK	43,154.00
Tatime të tjera	LEK	5,000.00
		23,283,242

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

- Paga dhe shpërblime në vlerën 39,475 mijë lekë përfaqëson pagat e punonjësve për vitin 2021 dhe shpërblimet në vlerë 3,139 mijë lekë.
- Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore në vlerën 6,459 mijë lekë përfaqëson sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të paguara për punonjësit për vitin 2021.
- Shpenzimet e amortizimit në vlerën 40,260 mijë lekë janë llogaritur si më poshtë vijon:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e Amortizimit</b>	<b>Norma e Amortizimit</b>
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	2%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilie dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

**Gjetje 12:** Grupi i auditimit konstatoi së norma e amortizimit për kategorinë e aktiveve nuk është llogaritur në përputhje me normat e përcaktuara në Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, neni 22. DSHTD ka llogaritur amortizim për ndërtesat në masën 2% të vlerës së asetit në fillim të vitit ushtrimor, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar i cili përcakton se kosto e ndërtesave amortizohet me normën 5%.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD-ja me VKD nr. 16, datë 30.08.2017 ka miratuar normën e amortizimit për godinat që administrojnë në masën 2%, bazuar në analizën e Sektorit të Buxhetit dhe Financës në relacionin përkatës drejtuar KD me nr. prot.904/1, datë 29.08.2017 “Relacion për të ulur normën e amortizimit për godinat që administrohen nga DSHTD-ja”, me arsyetimin se: Nisur nga fakti se investimet dhe riparimet në ndërtesat e administruara nga DSHTD-ja janë të përvitshme dhe në një vlerë relativisht të lartë, si dhe duke patur parasysh gjendjen fizike të ndërtesave pas investimeve dhe riparimeve, norma e amortizimit tavan 5 % është jo reale për DSHTD-në, pra nuk pasqyron amortizimin real të ndërtesave që administrohen nga DSHTD-ja.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Relacioni i paraqitur nga subjekti për uljen e normës së amortizimit nuk paraqet argumente justifikues dhe nuk ka një analizë të strukturuar për përcaktimin e nivelit 2% si norma efektive e amortizimit, për pasojë observacioni **nuk merret në konsideratë**.

-Shpenzimet interesi dhe shpenzime të ngjashme janë në vlerën pozitive prej 779 mijë lekë dhe përfaqësojnë interesat kreditorë të depozitës 300.000 euro në vlerë 185,561 lekë dhe interesat e depozitës 800.000 euro në vlerë 593,760 lekë.

- Shpenzimet të tjera financiare janë në vlerën pozitive prej 1,058 mijë lekë dhe përfaqësojnë kamatëvonesat e paguara nga qiradhënësit për vonesat në pagesat e qirave në vlerë 49,832 lekë; dëmshpërblim nga kompania e sigurimeve A. për dëmet e shkaktuara nga tërmeti në godinat në administrim të DSHTD në vlerë 883,619 lekë; dhe të ardhurat nga rivlerësimi në vlerë 174,597 lekë. Në fund të vitit ushtrimor 2021, DSHTD raporton fitim në vlerën 61,546 mijë lekë mbi të cilin paguhet vlera e tatueshme në masën 15% në përputhje me Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, neni 28.

#### **a. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare**

##### **Pasqyrat financiare viti 2022**

*Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.*

Mbyllja e llogarive vjetore është kryer në datë 30.03.2023 dhe është bazuar në ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK), në ligjet fiskale dhe në udhëzuesin nr.2, datë 04.02.2014 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal”.

Pasqyrat financiare janë miratuar me vendim të KD nr. 7, dt. 28.03.2023 në përputhje me pikën 6 të VKM nr. 840, dt. 17.12.2024, ndryshuar me VKM nr. 631, dt. 15.09.2006.

***Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 rezultoi:***

***Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.***

### **Aktivitet afatshkurtra**

Gjendja e llogarive aktive afatshkurtra për vitin 2022, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2022-2021), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 34

Në lekë

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021	Diferenca
<b>AKTIVE</b>				
<b>Aktive afatshkurtra</b>				
Mjete monetare		44,620,879	60,324,178	- 15,703,299
Investime afatshkurtra		148,499,000	97,187,648	51,311,352
Llogari të arkëtueshme tregtare		13,581,707	10,072,723	3,508,984
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		18,470,445	18,470,445	-
Të tjera llogari të arkëtueshme		5,569,468	955,757	4,613,711
Inventarë		18,481,927	21,538,383	- 3,056,456
Shpenzime të shtyra		2,520,000	3,102,400	- 582,400
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-		-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>251,743,426</b>	<b>211,651,534</b>	<b>40,091,892</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

**Aktive Afatshkurtra.** Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurtra dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve monetare” me “Investimet afatshkurtra”, “Llogarive të arkëtueshme”, Inventarëve dhe Shpenzimeve të shtyra.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Mjete monetare me vlerë 44,621 mijë lekë e cila përfaqëson gjendjen në llogaritë bankare në datë 31.12.2022, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 35

Në lekë

Banka	Monedha	Gjendja
R. LEK	LEK	106,170
B. LEK	LEK	29,381
C. LEK	LEK	137,895
I. LEK	LEK	1,762,199
BAI	LEK	345,539
R. EURO	EUR	15,010,311
I. USD	USD	5,708
B. EURO	EUR	299
C. EURO	EUR	32,195
I. EURO	EUR	9,384,012
BAI në Euro	EUR	17,807,170
<b>Totali</b>		<b>44,620,879</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

2. Investime afatshkurtra në vlerë 148,499 mijë lekë përfaqëson një depozitë në euro në Bankën C. me VKD nr. 30, dt. 17.12.2021.

3. Llogaria të arkëtueshme tregtare në vlerë 13,582 mijë lekë, është krijuar duke mbledhur detyrimin e Ambasadës së ish – Jugosllave në vlerën 17,480 mijë lekë me gjendjen e klientëve më datë 31.12.21 pa përfshirë detyrimin e MEPJ, në vlerë 6,128 mijë lekë; dhe duke zbritur provigjonet e krijuara për zhvlerësimin e klientëve me vendim të Këshillit Drejtues nr. 30, dt. 17.12.2023 në vlerë 10,032 mijë lekë.

4. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura në vlerë 18,470 mijë lekë përfaqëson detyrimin që ka

MEPJ ndaj DSHTD-së. Ky detyrim rezultoi i mbartur nga viti 2008 dhe përfshin punime të kryera nga DSHTD për godinën e MEPJ; shpenzime operative të vitit 2016 në Ambasadën në Washington; si dhe shpenzime për dieta të kryera për llogari të MEPJ.

5. Të tjera llogari të arkëtueshme në vlerë 5,569 mijë lekë, shtuar nga viti i kaluar me 4,614 mijë lekë, përfaqësojnë parapagimet e kryera ndaj punonjësve në vlerën 219 mijë lekë; parapagimet për Tatim Fitimin në vlerë 5,318 mijë lekë dhe të Tjera në vlerë 33 mijë lekë.

Parapagimet ndaj punonjësve përfaqësojnë shpenzime telefonike të punonjësve të larguar nga institucioni të cilat janë kryer pas shkëputjeve të marrëdhënieve të punës. DSHTD ka kryer pagesat për llogari të punonjësve si më poshtë vijon, pavarësisht se ato nuk ishin me pjesë e stafit të institucionit.

Tabela nr. 36

Në lekë

Emër	Monedha	Vlera	Viti
Sh.S.	LEK	13,028	2018
M.L.	LEK	40,683	2012-2013
E.A.	LEK	1,084	2022
S.P.	LEK	58	2018
V.B.	LEK	124,888	2014
K.T.	LEK	700	2022
L.P.	LEK	-413	2022
D.M.	LEK	0	2021
Y.T.	LEK	1,581	2021
O.B.	LEK	13,996	2019
H.V.	LEK	813	2019
Gj.S.	LEK	600	2018
E.C.	LEK	21,520	2022
<b>Totali</b>		<b>218,538.00</b>	

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

**Gjetje 13:** Në përputhje me SKK 2, pika 39 dhe 40 një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: (a) pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) e mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) pret të realizojë aktivin brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) aktivi është mjet monetar ose një ekuivalent i mjeteve monetare, i pa kufizuar për t'u përdorur për shkëmbim ose për të shlyer një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit. Njësia ekonomike duhet t'i klasifikojë të gjithë aktivet e tjera si afatgjata. Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk ka kryer klasifikimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e aktiveve afatshkurtra aktive të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2, 39. Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur:

(a) ajo pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike;

Duke qene se vlera e të arkëtueshmeve në shumën 194,066 lekë pritet të realizohet brenda afatit 12 mujor, dhe afati i realizimit është i pacaktuar, DSHTD ka vendosur që këtë shumë ta klasifikojë si aktiv afatshkurtër.

Kjo bazuar në guidën në përputhje me standardin 2 të kontabilitetit të përmirësuar, mbi bazën e të cilave është bërë plotësimi i pasqyrave.

a. Pasqyra e pozicionit financiar-udhëzues për plotësim.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Llogaria parapagime ndaj punonjësve rezulton e mbartur nga viti 2012, 2013, 2014, 2018 dhe 2019, pra nuk vlerat e arkëtueshme nuk janë realizuar brenda afatit 12 – mujor dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë**.

6. Inventarët në vlerën 18,482 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar me 3,056 mijë lekë, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 37

Në lekë

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Materiale te tjera	1,192,427
Materiale ndihmese	13,787,023
Lëndë djegëse	95,957
Pjesë ndërrimi	46,000
Inventar i imët ne përdorim	-
Mallra	2,737,523
Inventar i pa mbërritur ose tek të tretët	645,773
Materiale te tjera	- 22,776
<b>Totali</b>	<b>21,538,384</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Materialet ndihmëse zënë peshën më të madhe të inventarëve dhe kryesisht përbëhen nga materiale konsumi hidraulike, elektrike, etj. të cilat nevojitet të zëvendësohen nga përdorimi i zakonshëm i godinës.

7. Shpenzime të shtyra në vlerë 2,520 mijë lekë, shtuar nga viti i kaluar me 582 mijë lekë, përfaqëson gjendjen e lëndës djegëse në fund të vitit ushtrimor sipas procesverbalit të mbajtur në datë 04.01.2023 nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Drejtorit të DSHTD – së nr. 122, dt. 13.04.2022.

### **Aktive Afatgjata**

Gjendja e llogarive aktive afatgjata për vitin 2022, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2022-2021), rezultojnë në vlerën 3,248,184 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 10,408 mijë lekë.

Tabela nr. 38

Në lekë

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>Diferenca</b>
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	3,248,183,832	3,258,591,515	(10,407,683)
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>	<b>3,248,183,832</b>	<b>3,258,591,515</b>	<b>(10,407,683)</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr. 39

Në lekë

Toka	1,427,223,237
Ndërtesa	1,779,049,877
Kaldajat ne Ndërtesa	10,455,975
Kondicionerë	4,115,231
Instrumente dhe Vegla	1,672,423
Mjete transporti	4,358,771
Mobilje dhe pajisje zyre	1,495,875
Pajisje informative	2,136,085
Te tjera	7,682,163
AA materiale në proces	1,711,150
Investime në Romë	4,207,445
Investime në Misionin Shqiptar në OKB në NEW YORK	4,075,600

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Të detajuara aktivet afatgjata materiale përbëhen nga:

1. Toka në vlerën 1,427,223 mijë lekë
2. Ndërtesa në vlerën 1,779,050 mijë lekë detajuar në aneksin 5. Gjatë vitit 2022 DSHTD nuk ka kryer rivlerësime të objekteve.



3. Kaldajat në ndërtesa në vlerën 10,456 mijë lekë.
4. Kondicionerë në ndërtesa në vlerën 4,115 mijë lekë.
5. Instrumente dhe Vegla në vlerën 1,672 mijë lekë përfaqësojnë pajisjet e punës të cilat përdoren nga teknikët e DSHTD – së për shërbimet e mirëmbajtjes dhe punimet të ndryshme.
6. Mjete transporti detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 40

Në lekë

Përshkrimi	Njësia	Llogari inventar	Gjendja	Kosto	Vleftha
Magazina e Vlerave ne Përdorim					
Autovetura Great Audi	cope	215	1	2,220,000	2,220,000
Kamionçina	cope	215	1	1,485,000	1,485,000
Ë Pasat	cope	215	1	5,520,000	5,520,000
Kamionçine Renault Master 3.5 TON me vinç blere VITI 2021	cope	215	1	3,660,000	3,660,000
Amortizim i akumuluar					-8,526,229
		<b>Totali</b>	<b>4</b>		4,358,771

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

7. Mobilje dhe pajisje zyre në vlerën 1,496 mijë lekë përfaqësojnë mobiljet, orenditë, pajisjet elektroshtëpiake, etj. të cilat ndodhen në godinat në administrim të DSHTD – së.

9. Te tjera në vlerën 7,682 mijë lekë përfaqësojnë pajisje dhe instalime të tjera në godinat në administrim të DSHTD – së.

10. AA materiale në proces në vlerën 1,711 mijë lekë përfaqësojnë punimet në proces në godinat në administrim të DSHTD – së.

11. Investime në Misionin Shqiptar në OKB në New York në vlerën 4,076 mijë lekë përfaqëson pagesën prej 40,000 \$ të kryer për llogari të konsulentit ligjor në kuadër të zhvillimit të pronës shtetërore të shtetit shqiptar, tokë truall dhe ndërtesë të ndodhur në Manhattan Upper East Side, sipas përcaktimeve të VKM nr.203, datë 26.02.2020 dhe të Urdhrit nr.208, datë 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ.

12. Investime në Romë në vlerën 4,207 mijë lekë përfaqësojnë investimin e kryer godinën e Ambasadës në Romë, në nëntor të vitit 2022 në vlerën 36833.1 euro duke i zbritur 5% e garancisë në vlerën 1841.66 euro.

Gjatë vitit 2022 janë kryer procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve me vlerë 326,845 lekë. Me urdhër të Drejtorit nr. 436, dt. 09.12.2022 është ngritur komisioni për vlerësimin dhe asgjësimin e aktiveve që propozohen të hiqen nga përdorimi. Me shkresën nr. 1217/1 prot., dt. 16.12.2022 sektori i planifikimit dhe financës ka përcjellë listën e aktiveve të propozuara për nxjerrjen jashtë përdorimit. Me shkresën nr. 1217/2 prot., dt. 22.12.2022 grupi i punës ka përcjellë pranë Drejtorit të DSHTD informacionin dhe procesverbalin nr. 1, dt.22.12.2022 për vlerësimin e aktiveve të cilat do të nxirren jashtë përdorimit. Me shkresën nr. 1217/3 prot., dt. 22.12.2022 sektori i planifikimit dhe financës i ka paraqitur Këshillit Drejtues relacionin për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në administrim të DSHTD – së. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 20, dt. 22.12.2022 është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të propozuara nga komisioni i vlerësimit të aktiveve. Me shkresën nr. prot. 1217/4, dt. 23.12.2022 DSHTD ka njoftuar Drejtorinë Rajonale të Tatimeve për datën dhe orën e kryerjes së procedurës së asgjësimit të aktiveve. Asgjësimi i aktiveve është dokumentuar në procesverbalin nr. prot. 1217/5, dt. 30.12.2022 i firmosur nga Titullari i DSHTD dhe përfaqësuesit e DPT.

**Gjetje 14:** Konstatohet se institucioni nuk disponon inventar të detajuar të godinave të cilat ndodhen jashtë Shqipërisë. DSHTD ka regjistruar vlerën fillestarë të godinës, por pa specifikuar elementët specifik të cilët janë pjesë e saj. Gjithashtu investimet e kryera në këto godina i janë shtuar godinës vetëm në vlerë totale dhe jo sipas zërave të punimeve të kryera. Kjo situatë krijon problematika në përcaktimin e pjesëve takuese të godinës që i përkasin DSHTD dhe ato që i përkasin trupave diplomatik. Gjithashtu për shkak të mungesës së një detajimi të saktë mund të lindin vështirësi në përcaktimin e investimeve apo punimeve të mirëmbajtjes të cilat janë detyrim i DSHTD – së dhe cilat i takojnë qiramarrësit.

Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD gjatë vitit 2021, ka kryer inventarizimin e godinave jashtë për Ambasadën në Bruksel si dhe në Stokholm, ndërsa për Godinat e Ambasadave të tjera, është në vijim duke marrë parasysh rekomandimet e KLSH. DSHTD ka kryer regjistrimin në kontabilitet të sasisë dhe vlerës totale fillestare për secilën godinë të Ambasadave që ndodhen jashtë vendit, si dhe regjistron çdo vit shtesat e investimeve që realizohen në këto godina.

Gjithashtu DSHTD regjistron në mënyrë të detajuar ne evidenca excel, investimet në godinat e Ambasadave jashtë vendit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Komentet nga subjekti nuk e ndryshojnë gjendjen e evidentuar nga grupi auditues për periudhën e auditimit dhe observacioni **nuk merret në konsideratë.**

### **Detyrimet afatshkurtra**

Gjendja e llogarive detyrime afatshkurtra për vitin 2022, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultojnë në vlerën 34,029 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 12,393 mijë lekë.

Tabela nr. 41

Në lekë

<b>DETYRIMET</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>Diferenca</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	1,464,930	1,945,620	- 480,690
Detyrime tatimore	1,470,367	1,578,170	- 107,803
Grante dhe të ardhurat të shtyra	8,703,514	1,860,397	6,843,117
Provizione	4,099,960	4,099,960	-
Të tjera detyrime	18,290,333	12,152,054	6,138,279
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>34,029,104</b>	<b>21,636,201</b>	<b>12,392,903</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Në mënyrë të detajuar detyrimet afatshkurtra janë si më poshtë vijon:

1. Llogari tregtarë të pagueshme në vlerë 1,465 mijë lekë detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 42

Në lekë

Subjekti	Vlera
H.	66,000
F.	214,500
<b>PERSONA FIZIKE</b>	<b>33,982</b>
E.	155,040
GJ.	81,000
A.A.SH.	-14,000
M.	13,097
A.	63,600
S.	210,412
D.	73,697
R.N.	78,360
I.	90,960
I.E.	858
K.	24,394
S.	183,000
A.	60,858
K.H.	21,701
I.B.S.	11,940
N.	52,080
A.	43,450
<b>TOTALI</b>	<b>1,464,930</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Llogaritë tregtarë afatshkurtra përbëhen nga tre lloje debitorësh.

- Subjektet H.; S.; A.A.Sh.; I.E.; A.C. dhe T.S. kanë lëshuar faturat për kryerjen e shërbimeve në fund të vitin 2022 dhe likuidimi i tyre është mbartura në vitin pasardhës.

- Detyrimi ndaj subjekteve të tjera janë të mbartura nga vit pas viti dhe për të cilat nuk janë kryer likuidimet.

**Gjetje 15:** Në përputhje me SKK 2, pika 41 dhe 42 një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur: (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) njësia ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit. Njësia ekonomike duhet t'i klasifikojë të gjithë detyrimet e tjera si afatgjata. Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD nuk ka kryer klasifikimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e detyrimeve afatshkurtra detyrime të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2

41. Një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur:

- (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike;
- (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi;
- (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose
- (d) njësia ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit.

Duke qenë se vlera e detyrimeve afatshkurtra pritet të shlyhet brenda afatit 12 mujor, ose afati i shlyerjes është i pacaktuar, DSHTD ka vendosur që këto detyrime ti klasifikojë si Detyrime afatshkurtra.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Llogaria tregtarë të pagueshme rezultojnë e mbartur nga vitet e kaluara si dhe në vitet në vijim, pra nuk vlerat e detyrimeve nuk është shlyer brenda afatit 12 – mujor dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë.**

2. Detyrimet tatimore në vlerë 1,470 mijë lekë i përbërë nga detyrimi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe Tatimi mbi të ardhurat personale të muajit Dhjetor 2021 të cilat paguhen në muajin pasardhës.

Tabela nr. 43

Në lekë

Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,198,605
Tatim mbi të ardhurat personale	263,512
Tatim në burim	8,250
Tatim mbi fitimin	0
<b>Totali</b>	<b>1,470,367</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

3. Grante dhe të ardhura të shtyra në vlerë 8,703 mijë lekë, e cila përfaqëson paradhëniet, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 44

Në lekë

Përshkrimi	Gjendja ne monedhe llogari
	Kredi
qira 12 muaj qershor 22 deri maj 2023 ap 8/1/9+8/1/10 A.S. 7 muaj *1564=10948euro ,5 muaj *1564=7820 euro	942,544.60
qira 12 muaj ap 8/1/6 A.A. periudha 01 nëntor 2022-31 tetor 2023 ; v 22=3*1040=3120 ;v 23 =9*1040=9360 total =12480 euro	1,096,804.80
qira Janar+ Shkurt v 2023 ap 6/2/20 G.	280,608.00
qira janar 23 ap 6/2/16 A.Gj.	140,232.00
qira janar 23 vila 8+2 A.Gj.	3,697,076.45
qira janar- dhjetor v 23 ap 8/2/4 A.S. 12 muaj *1848 =22176 euro	2,546,248.32
qira 12 muaj qershor 22 deri maj 2023 ap 8/1/9+8/1/10 A.S. 7 muaj *1564=10948euro ,5	942,544.60

muaj *1564=7820 euro	
qira 12 muaj ap 8/1/6 A.S. periudha 01 nëntor 2022-31 tetor 2023 ; v 22=3*1040=3120 ;v 23 =9*1040=9360 total =12480 euro	1,096,804.80
<b>Gjendja</b>	<b>8,703,514.17</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

4. Provizione në vlerë 4,100 mijë lekë, e cila përfaqëson provizionet për çështjet gjyqësore të krijuara me vendim të Këshillit Drejtues nr.30, dt. 17.12.2021.
5. Të tjera detyrime në vlerë 18,290 mijë lekë, e cila përfaqëson garancitë për kontratat e qirasë në vlerën 14,294 mijë lekë; detyrimin e DSHTD – së ndaj MFE në përputhje me VKM nr. 54, dt. 05.02.2014, “Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore”, pika 7, në vlerën 3,972 mijë lekë; dhe detyrime të tjera në vlerën 24 mijë lekë që përfaqëson pagën e një punonjësi që është larguar nga puna dhe s’ka marrë ende pagën takuese.

Për vitin 2022 DSHTD nuk ka detyrime afatgjata.

### **Kapitali**

Kapitali i DSHTD është në vlerën 3,448,607 mijë lekë dhe është i përbërë nga:

Tabela nr. 45

Në lekë

<b>DETYRIMET</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>Diferenca</b>
Kapitali i paguar	3,120,460,177	3,120,460,177	0
Rezerva statutore	276,551,024	240,145,718	36,405,306
Rezerva ligjore	10,784,207	8,183,828	2,600,379
Fondi i ndihmave te menjëhershme	8,195,298	6,294,919	1,900,379
Fondi i shpërblimit rezerve te punonjësve	15,261,155	14,467,640	793,515
Fonde te tjera	9,647,365	7,046,986	2,600,379
Rezultati i ushtrimit	24,998,928	52,007,580	-27,008,652
<b>Totali</b>	<b>3,465,898,154</b>	<b>3,448,609,848</b>	<b>17,291,306</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 6, dt. 28.06.2022 është miratuar shpërndarja e fitimit të vitit 2021 në vlerën 52,008 mijë lekë, në përputhje me nenin 11.1 të ligjit Nr.7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore” si më poshtë vijon:

- 70% e fitimit ose vlera 36,405 mijë lekë është kaluar në llogarinë Rezerva statutore
- 5% e fitimit ose vlera 2,600 mijë lekë është kaluar në llogarinë Rezerva ligjore
- 15% e fitimit ose vlera 7,801 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fondi i shpërblimit, në përputhje me ligjin Nr.7582, datë 13.7.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, neni 13.1
- 5% e fitimit ose vlera 2,600 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fondi i ndihmës sociale
- 5% e fitimit ose vlera 2,600 mijë lekë është kaluar në llogarinë Fonde të tjera

### **Pasqyra e Performancës**

Në përputhje me VKM nr. 840, dt. 17.12.2004 “Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, si dhe nenin 14 të Rregullores së Brendshme të DSHTD, burimet financiare të DSHTD janë:

- a) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për Trupin Diplomatik të huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;
- b) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për subjekte të treta, si dhe nga shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;
- c) Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera dytësore;
- ç) Donacionet, vendase ose të huaja, të dhëna me miratimin paraprak të Ministrit të Punëve të Jashtme

Gjendja e llogarive të ardhurave për vitin 2022, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2022-2021), rezultojnë në vlerën 184,923 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 18,060 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar të ardhurat janë si më poshtë vijon:

Tabela nr. 46

Në lekë

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Ndryshimi
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	184,569,581	189,067,094	- 4,497,513
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	-	-	0
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar	12,046,654	17,820,038	-5,773,384
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	-11,692,827	- 3,903,508	- 7,789,319
<b>Total të ardhura</b>	<b>184,923,408</b>	<b>202,983,624</b>	- 18,060,216

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

1. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit, përfshin të ardhurat nga qiratë e përfuara nga godinat në administrim të DSHTD – së, detajuar në aneksin 6. Në total DSHTD ka në administrim 97 pasuri, nga të cilat për 83 prej tyre ka lidhur kontrata qiraje me misionet diplomatike dhe subjekte të treta të cilat gjenerojnë të ardhura; dhe për 14 prej tyre nuk arkëtohet qira për arsytet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 47

Në lekë

Nr.	Apartamenti	Kontrata Nr. Indeks	Subjektet	Data e fillimit	Data e mbarimit	Vlera e kontratës ALL/ muaj	Sipërfaqe	Çmimi /m2
1	8/3/40	BOSH	BOSH				157.21	
2	4/1/1	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		92.27	
3	4/1/2	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		95.32	
4	4/1/3	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		121.69	
5	4/1/4	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD	Zyre DSHTD		152.99	
6	4/1/17	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				92.27	
7	4/1/18	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				95.32	
8	4/1/19	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				121.69	
9	4/1/20	VKM nr. 592, date 25.05.2009	A.				152.99	
10	8/2/2	F.R.	F.R.	F.R.	F.R.	F.R.	231	
11	8/3/35	Mpj/S.F.B.P.		22,12,2014	Dhjetor 2024		122.82	
12	8/3/36	Mpj/S.F.B.P.		22,12,2014	Dhjetor 2024		88.76	
13	vila nr. 57	A.K.	marrëveshje	marrëveshje				
14	Pall.6, Shk.1+2, Kati Përdhe	W.	Kontrate nr. 3241 prot, dt. 23.05.2013	259 + 89	23.05.2013	22.05.2023		145, 543

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

-Katër apartamentet në katin e parë të pallatit nr. 4, janë në përdorim të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik të cilat përdoren për zyra:

- Apartamenti 4.1.1
- Apartamenti 4.1.2
- Apartamenti 4.1.3
- Apartamenti 4.1.4

-Katër apartamentet në katin e fundit të pallatit nr. 4, janë në përdorim të A., bazuar në VKM Nr. 592, dt. 25.05.2009 "Për dhënie në përdorim të disa mjediseve A.të K. Sh. të E.", konkretisht:

- Apartamenti 4.1.17

- Apartamenti 4.1.18
- Apartamenti 4.1.19
- Apartamenti 4.1.20

-Apartamenti 8.2.2 është në përdorim të përkohshëm pa shpërblim, për Stafin e Sekretariatit të Zyrës Rajonale për B.R., bazuar në VKM Nr. 816, dt. 29.12.2017.

-Apartamenti 8.3.35 dhe Apartamenti 8.3.36, janë në përdorim nga S.F.B.P., bazuar në VKM Nr. 856, datë 10.12.2014, i ndryshuar me Vendimin nr. 28, datë 22.01.2020. (Bashkëlidhur VKM).

-Marrëdhënia për objektin Vila nr. 57, në të cilën ushtron veprimtarinë e saj A.R.P.K., është e rregulluar me VKM – në nr. 67, dt. 28.01.2015 dhe Marrëveshjen mbi ofrimin e ndërsjellët të truallit dhe ambienteve të ambasadave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së R.P.K.

- Për subjektin W. është lidhur kontrata e qirasë me nr. 3241 rep., nr. 585 kol, datë 23.05.2013, midis shoqërisë "W." dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjetikës (METE). Drejtorja e Shërbimit të Trupit Diplomantik si njësi monitoruese e kësaj kontrate qiraje, monitoron dhe ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratës në mbështetje të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Kreu VI "Monitorimi i Kontratave", si dhe Udhëzimit Nr. 13, datë 26.04.2018 "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar. Detyrimi mujor i kësaj kontrate qiraje arkëtohet nga subjekti qiramarrës për llogari të DSHTD-së.

2. Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar në vlerën 12,047 mijë lekë, pakësuar nga viti i kaluar me 5,773 mijë lekë, përfaqësojnë investimet e kryera gjatë vitit 2022 në godinat në administrim të DSHTD. Në kushtet kur DSHTD kryen me punonjësit dhe materialet e saj investimin atëherë vlera e investimit kontabilizohet në llogarinë e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

3. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit në vlerë -11,693 mijë lekë, përfaqëson humbjen nga kursi valutor.

**Gjetje 16:** Në përputhje me SKK 2, shtojca 2 në Të ardhura të tjera të shfrytëzimit përfshihen "Të ardhurat që përftohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet në llogaritë/kërkesat e arkëtueshme dhe detyrimet për t'u paguar furnitorëve (nëse rezulton një humbje neto, ajo njihet në zërin "Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit)". Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit klasifikohen në llogarinë Të ardhurat dhe shpenzimet financiare, dhe jo në Të ardhura të shfrytëzimit.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtorja e Shërbimit të Trupit Diplomantik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** Sipas SKK 2, 56 Shtojca 2 e SKK2 paraqet një numër minimal të zërave të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Përbërja e saktë e zërave të kësaj pasqyre varet nga aktivitetet e njësisë ekonomike dhe praktikës ndërkombëtare në fushën ku kjo njësi operon. Çdo njësi ekonomike duhet të japë në politikën dhe procedurat e saj kontabël përshkrime të hollësishme, se cilat të ardhura dhe shpenzime janë përfshirë në zërat përkatës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Njësia ekonomike duhet t'i përmbahet këtij klasifikimi në mënyrë të vazhdueshme dhe DSHTD këtë ka bërë, fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për neto, në mënyrë të vazhdueshme është klasifikuar tek "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit". Kjo bazuar në guidën në përputhje me standardin 2 të kontabilitetit e përmirësuar mbi bazën e të cilave është bërë plotësimi i pasqyrave.

b. Pasqyra e performancës sipas natyrës -udhëzues për plotësim

Ne SKK e përmirësuar "Kompensimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (njohja në shumën neto)" në

paragrafin 60 pika (C): Fitim /humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Pasqyrat Financiare çdo vit janë të audituara nga një Ekspert Kontabël i miratuar nga MEPJ, i cili e ka parë të arsyeshme këtë klasifikim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në përputhje me SKK 2, shtojca 2 fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit klasifikohen në llogarinë Të ardhurat dhe shpenzimet financiare, dhe jo në Të ardhura të shfrytëzimit dhe për këtë arsye observacioni **nuk merret në konsideratë.**

### Shpenzimet:

Tabela nr. 48

Në lekë

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Ndryshimi
<b>Lënda e parë materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime</b>	<b>-57,773,150</b>	<b>-55,036,874</b>	2,696,276
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	-36,174,026	-31,753,629	4,420,397
2) Të tjera shpenzime	-21,559,124	-23,283,245	-1,724,121
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>-54,524,848</b>	<b>-45,933,707</b>	8,591,141
1) Paga dhe shpërblime	-46,809,463	-39,475,108	7,334,355
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	-7,715,385	-6,458,599	1,256,786
<b>Zhvlerësim i aktiveve afatgjata materiale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	-
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	<b>-40,836,135</b>	<b>-40,259,997</b>	576,138
<b>Shpenzime të tjera të shfrytëzimit</b>	<b>-2,101,549</b>	<b>-2,044,275</b>	57,274
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>53,639</b>	<b>1,837,372</b>	<b>- 1,783,733</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	0	779,322	-779,322
Shpenzime të tjera financiare	83,639	1,058,050	-1,004,411

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

- Lënda e parë, materiale të konsumueshme në vlerën 36,174 mijë lekë përfaqëson shpenzimet për materialet, materiale ndihmëse, mallra dhe shërbime.

- Të tjera shpenzime në vlerë 21,559 mijë lekë detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 49

Në lekë

	Valuta	Vlera
Shpenzime të tjera		
Blerje Energji, avull, ujë, karburant	LEK	1,515,703
Udhëtime dhe dieta	LEK	3,924,408
Mirëmbajtje dhe riparime	LEK	3,024,423
Sigurime	LEK	2,957,301
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	LEK	571,569
Komisione bankare	LEK	247,640
Taksa të ndryshme	LEK	7,045,074
Shpenzime të tjera	LEK	1,946,161
Rezultati neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve	LEK	326,845
<b>Totali</b>	<b>LEK</b>	<b>21,559,124</b>

Burimi: DSHTD, përpunoi grupi i auditimit

-Paga dhe shpërblime në vlerën 46,809 mijë lekë përfaqëson pagat e punonjësve për vitin 2022 dhe shpërblimet në vlerë 3,139 mijë lekë.

- Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore në vlerën 7,715 mijë lekë përfaqëson sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të paguara për punonjësit për vitin 2022.

- Shpenzimet e amortizimit në vlerën 40,836 mijë lekë janë llogaritur si më poshtë vijon:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	2%

Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

**Gjetje 17:** Grupi i auditimit konstatoi së norma e amortizimit për kategorinë e aktiveve nuk është llogaritur në përputhje me normat e përcaktuara në Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, neni 22. DSHTD ka llogaritur amortizim për ndërtesat në masën 2% të vlerës së asetit në fillim të vitit ushtrimor, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar i cili përcakton se kosto e ndërtesave amortizohet me normën 5%.

*Për sa është trajtuar më lart subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik ka paraqitur observacionin me nr. 1310/27, datë 14.06.2023 protokolluar në KLSH-së, me nr. 1176/5 prot., datë 15.06.2023, përkatësisht, si më poshtë:*

**Pretendimet e Subjektit:** DSHTD-ja me VKD nr. 16, datë 30.08.2017 ka miratuar normën e amortizimit për godinat që administrohen në masën 2%, bazuar në analizën e Sektorit të Buxhetit dhe Financës në relacionin përkatës drejtuar KD me nr. prot.904/1, datë 29.08.2017 “Relacion për të ulur normën e amortizimit për godinat që administrohen nga DSHTD-ja”, me arsyetimin se: Nisur nga fakti se investimet dhe riparimet në ndërtesat e administruara nga DSHTD-ja janë të përvitshme dhe në një vlerë relativisht të lartë, si dhe duke patur parasysh gjendjen fizike të ndërtesave pas investimeve dhe riparimeve, norma e amortizimit tavan 5 % është jo reale për DSHTD-në, pra nuk pasqyron amortizimin real të ndërtesave që administrohen nga DSHTD-ja.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Relacioni i paraqitur nga subjekti për uljen e normës së amortizimit nuk paraqet argumente justifikues dhe nuk ka një analizë të strukturuar për përcaktimin e nivelit 2% si norma efektive e amortizimit, për pasojë observacioni **nuk merret në konsideratë**.

- Shpenzimet interesi dhe shpenzime të ngjashme janë në vlerën 0 për arsye se interesat e depozitës në C. Bank arkëtohen në Mars të vitit 2023.

- Shpenzimet të tjera financiare janë në vlerën pozitive prej 54 mijë lekë dhe përfaqësojnë kamatëvonesat e paguara nga qiradhënësit për vonesat në pagesat e qirave.

Në fund të vitit ushtrimor 2021, DSHTD raporton fitim në vlerën 29,791 mijë lekë mbi të cilin paguhet vlera e tatueshme në masën 15% në përputhje me Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, neni 28.

Titulli i Gjetjes	Mbi klasifikimin e llogarive të Pasqyrave financiare
<b>Situata:</b>	<p>- Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022 DSHTD nuk ka kryer pasqyrimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e aktiveve afatshkurtra aktive të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti. Njësia ekonomike nuk ka klasifikuar të gjithë aktivet e tjera si afatgjata në përputhje me SKK 2, pika 39 dhe 40.</p> <p>- Gjithashtu nga auditimi rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022, DSHTD nuk ka kryer pasqyrimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e detyrimeve afatshkurtra detyrime të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti. Njësia ekonomike nuk ka klasifikuar të gjithë detyrimet e tjera si afatgjata në përputhje me SKK 2, pika, 41 dhe 42.</p> <p>- Nga auditimi rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022, DSHTD nuk ka kryer klasifikimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Performancës. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit janë klasifikuar në të ardhura të shfrytëzimit kur duhej të klasifikoheshin në llogarinë të ardhurat dhe shpenzimet financiare. Në përputhje me SKK 2, shtojca 2.</p>



<b>Kriteri:</b>	-Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet - Ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK), - Udhëzimi nr.2, datë 04.02.2014 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal”
<b>Ndikimi:</b>	Klasifikimi i gabuar i llogarive ndikon në paraqitjen e saktë të zërave të pasqyrave financiare
<b>Shkaku:</b>	Klasifikim i gabuar i llogarive të pasqyrave financiare
<b>Rëndësia:</b>	E ulët
<b>Rekomandimi:</b>	DSHTD të marrë masa për klasifikimin e zërave të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe bazën ligjore në fuqi.
<b>Afati zbatimit</b>	Menjëherë dhe në vijimësi

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mbi Aktivet Afatgjata Materiale
<b>Situata:</b>	<p>1. Gjatë vitit 2020 është regjistruar në aktivet afatgjata vlera prej 125,184,658 lekë e cila i korrespondon 10 apartamenteve në R., të cilat kanë kaluar nga MEPJ në administrim të DSHTD – së, sipas urdhrin të përbashkët nr. 613 datë 21.12.2020 të MEPJ dhe nr. 529/5 datë 21.12.2020 të DSHTD. Nga dokumentacioni u evidentua se gjatë viteve të kaluara në këto apartamente janë kryer punime ndërtimi duke ndryshuar konfigurimin dhe sipërfaqen e tyre. Nga auditimi rezultoi se grupi i punës i ngritur nga DSHTD gjatë vitit 2022, për kryerjen e vlerësimeve dhe verifikimeve fizike të këtyre apartamenteve, ka kryer vlerësime vetëm për pesë nga dhjetë apartamentet e kaluara në administrim.</p> <p>2. Rezultoi se për vitin 2020, 2021 dhe 2022 institucioni nuk disponon inventar të detajuar të godinave të cilat ndodhen jashtë Shqipërisë. DSHTD ka regjistruar vlerën fillestarë të godinës, por pa specifikuar elementët specifik të cilët janë pjesë e saj. Gjithashtu investimet e kryera në këto godina i janë shtuar godinës vetëm në vlerë totale dhe jo sipas zërave të punimeve të kryera. Kjo situatë krijon problematika në përcaktimin e pjesëve takuese të godinës që i përkasin DSHTD dhe ato që i përkasin trupave diplomatik. Gjithashtu për shkak të mungesës së një detajimi të saktë krijohen vështirësi në përcaktimin e investimeve apo punimeve të mirëmbajtjes të cilat janë detyrim i DSHTD – së.</p> <p>3. Gjatë vitit 2020 DSHTD ka kryer rivlerësime të objekteve. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka zgjedhur metodën e rivlerësimit për të matur vlerën e kategorisë së “ndërtesave”, dhe ka kryer rivlerësimin e disa prej tyre, por jo për të gjitha aktivet e përfshira në këtë kategori. Konkretisht janë rivlerësuar objektet me nr. pasurie 6/a; 6/b; 6/c; 6/d; 6/e dhe 6/f. Kjo mënyrë rivlerësimi nuk është në përputhje me SKK 5: Aktive Afatgjata Materiale, pika 24 dhe 25 i cili kërkon që nëse një aktiv afatgjatë rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e aktiveve afatgjata materiale të cilës ai i përket”. Bazuar në sa më sipër, sqarojmë se DSHTD-ja nuk ka bërë rivlerësim tërësor për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale, por vetëm për një pjesë të tyre, për arsye të pamundësisë ekonomike dhe logjistike (një pjesë e ndërtesave janë Ambasadat e RSH jashtë vendit).</p> <p>4. Grupi i auditimit rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021</p>

	dhe 2022, norma e amortizimit për kategorinë e aktiveve nuk është aplikuar në përputhje me normat e përcaktuara. DSHTD ka llogaritur amortizim për ndërtesat në masën 2% të vlerës së asetit në fillim të vitit ushtrimor, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar i cili përcakton se kosto e ndërtesave amortizohet me normën 5%.
<b>Kriteri:</b>	-Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet. - Ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK), - Udhëzimi nr.2, datë 04.02.2014 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal”.
<b>Ndikimi:</b>	Mungesa e informacionit të plotë në lidhje me vlerat e aktiveve afatgjata materiale krijon problematika në regjistrimet kontabël dhe llogaritjen e amortizimit.
<b>Shkaku:</b>	Problematika në regjistrimet kontabël të vlerave të aktiveve afatgjata materiale nga DSHTD .
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>1. Rekomandimi:</b>	DSHTD të marrë masa për kryerjen e vlerësimeve fizike për të gjitha apartamentet në Romë, të cilat kanë kaluar nga MEPJ në administrim të DSHTD – së me qëllim përcaktimin e vlerës së saktë të tyre.
<b>2. Rekomandimi:</b>	DSHTD të marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit për të gjitha godinat të cilat janë në administrim të saj.
<b>3. Rekomandimi:</b>	Institucioni të marrë masa për kryerjen e rivlerësimit të objekteve në përputhje me SKK 5: Aktive Afatgjata Materiale.
<b>4. Rekomandimi:</b>	DSHTD të marrë masa për hartimin e një analize të mirë strukturuar kosto – përfitimit për argumentimin e përlllogaritjes së amortizimit të ndërtesave në nivelin 2% dhe jo në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar.
<b>Afati zbatimit</b>	Menjëherë dhe në vijimësi

### **2.3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE MBI ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE**

Në zbatim të pikës nr.3 të programit të auditimit nr.1176/1 prot, datë 13.01.2023”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim.
- Transaksionet e llogarive bankare
- Procedurat për blerje te vogla.
- Shpenzimet për udhëtime dhe dieta.
- Inventarizimi

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

#### **a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës**

Nga auditimi me zgjedhje për vitet objekt auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësisimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.) i kryer në Sektorin e Financës, për veprimet e arkës në valutë rezultoi se, veprimet janë kryer komform kërkesave të Ligjit 25/2018 date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave

financiare vjetore”, i ndryshuar. Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji. Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës.

Nga auditimi i regjistrimit të veprimeve të kryera me bankën për 6 mujorin e parë të vitit 2020, 3 mujorin e parë dhe të fundit të 2021 dhe tremujorin e dytë të 2022 rezultoi se, veprimet ekonomike ishin kryer në mënyrë kronologjike dhe të justifikuara, me dokumentacionin bazë dhe atë mbështetës. Çdo veprim i kryer me bankën ishte i regjistruar në ditarët përkatës.

Nga auditimi i regjistrimit të veprimeve të kryera me bankën nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë vitit. Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve, shpenzimet janë regjistruar me numra rendor, në mënyrë kronologjike. Në përgjithësi veprimet e kryera me bankën kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

Me date 06.01.2020 subjekti qiramarrësi G. ka derdhur pranë bankës R.B. në Llogarinë e DSHTD vlerën 1,827.14 € sipas faturën nr.668 date 02.12.2019 të lëshuar nga DSHTD për pagesën e muajt dhjetor të apartamenteve 6/1/1 dhe 6/1/2.

Nga auditimi konstatohet se subjekti G. nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni nuk ka marrë masë për të aplikuar penalitetin për kamatëvonesat. Penaliteti i pavendosur llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **548.14 €**, të cilat për Institucionin janë të ardhura të munguara. (tabela me poshtë). *Në kundërshtim me kontratën nr. 1188/1 datë 20.11.2019, KQPH/-01.2019- G. 056 dhe nr. 1189/1 datë 20.11.2019, KQPH/-01.2019- G. 057, neni 4 pika 1 citon: Qiramarrësi duhet të paguaj qiradhënësit qiranë mujore brenda 5(pesë) ditëve, nga data e faturimit, dhe në rast vonese në pagimin e qirasë mujore, qiramarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesë prej 1 % të vlerës së çdo fature për çdo ditë vonese.*

Apartamenti 6.1.1 dhe 6.1.2				
Data e faturimit	Data e pagesës se kryer	Penaliteti ne dite vonese €	Dite vonese	Penaliteti ne €
02/12/2019	06/01/2020	18.2714	30	548.14
Totali kamatëvonesa në euro				548.14

## **b. Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera në magazinë**

Organizimi i evidentimit të lëvizjes së mallrave nga magazina dhe kontabilizimi i saj është bërë në mënyrë manuale. Fletë daljet e fletë hyrjet e magazinës ishin me blloqe dhe numra të ndarë për hyrjet dhe daljet e “brendshme”.

Nga audituan me zgjedhje hyrjet dhe daljet e “brendshme” rezultoi:

Fletë Hyrjet e mallrave dhe materialeve “në përdorim” ishin të plotësuara në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë, shoqëruar me urdhër dorëzimi.

Fletë Daljet e brendshme janë të ndara për dalje të mallrave e materialeve, për dalje të inventarit të imët, mobilieri e pajisje dhe magazina e librit. Fletë Daljet ishin të plotësuara në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë të firmosura nga marrësi në dorëzim, shoqëruar me urdhër dorëzimi.

Magazina përkon me specialisten e financës me kartelat respektive çdo 3 muaj dhe në fund të vitit firmosin për lëvizjet, gjendjet në librat dhe regjistrat respektiv.

## **c. Inventarizimi**

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2020-2022

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën 2020-2022 çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr.74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se: “Çdo njësi

publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës” dhe neni 31, citohet “...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m2, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës.

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Hyrja e aktiveve për çdo raste dokumentohet me flete hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve për çdo rast, janë kryer konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

#### **Më konkretisht:**

Procesi i inventarizimit të aktiveve, **për vitin 2020-2022** është kryer nga disa komisioni të ngritur sipas urdhrimit të Titullarit të Institucionit “Për krijimin e komisionit të inventarizimit”.

#### **Për vitin 2020**

Në zbatim të urdhrimit të Titullarit të DSHTD nr.1022 prot datë 21.12.2020 “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të DSHTD për vitin 2020, verifikimin fizik dhe cilësorë”.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar relacion me shkresë nr.1022/1,2,3 dhe 4 prot datë 31.12.2020 mbi inventarin fizik të aktiveve afatgjata materiale, jo materiale dhe financiare të Institucionit ku ka konstatuar se nga inventarizimi rezultojë se nuk ka diferenca.

Gjithashtu në Zbatim të Titullarit të DSHTD është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi me nr. 962/1 prot datë 27.11.2020.

Komisioni i vlerësimit të aktiveve ka hartuar një relacion mbi vlerësimin e aktive me nr.962/3 datë 10.12.2020 dhe ka propozuar që disa aktive të dalin nga përdorimit.

Me shkresën nr. 962/6, datë 14.12.2020 “njoftim për asgjësimin e aktiveve” është njoftuar Drejtoria Rajonale Tiranë, për të qenë të pranishëm për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara/propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

Me shkresë nr. 962/1 prot datë 27.11.2020 Titullari i Institucionit ka ngritur komisionit për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve të vlerësuara nga DSHTD.

Me shkresë 962/8 datë 21.12.2020 komisioni ka kryer procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi duke i asgjësuar bashkëngjijt relacionit fotot përkatëse dhe faturën e inceneratorit.

#### **Për vitin 2021**

Në zbatim të urdhrimit të Titullarit të DSHTD nr.1088 prot datë 07.12.2020 “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të DSHTD për vitin 2020, verifikimin fizik dhe cilësorë”.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar relacion me shkresë nr.1022/2,3 dhe 4 prot datë 31.12.2020 mbi inventarin fizik të aktiveve afatgjata materiale, jo materiale dhe financiare të Institucionit ku ka konstatuar se nga inventarizimi rezultoi se nuk ka diferenca.

Gjithashtu në Zbatim të Titullarit të DSHTD është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi me nr. 1087 prot datë 07.12.2021.

Komisioni i vlerësimit të aktiveve ka hartuar një relacion mbi vlerësimin e aktive me nr.1087/2 prot datë 22.12.2021 dhe ka propozuar që disa aktive të dalin nga përdorimit.

Me shkresë nr. 1087 prot datë 07.12.2021. Titullari i Institucionit ka ngritur komisionit për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve të vlerësuara nga DSHTD.

Me shkresën nr. 1087/5, datë 23.12.2021 “njoftim për asgjësimin e aktiveve” është njoftuar Drejtoria Rajonale Tiranë, për të qenë të pranishëm për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara/propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

Me shkresë 1087/8 prot datë 30.12.2021 komisioni ka kryer procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi duke i asgjësuar bashkëngjijt relacionit fotot përkatëse dhe faturën e inceneratorit.

### **Mbi shpenzimet për prokurimet me vlera të vogla.**

Për vitin 2020 me urdhrin nr.12 d/2 prot datë 07.01.2020 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2020” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbehet nga B.K. Kryetar, E.A. dhe A.N. anëtare.

Gjithashtu për vitin 2020 me urdhrin nr.13 d/2 prot datë 07.01.2020 “Krijimi i komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbehet B.K. Kryetar, E.A. dhe A.N. anëtare.

Për vitin 2020 janë realizuar në total 40 procedura prokurime me vlerë të vogël.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë parashikuar 19,292,380 si fond limit nga ku vlera e kontratës së realizuar është 13,067,373 lekë pa TVSh. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 16 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar në vlerën 10,081,873 lekë dhe me fond të realizuar në vlerë kontratë në shumën 7,228,268 lekë pa TVSh.

Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2020 u konstatua mangësi si më poshtë.

1. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 26.10.2020 “Hartim projekt preventive”, publikimi i procedurës është bërë me data 27.10.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 28.10.2020 ora 11:00.

2. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 10.02.2020 “Blerje flamuj të ndryshëm”, publikimi i procedurës është bërë me data 11.02.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 12.02.2020 ora 09:00.

3. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 01.12.2020 “Sigurimi vjetore i pasurive të paluajtshme”, publikimi i procedurës është bërë me data 02.12.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 03.12.2020 ora 09:00.

4. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 18.05.2020 “Pastrim pusi uji”, publikimi i procedurës është bërë me data 19.05.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 20.05.2020 ora 11:00.

5. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 18.05.2020 “Blerje depozita uji dhe shkëmbyes nxehtësie”, publikimi i procedurës është bërë me data 19.05.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 20.05.2020 ora 10:00.

6. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 26.10.2020 “Hartim studim dhe projekt preventive për shpim pusi uji”, publikimi i procedurës është bërë me data 27.10.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 28.10.2020 ora 10:00.

7. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 14.07.2020 “Blerje aksesore konsumi për punime ndërtimi”, publikimi i procedurës është bërë me data 15.7.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 16.07.2020 ora 10:00.

8. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 05.02.2020 “Blerje aksesore konsumi për punime ndërtimi”, publikimi i procedurës është bërë me data 06.02.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 07.02.2020 ora 10:00.

9. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 04.06.2020 “Shërbim teknik automjete”, publikimi i procedurës është bërë me data 07.06.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 08.06.2020 ora 09:00.

10. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 16.06.2020 “Blerje siguracion për automjete”, publikimi i procedurës është bërë me data 17.06.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 18.06.2020 ora 09:00.

11. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 04.03.2020 “Shërbim teknik automjete”, publikimi i procedurës është bërë me data 05.03.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 06.03.2020 ora 10:00.

12. Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 04.02.2020 “Shërbim mirëmbajta kondicionerë”, publikimi i procedurës është bërë me data 05.02.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 06.02.2020 ora 09:00.

**Nga auditimi i procedurave të mësipërme konstatohet se Komisioni i procedura me vlerë të vogël (KPVV) nuk ka respektuar afatin minimal për hapjen e procedura dhe pranimin e procedura i**

cili duhet te jete minimalisht 24 orë nga momenti i publikimit ne sistemi e prokurimit publik. Në të gjitha procedurat e sipër përmendura afati i publikimit dhe i hapjes është nga 20 orë deri ne 23 orë. Në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar Pika 11.

Gjithashtu përveç kërkesës për prokurim që është e protokolluar të gjitha dokumentet dhe procesverbalet e KPVV janë të pa protokolluara në kundërshtim me Referuar nenit 18 te Normave tekniko-profesionale te shërbimit arkivor ne Republikën e Shqipërisë, ne mbështetje te Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

1. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.165 d/9 prot me datë 10.02.2020 me lëndë ”Blerje pajisje kompjuterike”. Në kërkesën e prokurimit është dhe vlera e përlllogaritur për fondin limit e cila është **777,600 lekë pa TVSh.**

Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 11.02.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Publikimi i procedurës është bërë me data 12.02.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 13.02.2020 ora 09:00.

KPVV me procesverbal datë 19.02.2020 ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 3, pasi OE-t e renditur nga vendi i parë dhe të dytë janë tërhequr nga procedura, Me nr.165/2 datë 21.02.2020 është lidhur kontrata midis OE “E.I.” dhe AK me vlerën **483,900 lekë pa TVSh.**

2. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.234 prot me datë 03.03.2020 me lëndë ”Blerje set kompjuterik”. Në kërkesën e prokurimit është dhe vlera e përlllogaritur për fondin limit e cila është **240,000 lekë pa TVSh.**

Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 04.03.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Publikimi i procedurës është bërë me data 05.03.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 06.03.2020 ora 09:00.

KPVV me procesverbal datë 09.03.2020 ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 1. Me nr.234/2 datë 10.03.2020 është lidhur kontrata midis OE “E.H.” dhe AK me vlerën **214,000 lekë pa TVSh.**

**Nga auditimi i 2 procedurave të mësipërme konstatohet se KPVV nuk ka hartuar përlllogaritjen e fondin limit por është bazuar ne fondin e parashikuar për këto procedura, Në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5.**

KPVV nuk ka respektuar afatin minimal për hapjen e procedura dhe pranimin e procedurave i cili duhet të jetë minimalisht 24 orë nga momenti i publikimit në sistemin e prokurimit publik. Në procedurat e sipër përmendura afati i publikimit dhe i hapjes është 20 orë. Në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar Pika 11.

Gjithashtu përveç kërkesës për prokurim që është e protokolluar të gjithë dokumentet dhe procesverbalet e KPVV janë të pa protokolluara në kundërshtim Referuar nenit 18 të Normave tekniko-profesionale te shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të

veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Në lidhje me konstatimet tuaja më sipër, ju sqarojmë se:

Hedhja në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së e procedurave të prokurimit është bërë sipas manualeve përkatëse të miratuara për këtë qëllim. Gjatë hedhjes së të dhënave në sistem në fazën “Informacion administrativ”, personi i autorizuar ka klikuar tek “data e publikimit”, ku ka vendosur datën por nuk ka vendosur orën e publikimit e për rrjedhojë sistemi ka marrë automatikisht vetëm një orë atë 12.00.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk ka përllogaritur fondin limit pasi në kërkesat për prokurim janë përcaktuar përshkrimi i mallit, sasia e mallit që do të prokurohet, çmimi për njësi dhe vlera pa tvsh.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Autoriteti kontraktor duhet ti siguroj minimumi 1 ditë kohë OE për përgatitjen e oferta te tyre, afat qe nuk është respektuar nga AK. Gjithashtu AK duhet të bëjë përllogaritjen e fondit limit sipas pikës 5 të udhëzimit nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

1. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.101 prot me datë 29.01.2020 me lëndë “Blerje materiale izoluese”. Në kërkesën e prokurimit është dhe vlera e përllogaritur për fondin limit e cila është **614,550 lekë pa TVSh.**

Me urdhër prokurimi pa nr. prot date 29.01.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël i cili do të prokuroje mallrat si me poshtë vijon:

1. Rrjet për izolim.
2. Mapei me thasë 25 kg.
3. Solucion përzierje mapei me bidona 8 litra.
4. Polisterol i presuar 3-5cm.
5. Polikarbonat.

Publikimi i procedurës është bërë me data 30.01.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 31.01.2020 ora 09:00.

KPVV ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 9, pasi OE-t e renditur nga vendi i parë deri në vendin e tetë janë tërhequr nga procedura ose nuk janë paraqitur pranë AK.

Me procesverbal datë 17.02.2020 komisioni ka marrë në dorëzim aktivitetet dhe po në të njëjtën datë është bërë hyrje në magazine.

Pagesa është kryer nga Banka A.B. me datë 19.02.2020 me vlerë **631,440 me TVSh** kundrejt OE fituese “G.p.”.

**Nga auditimi i procedurës konstatohet** se KPVV nuk ka hartuar përllogaritjen e fondin limit por është bazuar në fondin e parashikuar për këto procedurë në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5.

Ndërkohë në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë në disa zëra është përdorur emri i markës "M." përmendja e markës është një kriter diskriminues, për arsye se nuk janë përdorur fjalët “ose ekuivalent”. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20, i cili përcakton se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo

*kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”, neni 23, pika 5, e cila përcakton se: “Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.*

Gjithashtu përveç kërkesës për prokurim që është e protokolluar të gjithë dokumentet dhe procesverbalet e KPVV janë të pa protokolluara në kundërshtim Referuar nenit 18 të Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

1. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.932 prot me datë 16.11.2020 me lëndë ”Përgatitjen e dhuratave të festave të fund-vitit”. KPVV ka marrë 3 oferta në treg dhe vlera e përllogaritur për fondin limit e cila është **500,000 lekë pa TVSh.**

Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 17.11.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël i cili do të prokurojë mallrat si me poshtë vijon:

1. Shportë dhurate e madhe e dekoruar 10 copë e cila do të përmbajë: 1 shishe uiski, 1 shishe amaro, 2 shishe vere, 2 shishe rakie, 4 pako çokollata të ndryshme, 4 pako fruta të thata dhe 2 pako karamele cilësore.

2. Vere 170 copë.

3. Kartolina urimi me zarf 200 copë.

4. Çanta Kartoni të mëdha 30 copë.

5. Çanta kartoni të mesme 100 copë.

Qëllimi i procedurës është ruajta e imazhit pozitiv të Institucionit si dhe forcimi e bashkëpunimin me partneret.

Publikimi i procedurës është bërë me data 30.01.2020 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranimit e ofertave me data 31.01.2020 ora 09:00.

KPVV ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 1 me ofertë **458,000 lekë pa TVSh.**

Me procesverbal datë 23.11.2020 komisioni ka marrë në dorëzim aktivitetet dhe shprehet se janë në sasinë, llojin dhe cilësinë sipas përcaktimeve në ftesën për ofertë, dhe po në të njëjtën datë është bërë hyrje në magazinë.

Pagesa është kryer nga C. Bank me datë 23.11.2020 me vlere **549,600 me TVSh** kundrejt OE fituese “R.”.

Komisioni i shpërndarjeve të dhuratave me proces verbal pa nr. prot datë 24.11.2020 ka vërejtur disa problematika në artikujt e dhuratave siç është 1. Shkrimi i kartolinave ishte shtypur në mënyrë jo cilësore. 2. Thurja e shporta ishte e një cilësie të dobët. 3. Ambalazhimi i çokollatave, karamelet dhe frutave të thata ishte i dëmtuar. Për sa më sipër komisioni ka vendosur që artikujt të kthehen përsëri OE.

Me shkresë 936/3 datë 24.11.2020 është kërkuar OE fitues që të tërheqë produktet e dorëzuara pranë AK për problematikën e sipër përmendura.

Me datë 27.11.2020 OE fitues “R.” pasi ka tërhequra produktet ka derdhur në llogarinë e Institucionit pranë bankës C. vlerën **549,600 lekë.**



**Nga auditimi i procedurës konstatohet se** blerja e dhurata për vitin e ri për të ruajtur imazhin pozitiv të institucioni nuk është në veprimtarinë e DSHTD pasi në *Vkm Nr.840, datë 17.12.2004* Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik. Pika 2/a citon : *Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë;*

Gjithashtu konstatohet se komisioni i marrjes ne dorëzim pasi ka marrë në dorëzim aktivet me procesverbal datë 23.11.2020, shprehet se produktet janë në sasinë, llojin dhe cilësinë sipas përcaktimeve në ftesë për oferte.

Për vitin **2021** me urdhrin nr.7 d/2 prot datë 05.01.2021 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2021” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbëhet nga B.K. Kryetar, E.A. dhe A.N. anëtare.

Gjithashtu për vitin 2021 me urdhrin nr.8 d/2 prot datë 05.01.2021 “Krijimi i komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbëhet B.K. Kryetar, E.A. dhe A.N. anëtare.

Për vitin **2021** janë realizuar në total 41 procedura prokurime me vlerë të vogël.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë parashikuar 22,232,419 lekë si fond limit nga ku vlera e kontratës së realizuar është 13,885,438 lekë pa TVSh. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 12 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar në vlerën 7,821,096 lekë dhe me fond të realizuar në vlerë kontratë në shumën 6,341,738 lekë pa TVSh.

Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2021 u konstatua mangësi si më poshtë.

1. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.150 prot me datë 17.02.2021 me lëndë ”Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare”. Në kërkesën e prokurimit është dhe vlera e përllogaritur për fondin limit e cila është **254,966 lekë pa TVSh.**

Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 17.02.2021 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Në ftesën për oferte KPVV ka kërkuar plotësimi e disa kriterëve te veçanta si me poshtë.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca kat 3/A, 4/AC dhe 4/ACJ. Fotokopje e noterizuar.

- Kopje të Certifikatës elektronike për fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin platformën qendrore të faturave.

- Kopje të Certifikatës elektronike për fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës se lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhen softuer-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softuer-ike.

- OE duhet të këtë në stafin e tij me kontratë një përkthyes të gjuhës angleze i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, për këtë duhet te paraqesë kopje të kontratës dhe licencën e miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Fotokopje e noterizuar.

Publikimi i procedurës është bërë me data 18.02.2021 ora 12:00 dhe afati i fundit për pranim e ofertave me data 19.02.2021 ora 09:00.

KPVV me procesverbal datë 03.03.2021 ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 7. Me shkresë nr.150/2 datë 04.03.2020 është lidhur kontrata midis OE “M.” dhe AK me vlerën **245,000 lekë pa TVSh.**

**Nga auditimi i procedurës konstatohet se** komisioni nuk ka hartuar përllogaritjen e fondin limit por është bazuar në fondin e parashikuar për këto procedurë në kundërshtim me *udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5.*

Gjithashtu përkthimi i projektit nuk është në veprimtarinë e DSHTD pasi në *VKM Nr.840, datë 17.12.2004* Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik. Pika 2/a citon : *Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë;* Ndërkohë konstatohet se KPVV ka skualifikuar OE “A.H.” me arsyetim se në fushën e veprimtarisë

nuk keni të përcaktuar objektin e fushës së prokurimit, por gjithashtu konstatohet se dhe OE “M.” i kualifikuar dhe i shpallur fitues nuk e ka objektin e fushës së prokurimit i cili është përkthimi. Ndërkohë kriteret e vendosura nga KPVV janë kritere diskriminuese pasi kërkohen licenca të cilat janë në fushën e projektimit dhe nuk kanë objektin e prokurimit i cili është Përkthim.

Licencat e kërkuara janë si më poshtë:

3/a: Projektme objekteve civile- industriale –turistike prej murature e skelet beton arme në 5 kate

4/a: Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

4/c: Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

4/j: Projektim të rrjeteve të telefonisë citofonisë, fonisë, internet, TV, acces kontrolli, CCTV, sisteme alarmi, sisteme detektimi të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.

Gjithashtu dhe kriteri tjetër i vendosur nga KPVV i cili kërkon “OE duhet të ketë në stafin e tij me kontratë një përkthyes të gjuhës angleze i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, për këtë duhet të paraqesë kopje të kontratës dhe licencën e miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Fotokopje e noterizuar”, është një kriter diskriminues pasi nuk lejon të marrin pjesë në procedurën e prokurimit përkthyes të cilët janë persona fizik. OE fituese ka lidhur një kontratë me një përkthyes dhe pagesa e tij për përkthimin do të jetë 120,000 lekë ndërkohë që kontrata e lidhur është AK është 245,000 leke pa TVSh. Veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (a, b, c, ç, d, dh), neni 2 germa (a, b, c), neni 20 Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre si dhe nenet 23 dhe 46, VKM 914 Date 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017” e ndryshuar neni 40, 59 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5, VKM Nr.840, datë 17.12.2004 Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik. Pika 2/a citon : Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë;

Referuar me sipër procedura e prokurimit nuk duhej zhvilluar dhe si pasojë ka sjellë përdorimin pa ekonomikitetit, eficiencë dhe efektivitetit të fondeve të buxhetit të DSHTD në vlerën **294,000 lekë me TVSh.**

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** ish titullari i Institucionit dhe komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Gjithashtu sa i takon gjetjes së grupit të auditimit për procedurën e prokurimit “Përkthim përpunim relacioni për projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare për vitin 2021”, ku shprehet se përkthimi i projektit nuk është në veprimtarinë e DSHTD, pasi në VKM nr.840 datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik” të ndryshuar, pika 2a citon: Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme dhe të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë”;

DSHTD shpreh qëndrimin se konstatimi i grupit të auditimit nuk qëndron pasi përkthimi i projektit nga DSHTD është bërë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj të përcaktuar në pikën 2a të VKM nr.840 datë 17.12.2004, pra mirëmbajtjes së pronës shtetërore në të cilën ushtron veprimtarinë e saj përfaqësia diplomatike e Bullgarisë.

Nga ana tjetër, mbështetur edhe në përcaktimet e pikës 4c të kësaj VKM, e cila përcakton se: Për të krijuar, garantuar dhe përmirësuar kushtet e qëndrimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë për Trupin Diplomantik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe për Përfaqësitë Diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituara në shtete të tjera, D.SH.T.D-ja përdor burimet e veta

financiare;

DSHTD shpreh se përkthimi i projektit nuk është në kundërshtim me përcaktimet ligjore, në të cilat mbështetet veprimtaria e DSHTD, por në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Sic jemi shprehur dhe me sipër përkthimi i projektit nuk është në veprimtarinë e DSHTD sipas VKM Nr.840, datë 17.12.2004 Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik. Pika 2/a citon : Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

**observacioni nuk merret në konsideratë.**

**2. Në 11 procedura grupi i auditimi u konstatoi se KPVV nuk ka hartuar përlllogaritjen e fondin limit por është bazuar në fondin e parashikuar për këto procedurë, (tabela me poshtë). Në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5, Udhëzim Nr. 05 datë 25.06.2021 pika 7 dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 76. Ndërsa në procedurat e vitit 2022 është hartuar përlllogaritja e fondit limit.**

Gjithashtu përveç kërkesës për prokurim që është e protokolluar të gjithë dokumentet dhe procesverbalet e KPVV janë të pa protokolluara në kundërshtim Referuar nenit 18 të Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi i parashikuar	Fondi i realizuar
1	Abonime të ndryshme	131,724	127,000
2	A.G. - F.V mbulese me xham të temperuar	365,000	350,000
3	Dyer të brendshme	760,000	361,680
4	Ekzaminim i plotë fillestar për ashensorë	339,314	183,000
5	F.V Mbulese vend parkimi për makinën	365,000	335,000
6	Kryerje punimesh të nevojshme, për të përfunduar procesin e ekzaminimit të parë të plotë të ashensorëve	950,092	744,000
7	Mirëmbajtje/Shërbim pajisje kompjuterike+materiale	550,000	412,000
8	Përkthim, përpunim relacionesh për projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare	254,966	245,000
9	Shërbim mirëmbajtje vjetore ashensori	605,000	497,200
10	Shërbim mirëmbajtje defekte për kondicionerët	700,000	651,000
11	Sigurim objektesh brenda vendit	800,000	790,000

**3. Në 9 procedura grupi i auditimi konstatoi se nuk KPVV nuk ka respektuar afatin minimal për hapjen e procedura dhe pranimin e procedurave i cili duhet të jetë minimalisht 24 orë nga momenti i publikimit në sistemin e prokurimit publik. Në procedurat e sipër përmendura afati i publikimit dhe i hapjes është nga 19 orë deri në 22 orë. (tabela më poshtë). Në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar Pika 11 dhe Udhëzim Nr.05 datë 25.06.2021 pika 12.**

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi i parashikuar	Fondi i realizuar
1	Abonime të ndryshme	131,724	127,000
2	Dyer të brendshme	760,000	361,680
3	Ekzaminim i plotë fillestar për ashensorë	339,314	183,000
4	F.V Mbulese vend parkimi për makinën	365,000	335,000
5	Mirëmbajtje/Shërbim pajisje kompjuterike+materiale	550,000	412,000
6	Përkthim, përpunim relacionesh për projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare	254,966	245,000
7	Shërbim mirëmbajtje vjetore ashensori	605,000	497,200
8	Shërbim mirëmbajtje defekte për kondicionerët	700,000	651,000
9	Sigurim objektësh brenda vendit	800,000	790,000

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Në lidhje me konstatimet tuaja më sipër, ju sqarojmë se:

Hedhja në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së e procedurave të prokurimit është bërë sipas manualeve përkatëse të miratuara për këtë qëllim. Gjatë hedhjes së të dhënave në sistem në fazën “Informacion administrativ”, personi i autorizuar ka klikuar tek “data e publikimit”, ku ka vendosur datën por nuk ka vendosur orën e publikimit e për rrjedhojë sistemi ka marrë automatikisht vetëm një orë atë 12:00.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk ka përlogaritur fondin limit pasi në kërkesat për prokurim janë përcaktuar përshkrimi i mallit, sasia e mallit që do të prokurohet, çmimi për njësi dhe vlera pa tvsh.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Autoriteti kontraktor duhet ti siguroj minimumi 1 ditë kohë OE për përgatitjen e oferta te tyre, afat qe nuk është respektuar nga AK. Gjithashtu AK duhet të bëjë përlogaritjen e fondit limit sipas pikës 5 udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar, Udhëzim Nr. 05 datë 25.06.2021 pika 7 dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 76 për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për vitin **2022** me urdhrin nr.332 d/2 prot datë 11.04.2022 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2022” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbehet nga B.K. Kryetar, E.A. dhe A.N. anëtare.

Gjithashtu për vitin 2022 me urdhrin nr.333 d/2 prot datë 11.04.2022 “Krijimi i komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbehet B.K. Kryetar, E.A. dhe A.N. anëtare.

Për vitin 2022 janë realizuar 43 procedura prokurime me vlerë të vogël.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë parashikuar 18,709,070 lekë si fond limit nga ku vlera e kontratës së realizuar është 13,184,894 lekë pa TVSh. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 13 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar në vlerën 9,026,230 lekë dhe me fond te realizuar në vlerë kontratë ne shumën 7,110,380 lekë pa TVSh.

1. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.458 prot me datë 20.05.2022 me lëndë ”FV Kondicionerë”. KPVV ka marrë 3 oferta në treg dhe vlera e përlogaritur për fondin limit e cila është **869,900 lekë pa TVSh.**

Me urdhër prokurimi pa nr. prot datë 23.05.2022 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Në ftesën për ofertë KPVV ka kërkuar plotësimi e disa kriterëve te veçanta si me poshtë.

- Sigurimin e kontratës në shumën 10% të vlerës së kontratës me TVSh.
- formulari i garancisë .
- Licencën e kategorisë NS-12A.
- Formularin e ofertës.

Me shkresë nr.127 prot datë 02.06.2022 OE “P.S.” ka paraqitur ofertën e tij pranë AK ofertë 825,600 lek me TVSh.

Me datë 02.06.2022 KPVV ka skualifikuar OE pasi në dokumentacionin e paraqitur nuk ka

dorëzuar sigurimin 10% të vlerës së kontratës.

Me datë 03.06.2022 OE ka paraqitur ankesën për skualifikim nga KPVV.

Me shkresë 507/1 prot datë 07.06.2022 pasi është marrë në shqyrtim ankesa, punonjësi i ngarkuar (E.C.) ka dalë në konkluzionin se skualifikimi i OE është i bazuar në ligjin e PP.

Me shkresë nr.458/5 datë 13.06.2022 është lidhur kontrata midis OE “K.T” dhe AK me vlerën **934,272 lekë pa TVSh.**

**Nga auditimi konstatohet se** vendosja e kriterit “Sigurimi e kontratës në shumën 10% të vlerës së kontratës me TVSh” është në kundërshtim me Ligj nr.162/2020 për prokurimin publik neni 83 pika 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Gjithashtu konstatohet se KPVV ka skualifikuar OE “P.S.” i renditur në vendin e dytë pasi në dokumentet e dorëzuar nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, KPVV nuk duhet të s’kualifikonte OE pasi në procedurat e blerjeve të vogla AK nuk duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës. Veprime në kundërshtim me Ligj nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 83 pika 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 30 pika 1 dhe neni 74 pika 3/i.

Referuar me sipër, diferenca e OE të shpallur fituese “K.T.” shpk dhe s kualifikimi i OE “P.S.” me oferte me të ulët, janë fonde të përdorura pa ekonomikitet në vlerën **64,372 lekë me TVSH.**

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël dhe personi i ngarkuar për të shqyrtuar ankesën.

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt “FV Kondicionerë”, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk ka kërkuar sigurimin e ofertës por sigurimin e kontratës në shumën 10% të vlerës së ofertës me tvsh. Sigurimi i kontratës është kërkuar sipas përcaktimit nën neni 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar ku theksohet “Sigurimi i kontratës garanton autoritetin/entit kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit/entit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Autoriteti kontraktor nuk duhet të vendos si kriter sigurimin e kontratës dhe të s’kualifikoj OE që nuk kanë paraqitur sigurimin e kontratës në ofertën e tyre, pasi kur OE ekonomik shpallet fitues para nënshkrimit të kontratës duhet ti kërkonte sigurimin e saj sipas përcaktimeve të nenit 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 që keni cituar dhe ju për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

**2. Në 7 procedura grupi i auditimi konstatoi se** nuk KPVV nuk ka respektuar afatin minimal për hapjen e procedura dhe pranimin e procedurave të cilat duhet të jetë minimalisht 24 orë nga momenti i publikimit në sistemi të prokurimit publik. Në procedurat e sipër përmendura afati i publikimit dhe i hapjes është nga 19 orë deri në 22 orë. (tabela më poshtë). Në kundërshtim me *udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 12.*

Gjithashtu përveç kërkesës për prokurim që është e protokolluar të gjitha dokumentet dhe procesverbalet e KPVV janë të pa protokolluara në kundërshtim me Referuar nenit 18 të Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të po këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të

tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

Nr.	Objekti I prokurimit	Fondi i parashikuar	Fondi i realizuar
1	Kryerje e inspektimit periodik te ashensorëve	447,130	400,000
2	Lule dhe materiale kopshtarie	250,000	149,750
3	Pajisje kompjuterike	932,000	868,000
4	Pompa aksesore	986,960	790,000
5	Shërbim automjetesh	800,000	579,339
6	Tonera për printera	464,750	169,000
7	Vegla pune të përgjithshme	572,256	397,400

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Hedhja në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së e procedurave të prokurimit është bërë sipas manualeve përkatëse të miratuara për këtë qëllim. Gjatë hedhjes së të dhënave në sistem në fazën “Informacion administrativ”, personi i autorizuar ka klikuar tek “data e publikimit”, ku ka vendosur datën por nuk ka vendosur orën e publikimit e për rrjedhojë sistemi ka marrë automatikisht vetëm një orë atë 12.00.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Autoriteti kontraktor duhet ti siguroj minimumi 1 ditë kohë OE për përgatitjen e oferta te tyre, afat qe nuk është respektuar nga AK për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

### **Sistemi dinamik i blerjeve te biletave te transportit ajrore ndërkombëtare.**

**1. Nga auditimi i 9 procedura** për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar të prokura nga Institucioni për vitin 2020 dhe 2021 grupi i auditimit konstatohet se KPVV vendoset si kriter “*OE duhet të ketë në staf 3 punonjës të pajisur me certifikata I. (e vërtetuar me dokumentacionin përkatës)*”. KPVV nuk ka argumentuar përse duhet të ketë 3 punonjës me certifikata I., kriteri i mësipërm është një i sforcuar dhe ka ngushtuar konkurrencën e OE për pasojë në të gjithë procedurat e audituar rezulton fitues i njëjti OE me vlerë **2,283,058 lekë** (tabela si më poshtë). Kriteri i mësipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (a, b, c, ç.), neni 2 germa (a, b, c), neni 20 Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre si dhe nenet 23 dhe 46, VKM 914 Date 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017” e ndryshuar neni 40/1, dhe Udhëzim Nr. 04 date 09.01.2018 pika 6. ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, neni 2, neni 3, neni 36 Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 44.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.

**Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në të gjitha rastet procedurat e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar realizohen në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjelle si pasojë, mungesë të studimit të tregut si rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, pasi biletat e avionit blihen në datën të afërta me nisjen, ku edhe çmimet kapin vlerën me të lartë të tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar.**

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** ish titullari i Institucionit.

Nr.	Destinacioni i udhëtimit	Viti	Kërkesa për prokurim	Datat e udhëtimit	Vlera e kontratave	Operatori fitues
1	Athine	2020	20.02.2020	26.02.2020	238,600	D.
2	Rome	2020	18.11.2020	23.11.2020	251,000	D.
3	Athine	2020	05.03.2020	11.03.2020	147,600	D.
4	Athine	2021	28.10.2021	02.11.2021	183,396	D.
5	Stokholm	2021	11.11.2021	17.11.2021	393,600	D.
6	Bruksel	2021	10.05.2021	18.05.2021	290,752	D.
7	Bruksel	2021	03.11.2021	10.11.2021	96,900	D.
8	Bruksel	2021	19.10.2021	25.10.2021	305,610	D.
9	Stokholm	2021	15.06.2021	21.06.2021	375,600	D.
Vlera totale e kontratave					2,283,058	

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Në lidhje me konstatimet tuaja më sipër, ju sqarojmë se:

Kriteri i mësipërm është vendosur bazuar në nenin 77, të ligjit nr.62, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 39, pika 4, pika 6/ç, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar se përse duhen që OE të ketë në stafin e tij 3 punonjës të pajisur me certifikata I. dhe pse jo 1 punonjës. Kriteri i mësipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

**2. Nga auditimi i 8 procedura** për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar të prokuruar nga Institucioni për vitin 2022 (tabela më poshtë) konstatohet se KPVV ka vendosur në të gjitha rastet vendos orarin e nisjes së fluturimi dhe orarin e kthimit. Vendosja e orarit për nisjen dhe kthimin ndikon drejtpërdrejt në përzgjedhjen e linjës ajrore me të cilën do të bëhet udhëtimi. Në kundërshtim me Ligj nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, neni 36 pika 4.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Komisioni i sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.

Nr.	Destinacioni i udhëtimit	Urdhri i prokurimit
1	Athine	09.12.2022
3	Athine	04.05.2022
4	Rome	18.05.2022
5	Rome	10.10.2022
6	Bruksel	25.10.2022
7	Athine	23.11.2022
8	Bruksel	16.12.2022

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Në lidhje me konstatimet tuaja më sipër, ju sqarojmë se:

Vendosja e orarit të nisjes dhe orarit të kthimit në ftesën për ofertë është bërë sipas përcaktimit në udhëzimin e APP-së nr.03, datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”, pika 5, germa b ku theksohet: “Ftesa për ofertë përmban objektin e prokurimit, të dhënat sasiore e teknike të biletave të transportit ajror ndërkombëtar, grafikun e ekzekutimit, afatin e paraqitjes si dhe dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues, nëse është rasti”. Oraret e nisjes dhe të kthimit lidhen me grafikun e ekzekutimit, sipas përcaktimit në udhëzimin e mësipërm të APP-së.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Siç e kemi cituar dhe me sipër vendosja e orarit për nisjen dhe kthimin ndikon drejtpërdrejt në përzgjedhjen e linjës ajrore me të cilën do të bëhet udhëtimi për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Titulli gjetjes:	Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit.
Situata:	<p>Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit në procedurat, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Procedura Blerje materiale izoluese 2020.</b> Në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë në disa zëra është përdorur emri i markës "M." përmendja e markës është një kriter kufizues, për arsye së nuk janë përdorur fjalët “ose ekuivalent”.</li> <li>• <b>Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare 2021.</b> Kriteret e vendosura nga KPVV janë kriterë kufizuesë pasi kërkohen licenca të cilat janë në fushën e projektimit dhe nuk kanë objektin e prokurimit i cili është Përkthim. Licencat e kërkuara janë si më poshtë: 3/a: Projektme objekteve civile- industriale –turistike prej murature e skelet beton arme në 5 kate 4/a: Projektim të instalimeve hidro-termosanitare. 4/c: Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. 4/j: Projektim të rrjeteve të telefonisë citofonisë, fonisë, internet, tv, acces kontrolli, cctv, sisteme alarmi, sisteme detektimi të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.</li> <li>• <b>Procedura FV Kondicionerë 2022.</b> Vendosja e kriterit “Sigurimin e kontratës në shumën 10% të vlerës së kontratës me TVSh” është në kundërshtim me Ligj nr.162/2020 për prokurimin publik neni 83 pika 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.</li> <li>• Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar të prokuruar nga Institucioni për vitin 2020 dhe 2021, KPVV ka vendoset si kriter “OE duhet të ketë ne staf 3 punonjës të pajisur me certifikata I.” kriteri i mësipërm është një kriter i sforcuar dhe ka ngushtuar konkurrencën e OE për pasojë në të gjithë procedurat e audituar rezulton fitues i njëjti OE.</li> </ul>
Kriteri:	neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; nenet 23 dhe 46, VKM 914 Date 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017”



	e ndryshuar neni 40, 59 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5. Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 2, neni 3, neni 36 Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre si dhe nenet 23, 46 dhe neni 83 pika 1 , dhe Vkm nr.285 datë 19.05.2021 neni 30 pika 1, neni 44. dhe neni 74 pika 3/i.
Ndikimi/Efekti	Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e Operatoreve ekonomik dhe nuk nxisin pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik.
Shkaku:	Devijimi nga kërkesat e akteve ligjore e nënligjore të Prokurimit publik.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël të marrë masa për hartimin e kriteve në mënyrë jo diskriminuese apo orientuese, në mënyrë që të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të OE, si dhe të nxitë pjesëmarrjen dhe konkurrencën ndërmjet tyre .

Titulli gjetjes:	Mosrespektimi i afatit minimal ndaj Operatoret Ekonomik për përgatitjen e ofertave.
Situata:	Në 13 procedura me vlerë të vogël për vitin 2020, 9 procedura me vlerë të vogël për vitin 2021 dhe 7 procedura me vlerë të vogël për vitin 2022 rezulton se KPVV nuk ka respektuar afatin minimal për hapjen dhe pranimin e procedurave i cili duhet të jetë minimalisht 24 orë nga momenti i publikimit në sistemi e prokurimit publik. Në të gjitha procedurat e sipër përmendura afati i publikimit dhe i hapjes është nga 20 orë deri në 23 orë.
Kriteri:	Udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar Pika 11 dhe Udhëzim Nr.05 datë 25.06.2021 pika 12.
Ndikimi/Efekti	Mosrespektimi i afatit minimal ndaj Operatoret Ekonomik për përgatitjen e ofertave, ka sjellë ngushtim e ofertuesve në procedurat me blerje me vlerë të vogël.
Shkaku:	Devijimi nga kërkesat e akteve ligjore e nënligjore të Prokurimit publik.
Rëndësia:	I larte.
Rekomandimi:	Komisioni i prokurimit me vlere te vogël të marrë masa për respektimi e afatit minimal duke i siguruar operatoreve ekonomike të paktën 24 orë kohë për përgatitjen e oferta.

Titulli gjetjes:	Përkthimi i projektit nuk është në veprimtarinë e DSHTD.
Situata:	• <b>Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare 2021.</b> Përkthimi i projektit nuk është në veprimtarinë e DSHTD pasi në VKM Nr.840, datë 17.12.2004 Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik. Pika 2/a citon : Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë;
Kriteri:	VKM Nr.840, datë 17.12.2004 Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik. Pika 2/a citon : Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë.
Ndikimi/Efekti	Përdorimin pa eficiencë të fondeve të buxhetit të Institucionit në vlerën

	<b>294,000 lekë</b>
Shkaku:	Realizimi i një investimi të cilën nuk e ka fushë të veprimtarisë së Institucionit.
Rëndësia:	I larte.
Rekomandimi:	Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të fondeve të buxhetit të Institucionit në vlerën <b>294,000 lekë me TVSh</b> për procedurën “Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadës Bullgare”.

Titulli gjetjes:	Mbi çmimet e biletave të paguara nga institucioni për udhëtime jashtë vendit.
Situata:	Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar të prokuruar nga Institucioni për vitin 2020 dhe 2021, realizohen në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjelle si pasojë, mungesë të studimit të tregut si rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, pasi biletat e avionit blihen në datën të afërta me nisjen, ku edhe çmimet kapin vlerën me të lartë të tyre.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm” i ndryshuar neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12. Udhëzimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kap.I, pika 1, 40 dhe 48, germa a. Ligjin e LPP nr.162 dt. 23.12.2020, neni 2.
Ndikimi/Efekti	Risku i përzgjedhjes së çmimit më të lartë në rastet kur bileta blihet në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.
Shkaku:	Nxjerrja me vonesë e autorizimit për udhëtimet jashtë vendit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit ose për planifikimet e udhëtimeve jashtë vendit të nxjerrë menjëherë autorizimin e pjesëmarrësve në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.

Titulli gjetjes:	Skualifikimi i Operatorit ekonomik.
Situata:	Vendosja e kriterëve jo ne përputhje me objektin e prokurimit në dhe skualifikimi i tyre ne procedurën: <b>Procedura FV Kondicionerë 2022.</b> Nga auditimi konstatohet se KPVV ka skualifikuar OE “P.S.” i renditur në vendin e dytë pasi në dokumentet e dorëzuar nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, KPVV nuk duhet të s’kualifikonte OE pasi në procedurat e blerjeve te vogla AK nuk duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës. Diferenca e OE të shpallur fituese “K.T.” shpk dhe skualifikimi i OE “P.S.” me oferte me të ulët, janë fonde të përdorura pa ekonomikitet në vlerën 64,372 lekë me TVSH.
Kriteri:	neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; nenet 23 dhe 46, VKM 914 Date 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017” e ndryshuar neni 40, 59 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5. Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 2, neni 3, neni 36

	Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre si dhe nenet 23, 46 dhe neni 83 pika 1, dhe Vkm nr.285 datë 19.05.2021 neni 30 pika 1, neni 44. dhe neni 74 pika 3/i.
Ndikimi/Efekti	Përdorimin pa eficiencë të fondeve të buxhetit të Institucionit në vlerën <b>64,372 lekë</b>
Shkaku:	Devijimi nga kërkesat e akteve ligjore e nënligjore të Prokurimit publik.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të fondeve të buxhetit të Institucionit në vlerën <b>64,372 lekë</b> në Procedurën “FV Kondicionerë 2022”.

#### **d. Administrimi i pronës shtetërore dhe procedurat e qiradhënies**

Drejtorja e Shërbimit të Trupit Diplomantik (këtu e në vijim “DSHTD”), referuar VKM nr. 840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik”, ka për objekt administrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, të njëjtat shërbime mund t’ua ofrojë edhe subjekteve, shtetërore ose private, shqiptare, si veprimtari dytësore, por që i shërbejnë objektit kryesor të veprimtarisë së saj. Po ashtu rezulton se DSHTD ofron dhe shërbime të tjera për pronat që jep me qira siç janë furnizimi me ujë të ngrohtë, mirëmbajtja e ashensorit, mirëmbajtja e ambienteve të përbashkëta si dhe parking. Ndër burimet kryesore të të ardhurave të DSHTD janë të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për Trupin Diplomantik të huaj dhe të subjekteve të treta.

Sa i takon bazës ligjore, deri më tani është konstatuar se nuk ka një akt tjetër nënligjor që rregullon procedurën e qiradhënies me subjektet e huaja, përfaqësi diplomatike apo organizata ndërkombëtare, dhe akti nënligjor i vetëm i identifikuar për këtë procedurë është VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i cili i referohet dhënies me qira apo enfi-teozë të pasurive shtetërore, ndër të tjera edhe nga ndërmarrjet shtetërore, sikurse është DSHTD.

DSHTD, përgjatë periudhës së auditimit, ka përcaktuar tarifat e qirave, nëpërmjet Vendimeve të Këshillit Drejtues, si më poshtë:

##### ➤ **Për vitin 2020**

Me Urdhrin e Drejtorit të DSHTD nr. 238, datë 07.11.2019 është ngritur grupi i punës për studimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve të vëna në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaja. Me shkresën nr. 1085/2 prot., datë 20/11/2019, grupi i punës harton relacionin mbi tarifat e dhënies me qira të objekteve pas kryerjes së studimit të tregut. Në përfundim, me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 20.11.2019 Këshilli Drejtues ka miratuar tarifat e dhënies me qira.

##### ➤ **Për vitin 2021**

Me Urdhrin e Drejtorit të DSHTD nr. 260, datë 05.11.2020 është ngritur grupi i punës për studimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve të vëna në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaja. Me shkresën nr. . 916/2 prot., datë 18/11/2020, grupi i punës harton relacionin mbi tarifat e dhënies me qira të objekteve pas kryerjes së studimit të tregut. Në përfundim, me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 25, datë 18.11.2020 Këshilli Drejtues ka miratuar tarifat e dhënies me qira.

##### ➤ **Për vitin 2022**

Me Urdhrin e Drejtorit të DSHTD nr. 258, datë 22.10.2021 është ngritur grupi i punës për studimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve të vëna në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaja. Me shkresën nr. 928/5 prot., datë 26/11/2021, grupi i punës harton relacionin mbi tarifat e dhënies me qira të objekteve pas kryerjes së studimit të tregut. Në përfundim, me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 27, datë 26.11.2021 Këshilli Drejtues ka miratuar tarifat e dhënies me qira.

Reflektimet e tarifave të vendosura paraqiten, si më poshtë:

Nr.	Objektet	2020	2021	2022
1	Apartament për banim i pa rikonstruktuar	5 €/m <sup>2</sup>		
2	Apartament për banim i rikonstruktuar	5,5 €/m <sup>2</sup>	5,5 €/m <sup>2</sup>	5,8 €/m <sup>2</sup>
3	Ambient për zyrë	7 €/m <sup>2</sup>	7 €/m <sup>2</sup>	7,3 €/m <sup>2</sup>
4	Ambient në katin përdhe fasadë kryesore	7 €/m <sup>2</sup>	7 €/m <sup>2</sup>	7,5 €/m <sup>2</sup>
5	Ambient në katin përdhe anash e mbrapa	5 €/m <sup>2</sup>	5 €/m <sup>2</sup>	6 €/m <sup>2</sup>
6	Truall i lirë funksional (çmim dysheme)	1,5 €/m <sup>2</sup>	1,5 €/m <sup>2</sup>	1,5 €/m <sup>2</sup>
7	Sipërfaqe vilash me destinacion :përdorim për zyra	7,5 €/m <sup>2</sup>	7,5 €/m <sup>2</sup>	7,5 €/m <sup>2</sup>
8	Sipërfaqe vilash me destinacion :përdorim për rezidencë	5,5 €/m <sup>2</sup>	5,5 €/m <sup>2</sup>	5,5 €/m <sup>2</sup>
9	Sipërfaqja e bodrumeve të vilave	4 €/m <sup>2</sup>	4 €/m <sup>2</sup>	4 €/m <sup>2</sup>
10	Sipërfaqja e oborreve të vilave	1,5 €/m <sup>2</sup>	1,5 €/m <sup>2</sup>	1,5 €/m <sup>2</sup>
11	Pall. Nr.57 (Apartament për banim)	4 €/m <sup>2</sup>	4 €/m <sup>2</sup>	5 €/m <sup>2</sup>
12	Pall. Nr.57 (Bodrume)	4 €/m <sup>2</sup>	4 €/m <sup>2</sup>	4 €/m <sup>2</sup>
13	Pall. Nr.57 (Apartament për zyrë)	5 €/m <sup>2</sup>	5 €/m <sup>2</sup>	6 €/m <sup>2</sup>

Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, DSHTD ka në administrim 97 objekte, të cilat janë dhënë me qira për subjektet e huaja ose vendase bazuar në tarifën e miratuara me VKD, si dhe përdoren për zyra nga vetë DSHTD apo nga marrëveshje të tjera të lidhura.

### Shpërndarja e të ardhurave

Referuar Kreut VII “Shpërndarja e të ardhurave” të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ardhurat që krijohen:

1. Nga kontrata e qirave të lidhura për pasuri me sipërfaqe nën 200m<sup>2</sup> ndahen 30% buxheti i shtetit dhe 70% ndërmarrja shtetërore që ka në administrim objektin;
2. Nga kontratat e qirasë të lidhura në ndërmarrjet shtetërore, ku ministria përgjegjëse për ekonominë ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore (u referohet pasurive me sipërfaqe mbi 200m<sup>2</sup>) ndahen 30% MFE dhe 70% ndërmarrja shtetërore që ka në administrim objektin.

Në rastin e DSHTD, edhe procedurat e qiradhënies për objektet me sipërfaqe mbi 200m<sup>2</sup>, në rastet kur janë përdorur për sistemimin e trupit diplomatik/ organizatave ndërkombëtare, janë ndjekur nga vetë DSHTD dhe jo nga ministria përgjegjëse për ekonominë, si detyrim që rrjedh nga VKM nr. 840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”.

Pika 6 e këtij kreu parashikon gjithashtu përjashtimet nga detyrimi i derdhjes së të ardhurave nga dhënia me qira, për institucionin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, Autoritetin Portual Durrës, si dhe shoqëritë e trajtimit të studentëve, ku përcaktohet se këto të ardhura do t’i përdorin për të mbuluar shpenzimet e veta.

**Nga auditimi ka rezultuar se** DSHTD ka aplikuar derdhjen e 30% të të ardhurave të krijuar nga qiraja vetëm nga “subjektet vendase”, me pretendimin se, meqenëse procedura e dhënies me qira e parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk mund të aplikohet për trupin diplomatik apo organizatat e tjera ndërkombëtare, rrjedhimisht, as derdhja e detyrimit 30% nuk duhet të aplikohet.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk e parashikon konceptin e subjektit vendas apo subjektit të huaj, kjo ndarje është bërë nga vetë DSHTD për efekt lehtësie në administrimin e procedurave. DSHTD nuk rezulton të ketë kërkuar asnjëherë rishikimin e këtij akti, me qëllim përjashtimin nga detyrimi për zbatim të procedurave të qiradhënies, në rastet kur pala qiramarrëse është pjesë e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

Pavarësisht sa më sipër, për sa kohë DSHTD është një ndërmarrje shtetërore dhe objektet që po jep me qira janë pasuri shtetërore, pavarësisht palës qiramarrëse, DSHTD ka detyrimin të derdhë 30% të të ardhurave në buxhetin e shtetit, për sa kohë nuk përjashtohet shprehimisht në VKM nr. 54, datë

5.2.2014.

Situacioni mbi derdhjet në buxhetin e shtetit, për vitet periudhë auditimi paraqitet, si më poshtë:

	Për vitin 2020	Për vitin 2021	Për vitin 2022
Të ardhura nga qiradhëniet	191,955,344	192,273,126	188,873,650
Derdhur në buxhetin e shtetit (vetëm për subjektet vendase)	2,549,003	3,206,032	4,304,069
30% e të ardhurave totale nga qiratë	57,586,603.20	57,681,937.80	56,662,095
<b>Diferenca</b>	<b>55,037,600.20</b>	<b>54,475,905.80</b>	<b>52,358,029</b>
<b>DIFERENCA TOTALE</b>	<b>161,871,535</b>		

Vlera prej **161,871,535 lekë** është diferenca ndërmjet 30% të të ardhurave totale nga qiratë dhe vlerës së derdhur në buxhetin e shtetit për vitet 2020-2022.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Sektori i Financës.

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Lidhur me shpërndarjen e të ardhurave, DSHTD e ka zbatuar vetëm në kontratat e qirasë të lidhura sipas VKM Nr.54/2014.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk e parashikon konceptin e subjektit vendas apo subjektit të huaj, kjo ndarje është bërë nga vetë DSHTD për efekt lehtësie në administrimin e procedurave. DSHTD nuk rezulton të ketë kërkuar asnjëherë rishikimin e këtij akti, me qëllim përjashtimin nga detyrimi për zbatim të procedurave të qiradhënies, në rastet kur pala qiramarrëse është pjesë e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

Pavarësisht sa më sipër, për sa kohë DSHTD është një ndërmarrje shtetërore dhe objektet që po jep me qira janë pasuri shtetërore, pavarësisht palës qiramarrëse, DSHTD ka detyrimin të derdhë 30% të të ardhurave në buxhetin e shtetit, për sa kohë nuk përjashtohet shprehimisht në VKM nr. 54, datë 5.2.2014. **Observacioni nuk merret në konsideratë.**

Nga auditimi me përzgjedhje i kontrata të qirave për periudhën objekt auditimi u konstatua mangësi si më poshtë.

**1.** Kontrata me nr. 1096/2 datë 22.11.2019 KQSV-12.2019- “M.“ - 014, me objekt ambientin në katin përdhe 77,7 m<sup>2</sup> + lulishte funksionale me sip.120,21 m<sup>2</sup>, Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 26.12.2019-25.12.2020.(1 vit) rinovuar çdo vit për periudhën objekt auditimi. Qiramarrësi deklaron se ambienti do të përdoret për Bar-Bufë, Piceri, me një tarifë qiraje prej 4 €/m<sup>2</sup> për ambientin përdhe prej 77.7m<sup>2</sup>, dhe 150 lekë / m<sup>2</sup> për 120.12 lulishten funksionale, të cilën sipas nenit 4 të kontratës subjekti duhet ta paguajë çdo muaj brenda 5 ditëve nga data e faturimit.

**Nga Auditimi** i dokumentacionit konstatohet se subjekti i sipërcituar është trajtuar si përfaqësi diplomatike dhe çmimi për m<sup>2</sup>, është më i ulët se sa ai i miratuar me VKD për këtë zonë. Për ambientin përdhe prej 77.7m<sup>2</sup> çmimi është 4€ dhe nuk ka ndryshuar ndërsa për truallin prej 120.12 m<sup>2</sup> çmimi është 150lek/m<sup>2</sup> dhe nuk janë aplikuar çmimet e reja të vendosura nga VKD që duhej të ishte 1.5€/m<sup>2</sup>.

Favorizimi i subjektit është në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira.”, ku përcaktohet se çmimet favorizuese do të bëhen për shkak të planeve të investimeve në rastet e kontratave mbi 200 m<sup>2</sup>. Konkretisht sipërfaqja prej 77,7m<sup>2</sup> duhej të tarifohej me 7 €/ m<sup>2</sup>, dhe 77,7 \* 3€/ m<sup>2</sup>=233 euro/muaj \* 12= **2796** euro në vit të ardhura të munguara për Institucionin.

Gjithashtu konstatohet se për subjektin e mësipërm tarifa e qirasë është vendosur sipas çmimeve të miratuara nga VKD për vitin 2019 pavarësisht se kontrata me subjektin është lidhur 2 dite mbasi Këshilli Drejtues miratoj tarifat e dhënies me qira për vitin 2020 me VKD nr. 29, datë 20.11.2019.

Konkretisht sipërfaqja e lulishtes prej 120.12 duhej të tarifohej 1.5€/m<sup>2</sup> pasi kontrata është firmosur

me datë 22.11.2019 dy ditë mbas miratimit të çmimeve të vendosura nga VKD dhe afati i kontratës është nga data 26.12.2019-25.12.2020.

Sipërfaqja prej  $120,12 * 150\text{lek} * 12 \text{ muaj} = 216,216 \text{ lekë}$  në vit sipas kontratë, por duhet të ishte  $120,12\text{m}^2 * 1.5\text{€} * 12\text{muaj} = 2162,16\text{€}$  euro në vit sipas VKD.

$2162,16\text{€} * 122.44\text{€}$  (çmimi mesatar i kursit të këmbimit sipas bankës së Shqipërisë) = 264,648 leke, 264,648 leke - 216,216 leke të përfituara sipas kontratës = 48,432.

Si përfundim në total vlera prej **2796 €** dhe **48,432 leke** janë ardhura të munguara për Institucionin.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Ish titullari i Institucionit.

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** DSHTD-ja në objektin e veprimtarisë së saj, ka dhënë me qira të ambienteve që ajo administron me qëllim rritjen e të ardhurave të saj. Pjesë e këtij objekti për dhënien me qira janë edhe ambientet në katin përdhe të pallatit nr. 4, në Rr. “Skënderbej”, Tiranë. Vlerësojmë t’u vëmë në dijeni se ambienti i marrë me qira nga subjekti “M.” kishte një periudhë të gjatë kohe që nuk përdorej. Deri në kohën që në DSHTD erdhi kërkesa për ta marrë me qira, ky ambient ishte përdorur si depo dhe në këto kushte ishte jashtë çdo standardi për t’u dhënë me qira si objekt shërbimesh, pasi ishte tepër i amortizuar, me lartësi të kufizuar, me hapësira të ngushta e të limituara për shkak të dimensionit të mureve në katin përdhe të godinës nr.4 (sipërfaqja e mureve të objektit prej 77.7 m<sup>2</sup> është 18.4 m<sup>2</sup>).

Tarifa e qirasë për ambientin e marrë me qira nga “M.”, është vendosur duke vlerësuar gjendjen fillestare të këtij ambienti (përmendur më sipër) dhe jo si çmim favorizues ndaj subjektit “M.”, si dhe në zbatim të nenit 6, pika 2, të ligjit “Për ndërmarrjet shtetërore”, sipas së cilit “*Ndërmarrjet shtetërore përcaktojnë lirisht çmimet e mallrave apo shërbimeve, në bazë të kërkesës e ofertës me përjashtim të atyre rasteve që përcaktohen me dispozita të veçanta.*”, me qëllim krijimin e mundësisë së shfrytëzimit me efikasitet të këtij ambienti dhe sjelljen e të ardhurave për ndërmarrjen. Sa më sipër, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 19.11.2018, “*Relacion mbi miratimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve të DSHTD- së të vëna në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaja për vitin 2019*”, janë miratuar tarifat e qirasë që do të zbatohen për të gjitha **kontratat e reja dhe ato që do të rinovohen rishtazi gjatë vitit 2019**, nga ku ka rezultuar se për ambientin e sipërcituar, janë miratuar tarifat si më poshtë:

Gjithashtu për këtë ambient për vitin 2020, me Vendim të Këshillit Drejtues, Nr. 29, datë 20.11.2019, “*Relacion mbi miratimin e tarifave të dhënies me qira të objekteve që DSHTD-ja ka në përgjegjësi administrimi, të vëna në dispozicion për subjekte vendase dhe ato të huaja për vitin 2020*”, janë miratuar tarifat si më poshtë:

Sa i takon arsyes pse kontrata e qirasë për vitin 2019, është lidhur me tarifat e miratuara me VKD nr. 24, datë 19.11.2018, sqarojmë se:

Në momentin e rinovimit të kontratës së qirasë me indeks KQSV-12.2019- M.-014, nga periudha 01.01.2019-31.12.2019, në fuqi ka qenë VKD nr. 24 dt. 19.11.2018, me tarifën 150 lekë /m<sup>2</sup>, si rrjedhojë DSHTD nuk mund të zbatonte tarifën prej 1.5 Euro/m<sup>2</sup>.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Trajtimi i këtij subjekti me çmim preferencial nuk konsiderohet e drejtë. Subjekti privat është trajtuar me çmim për m<sup>2</sup>, në dukje më të ulët se sa ai i miratuar me VKD, për këtë zonë. Trajtimi si rast përjashtimor është në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “*Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira*”, ku përcaktohet se çmimet favorizuese do të bëhen për shkak të planeve të investimeve në rastet e kontratave mbi 200 m<sup>2</sup>. Konkretisht sipërfaqja prej 77,7m<sup>2</sup> duhej të tarifohej me 7 €/ m<sup>2</sup>, dhe si rrjedhim do të kishim një vlerë më të madhe në të ardhurat e këtij institucioni, cituar sa më sipër në auditimin e kësaj dosjeje. Ndërkohë sipërfaqja prej 120.12 m<sup>2</sup> duhej të tarifohej me 1.5 €/ m<sup>2</sup> pasi kontrata është lidhur 2 ditë mbrapa daljes së VKD nr.29, datë 20.11.2019 me tarifat për vitin 2020. Gjithashtu kontrata e subjektit përfshin pothuajse të gjithë vitin kalendarik 2020 pasi fillon me datë 26.12.2019 dhe mbaron me

1. Me shkresë nr.428 prot datë 01.06.2020, znj. A. A qytetare me shtetësi nga Kosova ka bërë kërkesë pranë DTSHD për të marrë me qira apartamentit 57/2/24 pallati 57 në bulevardi “Zogu i zi”. Me shkresë nr.456/2 prot datë 09.06.2020 VKD ka vendosur të jap me qira apartamentit e sipër cituar me sipërfaqe 59.6 m<sup>2</sup> me dhe me çmim 4 € m<sup>2</sup>.

Me shkresë nr.428/3 prot datë 10.06.2020 ka dërguar për miratim pranë MEPJ dhënien e apartamentit me qira dhe me shkresë prot 428/7 date 15.06.2020 ka ardhur miratimi parimisht i dhënies me qira te ambientit.

Kontrata është lidhur me nr.428/11 prot datë 13.07.2020 KQSV-07.2020- “A.A“ - 013, me sipërfaqe 59.6 m<sup>2</sup> , Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është nga data 01.08.2020-31.07.2021.(1 vit) kontratë e rinovuar dhe në vitin 2022. Qiramarrësi deklaron se ambienti do të përdoret për Banim me një tarifë qiraje prej 4 €/ m<sup>2</sup> , 59.6 m<sup>2</sup> \* 4 €/ m<sup>2</sup>= 238.4 € në muaj.

Sipas pikës 2 të nenit 8 qiramarrësi duhet të derdh garancinë e kontratës e barabartë me 1 një muaj të qirasë.

2. Me shkresë nr.268 prot datë 02.04.2021, qytetari z. L.H ka bërë kërkesë pranë DTSHD për të marrë me qira të një apartamentit në pallatin nr.57 në bulevardin zogu i zi.

Me shkresë nr.295 prot datë 13.04.2021 VKD ka vendosur të jap me qira apartamentit 57/2/14 pallati 57 me sipërfaqe 59.6 m<sup>2</sup> me dhe me çmim 4 € m<sup>2</sup>.

Me shkresë nr. 268/4 prot datë 15.04.2021 ka dërguar për miratim pranë MEPJ dhënien e apartamentit me qira dhe me shkresë prot 268/5 date 22.04.2021 ka ardhur miratimi parimisht i dhënies me qira të ambientit.

Kontrata është lidhur me nr.268/8 prot datë 28.04.2021 KQSV-05.2021- “L.H“ - 038, me sipërfaqe 59.6 m<sup>2</sup>, Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është nga data 01.05.2021-30.04.2022 (1 vit) kontratë e rinovuar deri në vitin 2023 . Qiramarrësi deklaron se ambienti do të përdoret për Banim me një tarifë qiraje prej 4 €/ m<sup>2</sup> , 59.6 m<sup>2</sup> \* 4 €/ m<sup>2</sup>= 238.4 € në muaj.

Sipas pikës 2 të nenit 8 qiramarrësi duhet të derdh garancinë e kontratës e barabartë me 1 një muaj të qirasë.

**Nga Auditimi** i 2 procedura të dhënies me qira të apartamenteve konstatojmë se DSHTD i ka lëshuar me qira këto ambiente individëve dhe jo subjekteve ose personave fizik në kundërshtim me VKM Nr.840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e drejtorisë së shërbimit të trupit diplomatik” i ndryshuar neni 3 citon: *Të njëjtat shërbime, që D.SH.T.D-ja kryen për Trupin Diplomatik, mund t’ua ofrojë edhe subjekteve, shtetërore ose private, shqiptare, si veprimtari dytësore si dhe me VKM Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore” Kreu II pika 7.*

Gjithashtu dhe pagesat e garancisë referuar kontratave të lidhura është për 1 muaj dhe jo 3 muaj në kundërshtim me VKM Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore” Kreu II pika 14.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Ish titullari dhe titullari i Institucionit.

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Në zbatim të pikës 5,b të VKM nr.840 datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, burimet financiare të DSHTD janë:

*b-Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për subjekte të treta, si dhe nga shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;*

Për sa më sipër, DSHTD në objektin e veprimtarisë së saj, ka dhënien me qira të ambienteve që ajo administron me qëllim rritjen e të ardhurave të saj dhe si rrjedhojë është në përmbushje të qëllimit të saj juridik dhe ekonomik në administrim dhe krijimin e të ardhurave për ndërmarrjen dhe buxhetin e shtetit referuar ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, Kreu I, neni 1, ku citohet se: *Ky ligj përcakton regjimin juridik të ndërmarrjeve shtetërore të cilat, në përputhje*

me objektin e parashikuar në aktin e krijimit të tyre, ushtrojnë veprimtari prodhimi, tregtie, apo shërbimi duke pasur si qëllim realizimin e fitimit dhe shtimin e pasurisë.

Këto ambiente objekt kontrate dhe gjetje nga ana juaj, nuk janë kërkuar asnjëherë për marrjen me qira nga përfaqësi të huaja diplomatike/ subjekte publike apo juridike ( në kuptim të shoqërive tregtare ose persona fizik të cilët mund të ushtrojnë një aktivitet ekonomik në këto ambiente), që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në RSH. Ndodhur para këtij fakti, DSHTD në zbatim të nenit 5,b të VKM nr. 840/2004, këto ambiente i ka dhënë me qira me qëllim përdorimi banim, nga ku janë përfituar të ardhura sipas llogaritjes së mëposhtme: **Në total, të dy apartamentet cituar më sipër, kanë arkëtuar gjithsej shumën 14,230 euro në buxhetin e DSHTD.** Theksojmë se DSHTD, me dhënien me qira të këtyre dy apartamenteve nuk ka sjellë asnjë pasojë negative në buxhetin e saj ose të shtetit, por me administrimin me efikasitet të tyre ka pasuruar atë në vlerën **14 230** euro. Mbajtja e garancisë në kontratat e qirasë me nr. 428/11 Prot., datë 13.07.2020, KQSV-07.2020- A.A- 013 dhe kontratën e qirasë me nr. 268/8 Prot., datë 28.04.2021, KQSV -05.2021-L.H-038, është kryer në zbatim të Vendimit të Këshillit Drejtues të DSHTD Nr.8, Datë 05.06.2014, ku citohet se:

“Në momentin e lidhjes së kontratës së qirasë duhet që nga pala qiramarrëse të jetë ngurtësuar pagesa në vlerën e qirasë prej një muaji”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** VKM nr.840 datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, pikës 5,b që keni cituar dhe ju shprehet se *Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për subjekte të treta*, kontratat e sipërcituar nuk janë lidhur me subjekte por me individë. Gjithashtu dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” e ndryshuar Kreu II pika 7 përcakton të gjithë dokumentet që duhet të dorëzoj subjekti i cili minimalisht është i pajisur me Nius. Ndërkohë dhe qira është mbajtur për 1 muaj por në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 Kreu II pika 14 citon: *Para nënshkrimit të kontratës së qirasë ose të enfiteozës, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e tre muajve të pagesës së qirasë ose të enfiteozës* **Observacioni nuk merret në konsideratë.**

1. Kontrata me nr. 180/3 datë 07.03.2019, KQSV-03.2019-S.-007, me objekt apartamentin nr. 57/1/1, e cila ndodhet në adresën Bulevardin “Zogu I”. Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 16.03.2019-15.03.2020, rinovuar çdo vit për periudhën objekt auditimi. Vlera e apartamentin është 886.5 € në muaj të cilën sipas nenit 4 të kontratës subjekti duhet ta paguajë çdo muaj brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe në rast vonese në pagimin e qirasë mujore, qiramarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesë prej 1 % të vlerës së çdo fature për çdo ditë vonesë.

2. Kontrata me nr. 283/4 datë 15.04.2019, KQSV-05.2019-S.-008, me objekt bodrum për arshivë, e cila ndodhet në adresën Bulevardin “Zogu I”. Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 16.03.2019-15.03.2020, rinovuar çdo vit për periudhën objekt auditimi. Vlera e apartamentin është 636 € në muaj të cilën sipas nenit 4 të kontratës subjekti duhet ta paguajë çdo muaj brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe në rast vonese në pagimin e qirasë mujore, qiramarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesë prej 1 % të vlerës së çdo fature për çdo ditë vonesë.

**Nga auditimi** i dokumentacionit dhe faturave të pagesës së qirasë konstatohet se subjekti nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni nuk ka marrë masë për te aplikuar penaltitetin për kamatëvonesat. Penaltiteti i pavendosur llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **411.08 €**, të cilat për Institucionin janë te ardhura te munguara. (tabela me poshtë). *Në kundërshtim me kontratën nr.180/3 datë 07.03.2019, KQSV-03.2019-S.-007 dhe kontratën me nr.283/4 datë 15.04.2019, KQSV-05.2019- S.-008 neni 4 pika 1 citon: Qiramarrësi duhet ti paguaj qiradhënësit qiranë mujore brenda 5(pesë) ditëve, nga data e faturimit, përgjatë gjithë zgjatjes së kontratës.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Sektori i Financës dhe komisioni i monitorimit të kontratave me subjektet vendase.



Apartamenti 57/1/1 & Bodrumi				
Data e faturimit	Data e pagesës se kryer	Penalite ne dite vonese €	Dite vonese	Penaliteti ne €
06/01/2020	30/01/2020	15.23	19	289.28
05/02/2020	18/02/2020	15.23	8	121.80
<b>Totali kamatëvonesa ne euro</b>			<b>411.08</b>	

1. Kontrata me nr. 1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019- S.-059, me objekt vilën nr. 49, e cila ndodhet në adresën Rruga "Skënderbej". Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 01.11.2019-30.10.2020, rinovuar çdo vit për periudhën objekt auditimi. Sipërfaqja e vilës është 1137,3 m<sup>2</sup> dhe vlera totale e vilës nr.49 është 4904.75€ në muaj të cilën sipas nenit 4 të kontratës subjekti duhet ta paguajë çdo muaj brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe në rast vonese në pagimin e qirasë mujore, qiramarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesë prej 1 % të vlerës së çdo fature për çdo ditë vonese.

**Nga auditimi** i dokumentacionit konstatohet se nuk është kryer procedura e konkurrimit për dhënien me qira të vilës nr. 49. Nuk rezulton të jetë njoftuar MEPJ për dhënien e Vilës me qira. Qiramarrësi është një fondacion privat ndërkombëtar që nuk gëzon privilegje apo status diplomatik dhe si i tillë duhet të ishte zhvilluar garë, *Në kundërshtim me VKM nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore "kapitullin II" procedura e dhënies me qira dhe enfitëoze e pasurive shtetërore, dhe domosdoshmërinë e hartimit dokumentacionit përkatës, për dhënien me qira të këtyre pronave.* Gjithashtu ky akt parashikon edhe tagrin e organit Ministria e Financës dhe Ekonomisë i cili ka të drejtë të lidh kontratën e qirase mbi 200m<sup>2</sup>.

Ndërkohë nga auditimi i faturave të pagesës së qirasë konstatohet se subjekti nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni i ka vendosur penalitetin vetëm për muajin gusht me shkresë nr. 834 prot 02.10.2020 në vlerën 98€ penalitete.

Ndërsa për muaj e tjerë nuk janë marrë masa për të aplikuar penalitetet për kamatëvonesat.

Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **294.29 €**, të cilat për Institucionin janë të ardhura të munguara. (tabela me poshtë). *Në kundërshtim me kontratën nr. 1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019- S.-059 neni 4 pika 1 citon: Qiramarrësi duhet ti paguaj qiradhënësit qiranë mujore brenda 5(pesë) ditëve, nga data e faturimit, përgjatë gjithë zgjatjes së kontratës.*

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Ish titullari, titullari i Institucionit dhe sektori i financës.

VILA NR.49				
Data e faturimit	Data e pagesës se kryer	Penaliteti ne dite vonese €	Dite vonese	Penaliteti ne €
06/01/2020	16/01/2020	49.05	5	245.24
04/09/2020	10/09/2020	49.05	1	49.05
<b>Totali kamatëvonesa në euro</b>			<b>294.29</b>	

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** DSHTD gjatë gjithë kohës së funksionimit të saj, ka trajtuar organizatat që punojnë për shtetet e Bashkimit Evropian dhe SHBA-së dhe të cilat mbështeten nga ambasadat respektive në Tiranë, me të njëjtat kushte si përfaqësitë e trupit diplomatik. Si rrjedhojë, e trajtuar si e tillë, në regjimin e qiramarrjes, kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet DSHTD dhe S., nuk i nënshtrohen përcaktimeve ligjore të VKM nr.54 datë 05.02.2014.

Procedura e dhënies me qira e ambienteve ndaj këtyre subjekteve është përshtatur me procedurën e dhënies me qira të subjekteve diplomatike, duke zbatuar edhe legjislacionin shqiptar për aq sa është e mundur. Një procedurë e tillë është ndjekur për shkak të mungesës së përcaktimeve ligjore konkrete që rregullojnë dhënien me qira për organizatat e huaja, që operojnë me fondet e BE apo SHBA, dhe në asnjë rast për të krijuar favore ndaj tyre.

Edhe nga auditime të tjera që DSHTD ka pasur ndër vite, trajtimi i këtyre subjekteve si përfaqësi diplomatike nuk është gjetur shkelje. Në këto kushte është trajtuar S. për kontratën e Vilës nr. 49. Sa i takon marrjes së miratimit nga MEPJ sqarojmë se: Për lidhjen e kontratave të qirasë, DSHTD i nënshtrohet dispozitave të VKM nr.840 datë 17.12.2014, konkretisht pikës 8, të ndryshuar, “*Tarifat e shërbimeve dhe çmimet e qirave, që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik zbaton për Trupin Diplomantik, përcaktohen në përputhje me të drejtat e përfaqësive Diplomantike dhe detyrimet e shtetit shqiptar, që burojnë nga marrëveshjet dypalëshe dhe miratohen për çdo vit financiar, nga Këshilli Drejtues i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik.*”, e cila duke mos përcaktuar afate konkrete për kohëzgjatjen e kontratës së qirasë, nuk përjashton mundësinë e lidhjes së kontratave të qirasë me Trupin Diplomantik me afat më shumë se një vit, ashtu sikurse e përcakton VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Pika 3/1 e VKM nr.840 datë 17.12.2014 “Përcaktimi i çmimeve dysHEME të qirasë që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik zbaton për subjektet shqiptare jo diplomatike, dhe procedurat përkatëse bëhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për përcaktimin e tarifave të qirasë për objektet e ndërmarrjeve shtetërore”, na referon direkt tek zbatimi i procedurave të përcaktuara në VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, vetëm për subjektet shqiptare jo diplomatike. Bazuar në këtë interpretim ligjor, DSHTD nuk ka detyrim të përcaktuar në akte ligjore apo nënligjore, për të marrë miratimin e organit të vartësisë administrative, në këtë rast MEPJ, për lidhjen e kontratave të qirasë me Trupin Diplomantik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, apo për nënshtrohet procedurave të konkurrimit, kur ambientet e marra me qira nga këto subjekte janë mbi 200 m<sup>2</sup>.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Subjekti nuk është përfaqësi diplomatike dhe duhet ti nënshtrohet përcaktimeve VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si gjithë subjektet e tjerë si në përzgjedhje por edhe në kushtet e lidhjes së kontratës, pasi nuk ka statusin e përfaqësive diplomatike. **Observacioni nuk merret në konsideratë.**

2. Kontrata me nr. 1182/1 datë 17.12.2019, KQPH/V-01.2020- A.R.F.Gj-001, me objekt vilën nr.8 dhe nr.2, e cila ndodhet në adresën Rruga “Skënderbej”. Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 01.01.2020-31.12.2020, rinovuar çdo vit për periudhën objekt auditimi. Vlera totale e vilës nr.8 dhe nr.2 është 31,636.8€ në muaj të cilën sipas nenit 4 të kontratës subjekti duhet ta paguajë çdo muaj brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe në rast vonese në pagimin e qirasë mujore, qiramarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesë prej 1 % të vlerës së çdo fature për çdo ditë vonese.

**Nga auditimi** i dokumentacionit dhe faturave të pagesës së qirasë konstatohet se subjekti për periudhën janar 2020 - janar 2022, për 25 muaj ka paguar qiranë në vlerën 31,611.49 € ose 25.31€ me pak se vlera e kontratës së qirasë, 25.31€ \* 25 muaj = **632.75 €** të ardhura të munguara për DSHTD. Në kundërshtim me kontratën nr. 1182/1 datë 17.12.2019, KQPH/V-01.2020- A.R.F.Gj-001 neni 3 citon: *Vlera në total e qirasë për Vilën nr. 8 dhe nr. 2 është 31,636.8 €/muaj.*

Gjithashtu konstatohet se subjekti nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni nuk ka marrë masë për të aplikuar penaltitetin për kamatëvonesat. Penaltiteti i pavendosur llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **28,473.12 €**, (tabela me poshtë). Në kundërshtim me kontratën nr. 1182/1 datë 17.12.2019, KQPH/V-01.2020- A.R.F.GJ-001 neni 4 pika 1 citon: *Qiramarrësi duhet ti paguaj qiradhënësit qiranë mujore brenda 5(pesë) ditëve, nga data e faturimit, përgjatë gjithë zgjatjes së kontratës.*

Në total vlera prej **29,105.87 €** janë te ardhura te munguara për Institucionin.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Sektori i financës.

Vilën nr.8 dhe nr.2				
Data e faturimit	Data e pagesës se kryer	Penaliteti ne dite vonese €	Dite vonese	Penaliteti ne €
06/01/2020	07/02/2020	316.37	27	8,541.94

05/02/2020	28/02/2020	316.37	18	5,694.62
05/03/2020	17/04/2020	316.37	38	12,021.98
04/09/2020	15/09/2020	316.37	6	1,898.21
05/11/2020	11/11/2020	316.37	1	316.37
<b>Totali kamatëvonesa ne euro</b>				<b>28,473.12</b>

**3.** Kontrata me nr. 1067/1 datë 04.11.2019, KQPH-12.2019- A.R.F.Gj-059, qiramarrësi i lëshon apartamentin nr.6.2.16 i cili ndodhet në pallatin nr. 6 shkalla nr.1.

Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 01.12.2019-31.11.2020, rinovuar çdo vit për periudhën objekt auditimi. Vlera totale e apartamentin është 1,050€ ne muaj të cilën sipas nenit 4 të kontratës subjekti duhet ta paguajë çdo muaj brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe në rast vonese në pagimin e qirasë mujore, qiramarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesë prej 1 % të vlerës së çdo fature për çdo ditë vonese.

**Nga auditimi** i dokumentacionit dhe faturave të pagesës së qirasë konstatohet se subjekti për periudhën janar 2020 - janar 2022, për 25 muaj ka paguar vlerën 1045€ ose 5€ me pak se vlera e kontratës së qirasë,  $5€ * 25 \text{ muaj} = 125 €$  të ardhura të munguara për DSHTD. *Në kundërshtim me kontratën nr. 1067/1 datë 04.11.2019, KQPH-12.2019- A.R.F.GJ-059 neni 3 citon: Vlera në total e qirasë për apartamentin e sipërpërmendur është 1050 €/muaj.*

Gjithashtu konstatohet se subjekti nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni nuk ka marrë masë për të aplikuar penalitetet për kamatëvonesat. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **189 €**, (tabela me poshtë). *Në kundërshtim me kontratën 1067/1 datë 04.11.2019, KQPH-12.2019- A.R.F.Gj-059 neni 4 pika 1 citon: Qiramarrësi duhet ti paguaj qiradhënësit qiranë mujore brenda 5(pesë) ditëve, nga data e faturimit, përgjatë gjithë zgjatjes së kontratës.*

Në total vlera prej **314 €** janë të ardhura të munguara për Institucionin.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Sektori i financës.

<b>Apartamenti 6.2.16</b>				
Data e faturimit	Data e pagesës se kryer	Penaliteti ne dite vonese €	Dite vonese	Penaliteti ne €
06/01/2020	15/01/2020	10.5	4	42.00
08/07/2020	20/07/2020	10.5	7	73.50
04/09/2020	15/09/2020	10.5	6	63.00
05/11/2020	11/11/2020	10.5	1	10.50
<b>Totali kamatëvonesa në euro</b>				<b>189</b>

**4.** Kontrata KQPH/V-05.2020- A.R.F. -004, me objekt vilën nr.14, e cila ndodhet në adresën Rruga “Skënderbej”. Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 4 vjet dhe fillon prej 01.01.2020-31.12.2024. Vlera totale e vilës nr.14 është 11,688.29 € në muaj, të cilën sipas nenit 4 të kontratës subjekti duhet ta paguajë qiranë mujore deri në datën 20 të çdo muaj, nga data e faturimit. Në rast vonesash në pagimin e qirasë mujore, qiramarrësi është i detyruar të paguaj kamatë vonesën prej 1/1000 të vlerës së çdo fature për çdo dite vonese.

**Nga auditimi** i dokumentacionit konstatohet se DSHTD nuk ka miratim nga MEPJ për lidhjen e kontratës për një afat me shume se një vit edhe pse është përfaqësi diplomatike. *Në kundërshtim me VKM nr.840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik”, neni 8, citon: Tarifat e shërbimeve dhe çmimet e qirave, që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik zbaton për Trupin Diplomantik, përcaktohen në përputhje me të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe detyrimet e shtetit shqiptar, që burojnë nga marrëveshjet dypalëshe, dhe miratohen për çdo vit financiar, nga këshilli drejtues i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik.”.*

Gjithashtu konstatohet se subjekti nuk kryer pagesën deri në datën 20 të çdo muaj, nga data e faturimit. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **280.52 €**, të cilat për Institucionin janë të ardhura të munguara. (tabela më poshtë). *Në kundërshtim me kontratën KQPH/V-05.2020- A.R.F. -004, neni 4 të kontratës subjekti duhet ta paguajë qiranë mujore deri në datën 20 të çdo muaj, nga data e faturimit. Në rast vonesash në pagimin e qirasë mujore, qiramarrësi është i detyruar të paguaj kamatë vonesën prej 1/1000 të vlerës së çdo fature për çdo*

dite vonesë.

**Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:** Ish titullari i Institucionit dhe sektori i financës.

Vila nr.14				
Data e pagesës se kryer	Afati I fundit I pagesës	Penaliteti ne dite vonese €	Dite vonese	Penaliteti ne €
31/01/2020	20/01/2020	11.68829	11	128.57
26/01/2021	20/01/2021	11.68829	6	70.13
22/02/2021	20/02/2021	11.68829	2	23.38
21/07/2021	20/07/2021	11.68829	1	11.69
22/11/2021	20/11/2021	11.68829	2	23.38
22/02/2022	20/02/2022	11.68829	2	23.38
<b>Totali kamatëvonesa në euro</b>			<b>280.52</b>	

**Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit: DSHTD:** Për lidhjen e kontratave të qirasë, DSHTD i nënshtrohet dispozitave të VKM nr.840 datë 17.12.2014, konkretisht pikës 8, të ndryshuar, “*Tarifat e shërbimeve dhe çmimet e qirave, që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik zbaton për Trupin Diplomatik, përcaktohen në përputhje me të drejtat e përfaqësive Diplomatike dhe detyrimet e shtetit shqiptar, që burojnë nga marrëveshjet dypalëshe dhe miratohen për çdo vit financiar, nga Këshilli Drejtues i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.*”, e cila duke mos përcaktuar afate konkrete për kohëzgjatjen e kontratës së qirasë, nuk përjashton mundësinë e lidhjes së kontratave të qirasë me Trupin Diplomatik me afat më shumë se një vit, ashtu sikurse e përcakton VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Pika 3/1 e VKM nr.840 datë 17.12.2014 “Përcaktimi i çmimeve dysheme të qirasë që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik zbaton për subjektet shqiptare jo diplomatike, dhe procedurat përkatëse bëhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për përcaktimin e tarifave të qirasë për objektet e ndërmarrjeve shtetërore”, na referon direkt tek zbatimi i procedurave të përcaktuara në VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, vetëm për subjektet shqiptare jo diplomatike. Bazuar në këtë interpretim ligjor, DSHTD nuk ka detyrim të përcaktuar në akte ligjore apo nënligjore, për të marrë miratimin e organit të vartësisë administrative, në këtë rast MEPJ, për lidhjen e kontratave të qirasë me Trupin Diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, apo për nënshtruar procedurave të konkurrimit, kur ambientet e marra me qira nga këto subjekte janë mbi 200 m<sup>2</sup>.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** DSHTD ka të drejtë të lidhë kontrata 1-vjeçare pavarësisht sipërfaqes që ka pasuria e dhënë me qira, pasi tarifat miratohen çdo vit nga VKD dhe janë subjekte ndryshimesh në varësi të luhatjes së tregut. **Observacioni nuk merret në konsideratë.**

### **Monitorimi i kontratave**

Me urdhër të titullarit të Institucionit nr. 316 prot, datë 28.03.2019 është ngritur komisioni për monitorimin e kontratave me subjektet vendase i përbërë nga tre punonjës E.K., M.Gj., E.D.

Me urdhër të titullarit të Institucionit nr. 301 prot, datë 30.03.2022 është ngritur komisioni për monitorimin e kontratave me subjektet Shqiptare i përbërë nga tre punonjës E.I., D.P., A.N.

Nga auditimi konstatohet se komisioni për monitorimin e kontratave me subjektet vendase i ngritur me urdhër të titullarit të Institucionit nr. 316 prot, datë 28.03.2019 nuk ka kryer detyrimet përkatëse për monitorimin e kontratave, pasi nuk ka ndjekur në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të enfiteozës dhe çdo 6 (gjashtë) muaj të hartonte akte rakordime me subjektet qiramarrëse ose enfiteozë marrëse sipas VKM nr. 54 Kreu VI pika 6/c.

Komisioni i monitorimit të kontratave ka hartuar Shkresë me nr. 893 prot. datë 26.10.2020 mbi

monitorimin e kontratave me subjektet vendase nga ku nga grupi i auditimi konstatohet se nuk janë evidentuar të gjithë subjektet debitorë në bazë të kontratës së lidhur në kundërshtim VKM. Nr.54. datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar Kreu VI. Monitorimi i kontratave. Me urdhër të titullarit të Institucionit nr. 316 prot, datë 28.03.2019.

Gjithashtu në periudhën objekt auditimi nuk është ngritur ndonjë grup për monitorimin e kontratave me subjektet e huaja.

<b>Titulli gjetjes:</b>	Mos derdhja e 30% të të ardhurave nga kontratat e qirave të lidhura me Trupin Diplomatik të huaj ose organizatat e tjera ndërkombëtare.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi ka rezultuar se DSHTD ka aplikuar derdhjen e 30% të të ardhurave të krijuar nga qiraja vetëm nga “subjektet vendase”, me pretendimin se, meqenëse procedura e dhënies me qira e parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk mund të aplikohet për trupin diplomatik apo organizatat e tjera ndërkombëtare, rrjedhimisht, as derdhja e detyrimit 30% nuk duhet të aplikohet.</p> <p>VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk e parashikon konceptin e subjektit vendas apo subjektit të huaj, kjo ndarje është bërë nga vetë DSHTD për efekt lehtësie në administrimin e procedurave. DSHTD nuk rezulton të ketë kërkuar asnjëherë rishikimin e këtij akti, me qëllim përjashtimin nga detyrimi për zbatim të procedurave të qiradhënies, në rastet kur pala qiramarrëse është pjesë e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Pavarësisht sa më sipër, për sa kohë DSHTD është një ndërmarrje shtetërore dhe objektet që po jep me qira janë pasuri shtetërore, pavarësisht palës qiramarrëse, DSHTD ka detyrimin të derdhë 30% të të ardhurave në buxhetin e shtetit, për sa kohë nuk përjashtohet shprehimisht në VKM nr. 54, datë 5.2.2014.</p> <p>Vlera prej <b>161,871,535 lekë</b> është diferenca ndërmjet 30% të të ardhurave totale nga qiratë dhe vlerës së derdhur në buxhetin e shtetit për vitet 2020-2022.</p>
<b>Kriteri:</b>	<i>VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Kreu VII. Shpërndarja e të ardhurave.</i>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit në vlerën 161,871,535 lekë.
<b>Shkaku:</b>	Devijimi nga kërkesat e akteve ligjore e nënligjore të procedurës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>1. Rekomandimi:</b>	Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave të munguar për Buxhetin e Shtetit në vlerën 161,871,535 lekë.
<b>2. Rekomandimi:</b>	Titullari i DSHTD të marrë masat për ngritjen e një grupi pune për hartimin dhe propozimin për miratim të një akti nënligjor që do të formalizoj procedurat e qiradhënies kur pala qiramarrëse është trup diplomatik i akredituar/organizatë ndërkombëtare, ku të standardizohen ndër të tjera edhe (i) komunikimi periodik me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi nevojat e akomodimit të trupit diplomatik, si dhe (ii) detyrimet e DSHTD përgjatë kohëzgjatjes së kontratës (monitorimi i kontratës, ngrohja nëpërmjet kaldajës, punimet e ndryshme mirëmbajtëse, etj.).

<b>Titulli gjetjes:</b>	Vendosja e tarifës së qirasë më çmim më të ulët se sa ai i miratuar me VKD për zonën.
<b>Situata:</b>	<p>Nga Auditimi i kontratës me nr. 1096/2 datë 22.11.2019 KQSV-12.2019-“M.“ – 014, tarifa e qirasë e vendosur është më e ulët se sa ai i miratuar me VKD për këtë zonë. Për ambientin përdhe prej 77.7m<sup>2</sup> çmimi është 4€ dhe nuk ka ndryshuar ndërsa për truallin prej 120.12 m<sup>2</sup> çmimi është 150lek/m<sup>2</sup> dhe nuk janë aplikuar çmimet e reja të vendosura nga VKD që duhej të ishte 1.5€/m<sup>2</sup>.</p> <p>Favorizimi i subjektit është në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira”, ku përcaktohet se çmimet favorizuese do të bëhen për shkak të planeve të investimeve në rastet e kontratave mbi 200 m<sup>2</sup>. Konkretisht sipërfaqja prej 77,7m<sup>2</sup> duhej të tarifohej me 7 €/ m<sup>2</sup>, dhe 77,7 * 3€/ m<sup>2</sup>=233 euro/muaj * 12= 2796 euro në vit të ardhura të munguara për Institucionin.</p> <p>Gjithashtu rezulton se për subjektin e mësipërm tarifa e qirasë është vendosur sipas çmimeve të miratuara nga VKD për vitin 2019 pavarësisht se kontrata me subjektin është lidhur 2 ditë mbasi Këshilli Drejtues miratoi tarifat e dhënies me qira për vitin 2020 me VKD nr. 29, datë 20.11.2019. Konkretisht sipërfaqja e lulishtes prej 120.12 duhej të tarifohej 1.5€/m<sup>2</sup> pasi kontrata është firmosur me datë 22.11.2019 dy ditë mbas miratimit të çmimeve të vendosura nga VKD dhe afati i kontratës është nga data 26.12.2019-25.12.2020.</p> <p>Sipërfaqja prej 120,12 * 150lek * 12 muaj = 216,216 lekë në vit sipas kontratë, por duhet të ishte 120.12m<sup>2</sup> * 1.5€ * 12muaj = 2162,16€ euro në vit sipas VKD.</p> <p>2162,16€ * 122.44€ (çmimi mesatar i kursit të këmbimit sipas bankës së Shqipërisë) = 264,648 leke, 264,648 leke - 216,216 leke të përfituara sipas kontratës = 48,432.</p> <p>Si përfundim në total vlera prej 2796 € dhe 48,432 lekë janë ardhura të munguara për Institucionin.</p>
<b>Kriteri:</b>	<i>VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 29, datë 20.11.2019 Këshilli Drejtues ka miratuar tarifat e dhënies me qira për vitin 2020.</i>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Të ardhura të munguara në Buxhetin e Institucionit në vlerën 2796 € dhe 48,432 lekë.
<b>Shkaku:</b>	Trajtim preferencial mbi vendosjen e tarifës së qirasë.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën <b>2796 euro dhe 48,432 lekë.</b>

<b>Titulli gjetjes:</b>	Monitorimi i kontratave.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi rezultoi se në kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet vendase nga DSHTD, për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qirave nuk janë vendosur kamatëvonesat përkatëse. Kamate vonesat e llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vlerës së qirasë është 959.22 Euro.</p> <p>Me datë 06.01.2020 subjekti qiramarrësi G. ka derdhur pranë bankës R. në Llogarinë e DSHTD vlerën 1,827.14 € sipas faturës nr. 668 datë 02.12.2019 të lëshuar nga DSHTD për pagesën e muajt dhjetor të apartamenteve 6/1/1</p>

	<p>dhe 6/1/2.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se subjekti G. nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni nuk ka marrë masë për të aplikuar penalitetin për kamatëvonesat. Penaliteti i pavendosur llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 548.14 €.</p> <p>Subjekti S. dhe DSHTD kanë lidhur Kontrata me nr.180/3 datë 07.03.2019, KQSV-03.2019-S.-007 dhe Kontrata me nr.283/4 datë 15.04.2019, KQSV-05.2019-S.-008 dhe Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 411.08 €.</p>
<b>Kriteri:</b>	<i>VKM nr. 840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet dhe DSHTD.</i>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Të ardhura të munguara në Buxhetin e Institucionit në vlerën 959.22 Euro.
<b>Shkaku:</b>	Pasojë e penaliteteve në mos likuidimit në kohë të qirave.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>1. Rekomandimi:</b>	Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën <b>959.22 Euro</b> .
<b>2. Rekomandimi:</b>	Spektori i Financës të marrë masa ku të monitorojë çdo fund muaji vlerën e arkëtuar të qirave sipas mandat-pagesave në respektimin e afatit kontraktor si për subjektet vendase dhe ato të huaja si dhe në rastet e vonesave në likuidimin e këtyre qirave të vendosë dhe të arkëtohen kamatëvonesat përkatëse.

<b>Titulli gjetjes:</b>	Penalitete në mos likuidimit në kohë të kontratave të qirave me subjektet e huaja.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi rezultoi se kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet e huaja (trupi diplomatik/ organizatave ndërkombëtare), për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qirave nuk janë vendosur kamatëvonesat përkatëse. Kamatë vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vlerës së qirasë është 29,700.39 Euro.</p> <p>Kontrata me nr.1182/1 prot datë 17.12.2019, KQPH/V-01.2020- A.R.F.Gj-001. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën <b>29,105.87 €</b>.</p> <p>Kontrata me nr. 1067/1 datë 04.11.2019, KQPH-12.2019- A.R.F.Gj-059. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën <b>314 €</b>.</p> <p>Kontrata KQPH/V-05.2020-A.R.F. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën <b>280.52 €</b>.</p>
<b>Kriteri:</b>	<i>VKM nr. 840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, neni 8, citon: Tarifat e shërbimeve dhe çmimet e qirave, që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik zbaton për Trupin Diplomatik, përcaktohen në përputhje me të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe detyrimet e shtetit shqiptar, që burojnë nga marrëveshjet dypalëshe, dhe miratohen për çdo vit financiar, nga këshilli drejtues i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.”. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet dhe DSHTD.</i>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Të ardhura të munguara në Buxhetin e Institucionit në vlerën <b>29,700.39 Euro</b> .

<b>Shkaku:</b>	Pasojë e penaliteteve në mos likuidimit në kohë të qirave.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën <b>29,700.39 Euro</b> .

<b>Titulli gjetjes:</b>	Lidhja e kontratave të qirasë mbi 200m <sup>2</sup> pa pasur tagrin e organit qe mund të lidhe kontratën dhe penalitetet në mos likuidimit në kohë të kontratës së qirasë.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i kontratës me nr.1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019-S.-059 rezultoi se nuk është kryer procedura e konkurrimit për dhënien me qira të vilës nr. 49. Nuk rezulton të jetë njoftuar MEPJ për dhënien e Vilës me qira. Qiramarrësi është një fondacion privat ndërkombëtar që nuk gëzon privilegje apo status diplomatik dhe si i tillë duhet të ishte zhvilluar garë, Në kundërshtim me VKM nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera te pasurisë shtetërore "kapitullin II" procedura e dhënies me qira dhe enfiteoze e pasurive shtetërore, dhe domosdoshmërinë e hartimit dokumentacionit përkatës, për dhënien me qira te këtyre pronave. Gjithashtu ky akt parashikon edhe tagrin e organit Ministria e Financës dhe Ekonomisë i cili ka të drejtë të lidh kontratën e qirase mbi 200m<sup>2</sup>.</p> <p>Nga auditimi i kontratës me nr.1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019-S.-059. rezultoi se subjekti nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni i ka vendosur penalitetin vetëm për muajin gusht me shkresë nr. 834 prot 02.10.2020 në vlerën 98€ penalitete. Ndërsa për muaj e tjerë nuk janë marrë masa për të aplikuar penalitetet për kamatëvonesat. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 294.29 €, të cilat për Institucionin janë të ardhura te munguara. Në kundërshtim me kontratën nr. 1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019-S.-059 neni 4 pika 1 citon: Qiramarrësi duhet ti paguaj qiradhënësit qiranë mujore brenda 5(pesë) ditëve, nga data e faturimit, përgjatë gjithë zgjatjes së kontratës.</p>
<b>Kriteri:</b>	<i>VKM nr. 840, datë 17.12.2004 "Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik", VKM nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera te pasurisë shtetërore "kapitullin II" procedura e dhënies me qira dhe enfiteoze e pasurive shtetërore, dhe domosdoshmërinë e hartimit dokumentacionit përkatës, për dhënien me qira te këtyre pronave. kontratën nr. 1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019- S.-059 neni 4 pika 1 citon: Qiramarrësi duhet ti paguaj qiradhënësit qiranë mujore brenda 5(pesë) ditëve, nga data e faturimit, përgjatë gjithë zgjatjes së kontratës.</i>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Të ardhura të munguara në Buxhetin e Institucionit në vlerën 294.29 Euro.
<b>Shkaku:</b>	Pasojë e penaliteteve në mos likuidimit në kohë të qirave.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>1. Rekomandimi:</b>	Këshilli Drejtues të marrë miratimin nga MEPJ, para lidhjes së kontratave të qirasë për objekte sipërfaqja e të cilëve është mbi 200 m <sup>2</sup> , në përputhje me VKM nr.54 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata, të tjera të pasurisë shtetërore".
<b>2. Rekomandimi:</b>	Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën <b>294.29 Euro</b> .



## 2.4. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

### a. Procedurat e prokurimit publik sipas legjislacionit shqiptar

Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik (këtu e në vijim DSHTD), përgjatë viteve periudhë auditimi, janë kryer procedurat e prokurimit publik, si më poshtë:

➤ **Për vitin 2020** janë realizuar 53 procedura prokurimi, nga të cilat:

40 prokurime me vlerë të vogël;

11 kërkesë për propozim;

2 procedura të hapura.

Vlera totale e fondit limit parashikuar për të gjitha llojet e procedurave është **60,753,485 lekë pa tvsh**, ndërsa vlera totale e tenderuar është **49,460,359 lekë pa tvsh**.

➤ **Për vitin 2021** janë realizuar 50 procedura prokurimi, nga të cilat:

41 prokurime me vlerë të vogël;

8 kërkesë për propozim;

1 procedurë e hapur.

Vlera totale e fondit limit parashikuar për të gjitha llojet e procedurave është **60,270,368 lekë pa tvsh**, ndërsa vlera totale e tenderuar është **36,604,740 lekë pa tvsh**.

➤ **Për vitin 2022** janë realizuar 48 procedura prokurimi, nga të cilat:

43 prokurime me vlerë të vogël;

5 procedura e hapur e thjeshtuar.

Janë nënshkruar minikontrata në zbatim të marrëveshjeve kuadër të vitit 2021:

4 nga procedurat “Kërkesë për propozim”;

4 nga procedura “Procedurë e Hapur”.

Vlera totale e fondit limit parashikuar për të gjitha llojet e procedurave është **29,216,798 lekë pa tvsh**, ndërsa vlera totale e tenderuar është **18,750,790 lekë pa tvsh**.

Ndërkohë janë realizuar në zbatim të marrëveshjeve kuadër të nënshkruara gjatë vitit 2021 minikontrata në vlerën **22,130,648 lekë pa tvsh**.

<b>Vlera totale e tenderuar për 3 vite 2020-2022</b>	126,946,537
<b>1. Vlera e fondeve të audituara në procedurat blerje të vogla</b>	20,680,386
<b>2. Vlera e fondeve të audituara në procedurat e prokurimit</b>	27,189,307
<b>3. Lëndë djegëse solar</b>	31,177,138
<b>Vlera totale e audituar (1+2+3)</b>	79,046,831
<b>Materialiteti</b>	62.27%

### I. Për vitin 2020, grupi i auditimit ka përzgjedhur procedurat e prokurimit, si më poshtë:

Nr.	Objekti	Fondi limit	Lloji i procedurës	Vlera e kontratës
1.	Dyer të brendshme	2,594,300	Kërkesë për propozim	2,254,000
2.	Parkete e aksesore	1,000,920	Kërkesë për propozim	822,215
3.	Pllaka të ndryshme	4,520,520	Kërkesë për propozim	3,885,600
4.	Rikonstruksion i ashensorit të pallatit nr. 8/2, 8/3	2,400,000	Kërkesë për propozim	2,348,904
5.	Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Amb.Bullgare	5,352,818	Kërkesë për propozim	5,251,200

Për auditimin e këtyre procedurave u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020-31.12.2022;
2. Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;
3. Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;
4. Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;
5. Përllogaritja e fondit limit.
6. Situacionin përfundimtar etj.

**1. Procedura e prokurimit “Dyer të brendshme”**, me fond limit **2,594,300 lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2020, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2020.

*A. Të dhëna mbi objektin*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Dyer të brendshme”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozime” <b>REF-48782-02-03-2020</b> Urdhri nr. 45, datë 31.02.2020	<b>2. Grupi i hartimit kritereve specifike</b> Urdhri nr. 26, datë 27.01.2020 <b>Hartimi i specifikimeve teknike:</b> E.K. F.T. A.C. <b>Përlllogaritja e fondit limit:</b> E.K. B.K. V.Sh.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 25, datë 27.01.2020 D.B. E.K. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 46, datë 31.01.2020 G.V. E.Th. M.Gj.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,594,300 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 2,254,000 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 340,300 lekë	
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 10.02.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>5 OE;</b> b) Skualifikuar 4 OE: B. E. P. SH. c) Kualifikuar 1 OE H.	
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 31.12.2020			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 233/3 prot., datë 30.03.2020	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrin nr. 114, datë 02.04.2020 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit. - Është likuiduar vlera prej <b>2,638,800 lekë me tvsh.</b>		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.**

Me shkresën nr. 84 prot., datë 27.01.2020, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje malli me objekt “Dyer të brendshme”. Në shkresë citohet se “Mallrat do të prokurohen për punimet e mirëmbajtjes dhe investimet e apartamenteve në pallatet 4, 6, 8 në rr. Skënderbej dhe pallatin 57 në Blv. Zogu i I, në varësi të kërkesave të diplomatëve dhe planit ekonomiko-financiar të vitit 2020”.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 25, datë 27.01.2020 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.K. dhe E.A..

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 26, datë 27.01.2020 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike:

E.K.

F.T.

A.C.

Përlllogaritja e fondit limit:

E.K.

B.K.

V.Sh.

Në procesverbalin e datës 31.01.2020, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, si dhe sasi të që do të prokurohen, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Nj/matëse	Sasia	Çmimi mesatar për njësi	Vlera (lekë pa tvsh)
1	Dyer të brendshme me kasë cilësia e parë	Copë	62	36,250	2,247,500
2	Dyer të brendshme dy kanata e xham, cilësia e parë	Copë	7	45,200	316,400
3	Dyer të brendshme një kanatë xham, cilësia e parë	Copë	1	30,400	30,400
	<b>Totali</b>		<b>70</b>	<b>Fondi limit</b>	<b>2,594,300</b>

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 45, datë 31.01.2020 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit për blerje/ furnizim malli me objekt “Dyer të brendshme”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozime”, me fond limit 2,594,300 lekë pa tvsh.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 03.02.2020, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të procesverbalit nr. 2 të datës 03.02.2020, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit.

**Gjetje:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nga grupi, kanë disa parregullsi si më poshtë:

Sa i përket aftësisë teknike e profesionale, AK kërkon:

- OE ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej 8 punonjës, për periudhën nëntor 2019 – janar 2020.

- OE ofertues duhet të ketë të punësuar gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës 1 arkitekt, 1 inxhinier pyjesh, 2 marangozë.

Njësia e prokurimit nuk argumenton nevojën për punësimin mesatar prej 8 punonjësish për 3 muajt e përmendur, si dhe nga mënyra e formulimit të kërkesave, 4 punonjësit e kërkuar (1 arkitekt, 1 inxhinier pyjesh e 2 marangozë) jo domosdoshmërisht duhet të kenë qenë pjesë e organikës së OE ofertues, por mjafton të paraqiten kontrata që garantojnë se do të jenë të punësuar gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës. Njësia e prokurimit kërkon 1 (një) arkitekt, me argumentimin se prania e tij është e nevojshme për të konceptuar modelin e dyerve, sipas hapësirave ku do të vendosen. Grupi i auditimit gjykon se edhe kjo kërkesë nuk është e argumentuar, kjo pasi nuk nevojitet një arkitekt vetë për realizimin e matjeve, pasi ngjyra, modeli do të zgjidhen nga AK rast pas rasti, në përshtatje me ambientin ku do të vendosen ndaj nuk është e qartë se si prania e arkitektit do të ishte e nevojshme.

- OE ofertues duhet të disponojë të paktën një mjet në pronësi apo të marrë me qira me kontratë noteriale për transportin e mallrave.

Njësia e prokurimit argumenton nevojën e këtij kriteri për të garantuar se AK do të kryejë furnizimin / vendosjen e mallrave në kohën e kërkuar dhe sipas kushteve të kontratës, pa shkakuar vonesa. Grupi i auditimit gjykon se, në këtë rast, duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, e jo punë/shërbim, në të cilat automjeti do të ishte i nevojshëm në çdo kohë, njësia e prokurimit nuk duhet të kufizonte vetëm këto dy mundësi për OE, por duhet të mjaftohej duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave. Kjo pasi, OE mund të zgjidhte nën kontraktimin për të kryer transportin e mallrave, pa qenë i detyruar të hyjë paraprakisht në marrëdhënie kontraktuale qiramarrje, në rast se nuk do të shpallej fitues. Sa më sipër, grupi i auditimit gjykon se ky kriter nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasën e kontratës që do të prokurimet.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 46, datë 31.01.2020 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., E.Th. dhe M.Gj.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 9, datë 20.02.2020 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 10, date 20.02.2020 dokumentoi administrimin e mostrave

dhe, me anë të procesverbalit nr. 11, datë 20.02.2020 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura, nga ku rezultoi, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	E.	1,532,320	Jo	1. Nuk është paraqitur Leja e transportit për mjetet e paraqitura; 2. Nuk ka paraqitur kontratë pune dhe dëshmi aftësie për 2 punonjës marangozë.
2	B.	1,727,000	Jo	Nuk ka paraqitur mostër, sikurse kërkuar në DST.
3	Sh.	1,980,200	Jo	Nuk ka paraqitur mostër, sikurse kërkuar në DST.
4	P.	2,114,000	Jo	1. Nuk është paraqitur kontratë pune dhe diplomë për arkitektin, kontratë pune dhe dëshmi aftësie për 2 punonjës marangozë, kontrata për inxhinierin është kontratë bashkëpunimi; 2. Nuk është paraqitur Leja e transportit për mjetet e paraqitura; 3. Nuk është paraqitur deklarata e konformitetit; 4. Mostrat e administruara konsistojnë në mostra të mallrave fillestare me të cilat do të prodhoheshin mallrat objekt prokurimi.
5	H.	2,254,000	Po	

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE H., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej 2,254,000 lekë pa tvsh ose 2,704,800 lekë me tvsh.

**Gjetje:** Mbi arsyet e skualifikimit të ofertës ekonomike më të ulët OE E., nga auditimi u konstatua se:

- Sa i përket mungesës së Lejes së transportit për mjetet e paraqitura, grupi i auditimit gjykon se ky kriter nuk është në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës që do të prokurohet, në kundërshtim me nenin 46, pika 1 të Ligjit “Për prokurimin publik” nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, si dhe nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke rezultuar në skualifikimin e tij.

- Sa i përket dokumentacionit mbi punonjësit marangozë, referuar listë pagesave të vëna në dispozicion nga OE E., është lehtësisht e verifikueshme që, në organikën e shoqërisë bëjnë pjesë jo 2 (dy) por 8-10 marangozë në çdo muaj, referuar Kodit 7115.14 “Marangoz”, sipas VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”. Mungesa e paraqitjes së kontratave të punës dhe dëshmive të aftësisë duhej të konsiderohej devijim i vogël nga ana e KVO, duke marrë parasysh që OE ofertues ka paraqitur dokumentacion vërtetues mbi kapacitetin për realizimin e kësaj kontrate jo vetëm nëpërmjet listë pagesave, por edhe nëpërmjet fushës së tij të veprimtarisë, xhirove vjetore, bilanceve e kontratave të ngjashme.

Nga ana tjetër, OE fitues H. ka paraqitur kontratat e punës për 1 marangoz dhe 1 ndihmës marangoz, ndërkohë që DST kërkonte 2 marangozë, si më poshtë:

EB, në muajin nëntor 2019 figuron në listë pagesë si punëtor parketi me kodin 7122.02, për muajt dhjetor 2019-janar 2020 figuron si karpentier me kodin 7115.02. Certifikimi i paraqitur figuron nga subjekti certifikues “T.”, i cili certifikon punonjësit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

FC, figuron në listë pagesë si punëtor izolimi për ndërtesa me kodin 7124.03 për 3 muajt e paraqitur. Certifikimi i paraqitur figuron nga subjekti certifikues “T.”, i cili certifikon punonjësit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Gjithashtu, JT, punonjësi i paraqitur në cilësinë e arkitektit, figuron në listë pagesa si teknik i punimeve të ndërtimit me kodin 3112.06 për muajt nëntor-dhjetor 2019, dhe si teknik ndërtimi me kodin 3119.15 për muajin janar 2020.

#### **-Lidhja e kontratës**

Midis AK DSHTD dhe OE H. është lidhur kontrata nr. 233/3 prot., datë 30.03.2020 për furnizim/

vendosje dyer të brendshme.

**-Zbatimi i kontratës.**

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 114, datë 02.04.2020 është krijuar komisioni për pritjen dhe marrjen në dorëzim të mallit me përbërje E.K., A.C., F.T. Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 14.04.2020, ku shprehet se ka marrë në dorëzim mallin sipas sasisë, cilësisë dhe llojit të parashikuar në DST.

Midis AK dhe OE H. u lidh Akt-Marrëveshja nr. 233/6 prot., datë 20.11.2020, ku cilësohet se, duke qenë se deri në datë 20.11.2020 janë vendosur 41 dyer, si dhe nisur nga nota verbale e A. K., që kërkon shtyrjen e vendosjes së dyerve prej situatës së krijuar nga COVID-19, kontraktuesi pranon të marrë në ruajtje në magazinat e tij për llogari të DSHTD pjesën e mbetur të dyerve (29 dyer), si dhe likuidimi i kontraktuesit do të kryhet pas marrjes në dorëzim të mallit.

Me anë të Urdhër transfertës së muajit dhjetor 2020 është kryer likuidimi i vlerës 1,436,970 lekë me tvsh. PV i Komisionit të Marrjes në Dorëzim (KMD) i datës 17.12.2020 dokumenton marrjen në dorëzim të 41 dyerve, por jo vendosjen e tyre, që është gjithashtu objekt i kontratës. Fatura e paraqitur nga OE nr. 452, datë 17.12.2020 me vlerë 1,512,600 lekë me tvsh është likuiduar pasi është zbritur 5% i garancisë në vlerë 75,630 lekë.

OE, për pjesën e mbetur të dyerve ka paraqitur faturën tatimore nr. 453, datë 29.12.2020, për 29 dyer në total, me vlerë 1,192,200 lekë me tvsh. Kjo faturë është likuiduar në vijim, e ndarë në pjesë, pas marrjeve në dorëzim të mallit, si më poshtë:

Me anë të Urdhër transfertës së muajit prill 2021 është kryer likuidimi i vlerës 571,710 lekë me tvsh. PV i KMD i datës 07.04.2021 dokumenton marrjen në dorëzim të 17 dyerve, por jo vendosjen e tyre, që është gjithashtu objekt i kontratës.

Me anë të Urdhër transfertës së muajit korrik 2021 është kryer likuidimi i vlerës 172,200 lekë me tvsh. PV i KMD i datës 28.06.2021 dokumenton marrjen në dorëzim të 4 dyerve dhe vendosjen e tyre në pallatin nr. 6, shkalla nr. 1, apartamenti nr. 6.

Me anë të Urdhër transfertës së muajit gusht 2021 është kryer likuidimi i vlerës 220,200 lekë me tvsh. PV i KMD i datës 05.08.2021 dokumenton marrjen në dorëzim të 5 dyerve dhe vendosjen e tyre në pallatin nr. 4, shkalla nr. 1, apartamenti nr. 8.

Me anë të Urdhër transfertës së muajit dhjetor 2021 është kryer likuidimi i vlerës 66,000 lekë me tvsh. PV i KMD i datës 20.12.2021 dokumenton marrjen në dorëzim të 1 derye dhe vendosjen e saj në pallatin nr. 4, shkalla nr. 1, apartamenti nr. 16.

Me anë të Urdhër transfertës së datës 29.12.2022 është kryer likuidimi i vlerës 66,000 lekë me tvsh. PV i KMD i datës 16.11.2022 dokumenton marrjen në dorëzim të 1 derye dhe vendosjen e saj në pallatin nr. 6, shkalla nr. 1, apartamenti nr. 5.

Me anë të Urdhër transfertës së datës 30.12.2022 është kryer likuidimi i vlerës 187,129 lekë me tvsh, për ç'ngurtësimin e garancive 5% të dy kontratave. Pjesa takuese likuiduar për kontratën "Dyer të brendshme" është vlera 105,720 lekë me tvsh.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit, likuidimi rezulton në vlerën 2,638,800 lekë me tvsh, ndërkohë që, referuar dokumentacionit, janë marrë në dorëzim 69 dyer, nga 70 për të cilat është lidhur kontrata, me shpërndarje, si më poshtë:

- 41 dyer në vitin 2020;
- 27 dyer në vitin 2021;
- 1 derë në vitin 2022.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**1. Procedura e prokurimit "Dyer të brendshme", me fond limit 2,594,300 lekë pa tvsh**

**Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST:**

- Sa i takon konstatimit të grupit të auditimit se mungon argumentimi i çdo kriteri sipas

parashikimeve ligjore, NJP, ka mbajtur PV nr.1 datë 03.02.2020, ku janë hartuar dhe argumentuar kriteret dhe PV nr.3 datë 03.02.2020, ka argumentuar edhe kriteret e kualifikimit sa i takon kapacitetit ekonomik dhe financiar.

- Prania e një Arkitekti gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës është e nevojshme për të konceptuar modelin e dyerve, sipas hapësirave përkatëse të objekteve ku do të bëhet vendosja. Ngjyra dhe modeli do të zgjidhen nga AK rast pas rasti, në përshtatje me ambientin ku do të vendosen.

- Vendosja e kriterit për automjetin është në përpjesëtim dhe lidhet ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës nga OE, si dhe duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë e klientëve të DSHTD (diplomatë), ekzekutimi në kohë dhe pa vonesa i punimeve është shumë i rëndësishëm për DSHTD, si dhe realizimin me sukses të objektit të veprimtarisë së saj.

Konstatimet lidhur me realizimin e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:

- Në lidhje me konstatimin e vlefshmërisë së lejes së transportit paraqitur nga OE fitues, certifikata e paraqitur nuk do të ishte e vlefshme vetëm për periudhën Nëntor - Dhjetor por ndërkohe OE nuk mund të merrte asnjë masë për rinovimin e saj përpara afatit të përfundimit të vlefshmërisë.

- Kontratat e punës shërbejnë për të garantuar ekzistencën e marrëdhënieve të punës për periudhën e zbatimit të kontratës. Listpagesat japin të dhëna për historikun e punësimit por jo për ekzistencën e marrëdhënies së punës në të ardhmen.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

#### **1. Procedura e prokurimit “Dyer të brendshme”:**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

- OE ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej 8 punonjës nuk është e argumentuar pse duhen 8 punonjës. Për punësimin e arkitektit dhe ju në observacion shpreheni se “Ngjyra dhe modeli do të zgjidhen nga AK rast pas rasti, në përshtatje me ambientin ku do të vendosen” pra nuk është e nevojshme prania e arkitektit. Vendosja e kriterit për automjetin vetëm për siguri të AK për realizimin me sukses të kontratës e cila është detyrim kontraktual i OE nuk qëndron. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Konstatimet lidhur me realizimin e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:

- Sipas LPP në çdo rast AK ka të drejtën të kryejë gjithë verifikimet e nevojshme dhe që OE duhet të kualifikohet vetëm pasi të përmbushë të gjitha kërkesat për kualifikim. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**2. Procedura e prokurimit “Parkete e aksesore”, me fond limit **1,000,920 lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2020, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2020.**

### **B. Të dhëna mbi objektin**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Parkete e aksesore”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozime” <b>REF-48704-01-31-2020</b> Urdhri nr. 43, datë 30.01.2020	<b>2. Grupi i hartimit kriterëve specifike</b> Urdhri nr. 24, datë 27.01.2020 <b>Hartimi i specifikimeve teknike:</b> E.Th. F.T. G.A.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 23, datë 27.01.2020 D. B. E.Th. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 44, datë 30.01.2020 G.V. E.K. A.N.

	<b>Përlllogaritja e fondit limit:</b> E.Th. B.K. V.B.		
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 1,000,920 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 822,215 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 178,705 lekë	
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 10.02.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 5 OE; b) Skualifikuar 3 OE: B. L.B. P. c) Kualifikuar 2 OE H. SH.	
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 15 ditë			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 253/3 prot., datë 30.03.2020	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrin nr. 116, datë 02.04.2020 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit. - OE është likuiduar me mandat-pagesën e datës 03.04.2020.		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Me shkresën nr. 83 prot., datë 27.01.2020, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje malli me objekt "Parkete e aksesore". Në shkresë citohet se "Mallrat do të prokurohen për punimet e mirëmbajtjes dhe investimet e apartamenteve në pallatet 4, 6, 8 në rr. Skënderbej dhe pallatin 57 në Blv. Zogu i I, në varësi të kërkesave të diplomatëve dhe planit ekonomiko-financiar të vitit 2020".

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 23, datë 27.01.2020 është ngritur njësi e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.Th. dhe E.A.

Në procesverbalin nr. 1, datë 31.01.2020, Njësia e Prokurimit ka dokumentuar hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 24, datë 27.01.2020 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike:	Përlllogaritja e fondit limit:
E.Th.	E.Th.
F.T.	B.K.
G.A.	V.B.

Në procesverbalin e datës 30.01.2020, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, si dhe sasi të që do të prokurohen, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Nj/matëse	Sasia	Çmimi mesatar për njësi	Vlera (lekë pa tvsh)
1	Parket laminat AC5 8mm	m2	464	1,750	812,000
2	Korniza parketi	m	646	250	161,500
3	Shtresë plastike nën parket	m2	457	60	27,420
				<b>Fondi limit</b>	<b>1,000,920</b>

Me anë të shkresës nr. 83/3 prot., datë 30.01.2020, Kryetari i grupit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit ka paraqitur relacionin mbi specifikimet teknike dhe fondin limit për prokurimin me objekt "Parkete e aksesore", ku është përcaktuar fondi limit prej 1,000,920

lekë pa TVSH.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 43, datë 30.01.2020 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit me objekt "Parkete e aksesore", lloji i procedurës "Kërkesë për propozime", me fond limit 1,000,920 lekë pa tvsh.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 31.01.2020, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të procesverbalit nr. 2 të datës 31.01.2020, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 46, datë 31.01.2020 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., E.K. dhe A.N.

Referuar PV të KVO nr. 11, datë 27.02.2020 "Mbi hapjen e ofertave të paraqitura" dhe PV të KVO nr. 10, datë 27.02.2020 "Mbi administrimin e mostrave të mallrave", rezultoi (renditur nga oferta ekonomike më e ulët te ajo më e lartë), si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	L.B.	798,300	Jo	1. Objekti i prokurimit nuk është në fushën e veprimtarisë; 2. OE nuk ka paraqitur asnjë të dhënë mbi xhiron vjetore të vitit 2019; 3. OE nuk ka paraqitur deklaratën e konformitetit, dokumenti i paraqitur ka qenë i vlefshëm deri në 2018.
2	H.	822,215	Po	
3	Sh.	832,890	Po	
4	B.	966,725	Jo	Nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të rregullt sipas DST.
5	P.	987,250	Jo	Nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të rregullt sipas DST.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE H., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar në vlerën prej 822,215 lekë pa tvsh ose 986,658 lekë me tvsh.

**Gjetje:** Mbi arsyet e skualifikimit të ofertës ekonomike më të ulët OE L.B., nga auditimi u konstatua se:

- Sa i përket fushës së veprimtarisë, OE përfshin, ndër të tjera "import/ eksport, shitje/ blerje dhe instalim të pajisjeve ndërtimore...", ndaj objekti i prokurimit "parket dhe aksesore" është në fushën e veprimtarisë.

- Sa i përket të dhënave mbi xhiron e vitit 2019, sjellim në vëmendje faktin se afati i dorëzimit të ofertave ishte data 27.02.2020. Referuar nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme dhe e paraqet në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Sa më sipër, të dhënat mbi xhiron vjetore të vitit 2019 nuk duhej të ishin kërkuar në DST dhe rrjedhimisht nuk duhet të ndikonin në skualifikimin e OE.

Nga ana tjetër, OE H., i kualifikuar, për të njëjtën kërkesë, ka paraqitur vërtetimin e të ardhurave për vitin 2019, lëshuar nëpërmjet shkresës nr. 875 prot., datë 06.03.2020 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (konfirmuar edhe në pikën 14 të PV të KVO nr. 253/2 prot., datë 30.03.2020 "Mbi emërtimin dhe listimin e dokumentacionit...", ndërkohë që dokumentacioni është ngarkuar elektronikisht në datën 26.02.2020 (sipas SPE). Referuar kësaj shkrese, në zbatim të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhej të kishte konstatuar nevojën për verifikim dokumentacioni.

- Sa i përket deklaratës së konformitetit të prodhuesit për lëndën drusore në përputhje me specifikimet teknike, kjo kërkesë është parashikuar nga njësia e prokurimit në mbështetje të pikës 6, neni 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me qëllim garantimin e cilësisë së mallit që do të prokurohet. OE L.B. ka paraqitur katalogun nga



prodhuesi, të noterizuar, një mostër të mallit, si dhe një deklaratë konformiteti me vlefshmëri deri në 31 dhjetor 2017. Nga ana tjetër, OE H. gjithashtu ka paraqitur një mostër të mallit dhe një katalog në gjuhë të huaj, duke mos paraqitur deklaratë konformiteti sipas kërkesave në DST dhe është kualifikuar. KVO ka përdorur standarde të dyfishta, duke kualifikuar njërin prej OE dhe duke skualifikuar OE tjetër me të njëjtën mangësi në dokumentacion.

**-Lidhja e kontratës**

Midis AK DSHTD dhe OE H. është lidhur kontrata nr. 253/3 prot., datë 30.03.2020 për blerje/ furnizim parkete e aksesore.

**-Zbatimi i kontratës.**

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 116, datë 02.04.2020 është krijuar komisioni për pritjen dhe marrjen në dorëzim të mallit. Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 14.04.2020, ku shprehet se ka marrë në dorëzim mallin sipas sasisë, cilësisë dhe llojit të parashikuar në DST.

OE është likuiduar nëpërmjet mandat-pagesës së datës 23.04.2020, bazuar në faturën tatimore nr. 430, datë 14.04.2020 në vlerën 986,658 lekë me tvsh.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Procedura e prokurimit “Parkete e aksesore” me fond limit 1, 000, 920 lekë pa tvsh**

*Konstatimet lidhur me realizimit e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:*

- Në lidhje mbi arsyet e skualifikimit të ofertës ekonomike më të ulët OE L.B.:

Nuk mund të konsiderohet devijim i vogël në kontekstin edhe të mungesave të tjera të OE.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Procedura e prokurimit “Parkete e aksesore”:**

*Konstatimet lidhur me realizimit e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:*

- Sipas LPP në çdo rast AK ka të drejtën të kryejë gjithë verifikimet e nevojshme dhe që OE duhet të kualifikohet vetëm pasi të përmbushë të gjitha kërkesat për kualifikim, një pjesë e konsiderueshme e kriterëve të skualifikimit nuk qëndrojnë. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**3. Procedura e prokurimit “Pllaka të ndryshme”, me fond limit 4,520,520 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2020, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2020.**

**C. Të dhëna mbi objektin**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Pllaka të ndryshme”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozime” <b>REF-49336-02-05-2020</b> Urdhri nr. 57, datë 04.02.2020	<b>2. Grupi i hartimit kriterëve specifike</b> Urdhri nr. 38, datë 30.01.2020 <b>Hartimi i specifikimeve teknike:</b> E.Th. E.D. A.B. <b>Përlllogaritja e fondit limit:</b> E.Th. B.K. I.K.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 37, datë 30.01.2020 D.B. E.Th. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 58, datë 04.02.2020 G.V. E.K. D.M.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 4,520,520 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 3,885,600 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b>	

		634,920 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 10.02.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 3 <b>OE</b> ; b) Skualifikuar 2 OE: R. BOE G.H. & L. c) Kualifikuar 1 OE H.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 30 ditë		
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>		
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 219/3 prot., datë 30.03.2020	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrit nr. 117, datë 02.04.2020 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit. - OE është likuiduar me mandat-pagesën e datës 18.04.2020.	

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Me shkresën nr. 106 prot., datë 29.01.2020, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje malli me objekt “Pllaka të ndryshme”. Në shkresë citohet se “Mallrat do të prokurohen për punimet e mirëmbajtjes dhe investimet e apartamenteve në pallatet 4, 6, 8 në rr. Skënderbej dhe pallatin 57 në Blv. Zogu i, në varësi të kërkesave të diplomatëve dhe planit ekonomiko-financiar të vitit 2020”.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 37, datë 30.01.2020 është ngritur njësi e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.Th. dhe E.A.

Në procesverbalin nr. 1, datë 31.01.2020, Njësia e Prokurimit ka dokumentuar hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 38, datë 30.01.2020 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike:	Përllogaritja e fondit limit:
E.Th.	E.Th.
E.D.	B.K.
A.B.	I.K.

Në procesverbalin e datës 04.02.2020, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, si dhe sasi të që do të prokurohen, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Nj/matëse	Sasia	Çmimi mesatar për njësi	Vlera (lekë pa tvsh)
1	Pllakë shtrimi porcelanat – imitim mermeri	m <sup>2</sup>	675	4,000	2,700,000
2	Pllaka shtrimi WC - porcelanati	m <sup>2</sup>	80	1,900	152,000
3	Pllaka veshje WC– imitim mermeri	m <sup>2</sup>	218	4,000	872,000
4	Pllaka veshje kuzhine	m <sup>2</sup>	43	2,000	86,000
5	Aksesorë plastikë fugash për jashtë	m	114	280	31,920
6	Plintusa pllake grez	m	261	2,600	678,600
	<b>Totali</b>			<b>Fondi limit</b>	<b>4,520,520</b>

Me anë të shkresës nr. 106/3 prot., datë 04.02.2020, Kryetari i grupit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit ka paraqitur relacionin mbi specifikimet teknike dhe fondin limit për prokurimin me objekt “Pllaka të ndryshme”, ku është përcaktuar fondi limit prej 4,520,520 lekë pa TVSH.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 57, datë 04.02.2020 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit për blerje/ furnizim malli me objekt “Pllaka të ndryshme”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozime”, me fond limit 4,520,520 lekë pa TVSH.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 05.02.2020, njësi e prokurimit ka paraqitur kriteret e

veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të procesverbalit nr. 2 të datës 05.02.2020, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit.

**Gjetje:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nga grupi, kanë disa parregullsi si më poshtë:

• *OE ofertues duhet të disponojë të paktën një mjet në pronësi apo të marrë me qira me kontratë noteriale për transportin e mallrave.*

Njësia e prokurimit argumenton nevojën e këtij kriteri për të garantuar se AK do të kryejë furnizimin e mallrave në kohën e kërkuar dhe sipas kushteve të kontratës, pa shkaktuar vonesa. Grupi i auditimit gjykon se, në këtë rast, duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, e jo punë/shërbim, në të cilat automjeti do të ishte i nevojshëm në çdo kohë, njësia e prokurimit nuk duhet të kufizonte vetëm këto dy mundësi për OE, por duhet të mjaftohej duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave. Kjo pasi, OE mund të zgjidhte nën kontraktimin për të kryer transportin e mallrave, pa qenë i detyruar të hyjë paraprakisht në marrëdhënie kontraktuale qiramarrje, në rast se nuk do të shpallej fitues. Sa më sipër, grupi i auditimit gjykon se ky kriter nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasën e kontratës që do të prokurohet.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 58, datë 04.02.2020 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., E.K. dhe D.M.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 5, datë 17.02.2020 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 6, datë 17.02.2020 dokumentoi administrimin e mostrave, me anë të procesverbalit nr. 7, datë 17.02.2020 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura dhe me anë të procesverbalit nr. 8, datë 19.02.2020 dokumentoi shqyrtimin dhe vlerësimin e sa më sipër, nga ku rezultoi:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	R.	2,490,500	Jo	Nuk ka paraqitur mostër, sikurse kërkuar në DST. Nuk është paraqitur Leja e transportit për mjetet e paraqitura;
2	BOE G.H. & L.	3,570,375	Jo	1. BOE nuk ka paraqitur mostër për produktin "Pllaka veshje kuzhine". 2. Mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit në pronësi ose kontrata e qirasë dhe leja e transportit.
3	H.	3,885,600	Po	

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE H., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej 3,885,600 lekë pa tvsh ose 4,662,720 lekë me tvsh.

**Gjetje:** Nga auditimi i ofertës së kualifikuar u konstatua se:

• Mbi kriterin 2.3.6 "Ofertuesi, nëse nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, të paraqesë autorizim nga Prodhuesi, ose distributori i autorizuar, i cili merr përsipër të furnizojë Ofertuesin me mallrat objekt prokurimi", OE ka paraqitur një akt-marrëveshje me një palë të tretë të datës 23.02.2016, si dhe një deklaratë konformiteti në gjuhën spanjolle të pa përkthyer, me vlefshmëri deri në 08.04.2017. KVO nuk e ka konstatuar këtë parregullsi në procesverbalin nr. 8, datë 19.02.2020 mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit, duke cituar se "OE e ka paraqitur dokumentacionin në plotë dhe të rregullt, sipas të gjitha kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të caktuara në DST nga AK". Mungesa e deklaratës së konformitetit është bërë shkak për skualifikimin e OE ofertues në procedura të tjera të zhvilluara nga DSHTD, ndërkohë që në këtë vlerësim ofertash nuk rezultoi të jetë konstatuar nga KVO e të vlerësohej nëse do të konsiderohej devijim i vogël apo jo.

### **-Lidhja e kontratës**

Midis AK dhe OE H. është lidhur kontrata nr. 219/3 prot., datë 30.03.2020 për blerje/ furnizim me pllaka të ndryshme me afat 30 ditë nga dita e nënshkrimit.

### **-Zbatimi i kontratës.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 117, datë 02.04.2020 është krijuar Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim me përbërje E.Th., E.D. dhe F.T.

Me anë të Urdhër transfertës së muajit prill 2020 është likuiduar OE H. në vlerën 4,662,720 lekë, bazuar në procesverbalin e pritjes së mallit të datës 02.04.2020 dhe faturës tatimore nr. 429, datë 02.04.2020, në vlerën 4,662,720 lekë me tvsh.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

#### **Pretendimet e subjektit:**

#### **Procedura e prokurimit “Pllaka të ndryshme”, me fond limit 4,520,520 lekë pa tvsh**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

- Sa i takon konstatimit të grupit të auditimit se mungon argumentimi i çdo kriteri sipas parashikimeve ligjore, NJP, ka mbajtur PV nr.1 datë 03.02.2020, ku janë hartuar dhe argumentuar kriteret dhe PV nr.3 datë 03.02.2020, ka argumentuar edhe kriteret e kualifikimit sa i takon kapacitetit ekonomik dhe financiar.

- Vendosja e kriterit për automjetin është në përpjesëtim dhe lidhet ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës nga OE, si dhe duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë e klientëve të DSHTD (diplomatë), ekzekutimi në kohë dhe pa vonesa i punimeve është shumë i rëndësishëm për DSHTD, si dhe realizimin me sukses të objektit të veprimtarisë së saj.

Konstatimet lidhur me realizimit e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:

- Në procedura të tjera, mungesa e deklaratës së konformitetit së bashku dhe me arsye/mungesa të tjera të vlerësuara në tërësi kanë përbërë shkak për skualifikim sepse tërësia e problematikave nuk mund të konsiderohej "devijim i vogël".

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

#### **Procedura e prokurimit “Pllaka të ndryshme”:**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

- Vendosja e kriterit për automjetin vetëm për siguri të AK për realizimin me sukses të kontratës e cila është detyrim kontraktual i OE, nuk qëndron. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Konstatimet lidhur me realizimit e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:

- Mungesa e deklaratës së konformitetit është bërë shkak për skualifikimin e OE ofertues në procedura të tjera të zhvilluara nga DSHTD, ndërkohë që në këtë vlerësim ofertash nuk rezulton të jetë konstatuar nga KVO e të vlerësohej nëse do të konsiderohej devijim i vogël apo jo. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

3. **Procedura e prokurimit “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, me fond limit 2,400,000 pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2020, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2020.**

*D. Të dhëna mbi objektin*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozime” <b>REF-64469-07-07-2020</b> Urdhri nr. 160, datë 30.06.2020	<b>2. Grupi i hartimit kritereve specifike</b> Urdhri nr. 149, datë 16.06.2020 <b>Hartimi i specifikimeve teknike:</b> E.Dh. E.D. A.B. <b>Përlllogaritja e fondit limit:</b> E.Dh. B.K. E.D.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 148, datë 16.06.2020 D.B. E.Dh. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 161, datë 30.06.2020 G.V. D.H. V.Sh.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,400,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 2,348,904 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 51,096 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 13.07.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD		<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>4 OE</b> ; b) Skualifikuar 2 OE: K. S. c) Kualifikuar 2 OE BOE E.C. & D. F.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 2 muaj			
<b>12. Ankimim</b> AK-ka; protokolluar në DSHTD nr.559/3 prot., datë 03.08.2020; APP-s’ka; KPP-s’ka;	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> AK-ka; shkresa nr.559/4 datë 07.08.2020		<b>14. Përgjigje Ankesës nga APP-s’ka;</b> KPP-s’ka;
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 712/6 prot., datë 04.09.2020	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrin nr. 268, datë 19.11.2020, është ngritur komisioni për marrjen e përkohshme në dorëzim të punimeve. - Me Urdhrin nr. 308, datë 17.12.2021, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve. - OE është likuiduar me urdhër transfertën e datës 10.12.2020 dhe urdhër transfertën e datës 21.12.2021.		
<b>16. Mbikëqyrësi i punimeve</b> I.	<b>Nr. licence</b> MK.	<b>Kontrata</b> nr.750/2 prot., datë 15.09.2020, vlera kontratës 71,500 lekë pa tvsh /85,800 lekë me tvsh	
<b>17. Kolaudatori i Punimeve</b> V.	<b>Nr. licence</b> MK.	<b>Kontrata</b> nr.911/2 prot., datë 11.11.2020, vlera kontratës 1,010 lekë pa tvsh / 1,212 lekë me tvsh	
<b>18 Akt kolaudimi</b> datë 16.11.2020	<b>19. Akti i marrjes në dorëzim</b> Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve datë 23.11.2020 Certifikata e marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve datë 18.12.2021		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.**

Me shkresën nr. 509 prot., datë 16.06.2020, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të

DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje me objekt “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.6, 8”. Në shkresë citohet se është e parashikuar në regjistrin e prokurimeve për vitin 2020.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 148, datë 16.06.2020 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.Dh. dhe E.A.

Në procesverbalin nr. 1, datë 07.07.2020, Njësia e Prokurimit ka dokumentuar hartimin e kritereve të veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 149, datë 16.06.2020 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike:

Përllogaritja e fondit limit:

E.Dh.

E.Dh.

E.D.

B.K.

A.B.

E.D.

Fondi limit për këtë punë publike është 2,400,00 lekë pa tvsh, vlerë kjo e miratuar me VKD nr.01 datë 06.01.2020. Grupi i punës ka mbajtur procesverbalin më datë 22.06.2020, i cili për përllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave, si më poshtë:

OE	Vlera e ofertës (lekë)	Oferta ardhur me shkresën
OE-F.	2,348,904	Oferta datë 22.06.2020
OE-H.	2,451,100	Oferta datë 22.06.2020
OE-E.	2,400,000	Oferta datë 22.06.2020

Me VKD nr.15 datë 24.06.2020 është vendosur zëvendësimi në regjistrin e prokurimeve të zërit “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.6, 8” me zërin “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, pasi në preventivat e dërguar për planifikim i përkisnin rikonstruksionit të pallateve nr.8/2 dhe nr. 8/3.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr.160, datë 30.06.2020 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozime”, me fond limit 2,400,000 lekë pa TVSH.

Me anë të procesverbalit nr. 2 të datës 07.07.2020, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”.

**Gjetje:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kritereve teknike konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nga grupi, kanë disa parregullsi si më poshtë:

- Referuar pikës 2.3 Për kapaciteti teknik, pika 2 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, të DST, ku citohet: “...Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të vlefshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë: NS-12 “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”. Grupi i auditimit gjykon se kriter i vendosur është në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

- Referuar pikës 2.3 Për kapaciteti teknik, pika 2 Licencë profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, të DST, ku citohet: “...Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës: 1 (një) inxhinier mekanik, të pajisur me licencë individuale (të vlefshme) me kategori 12/a, me kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës dhe diplomë përkatëse...”. Grupi i auditimit gjykon se kriter i vendosur mbi inxhinierin mekanik me licencë është në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.1.2008, ku citohej: “... Licencimi është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij...” Sa më sipër për pajisjen me licencë në zbatim që nga viti 2008, nuk nxirren licenca

individuale për zbatim, por këto licenca merren nga shoqëritë ku ata janë drejtues teknik, vendosja e një kriteri të tillë në DST tregon që është një kriter në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 161, datë 30.06.2020 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., D.H., V.Sh.

Referuar PV të KVO nr. 8, datë 27.07.2020 “Mbi hapjen e ofertave të paraqitura” dhe PV të KVO nr. 9, datë 29.07.2020 “Mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit, mostrave të mallit dhe ofertave të paraqitura”, rezultoi (renditur nga oferta ekonomike më e ulët te ajo më e lartë), si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	K.	2,022,600	Jo	1. Mungojnë në deklaratë të dhënat lidhur me freze, tranxhi dhe sharre profilesh, dhe një sërë pajisjesh ndihmëse. 2. Punë e ngjashme, nuk përputhen me natyrën e punës së kërkuar AK. 3. OE nuk ka paraqitur licencë individuale me kategori 12/a për inxhinierin mekanik. 4. OE nuk ka paraqitur asnjë të dhënë lidhur me 2 punonjës të certifikuar në mirëmbajtjen e ashensorëve.
2	BOE E.C.& D.	2,319,270	Po	
3	F.	2,348,904	Po	
4	S.	0	Jo	OE nuk ka paraqitur Ofertë ekonomike.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është BOE E.C. dhe D., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej 2,319,270 lekë pa tvsh ose 2,783,124 lekë me tvsh. BOE E.C. dhe D. ka dërguar shkresën me lëndë tërheqje nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”.

AK ka shpallur fitues OE F. i renditur i dyti në procedurë dhe me diferencë oferte më të vogël se 2% e vlerës së fondit limit, në vlerën prej 2,348,904 lekë pa tvsh ose 2,818,684.8 lekë me tvsh.

**-Lidhja e kontratës**

Midis AK dhe OE F. është lidhur kontrata nr. 712/6, datë 04.09.2020 me afat realizimi punimesh 2 muaj nga dita që kontraktorit i dorëzohet sheshi i punës, me vlerë kontrate 2,348,904 lekë pa tvsh/2,818,648.8 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 281,869 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

Midis AK dhe Mbikëqyrësit të punimeve OE I. është lidhur kontrata nr. 750/2, datë 15.09.2020, me vlerë kontrate 71,500.00 lekë pa tvsh /85,800 lekë me tvsh, me afat deri në marrjen në dorëzim të punimeve nga AK.

Midis AK dhe Kolaudatorit të punimeve OE V. është lidhur kontrata nr. nr.911/2, datë 11.11.2020, me vlerë kontrate 1,010 lekë pa tvsh/1,212 lekë me tvsh, me afat 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

**-Zbatimi i kontratës.**

Me shkresën nr.712/7 prot. datë 08.09.2020, “Dërgim për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3””, Sektorit të Planifikimit dhe Financës dhe Sektorit të Administratës dhe Zbatimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit është mbajtur më datë 07.10.2020 midis Sipërmarrësit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe Investitorit të punimeve, njoftimi i fillimit të punimeve të sipërmarrësit të punimeve, Procesverbali mbi fillimin e punimeve, janë mbajtur më datë 07.10.2020. Punimet kanë përfunduar më datë 30.10.2020, ose brenda afatit kontraktuale të përfundimit të punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve me anë të shkresës datë 30.10.2020, njofton DSHTD për përfundimin e punimeve më datë 30.10.2020.

Më datë 02.11.2020 midis Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve është mbajtur procesverbali i përfundimit të punimeve.

Situacioni përfundimtar me vlerë 2,348,904 lekë pa tvsh / 2,818,685 lekë me tvsh, i miratuar nga Sipërmarrësi i punimeve F. përfaqësuar nga ing. A.H., Mbikëqyrësi i punimeve I. dhe Investitori DSHTD A.S.

Procesverbali i kolaudimit, protokolluar në DSHTD me nr.911/3 prot., datë 16.11.2020, vërteton realizimin e punimeve në përputhje me kontratën dhe projekt preventivin, i mbajtur midis Sipërmarrësit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe Kolaudatorit të punimeve dhe Investitorit të punimeve.

Komisioni i marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, është ngritur sipas Urdhrit nr.268, datë 19.11.2020, me përbërje E.Dh., E.D. dhe Y.T.

Më datë 23.11.2020, është mbajtur Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, në prani të komisionit të marrjes në dorëzim përfaqësuar nga E.Dh., E.D. dhe Y.T., Sipërmarrësi i punimeve OE F. përfaqësuar nga A.H., Mbikëqyrësi i punimeve I. përfaqësuar nga F.V. dhe kolaudatori i punimeve V. përfaqësuar nga B.S. dhe Autoritetit Kontraktor përfaqësuar nga A.S., ku u vendos marrja në dorëzim e punimeve të kryera, të realizuar konform kontratës së nënshkruar.

Komisioni i marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, është ngritur sipas Urdhrit nr.308, datë 17.12.2021, me përbërje E.Dh., E.D. dhe A.S.

Më datë 18.12.2021, është mbajtur Certifikata e marrjes në dorëzim përfundimtar për objektin “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, në prani të grupit të marrjes në dorëzim përfaqësuar nga E.Dh., E.D. dhe A.S., Investitori DSHTD i përfaqësuar nga A.S., Sipërmarrësi i punimeve OE F. përfaqësuar nga A.H., Mbikëqyrësi i punimeve I. përfaqësuar nga F.V. dhe kolaudatori i punimeve V. përfaqësuar nga B.S., ku u vendos marrja në dorëzim e punimeve të kryera, pas përfundimit të garancisë së punimeve.

OE është likuiduar nëpërmjet urdhër transfertës e datës 10.12.2020 dhe urdhër transfertës e datës 31.12.2021, bazuar në faturën tatimore nr. 26, datë 26.11.2020 në vlerën 2,348,904 lekë pa tvsh / 2,818,685 lekë me tvsh.

Ashensorët janë regjistruar, nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, më anë të certifikatave të regjistrimit nr. 001283 TR dhe nr. 001284 TR, datë 28.01.2022, ashensorët e godinës 8/3 dhe nr. 001285 TR dhe nr. 001286 TR, datë 28.01.2022, ashensorët e godinës 8/2, të cilëve i është bërë dhe ekzaminimi i plotë.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Procedura e prokurimit “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr. 8/2, 8/3”, me fond limit 2,400,000 lekë pa tvsh**

*Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:*

- Licenca NS -12 “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”, është vendosur për të ruajtur në kushte optimale funksionin e sistemit të ventilimit dhe të ajrosjes së ashensorëve.

**Procedura e prokurimit “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr. 8/2, 8/3”, me fond limit 2,400,000 lekë pa tvsh**

*Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:*



- Licenca NS -12 nuk është në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**5. Procedura e prokurimit “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”,** me fond limit **5,352,818 pa TVSH**, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2020, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2020.

*E. Të dhëna mbi objektin*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozime” <b>REF-64309-07-06-2020</b> Urdhri nr. 154, datë 23.06.2020	<b>2. Grupi i hartimit kritereve specifike</b> Urdhri nr. 147, datë 16.06.2020 <b>Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit :</b> E.Th. E.D. A.B.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 146, datë 16.06.2020 D.B. E.Th. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 155, datë 23.06.2020 G.V. E.K. A.N.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 5,352,818 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 5,251,200 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 101,618 lekë	
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 13.07.2020	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>4 OE;</b> b) Skualifikuar 3 OE: L.C. 6D. E. c) Kualifikuar 1 OE BOE D. & H.	
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 20 ditë			
<b>12. Ankimim</b> AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka;	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> AK-s’ka;	<b>14. Përgjigje Ankesës nga</b> APP-s’ka; KPP-s’ka;	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 253/3 prot., datë 30.03.2020	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrin nr. 259, datë 05.11.2020, është ngritur komisioni për marrjen e përkohshme në dorëzim të punimeve. - Me Urdhrin nr. 286, datë 18.11.2021, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve. - OE është likuiduar me mandat-pagesën e datës 17.11.2020 dhe urdhër transfertën e datës 13.12.2021.		
<b>16. Mbikëqyrësi i punimeve</b> A.	<b>Nr. licence</b> MK.	<b>Kontrata</b> nr.727/2 prot., datë 02.09.2020, vlera kontratës 84,500 lekë pa tvsh /101,400 lekë me tvsh	
<b>17. Kolaudatori i Punimeve</b> M.		<b>Kontrata</b> nr.853/2 prot., datë 19.10.2020, vlera kontratës 577 lekë pa tvsh / 692 lekë me tvsh	
<b>18 Akt kolaudimi</b> datë 04.11.2020	<b>19. Akti i marrjes në dorëzim</b> Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve datë 10.11.2020 Certifikata e marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve datë 22.11.2021		

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.***

Me shkresën nr. 503 prot., datë 15.06.2020, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje me objekt “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”. Në shkresë citohet se është e parashikuar në regjistrin e prokurimeve për vitin 2020.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 146, datë 16.06.2020 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.Th. dhe E.A.

Në procesverbalin nr. 1, datë 06.07.2020, Njësia e Prokurimit ka dokumentuar hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 147, datë 16.06.2020 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike Përllogaritja e fondit limit:

E.Th.

E.D.

A.B.

Fondi limit për këtë punë publike është 5,352,818 lekë pa tvsh, vlerë kjo e miratuar me VKD nr.01 datë 06.01.2020.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr.154, datë 23.06.2020 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit me objekt “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozime”, me fond limit 5,352,818 lekë pa TVSH.

Me anë të procesverbalit nr. 2 të datës 06.07.2020, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”.

**Gjetje:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nga grupi, kanë disa parregullsi si më poshtë:

- Mungon procesverbali mbi hartimin e fondit limit dhe analizat e çmimeve respektive.
- Referuar pika 2.3 Për kapaciteti teknik, pika 6b, të DST, ku citohet: “...6.Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij, specialistë ndërtimi të certifikuar sipas profesioneve si më poshtë .... b. Inxhinier Ndërtimi, Specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, e vërtetuar me certifikatë përkatëse (të vlefshme), të lëshuar nga organizëm certifikimi , të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë...”. Certifikatë që duhet të ketë një person i punësuar në kompani i cili ka profilin arsimor si specifikohet në VKM nr. 312, datë 5.5.2010. Kriter i vendosur diskriminues *në kundërshtim me Nenin 10, pika 1a, të VKM nr. 312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, ku citohet: “...1. Koordinatori për projektin dhe koordinatori për realizimin e punimeve duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme; a) diplomë universitare në inxhinieri, arkitekturë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi... ”.*
- Referuar DST pika 2.3 Për kapaciteti teknik, pika 6e, ku citohet, ku citohet: “...6. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij, specialistë ndërtimi të certifikuar sipas profesioneve si më poshtë .... e) Ekspert zjarrfikës, shoqëruar Kontratë pune të vlefshme gjatë ekzekutimit të kontratës, leje të vlefshme për ushtrimin e profesionit “Ekspert Privat Zjarrfikës”, lëshuar nga institucionet kompetente, cv, si dhe të figurojë në listë pagesat me kohë të plotë Tetor 2019-Mars 2020...”. Kriter i vendosur në *kundërshtim me nenin 26, Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës... ”.*

• Referuar DST pika 2.3 Për kapaciteti teknik, pika 6h dhe 6i, ku citohet, ku citohet: “...6. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij, specialistë ndërtimi të certifikuar sipas profesioneve si më poshtë ... h) 1 (një) Inxhinier Mekanik, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme gjatë ekzekutimit të kontratës ... i) 1 (një) Inxhinier elektrik, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme gjatë ekzekutimit të kontratës ...”. Kriter i vendosur në kundërshtim me nenin 26, Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

• Referuar DST pika 2.3 Për kapaciteti teknik, pika 9, ku citohet, ku citohet: “...9. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik (sipas shtojcës 9 të DST): .... 1 Auto betoniere, 1 Auto pompë betoni, Pompë Suvatimi, helikopter nivelimi ...”. Kriter vendosur në kundërshtim me nenin 26, Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 155, datë 23.06.2020 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., E.K., A.N.

Referuar PV të KVO nr. 11, datë 03.08.2020 “Mbi hapjen e ofertave të paraqitura” dhe PV të KVO nr. 12, datë 07.08.2020 “Mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit, mostrave të mallit dhe ofertave të paraqitura”, rezultoi (renditur nga oferta ekonomike më e ulët te ajo më e lartë), si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	L.C.	5,160,282.02	Jo	1. OE nuk ka paraqitur deklaratë që inxhinierët nuk janë të dy punësuar. 2. OE nuk ka paraqitur dokumentacion për “Inxhinier Ndërtimi, i certifikuar me certifikatë trajnimi me titull “Specialist për testimin e performancë së produkteve të ndërtimit”. 3. OE, nuk plotëson pikën 6/g të Kapacitetit teknik ne lidhje me dëshmitë e kualifikimit të stafit teknik. 4. OE nuk ka përmbyshur kërkesën e pikës 8 të Kapacitetit teknik. Leja mjedisore me kod III.1.A. 5. O.E nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me disponimin: Helikopter nivelimi 1(një) copë, fatura doganore e paraqitur në këtë rast lidhet me një pompe betoni të përdorur. Pompë suvatimi - Fatura doganore e paraqitur është sërish ajo e përmendur me sipër lidhur me një pompe betoni të përdorur
2	BOE D.& H.	5,251,200	Po	
3	6D.	0	Jo	OE nuk ka paraqitur Ofertë ekonomike.
4	E.	0	Jo	OE nuk ka paraqitur Ofertë ekonomike.

Sa më sipër, fitues është shpallur BOE D. shpk & H. me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar në vlerën prej 5,251,200 lekë pa tvsh ose 6,301,440 lekë me tvsh.

**Gjetje:** Nga auditimi i realizimit të procedurës në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, konstatohet se:

- KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar për punonjësit certifikatat të lëshuara nga një subjekt i pa akredituar për këtë trajnim, si dhe në listë pagesën e shoqërisë nuk figurojnë të siguruar me profesione sipas kontratave. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 6g, të DST, ku citohet: "...g) Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij punonjësit, si më poshtë: Hidroizolues 2; Suvatues/Murator 5; Punëtorë përpunim d/alumini 4; Elektracist 2; Mekanik 1; Bojaxhi 5; Punëtorë lartësie 5; Hidraulik 1; Karpentier 2. Për Punonjësit e mësipërm duhet të dorëzojë dëshmi kualifikimi të Sigurimit Teknik, si dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë Tetor 2019-Mars 2020”.

Referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit midis OE, shikohet se punimet e lysterjes dhe suvatimit do të realizohen nga OE H., i cili nuk ka të punësuar në stafin e tij 5 punonjësit bojaxhi dhe 5 punonjësit suvatues, ndërsa OE D. i cili ka marrë punimet për rikonstruksionin e dritareve dhe vetratave nuk ka të punësuar në stafin e tij 4 Punëtorë përpunim d/alumini. Në kundërshtim me nenin 74, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, ku citohet: "...Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje...”.

- KVO ka skualifikuar OE pasi nuk ka paraqitur deklaratë që inxhinierët nuk janë të dy punësuar, por OE ka sjellë deklaratën që inxhinieri i ndërtimit, mjedisit dhe elektrik nuk janë të dy punësuar, gjithashtu referuar listë pagesës janë të punësuar me kohë të plotë. Ndërkohë inxhinieri elektrik dhe i mjedisit i njërit nga OE fitues sipas listë pagesës është i punësuar me kohë të pjesshme.

- KVO ka skualifikuar OE pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për “Inxhinier Ndërtimi, i certifikuar me certifikatë trajnimi me titull “Specialist për testimin e performancë së produkteve të ndërtimit”, e dhënë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar, me modulet e mëposhtme: Moduli 2 “Standardet për sigurimin e cilësisë së produkteve të ndërtimit”, ndërkohë OE fitues ka sjellë një certifikatë trajnimi e dhënë nga një organizëm certifikimi shqiptar i pa akredituar për këtë lloj certifikimi.

#### **-Lidhja e kontratës**

Midis AK dhe BOE D. & H. është lidhur kontrata nr. 697/3, datë 08.09.2020 me afat realizimi punimesh 2 ditë kalendarike nga dita që kontraktorit i dorëzohet sheshi i punës, me vlerë kontrate 5,251,200.00 lekë pa tvsh/6,301,440 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 630,144 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

Është lidhur kontrata me nr. 727/2, datë 02.09.2020 midis Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, përfaqësuar nga Titullari A.S. dhe OE A., me NIPT përfaqësuar nga I.D., me vlerë kontrate 84,500.00 lekë pa tvsh/101,400 lekë me tvsh, me afat deri në marrjen në dorëzim të punimeve nga AK, me licencë MK.

Është lidhur kontrata me nr.853/2, datë 19.10.2020 midis Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, përfaqësuar nga Titullari A.S. dhe OE M., me NIPT përfaqësuar nga T.S., me vlerë kontrate 577.00 lekë pa tvsh/692 lekë me tvsh, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

#### **-Zbatimi i kontratës.**

Me shkresën nr.697/4 prot. datë 08.09.2020, “Dërgim për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare””, Sektorit të Planifikimit dhe Financës dhe Sektorit të Administratës dhe Zbatimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit është mbajtur më datë 22.09.2020 midis Sipërmarrësit të punimeve dhe Mbikëqyrësit të punimeve, njoftimi i fillimit të punimeve të sipërmarrësit të punimeve, Procesverbali mbi fillimin e punimeve dhe akt piketimi i objektit, janë mbajtur më datë 22.09.2020. Punimet kanë përfunduar më datë 12.10.2020, ose brenda afatit kontraktuale të përfundimit të punimeve.

Sipërmarrësi i punimeve me anë të shkresës datë 12.10.2020, njofton Mbikëqyrësin e punimeve për përfundimin e punimeve më datë 12.10.2020.

Mbikëqyrësi i punimeve me anë të shkresës datë 12.10.2020, protokolluar në DSHTD me nr. 806/1 prot., datë 12.10.2020, njofton DSHTD për përfundimin e punimeve më datë 12.10.2020.

Më datë 12.10.2020 midis Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve është mbajtur procesverbali i përfundimit të punimeve. Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 259, datë 05.11.2020, është krijuar komisioni për marrjen e përkohshme në dorëzim të punimeve, i përbërë nga: E.K., D.H. dhe A.B.

Situacioni përfundimtar me vlerë 5,246,190 lekë pa tvsh / 6,295,428 lekë me tvsh, i miratuar nga Sipërmarrësi i punimeve BOE H. & D. përfaqësuar nga ing. N.H., Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria A. përfaqësuar nga ing. I.D. dhe Mbikëqyrësi nga ana e DSHTD inxh. E.K. si dhe Investitori DSHTD A.S.

Procesverbali i kolaudit, protokolluar në DSHTD me nr.853/4 prot., datë 04.11.2020, vërteton realizimin e punimeve në përputhje me kontratën dhe projekt preventivin, i mbajtur midis Sipërmarrësit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe Kolaudatorit të punimeve.

Komisioni i marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksioni i fasadave të jashtme të ambasadës Bullgare”, është ngritur sipas Urdhrit nr.259, datë 05.11.2020, me përbërje E.K., D.H. dhe A.B.

Më datë 10.11.2020, është mbajtur Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve në objektin “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, në prani të komisionit të marrjes në dorëzim përfaqësuar nga E.K., D.H. dhe A.B., Sipërmarrësi i punimeve BOE H. & D. përfaqësuar nga N.H., Mbikëqyrësi i punimeve A. përfaqësuar nga I.D. dhe kolaudatori i punimeve M. përfaqësuar nga T.S., ku u vendos marrja në dorëzim e punimeve të kryera, të realizuar konform kontratës së nënshkruar.

Komisioni i marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksioni i fasadave të jashtme të ambasadës Bullgare”, është ngritur sipas Urdhrit nr.286, datë 18.11.2021, me përbërje A.D., E.I. dhe I.B.

Më datë 22.11.2021, është mbajtur Certifikata e marrjes në dorëzim përfundimtar për objektin “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, në prani të grupit të marrjes në dorëzim përfaqësuar nga A.D., E.I., I.B., Investitori DSHTD i përfaqësuar nga A.S., Sipërmarrësi i punimeve BOE H.& D. përfaqësuar nga N.H., Mbikëqyrësi i punimeve A. përfaqësuar nga I.D. dhe kolaudatori i punimeve M. përfaqësuar nga T.S., ku u vendos marrja në dorëzim e punimeve të kryera, pas përfundimit të garancisë së punimeve.

OE është likuiduar nëpërmjet mandat-pagesës së datës 17.11.2020 dhe urdhër transfertën e datës 13.12.2021, bazuar në faturën tatimore nr. 447, datë 11.11.2020 në vlerën 5,246,190 lekë pa tvsh / 6,295,428 lekë me tvsh.

**Gjetje:** Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezat e masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si më poshtë:

Tabela nr. 1: Diferencat e volumeve në objektin: “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libreza masash	Fakti	Diferenca në volume	
							Vol.	Vlera
I.2	Shpatullim mure dritare dhe vetratë	m2	500	149	149	131.4	17.6	8,800
I.3	Dritare durali termik dopjo xham, xham termik	m2	16,700	148.7	148.7	147.25	1.45	24,215
II.3	Suvatim me grafiato H>4m	m2	1,600	887	887	848.13	38.87	62,192
II.4	Lyerje fasade me bojë me ngjyrë okër	m2	400	887	887	848.13	38.87	15,548
Totali								<b>110,755</b>

Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit.

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Zëri Shpatullim mure dritare dhe vetratë. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 149 m2, pas verifikimit në terren u konstatua se ky zë pune ka gjerësinë 291.9 m (sipas tabelës së mëposhtme) dhe gjerësinë 0.45m. Nga rillogaritja, sipërfaqja e

shpatullimit është 23 m2 më pak se sasia e situacionuar, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. (Sipas tabelës nr.3 në aneksin IV).

Zëri Dritare durali termik dopjo xham, xham termik. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 148.7 m2, pas verifikimit në terren u konstatua se ky zë pune është 147.25, pasi dritaret e vetratës së katit përdhe kanë gjerësi 3.5 m dhe jo 4m si në librezën e masave. Nga rillogaritja, sipërfaqja e shpatullimit është 1.45 m2 më pak se sasia e situacionuar, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. (Sipas tabelës nr.4 në aneksin IV).

Zëri Suvatim me grafiato H>4m dhe Zëri Lyerje fasade me bojë me ngjyrë okër. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 887 m2, pas verifikimit në terren u konstatua se ky diferenca në disa elementë, diferencat jepet sipas tabelës së mëposhtme. Nga rillogaritja, sipërfaqja e suvatimit grafiato dhe lyerjes me bojë është 38.87 m2 më pak se sasia e situacionuar, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. (Sipas tabelës nr.4 në aneksin IV).

Për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar më tepër vlere prej 110,755 lekë pa tvsh / 132,906 lekë me tvsh sipërmarrësit të punimeve për punime të pa kryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** ing. I.D. nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1. Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

*“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”*

2. Kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr.727/2 prot., datë 02.09.2020.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstrukcion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Zëri Shpatullim mure dritare dhe vetratë. Vlora prej <b>8,800 lekë pa tvsh / 10,560 lekë me tvsh</b>, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</li> <li>○ Zëri Dritare durali termik dopjo xham, xham termik. Vlora prej <b>24,215 lekë pa tvsh / 29,058 lekë me tvsh</b> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</li> <li>○ Zëri Suvatim me grafiato H&gt;4m. Vlora prej <b>62,192 lekë pa tvsh / 74,630 lekë me tvsh</b> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</li> <li>○ Zëri Lyerje fasade me bojë me ngjyrë okër. Vlora prej <b>15,548 lekë pa tvsh / 18,658 lekë me tvsh</b> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Neni 7 Kontrata sipërmarrjes nr. 697/3, datë 08.09.2020. Kontrata e Mbikëqyrjes me nr.727/2, datë 02.09.2020. Librezat e masave, situacioni përfundimtar.
<b>Ndikimi:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë prej <b>132,906 lekë me tvsh</b> në fondet e DSHTD.
<b>Shkaku</b>	Mungesë e kontrollit të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit të punimeve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë

<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej <b>132,906 lekë me tvsh</b> nga BOE D.& H., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 697/3, datë 08.09.2020, me objekt “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të DSHTD.
---------------------	--

BOE D. & H. është lidhur kontrata nr. 697/3, datë 08.09.2020 me afat realizimi punimesh 2 ditë kalendarike nga dita që kontraktorit i dorëzohet sheshi i punës, me vlerë kontrate 5,251,200.00 lekë pa tvsh/6,301,440 lekë me tvsh.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Procedura e prokurimit “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, me fond limit 5,352,818 lekë pa tvsh**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

- Preventivi i punimeve është hartuar nga inxhinieri z. E.Th., i cili ka edhe analizën e çmimeve.
- Kriteret për kapacitetin teknik të vendosura në këtë procedurë prokurimi kanë kaluar të gjitha mekanizmat e shqyrtimit, (APP, operatorë ankimes, Komision i shqyrtimit të ankesave, rishqyrtim nga specialisti i fushës). Si të tillë, duke qenë se pas ndryshimeve të bëra, sqarojmë se këto kriterë janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe në përputhje me aktet ligjore.

Konstatimet lidhur me realizimin e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:

- Në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik i cila ka dorëzuar për punonjësit certifikata të lëshuara nga një subjekt i pa akredituar për këtë trajnim, sipas verifikimit të KVO në periudhën e vlerësimit të procedurës, subjekti rezultonte i akredituar.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Procedura e prokurimit “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, me fond limit 5,352,818 lekë pa tvsh.**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

- Analizat e çmimeve duhet të disponohen nga DSHTD pasi Inxhinieri i ka kryer për nevoja të institucionit. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Konstatimet lidhur me realizimin e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:

- Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga OE rezulton se certifikata trajnimi me titull “Specialist për testimin e performancë së produkteve të ndërtimit” nuk e ka stemën që subjekti është i akredituar për këtë lloj certifikimi. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**II. Për vitin 2021, grupi i auditimit ka përzgjedhur procedurat e prokurimit, si më poshtë:**

Nr.	Objekti	Fondi limit	Lloji i procedurës	Vlera e kontratës
1.	Amb. Bullgare + Hapje pusi + Impiant klorifikimi	1,359,912	Kërkesë për propozim	1,356,819
2.	Blerje kamionçine 3 ton me vinç	3,100,000	Kërkesë për propozim	3,050,000
3.	Blerje furnizim lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj vlerës	20,647,833	Procedurë e hapur (marrëveshje kuadër 21 muaj)	34.78% (marzh fitimi)
4.	Materiale ndërtimi inerte	2,952,099	Kërkesë për propozim (marrëveshje kuadër)	2,560,490

5.	Pllaka të ndryshme	2,879,480	Kërkesë për propozim (marrëveshje kuadër)	1,603,450
----	--------------------	-----------	--	-----------

**1. Procedura e prokurimit “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”,** me fond limit **1,359,912 lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2021, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2021

**A. Të dhëna mbi objektin**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozime” <b>REF-90755-03-23-2021</b> Urdhri nr. 45, datë 29.01.2021.	<b>2. Urdhri i hartimit kritereve specifike</b> Urdhri nr. 41, datë 26.01.2021 <b>Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit:</b> Procedurë prokurimi	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 40, datë 26.01.2021 D.B. E.Dh. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 46, datë 29.01.2021 G.V. E.K. A.N.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 1,359,912 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 1,356,819 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 3,093 lekë	
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 29.03.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>1 OE</b> ; b) Kualifikuar 1 OE OE H.	
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 40 ditë			
<b>12. Ankimim</b> AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka;	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> AK-s’ka;	<b>14. Përgjigje Ankesës nga</b> APP-s’ka; KPP-s’ka;	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 300/3 prot., datë 05.05.2021	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrin nr. 289, datë 22.11.2021, është ngritur komisioni për marrjen e përkohshme në dorëzim të punimeve. - Me Urdhrin nr. 453, datë 20.12.2022, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve. - OE është likuiduar me urdhër transfertën e datës 06.12.2021 dhe urdhër transfertën e datës 30.12.2022.		
<b>16. Mbikëqyrësi i punimeve</b> A.	<b>Nr. licence</b> MK.	<b>Kontrata</b> nr.685/2 prot., datë 07.09.2021, vlera kontratës 49,400 lekë pa tvsh /59,280 lekë me tvsh	
<b>17. Kolaudatori i Punimeve</b> M.		<b>Kontrata</b> nr.920/2 prot., datë 01.11.2021, vlera kontratës 1,077 lekë pa tvsh / 1,292 lekë me tvsh.	
<b>18 Akt kolaudimi</b> datë 09.11.2021	<b>19. Akti i marrjes në dorëzim</b> Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve datë 24.11.2021. Certifikata e marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve dhjetor 2022.		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.**

Me shkresën nr. 92 prot., datë 26.01.2021, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje me objekt “Hapje pusi uji + impiant klorifikimi te Ambasada Bullgare”. Në shkresë citohet se është e parashikuar në regjistrin e prokurimeve për vitin 2021.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 40, datë 26.01.2021 është ngritur njësia e prokurimit, e



përbërë nga D.B., E.Dh. dhe E.A.

Me shkresën nr.92/3 prot. datë 27.01.2021, përcillet projekti dhe fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt: “Ambasada Bullgare - Hapje pus uji + impiant klorifikimi”, drejtuar njësisë së prokurimit nga sektori i planifikimit dhe financës. Projekti “Hartim studimi dhe projekt preventivi për shpim pusi uji në Ambasadën Bullgare” hartuar me procedurë prokurimi nga studio projektuese A. dhe fondi limit për këtë punë publike është 1,359,912 lekë pa tvsh.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 45, datë 29.01.2021 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit me objekt “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozime”, me fond limit 1,359,912 lekë pa tvsh.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 12.02.2021, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të procesverbalit nr. 2 të datës 12.02.2021, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”.

**Gjetje:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nga grupi, kanë disa parregullsi si më poshtë:

- Referuar pikës 2.3 Për kapaciteti teknik, pika 6, të DST, ku citohet: “...6. Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se ka të punësuar në licencën e shoqërisë, stafin inxhinierik si më poshtë: ... Inxhinier Shpimi 1(një)...”. Kriteri i vendosur diskriminues në kundërshtim me nenin 1 Objekti dhe qëllimi, pika 2b, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku citohet: “...qëllimi i këtij ligji është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik...” dhe në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar, lidhja 4, Profili i diplomimit sipas kategorive studiues - projektues gjeologo-inxhinierik e kanë Gjeologji Inxhinierike/ Hidrogjeologji / Gjeoteknikë. Referuar VKM Nr.42, datë 16.1.2008, ku citohej: “... Licencimi është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij...” Sa më sipër, shoqëria ka licenca për kryerjen e veprimtarisë jo drejtuesi teknik, vendosja e një kriteri të tillë në DST tregon që është një kriter në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

- Referuar pikës 2.3 Për kapaciteti teknik, pika 9, të DST, ku citohet: “...9. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, Autovinç...”. Kriteri i vendosur në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, ku citohet: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 46, datë 29.01.2021 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., E.K. dhe A.N.

Referuar PV të KVO nr. 6, datë 01.03.2021 “Mbi hapjen e ofertave të paraqitura” dhe PV të KVO nr. 7, datë 03.03.2021 “Mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit ofertave të paraqitura”, rezultoi se ishte paraqitur 1 (një) operator ekonomik, H. me ofertë ekonomike 1,349,609 lekë pa tvsh, i cili është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur licencë për ushtrimin e veprimtarisë “Shpues profesionist për ujë” me kodin III.7.B.

Me anë të procesverbalit nr.8 datë 11.03.2021, “Mbi vlerësimin e anulimit të procedurës së prokurimit”, AK anulon procedurën e prokurimit pasi asnjë ofertë nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në DST.

Referuar PV të KVO nr. 6, datë 06.04.2021 “Mbi hapjen e ofertave të paraqitura” dhe PV të KVO nr. 7, datë 06.04.2021 “Mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit ofertave të paraqitura”, rezultoi se ishte paraqitur 1 (një) operator ekonomik, H. me ofertë ekonomike 1,356,819 lekë pa

tvsh, i cili plotëson të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE H., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej 1,356,819 lekë pa tvsh ose 1,628,182.8 lekë me tvsh.

#### ***-Lidhja e kontratës***

Midis AK DSHTD dhe OE H. është lidhur kontrata nr. 300/3 prot., datë 05.05.2021 me afat realizimi punimesh 40 ditë kalendarike nga dita që kontraktorit i dorëzohet sheshi i punës, me vlerë kontrate 1,356,819 lekë pa tvsh/1,628,182.8 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 162,819 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

Është lidhur kontrata me nr.685/2, datë 07.09.2021 midis Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, përfaqësuar nga Titullari A.S. dhe OE A., me NIPT, përfaqësuar nga I.D., me vlerë kontrate 49,400.00 lekë pa tvsh/59,280 lekë me tvsh, me afat deri në marrjen në dorëzim të punimeve nga AK, me licencë MK.

Është lidhur kontrata me nr.920/2, datë 01.11.2021 midis Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, përfaqësuar nga Titullari A.S. dhe OE M., me NIPT përfaqësuar nga T.S., me vlerë kontrate 1,077 lekë pa tvsh/1,292 lekë me tvsh, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

#### ***Miratimi i lejes***

Vendim nr.7, datë 15.07.2021, i Këshillit Basenit Ujor Ishëm për miratimin e lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi), për subjektin Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, miratuar nga kryetari i KBU Ishëm R.N. Projekti është hartuar nga Studio A.

#### ***-Zbatimi i kontratës.***

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit është mbajtur më datë 04.10.2021 midis Sipërmarrësit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe Investitorit të punimeve, njoftimi i fillimit të punimeve të mbikëqyrësit të punimeve, procesverbali mbi akt piketimin e objektit, procesverbali mbi fillimin e punimeve, janë mbajtur më datë 04.10.2021.

Më datë 08.10.2021, Sipërmarrësi i punimeve i ka dorëzuar Mbikëqyrësit të punimeve kërkesën për përdorimin e fondit rezervë të kontratës, si rrjedhojë e spostimit të pikës së shpimit, sipas propozimit të personelit të ambasadës Bullgare në bashkëpunim me projektuesin dhe Autoritetin Kontraktor, pasi në pikën e caktuar dëmtoheshin rrjeti elektrik, interneti, sistemi i ndriçimit dhe vëzhgimit të objektit të ambasadës. Ky spostim sipas shkresës dërguar ishte i papërfillshëm nga ana gjeologjike. Mbikëqyrësi i punimeve më datë 08.10.2021 i ka dërguar AK, protokolluar në DSHTD nr.685/7 prot., datë 08.10.2021, kërkesën për miratimin e punimeve shtesë brenda fondit rezervë të objektit me vlerë 39,519 lekë pa tvsh.

Sipërmarrësi i punimeve dhe Mbikëqyrësi i punimeve më datë 08.10.2021, kanë mbajtur procesverbalin e fondit rezervë dhe kanë miratuar preventivin e fondit rezervë.

AK me anë të shkresës nr.685/9 prot., datë 12.10.2021, i ka kthyer përgjigje Mbikëqyrësit të punimeve, ku miraton kryerjen e punimeve shtesë dhe miratimin e preventivit të fondit rezervë. Punimet kanë përfunduar më datë 19.10.2021, ose brenda afatit kontraktuale të përfundimit të punimeve.

Sipërmarrësi i punimeve me anë të shkresës datë 19.10.2021, njofton Mbikëqyrësin e punimeve për përfundimin e punimeve më datë 19.10.2021.

Mbikëqyrësi i punimeve me anë të shkresës nr.70/1 prot., datë 19.10.2021, protokolluar në DSHTD nr.685/10 prot., datë 19.10.2021, njofton DSHTD për përfundimin e punimeve më datë 19.10.2021.

Më datë 18.10.2021 midis Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve është mbajtur procesverbali i përfundimit të punimeve.

Situacioni përfundimtar me vlerë 1,356,819 lekë pa tvsh / 1,628,183 lekë me tvsh, i miratuar nga Sipërmarrësi i punimeve H. përfaqësuar nga ing. N.H., Mbikëqyrësi i punimeve A. përfaqësuar nga ing. I.D. dhe Investitori DSHTD A.S.

Procesverbali i kolaudimit, protokolluar në DSHTD me nr.920/4 prot., datë 10.11.2021, vërteton realizimin e punimeve në përputhje me kontratën dhe projekt preventivin, i mbajtur midis Sipërmarrësit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe Kolaudatorit të punimeve.

Komisioni i marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve për kontratën me objekt “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”, është ngritur sipas Urdhrit nr.289, datë 22.11.2021, me përbërje E.Dh., K.Sh. dhe I.B.

Më datë 24.11.2021, është mbajtur Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve në objektin “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”, në prani të komisionit të marrjes në dorëzim përfaqësuar nga E.Dh., K.Sh. dhe I.B., Sipërmarrësi i punimeve OE H. përfaqësuar nga N.H., Mbikëqyrësi i punimeve A. përfaqësuar nga I.D. dhe kolaudatori i punimeve M. përfaqësuar nga T.S., Autoritetit Kontraktor DSHTD përfaqësuar nga A.S., ku u vendos marrja në dorëzim e punimeve të kryera, të realizuar konform kontratës së nënshkruar.

Komisioni i marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve për kontratën me objekt “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”, është ngritur sipas Urdhrit nr.453, datë 20.12.2022, me përbërje E.Dh., K.Sh. dhe I.B.

Është mbajtur Certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve për objektin “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”, në prani të grupit të marrjes në dorëzim përfaqësuar nga E.Dh., K.Sh. dhe I.B., Investitori DSHTD i përfaqësuar nga E.P., Sipërmarrësi i punimeve OE H. përfaqësuar nga N.H., Mbikëqyrësi i punimeve A. përfaqësuar nga I.D. dhe kolaudatori i punimeve M. përfaqësuar nga T.S., ku u vendos marrja në dorëzim e punimeve të kryera, pas përfundimit të garancisë së punimeve.

OE është likuiduar nëpërmjet urdhër transfertës e datës 06.12.2021 dhe urdhër transfertës e datës 30.12.2022, bazuar në faturën tatimore nr. 37/2021, datë 26.11.2021 në vlerën 1,356,819 lekë pa tvsh / 1,628,183 lekë me tvsh.

**Gjetje:** Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezat e masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si më poshtë:

Tabela nr. 2: Diferencat e volumeve në objektin: “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacion përfundimtar	Situacioni i rezervës	Librezat masash	Fakti	Diferenca në volume	
								Vol.	Vlera
III.3	Gërmim dheu me krah	m3	1,000	15	8.019	23.019	13.079	9.94	9,940
III.4	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri në 10 km	m3	2,500	35	0	35	17.6	17.4	43,500
IV.3	Mbushje me çakëll kanali dhe pusetat	m3	1,500	14	0	14	4.75	9.25	13,875
V.2	Shtresë betoni C12/15	m3	8,000	0.4	1.5	1.9	1.5	0.4	3,200
V.3	F.V. hekur betoni periodik Ø>10mm	ton	110,000	0.35	0	0	0	0.35	38,500
Totali									<b>109,015</b>

Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit.

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Zëri Gërmim dheu. Sipas situacionit përfundimtar+situacioni i fondit rezervë dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 23.019 m3, pas verifikimit në terren dhe auditimit të dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit u konstatua se hapja e gropës me dimensione 2.15x2.15x2.15 për materialin e pusit nuk është realizuar. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 9.94 m3 më pak se sasia e situacionuar, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri në 10 km. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 35 m3, pas verifikimit në terren dhe auditimit të

dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit u konstatua se ky zë pune është 17.6 m3, duke llogaritur volumin e materialit të dalë gjatë hapjes së pusit, përkatësisht  $3.14 \times 0.2 \times 0.2 \times 36 = 4.52$  m3 dhe volumi i zërit III.3 Gërmim dhe me krah si jepet në tabelën e mësipërme përkatësisht volumi 13,08 m3. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 17.4 m3 më pak se sasia e situacionuar, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri Mbushje me çakëll kanali dhe pusetat. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 14 m3, pas verifikimit në terren dhe auditimit të dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit u konstatua se hapja e gropës me dimensione 2.15x2.15x2.15 për materialin e pusit nuk është realizuar. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 9.25 m3 më pak se sasia e situacionuar, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri Shtresë betoni C12/15. Sipas situacionit përfundimtar + situacioni i fondit rezervë dhe librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 1.9 m3, pas verifikimit në terren dhe auditimit të dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit u konstatua se hapja e gropës me dimensione 2.15x2.15x2.15 për materialin e pusit nuk është realizuar. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 0.4 m3 më pak se sasia e situacionuar, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri F.V. hekur betoni periodik Ø>10mm. Sipas situacionit përfundimtar sasia e këtij zëri pune është 0.35 ton dhe në librezave të masave sasia e këtij zëri pune është 0 ton. Nga rillogaritja, sasia e këtij zëri pune është 0.35 ton më pak se sasia e situacionuar, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar më tepër vlera prej 109,015 lekë pa tvsh / 130,818 lekë me tvsh sipërmarrësit të punimeve për punime të pa kryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

**Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** ing. I.D. nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1. Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

*“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”*

2. Ligjin nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 7/1 ku përcaktohet se:

*“Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.*

3. Kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. 685/2 prot., datë 07.09.2021.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Zëri Gërmim dhe me krah. Vlera prej <b>9,940 lekë pa tvsh / 11,928 lekë me tvsh</b> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</li> <li>○ Zëri Transport materiale ndërtimi, dhe me auto deri në 10 km. Vlera prej <b>43,500 lekë pa tvsh / 52,200 lekë me tvsh</b> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</li> <li>○ Zëri Mbushje me çakëll kanali dhe pusetat. Vlera prej <b>13,875 lekë pa</b></li> </ul>

	<p><b>tvsh / 16,650 lekë me tvsh</b> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Zëri Shtresë betoni C12/15. Vlera prej <b>3,200 lekë pa tvsh / 3,840 lekë me tvsh</b> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</li> <li>○ Zëri F.V. hekur betoni periodik Ø&gt;10mm. Vlera prej <b>38,500 lekë pa tvsh / 46,200 lekë me tvsh</b> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Neni 7.  Ligji nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1.  Kontrata sipërmarrjes nr. 300/3, datë 05.05.2021.  Kontrata e Mbikëqyrjes me nr.685/2, datë 07.09.2021.  Librezat e masave, situacioni përfundimtar.</p>
<b>Ndikimi:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë prej <b>130,818 lekë me tvsh</b> në fondet e DSHTD.
<b>Shkaku</b>	Mungesë e kontrollit të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit të punimeve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej <b>130,818 lekë me tvsh</b> nga OE H., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 300/3, datë 05.05.2021, me objekt “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të DSHTD.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Procedura e prokurimit “Ambasada Bullgare Hapje Pusi uji +impiant klorifikimi”, me fond limit 1,359,912 lekë pa tvsh.**

*Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:*

- Sipas procesverbalin nr. 1 datë 23.01.2021, të mbajtur nga NJP, ka hartuar dhe argumentuar kriteret e veçanta sa i takon Kapacitetit teknik që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës dhe Kriteret e vlerësimit.

Inxhinier Shpimi, i cili lidhet me mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve në tërësi, objekt prokurimi, duke qenë edhe vetë objekti i prokurimit shpim pus.

- Sa i takon Automjetit vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton”, janë vlerësuar të nevojshëm për transportin e materialeve që dëlnin nga puna për shpimin e pusit dhe transportin e tyre në venddepozitimin e mbetjeve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Procedura e prokurimit “ Ambasada Bullgare Hapje Pusi uji +impiant klorifikimi”:**

*Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:*

- Në lidhje me observacionin e subjektit Inxhinieri i shpimit është një kriter diskriminues duke zvogëluar konkurrimin. Pasi punimet e shpimit të pusit sipas VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar, lidhja 4, Profili i diplomimit sipas kategorive studiues - projektues gjeologo-inxhinierik e kanë Gjeologji Inxhinierike/ Hidrogeologji / Gjeoteknikë, pra duhet të përfshiheshin profesionet sipas përcaktimeve ligjore që kryejnë shpimin e pusit.

Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë

nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

- Përsa i takon mjeteve referuar preventivit të punimeve nr. i automjeteve është i mbivlerësuar, pra kriteri jo në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**2. Procedura e prokurimit “Blerje kamionçine”, me fond limit 3,100,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2021, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2021.**

**B. Të dhëna mbi objektin**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje kamionçine”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozime” <b>REF-90087-03-16-2021</b> Urdhri nr. 102, datë 16.03.2021	<b>2. Grupi i hartimit kriterëve specifike</b> Urdhri nr. 33 datë 26.01.2021 <b>Hartimi i specifikimeve teknike:</b> E.Dh. M.M. A.S. <b>Përlllogaritja e fondit limit:</b> B.K. I.K. M.Gj.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 32, datë 26.01.2021 D.B. E.Dh. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr 103, datë 16.03.2021 G.V. E.J. M.K.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 3,100,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 3,050,000 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 50,000 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 23.03.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD		<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 3 <b>OE:</b> b) Skualifikuar: 1 OE A.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 10 ditë			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>		<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 284/3 prot., datë 24.05.2021	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit dhe është likuiduar OE.		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Me shkresën nr. 86 prot., datë 25.01.2021, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje malli me objekt “Blerje kamionçine”.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 32, datë 26.01.2021 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.Dh. dhe E.A.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 33, datë 26.01.2021 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike:	Përlllogaritja e fondit limit:
E.Dh.	B.K.
M.M.	I.K.
A.S.	M.Gj.

Me anë të shkresës nr. 86/7 prot., datë 16.03.2021, Kryetari i grupit për përlllogaritjen e fondit limit ka paraqitur relacionin mbi fondin limit për prokurimin me objekt “Blerje kamionçine”, ku është përcaktuar fondi limit prej 3,100,000 lekë pa TVSH.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 102, datë 16.03.2020 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e

prokurimit për blerje/ furnizim malli me objekt “Blerje kamionçine”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozime”, me fond limit 3,100,000 lekë pa TVSH.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 16.03.2021, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 103, datë 16.03.2021 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., E.J. dhe M.K.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 5, datë 29.03.2021 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 6, datë 29.03.2021 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura dhe me anë të procesverbalit nr. 7, datë 31.03.2021 dokumentoi shqyrtimin dhe vlerësimin e sa më sipër, nga ku rezultoi:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	A.	2,990,000	Jo	<ul style="list-style-type: none"> <li>OE nuk ka paraqitur licencë të vlefshme Kodi VII.3.b.2 të kategorisë “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor” nënkategoria “Shitblerje e mjeteve rrugore me motor dhe/ ose e rimorkiove të reja ose të përdorura”.</li> <li>Të dhënat teknike të mjetit janë të përkthyer, por jo të noterizuara.</li> </ul>
2	S.	3,050,000	Po	
3	L.	3,075,000	Po	

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE S. me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej 3,050,000 lekë pa tvsh ose 3,660,000 lekë me tvsh.

**-Lidhja e kontratës**

Midis AK DSHTD dhe OE S. është lidhur kontrata nr. 284/3 prot., datë 24.05.2021, për blerje kamionçine.

**-Zbatimi i kontratës.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 136, datë 25.05.2021 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim.

OE është likuiduar me anë të Urdhër transfertës së muajit qershor 2021 në vlerën **3,477,000 lekë** (pas zbritjes së garancisë 5% në vlerën 183,000 lekë, e cila nuk rezulton të jetë likuiduar deri në përfundim të periudhës së auditimit), bazuar në procesverbalin e datës 26.05.2021 dhe faturën elektronike nr. 17/2021 në vlerën 3,660,000 lekë.

**3. Procedura e prokurimit “Blerje Lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”, me fond limit 20,444,650 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2021, i detajuar, si më poshtë:**

- **6,981,100 lekë pa tvsh** për prokurimin e sasisë 70,000 litra për vitin 2021;
- **13,463,550 lekë pa tvsh** për prokurimin e sasisë 135,000 litra për vitin 2022.

**C. Të dhëna mbi objektin**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ <u>Blerje Lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës</u> ”			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur” <b>REF-87560-02-18-2021</b> Urdhri nr. 102, datë 16.03.2021	<b>2. Grupi i përlllogaritjes së fondit limit</b> Urdhri nr. 67 datë 10.02.2021 E.Dh. B.K. I.K.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 66, datë 10.02.2021 D.B. E.Dh. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 103, datë 16.03.2021 G.V. E.J. A.N.

<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 20,444,650 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> Marzh fitimi <b>34.78%</b>	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b>
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 22.02.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 <b>OE:</b> b) Skualifikuar: s'ka
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 21 muaj		
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>		
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 267/3 prot., datë 20.04.2021	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit dhe është likuiduar OE me 15 pagesa për vitet 2021 dhe 2022.	

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Me shkresën nr. 134 prot., datë 10.02.2021, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje malli me objekt “Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”. Në planin ekonomiko-financiar afatmesëm, të miratuar me VKD nr. 1, datë 06.01.2020, i ndryshuar, është përllogaritur nevoja për kaldajat 70,000 litra për periudhën maj-dhjetor 2021 dhe 135,000 litra për vitin 2022.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 66 datë 10.02.2021 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.Dh. dhe E.A.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 67, datë 10.02.2021 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Përllogaritja e fondit limit:

E.Dh.

B.K.

I.K.

Me anë të shkresës nr. 134/7 prot., datë 11.02.2021, Kryetari i grupit për përllogaritjen e fondit limit ka paraqitur relacionin mbi përllogaritjen e fondit limit mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”, ku është përcaktuar çmimi mesatar 99.73 lekë pa tvsh/ litër dhe fondi limit prej 20,444,650 lekë pa TVSH.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 70, datë 15.02.2021 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit për blerje/ furnizim malli me objekt “Blerje Lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”, lloji i procedurës “Procedurë e hapur”, me fond limit 20,444,650 lekë pa TVSH.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 18.02.2021, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

Me anë të procesverbalit nr. 2 të datës 18.02.2021, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 72, datë 15.02.2021 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., E.J. dhe A.N.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 5, datë 15.03.2021 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 6, datë 15.03.2021 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura dhe, me anë të procesverbalit nr. 7, datë 24.03.2021 dokumentoi shqyrtimin dhe vlerësimin e sa më sipër, nga ku rezultoi:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	T.	Marzh fitimi <b>34.78%</b>	Po	

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE T., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar,



me marzh fitimi 34.78%.

#### **-Lidhja e kontratës**

Midis AK dhe OE është lidhur marrëveshja kuadër nr. 267/3 prot., datë 20.04.2021, me kohëzgjatje 21 muaj.

#### **-Zbatimi i kontratës.**

##### **Për vitin 2021**

Me anë të ftesës për ofertë nr. 382/1 prot., datë 12.05.2021, Titullari i AK kërkon paraqitjen nga ana e OE të ofertës për kryerjen e furnizimit në sasinë 70000 litra.

Midis AK dhe OE lidhet kontrata nr. 382/3 prot., datë 18.05.2021, me kohëzgjatje deri më datë 31.12.2021, për sasinë e kërkuar 70000 litra.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 152, datë 01.07.2021 është krijuar Komisioni i Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, i përbërë nga B.K., K.Sh. dhe F.T.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 301, datë 09.12.2021 është krijuar Komisioni i Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, i përbërë nga B.K., K.Sh., V.Sh., M.K. dhe I.B.

Kontrata është zbatuar me 5 furnizime dhe likuiduar me 5 pagesa, si më poshtë:

- Fatura me nr. 974/2021 dt. 08.07.2021 për 14,000 litra në vlerën 1,909,684 lekë likuiduar me dt. 14.07.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbalin e pritjes së mallit i datës 08.07.2021;
  - Fatura e shitjes me nr. 974/2021 datë 08.07.2021, çmimi me TVSH 136.406 lekë/litër;
  - Certifikata e cilësisë e datës 05.06.2021, lëshuar nga "B.R.". Referuar ekstraktit historik në QKR, kjo shoqëri nuk e ka objekt veprimtarie kryerjen e analizave, si dhe nuk administrohet asnjë dokumentacion që të vërtetojë lidhjen e produktit të marrë në dorëzim me rezultat e këtyre analizave.
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.01, datë 08.07.2021;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura me nr. 1094/2021 dt. 10.09.2021 për 14,000 litra në vlerën 1,908,760 lekë likuiduar me dt. 10.09.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 10.09.2021;
  - Fatura e shitjes me nr. 1094/2021, datë 10.09.2021, çmimi me TVSH 136.342 lekë/litër;
  - Certifikata e cilësisë e datës 05.06.2021, lëshuar nga "B.R.". Referuar ekstraktit historik në QKR, kjo shoqëri nuk e ka objekt veprimtarie kryerjen e analizave, si dhe nuk administrohet asnjë dokumentacion që të vërtetojë lidhjen e produktit të marrë në dorëzim me rezultat e këtyre analizave.
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.02, datë 10.09.2021;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura me nr. 107/2021, dt. 11.11.2021 për 14,000 litra në vlerën 2,037,546 lekë likuiduar me dt. 18.11.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 11.11.2021;
  - Fatura e shitjes me nr. 107/2021, datë 11.11.2021, çmimi me TVSH 145.539 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.03, datë 11.11.2021;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura me nr. 267/2021 dt. 10.12.2021 për 14,000 litra në vlerën 2,021,726 lekë likuiduar me dt. 21.12.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 10.12.2021;
  - Fatura e shitjes nr. 267/2021, datë 10.12.2021, çmimi me TVSH 144.409 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës Nr.04, datë 10.12.2021;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura me nr. 307/2021 dt. 28.12.2021 për 14,000 litra në vlerën 1,939,042 lekë likuiduar me dt. 30.12.2021. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 28.12.2021;
  - Fatura e shitjes nr. 307/2021, datë 28.12.2021, çmimi me TVSH 138.503 lekë/litër;

- Fletëhyrja e magazinës nr. 05, datë 28.12.2021;
- Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.

Në të gjitha faturat nuk ka dokumentacion të verifikimit fizik të sasisë së lëndës djegëse të marrë në dorëzim, si dhe densiteti është marrë apriori në vlerat 0.97-0.975 g/ml, pa u mbështetur në analizat e nevojshme.

### **Për vitin 2022**

1. Me anë të ftesës për ofertë nr. 21/1 prot., datë 13.01.2022, Titullari i AK kërkon paraqitjen nga ana e OE të ofertës për kryerjen e furnizimit në sasinë 28000 litra.

Midis AK dhe OE lidhet kontrata nr. 21/3 prot., datë 14.01.2022, me kohëzgjatje deri më datë 28.02.2022, për sasinë e kërkuar 28000 litra.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 9, datë 14.01.2022 është krijuar Komisioni i Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, i përbërë nga B.K., K.Sh. dhe M.H.

Kontrata është zbatuar me 2 furnizime dhe likuiduar me 2 pagesa, si më poshtë:

- Fatura nr. 23/2022, dt. 17.01.2022 për 14,000 litra në vlerën 2,051,518 lekë, likuiduar me dt. 21.02.2022. Densiteti i lëndës djegëse është përlllogaritur 0.97 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 17.01.2022;
  - Fatura e shitjes me nr. 23/2022, datë 17.01.2022, çmimi me TVSH 146.537 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr.01, datë 17.01.2022;
  - Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura nr. 52/2022, dt. 03.02.2022 për 14,000 litra në vlerën 2,149,000 lekë likuiduar me dt. 04.03.2022. Densiteti i lëndës djegëse është përlllogaritur 0.97 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 03.02.2022;
  - Fatura e shitjes me nr. 52/2022, datë 03.02.2022, çmimi me TVSH 153.300 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr.02, datë 03.02.2022;
  - Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.

2. Me anë të ftesës për ofertë nr. 109/1 prot., datë 16.02.2022, Titullari i AK kërkon paraqitjen nga ana e OE të ofertës për kryerjen e furnizimit në sasinë 42000 litra.

Midis AK dhe OE lidhet kontrata nr. 109/3 prot., datë 18.02.2022, me kohëzgjatje deri më datë 20.06.2022, për sasinë e kërkuar 42000 litra.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 23, datë 18.02.2022 është krijuar Komisioni i Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, i përbërë nga B.K., K.Sh. dhe M.H.

Kontrata është zbatuar me 3 furnizime dhe likuiduar me 3 pagesa, si më poshtë:

- Fatura me nr. 91/2022, dt. 21.02.2022 për 14,000 litra në vlerën 2,157,820 lekë likuiduar me dt. 07.03.2022. Densiteti i lëndës djegëse është përlllogaritur 0.97 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 21.02.2022;
  - Fatura e shitjes me nr. 91/2022, datë 21.02.2022, çmimi me TVSH 154.130 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr.03, datë 21.02.2022;
  - Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura nr. 134/2022, dt. 08.03.2022, për 14,000 litra në vlerën 2,386,076 lekë, likuiduar me dt. 11.03.2022. Densiteti i lëndës djegëse është përlllogaritur 0.97 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 08.03.2022;
  - Fatura e shitjes nr. 134/2022, datë 08.03.2022, çmimi me TVSH 170.434 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr.04, datë 08.03.2022;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura nr. 44/2022, dt. 08.03.2022, për 14,000 litra në vlerën 2,303,560 lekë, likuiduar me dt. 21.04.2022. Densiteti i lëndës djegëse është përlllogaritur 0.97 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 11.04.2022;
  - Fatura e shitjes nr. 44/2022, datë 08.03.2022, çmimi me TVSH 164.537 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr.05, datë 11.04.2022;

- Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
- Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.

3.Me anë të ftesës për ofertë nr. 651/1 prot., datë 20.07.2022, Titullari i AK kërkon paraqitjen nga ana e OE të ofertës për kryerjen e furnizimit në sasinë 56000 litra.

Midis AK dhe OE lidhet kontrata nr. 651/3 prot., datë 22.07.2022, me kohëzgjatje deri më datë 10.12.2022, për sasinë e kërkuar 56,000 litra.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 253, datë 22.07.2022 është caktuar E.Dh. përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e kontratës.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 254, datë 22.07.2022 është krijuar Komisioni i Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, i përbërë nga B.K., K.Sh. dhe M.H.

Kontrata është zbatuar me 4 furnizime dhe likuiduar me 4 pagesa, si më poshtë:

- Fatura nr. 195/2022, dt. 26.07.2022, për 14,000 litra në vlerën 2,224,950 lekë, likuiduar me dt. 25.08.2022. Densiteti i lëndës djegëse është përlllogaritur 0.97 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 26.07.2022;
  - Fatura e shitjes nr. 195/2022, datë 26.07.2022, çmimi me TVSH 158.925 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr.05, datë 11.04.2022;
  - Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura nr. 304/2022 dt. 17.10.2022 për 14,000 litra në vlerën 2,468,788 lekë likuiduar me dt. 26.10.2022. Densiteti i lëndës djegëse është 0.97 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 17.10.2022;
  - Fatura e shitjes nr. 304/2022, datë 17.10.2022, çmimi me TVSH 176.342 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr. 10, datë 17.10.2022;
  - Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse;
- Fatura nr. 383/2022 dt. 02.12.2022 për 14,000 litra në vlerën 2,168,152 lekë likuiduar me dt. 09.12.2022. Densiteti i lëndës djegëse është 0.9595 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 02.12.2022;
  - Fatura e shitjes nr. 383/2022, datë 02.12.2022, çmimi me TVSH 154.868 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr. 13, datë 02.12.2022;
  - Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.
- Fatura me nr. 414/2022 dt. 19.12.2022 për 14,000 litra në vlerën 2,074,380 lekë likuiduar me dt. 30.12.2022. Densiteti i lëndës djegëse është 0.9559 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 19.12.2022;
  - Fatura e shitjes nr. 414/2022 dt. 19.12.2022, çmimi me TVSH 148.170 lekë/litër;
  - Fletëhyrja e magazinës nr. 14, datë 19.12.2022;
  - Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
  - Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.

4. Me anë të ftesës për ofertë nr. 1269/1 prot., datë 22.12.2022, Titullari i AK kërkon paraqitjen nga ana e OE të ofertës për kryerjen e furnizimit në sasinë 9000 litra.

Midis AK dhe OE lidhet kontrata nr. 1269/3 prot., datë 23.12.2022, me kohëzgjatje deri më datë 31.12.2022, për sasinë e kërkuar 9000 litra.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 456, datë 23.12.2022 është caktuar E.Dh. përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e kontratës.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 457, datë 27.12.2022 është krijuar Komisioni i Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, i përbërë nga B.K., K.Sh., V.Sh., M.K. dhe I.B.

Kontrata është zbatuar me 1 furnizim dhe likuiduar me 1 pagesë, si më poshtë:

- Fatura me nr. 439/2022 dt. 28.12.2022 për 9,000 litra në vlerën 1,376,136 lekë likuiduar me dt. 30.12.2022. Densiteti i lëndës djegëse është 0.9559 g/ml. Likuidimi u krye bazuar në:
  - Procesverbali i pritjes së mallit i datës 28.12.2022;
  - Fatura e shitjes nr. 439/2022, datë 28.12.2022, çmimi me TVSH 152.904 lekë/litër;

- Fletëhyrja e magazinës nr. 15, datë 28.12.2022;
- Tabelën me përlllogaritjen e çmimit të lëndës djegëse;
- Pasaporta e automjetit me të cilën u krye furnizimi me lëndë djegëse.

Nr.	Kontrata	Sasia (litra)	Çmimi (/litër)	Fatura	Likuidimi	Vlera (lekë me tvsh)
<b>Viti 2021</b>						
1.	382/3 prot., datë 18.05.2021	14000	<b>136.406</b>	974/2021 dt. 08.07.2021	14.07.2021	<b>1,909,684</b>
2.		14000	<b>136.342</b>	1094/2021 dt. 10.09.2021	10.09.2021	<b>1,908,760</b>
3.		14000	<b>145.539</b>	107/2021, dt. 11.11.2021	18.11.2021	<b>2,037,546</b>
4.		14000	<b>144.409</b>	267/2021 dt. 10.12.2021	21.12.2021	<b>2,021,726</b>
5.		14000	<b>138.503</b>	307/2021 dt. 28.12.2021	30.12.2021	<b>1,939,042</b>
	<b>Totali 2021</b>	<b>70,000</b>				<b>9,816,758</b>
<b>Viti 2022</b>						
1.	21/3 prot., datë 14.01.2022	14000	<b>146.537</b>	23/2022, dt. 17.01.2022	21.02.2022	<b>2,051,518</b>
2.		14000	<b>153.300</b>	52/2022, dt. 03.02.2022	04.03.2022	<b>2,149,000</b>
3.	109/3 prot., datë 18.02.2022	14000	<b>154.130</b>	91/2022, dt. 21.02.2022	07.03.2022	<b>2,157,820</b>
4.		14000	<b>170.434</b>	134/2022, dt. 08.03.2022	11.03.2022	<b>2,386,076</b>
5.		14000	<b>164.537</b>	44/2022, dt. 08.03.2022	21.04.2022	<b>2,303,560</b>
6.	651/3 prot., datë 22.07.2022	14000	<b>158.925</b>	195/2022, dt. 26.07.2022	25.08.2022	<b>2,224,950</b>
7.		14000	<b>176.342</b>	304/2022 dt. 17.10.2022	26.10.2022	<b>2,468,788</b>
8.		14000	<b>154.868</b>	383/2022 dt. 02.12.2022	09.12.2022	<b>2,168,152</b>
9.		14000	<b>148.170</b>	414/2022 dt. 19.12.2022	30.12.2022	<b>2,074,380</b>
10.	1269/3prot., datë 23.12.2022	9000	<b>152.904</b>	439/2022 dt. 28.12.2022	30.12.2022	<b>1,376,136</b>
	<b>Totali 2022</b>	<b>135,000</b>				<b>21,360,380</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>205,000</b>				<b>31,177,138</b>

- Për përlllogaritjen e çmimit për litër, është përdorur formula, si më poshtë:

$$\text{Çmimi paraprak i konvertuar në lekë} = \frac{(\text{Cif} \cdot \text{kursi } \$/\text{lek}^5) \cdot \text{densiteti}}{1000}$$

Për të nxjerrë *çmimin përfundimtar për litër*, çmimit paraprak të konvertuar i shtohen taksat (akciza, taksa e karbonit dhe markimi) e, mbi totalin përlllogaritjet dhe shtohet marzhi i fitimit prej 34.78%, nga oferta fituese e OE.

Vetëm në 3 faturat e fundit të likuiduara, OE ka paraqitur një certifikatë cilësie (në gjuhë të huaj) ku përcaktohet *densiteti* në vlerën 0.9559 g/ml. Në të gjitha faturat e tjera të likuiduara, densiteti është marrë apriori në vlerën 0.97-0.975 g/ml, pa analizat e nevojshme për përcaktimin e tij, çka ka ndikuar në përlllogaritjen e çmimit për litër.

- Për verifikimin e sasisë së marrë në dorëzim, Komisioni i Marrjes në Dorëzim bazohet te kapaciteti i automjetit transportues, i cili ka një vëllim të përgjithshëm të botit prej 14,000 litra, referuar pasaportës së automjetit. Kjo mënyrë përlllogaritje nuk ofron garanci për verifikimin fizik të sasisë. Referuar pikës 44.a të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, kur sasia e aktivitet matet me anë të peshimit, verifikimi i sasisë bëhet duke zbritur nga pesha bruto peshën e ambalazhit, ose duke peshuar vlerat materiale që gjenden brenda ambalazhit, sipas natyrës së tij. Sa më sipër, mënyra e saktë për të kryer verifikimin fizik të sasisë, në pamundësi për të peshuar vetë lëndën djegëse, do të ishte duke kryer peshimin e automjetit para dhe pas furnizimit, në prani të (një anëtar nga) Komisionit të Marrjes në Dorëzim, në mënyrë që të nxirret diferenca dhe të përcaktohet sasia faktike e lëndës djegëse të marrë në dorëzim.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mangësi në verifikimin e produktit final të dorëzuar në objektin “Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”
<b>Situata:</b>	- Për përlllogaritjen e çmimit për litër, është përdorur formula, si më poshtë:

<sup>4</sup> Cif – Çmimi Reuters i publikuar + 30\$/ton

<sup>5</sup> Kursi \$/lek – Kursi i këmbimit i publikuar nga BSH

	<p>Çmimi paraprak i konvertuar në lekë = ((Cif * kursi \$/lek ) * densiteti)/1000</p> <p>Për të nxjerrë çmimin përfundimtar për litër, çmimit paraprak të konvertuar i shtohen taksat (akciza, taksa e karbonit dhe markimi) e, mbi totalin përlllogaritjet dhe shtohet marzhi i fitimit prej 34.78%, nga oferta fituese e OE.</p> <p>Vetëm në 3 faturat e fundit të likuiduara, OE ka paraqitur një certifikatë cilësie (në gjuhë të huaj) ku përcaktohet densiteti në vlerën 0.9559 g/ml. Në të gjitha faturat e tjera të likuiduara, densiteti është marrë apriori në vlerën 0.97-0.975 g/ml, pa analizat e nevojshme për përcaktimin e tij, çka ka ndikuar në përlllogaritjen e çmimit për litër.</p> <p>- Për verifikimin e sasisë së marrë në dorëzim, Komisioni i Marrjes në Dorëzim bazohet te kapaciteti i automjetit transportues, i cili ka një vëllim të përgjithshëm të botit prej 14,000 litra, referuar pasaportës së automjetit. Kjo mënyrë përlllogaritje nuk ofron garanci për verifikimin fizik të sasisë.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011
<b>Ndikimi:</b>	Mënyra e përlllogaritjes së densitetit dhe të sasisë së marrë në dorëzim nuk jep garanci minimale mbi saktësinë e matjes, çka ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në vlerën totale të paguar për marrjen e këtij malli.
<b>Shkaku</b>	Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ushtron mekanizmat e nevojshëm të kontrollit mbi mallin e marrë në dorëzim.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Komisioni i marrjes në dorëzim të lëndës djegëse të kryejë likuidimet e faturave të lëndës djegëse duke administruar dokumentacion vërtetues, ndër të tjera, mbi (i) sasinë faktike të lëndës djegëse të marrë në dorëzim dhe (ii) densitetin e lëndës, me qëllim dokumentimin e saktë të përlllogaritjes së vlerës së likuiduar.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim.*

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Procedura e prokurimit “Blerje lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1 % ndaj peshës”, me fond limit 20,444,650 lekë pa tvsh.**

**Konstatimet lidhur me zbatimin e kontratës:**

- Lidhur me certifikata e cilësisë, lëshuar nga “B.R.”, sqarojmë se këto certifikata janë lëshuar nga kompania e mësipërme si kompani prodhuese pasi nga kjo kompani është marrë lëndë djegëse dhe kanë për qëllim jo vërtetimin e cilësisë së produktit pasi cilësinë e ka vërtetuar ISHTI me raportin e testimit, por vetëm për efekt të përcaktimit të densitetit pasi këtë tregues nuk arrin ta analizojë ISHTI.

- Komisioni nuk mund të marrë në dorëzim lëndën djegëse me peshë pasi në kontratë njësia e matjes është e përcaktuar në litra, pasaporta e automjetit volumin e ka të përcaktuar në litra dhe komisioni e ka lehtësisht të verifikueshme marrjen në dorëzim të sasisë së mallit. Edhe depozitat e lëndëve djegëse të vendosura në kaldajat e montuara në pallatin nr.6 dhe nr.8 janë të kalibruara në litra.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Procedura e prokurimit “ Blerje lëndë djegëse me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1 % ndaj peshës”:**

**Konstatimet lidhur me zbatimin e kontratës:**

- Kompania B.R., referuar ekstraktit historik në QKR, kjo shoqëri nuk e ka objekt veprimtarie kryerjen e analizave, si dhe nuk administrohet asnjë dokumentacion që të vërtetojë lidhjen e

produktit të marrë në dorëzim me rezultat e këtyre analizave. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

- Lidhur me verifikimin e sasisë së marrë në dorëzim, pretendimet e subjektit nuk bazohen në ligj, si dhe nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**4. Procedura e prokurimit “Materiale ndërtimi Inerte”, me fond limit 2,927,473 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2021, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2021.**

***D. Të dhëna mbi objektin***

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Materiale ndërtimi Inerte”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozime” <b>REF-86953-02-12-2021</b> Urdhri nr. 102, datë 16.03.2021	<b>2. Grupi i hartimit kritereve specifike</b> Urdhri nr. 35 datë 26.01.2021 <b>Hartimi i specifikimeve teknike:</b> D.H. K.T. E.D. <b>Përlogaritja e fondit limit:</b> B.K. V.Sh. I.K.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 34, datë 26.01.2021 D.B. D.H. E.A.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr 103, datë 16.03.2021 G.V. E.J. M.K.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,927,473 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 2,817,533 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 109,940 lekë	
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 22.02.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE: b) Skualifikuar: s’ka	
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 12 muaj	<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 195/3 prot., datë 19.03.2021	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit dhe është likuiduar OE.		

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kritereve të DST.***

Me shkresën nr. 87 prot., datë 25.01.2021, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje malli me objekt “Materiale ndërtimi Inerte”.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 3234 datë 26.01.2021 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., D.H. dhe E.A.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 33, datë 26.01.2021 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike:	Përlogaritja e fondit limit:
D.H.	B.K.
K.T.	V.Sh.
E.D.	I.K.

Me anë të shkresës nr. 87/3 prot., datë 16.03.2021, Kryetari i grupit për hartimin e kritereve të veçanta ka paraqitur relacionin mbi përcaktimin e kritereve dhe, me anë të shkresës nr. 87/7 prot., datë 03.02.2021, Kryetari i grupit të punës për përlogaritjen e fondit limit ka paraqitur relacionin mbi përlogaritjen e fondit limit mbi procedurën e prokurimit me objekt “Materiale ndërtimi Inerte”, duke u bazuar në çmimin e tregut, pra 3 oferta të subjekteve privatë, ku është përcaktuar fondi limit

prej 2,927,473 lekë pa TVSH.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 54, datë 03.02.2021 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit për blerje/ furnizim malli me objekt “Materiale ndërtimi Inerte”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozime”, me fond limit 2,927,473 lekë pa TVSH.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 11.02.2021, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 55, datë 03.02.2021 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., E.K. dhe M.Gj.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 5, datë 25.02.2021 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 6, datë 25.02.2021 dokumentoi administrimin e mostrave të mallrave, me anë të procesverbalit nr. 7, datë 25.02.2021 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura dhe me anë të procesverbalit nr. 8, datë 25.02.2021 dokumentoi shqyrtimin dhe vlerësimin e sa më sipër, nga ku rezultoi:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	G.H.	2,817,533	Po	

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE G.H., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej 2,817,533 lekë pa tvsh ose 3,381,040 lekë me tvsh.

**-Lidhja e kontratës**

Midis AK DSHTD dhe OE G.H. është lidhur marrëveshja kuadër nr. 195/3 prot., datë 19.03.2021, me kohëzgjatje 12 muaj.

**-Zbatimi i kontratës.**

Nëpërmjet ftesës për ofertë nr. 270/1 prot., datë 06.04.2021, AK kërkon kryerjen e një furnizimi nga ana e OE. Midis AK dhe OE është lidhur minikontrata nr. 270/3 prot., datë 07.04.2021 me vlerë 2,560,490 lekë pa tvsh ose 3,072,588 lekë me tvsh.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 119, datë 14.04.2021 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim.

OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër transfertës së muajit prill 2021 në vlerën 3,072,588 lekë, bazuar në procesverbalin e datës 14.04.2021 dhe faturën elektronike nr. 7/2021 të paraqitur nga OE. Nëpërmjet ftesës për ofertë nr. 252/1 prot., datë 17.03.2022, AK kërkon kryerjen e një furnizimi nga ana e OE. Midis AK dhe OE është lidhur minikontrata nr. 252/3 prot., datë 18.03.2021 me vlerë 226,343 lekë pa tvsh ose 271,612 lekë me tvsh.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 106 datë 25.03.2022 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim.

OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër transfertës së muajit prill 2022 në vlerën 271,611 lekë, bazuar në procesverbalin e datës 24.03.2021 dhe faturën elektronike nr. 14/2022 të paraqitur nga OE.

**5. Procedura e prokurimit “Pllaka të ndryshme”, me fond limit 2,677,694 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2021, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2021.**

**E. Të dhëna mbi objektin**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Pllaka të ndryshme”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozime” <b>REF-86008-02-04-2021</b> Urdhri nr. 56, datë 03.02.2021	2. Grupi i hartimit kriterëve specifike Urdhri nr. 27 datë 22.01.2021 Hartimi i specifikimeve teknike: E.K. A.B. E.D. Përlllogaritja e fondit	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 26, datë 22.01.2021 D.B. E.K. E.A.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr 57, datë 03.02.2021 G.V. D.H. M.K.

	<b>limit:</b> B.K. V.B. I.K.		
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,677,694 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 1,603,450 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 1,074,244 lekë	
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 08.02.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE: <b>V.</b> <b>D.</b> b) Skualifikuar: s'ka	
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 12 muaj			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata marrëveshje kuadër me nr. 177/3 prot., datë 09.03.2021	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit dhe është likuiduar OE.		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Me shkresën nr. 76 prot., datë 22.01.2021, Sektori i Planifikimit dhe Financës i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve kërkesën për blerje malli me objekt “Pllaka të ndryshme”. Në shkresë citohet se “Mallrat do të prokurohen për punimet e mirëmbajtjes dhe investimet e apartamenteve në pallatet 4, 6, 8 në rr. Skënderbej dhe pallatin 57 në Blv. Zogu i I, në varësi të kërkesave të diplomatëve dhe planit ekonomik-financiar të vitit 2021”.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 26, datë 22.01.2021 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.K. dhe E.A.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 27, datë 22.01.2021 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike:

E.K.  
A.B.  
E.D.

Përllogaritja e fondit limit:

B.K.  
V.B.  
I.K.

Me anë të shkresës nr. 76/7 prot., datë 29.02.2021, Kryetari i grupit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit ka paraqitur relacionin mbi specifikimet teknike dhe fondin limit për prokurimin me objekt “Pllaka të ndryshme”, ku është përcaktuar fondi limit prej 2,677,694 lekë pa TVSH.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 56, datë 03.02.2020 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit për blerje/ furnizim malli me objekt “Pllaka të ndryshme”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozime”, me fond limit 2,677,694 lekë pa TVSH.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 03.02.2021, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 57, datë 03.02.2021 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga G.V., D.H. dhe M.K.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 5, datë 15.02.2021 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 6, datë 15.02.2021 dokumentoi administrimin e mostrave, me anë të procesverbalit nr. 7, datë 15.02.2021 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura dhe me anë të procesverbalit nr. 8, datë 18.02.2021 dokumentoi shqyrtimin dhe vlerësimin e sa më sipër, nga ku rezultoi:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	V.	1,603,450	Po	
2	D.	1,740,000	Po	



Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE V., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej 1,603,450 lekë pa tvsh ose 1,924,140 lekë me tvsh.

**-Lidhja e kontratës**

Midis AK DSHTD dhe OE V. është lidhur marrëveshja kuadër nr. 177/3 prot., datë 09.03.2021, me kohëzgjatje 12 muaj.

**-Zbatimi i kontratës.**

Nëpërmjet ftesës për ofertë nr. 216/1 prot., datë 16.03.2021, AK kërkon kryerjen e një furnizimi nga ana e OE. Midis AK dhe OE është lidhur minikontrata nr. 216/3 prot., datë 19.03.2021 me vlerë 1,256,950 lekë pa tvsh ose 1,508,340 lekë me tvsh.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 110, datë 23.03.2021 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim.

OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër transfertës së muajit mars 2021 në vlerën 1,508,340 lekë, bazuar në procesverbalin e datës 24.03.2021 dhe faturën elektronike nr. 5/2021 të paraqitur nga OE. Nëpërmjet ftesës për ofertë nr. 740/1 prot., datë 14.09.2021, AK kërkon kryerjen e një furnizimi nga ana e OE. Midis AK dhe OE është lidhur minikontrata nr. 740/3 prot., datë 23.09.2021 me vlerë 346,500 lekë pa tvsh ose 415,800 lekë me tvsh.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 239, datë 23.09.2021 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim.

OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër transfertës së muajit tetor 2021 në vlerën 415,800 lekë, bazuar në procesverbalin e datës 30.09.2021 dhe faturën elektronike nr. 43/2021 të paraqitur nga OE.

**III. Për vitin 2022, grupi i auditimit ka përzgjedhur procedurat e prokurimit, si më poshtë:**

Nr.	Objekti	Fondi limit	Lloji i procedurës	Vlera e kontratës
1.	Furnizim/ vendosje dyer të brendshme	1,294,535	Procedurë e hapur	682,000
2.	Pllaka të ndryshme	1,737,896	Procedurë e hapur	1.291,130
3.	Shërbim mirëmbajtje ashensori	1,631,330	Procedurë e hapur	928,578

**1. Procedura e prokurimit “Dyer të brendshme”, me fond limit 1,265,333 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2022, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2022, me fond 1,294,535 lekë pa TVSH.**

**A. Të dhëna mbi objektin**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Dyer të brendshme”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur e thjeshtuar” (marrëveshje kuadër) <b>REF-40771-09-06-2022</b> Urdhri nr. 305, datë 01.09.2022	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 292, datë 22.08.2022 A.D. Sh.I. A.C.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 291, datë 22.08.2022 D.B. E.I. E.Ç.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 306, datë 01.09.2022 S.H. G.V. I.B.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 1,265,333 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 1,252,000 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 13,333 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 12.09.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD		<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>2 OE;</b> b) Skualifikuar 1 OE: K. c) Kualifikuar 1 OE D.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 12 muaj			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Marrëveshja kuadër me nr.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrit nr. 337, datë 26.10.2022 është caktuar Sh.I. si person përgjegjës për		

794/5 prot., datë 17.10.2022, Kontrata me nr. 996/3 prot., datë 25.10.2022	ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratave. - Me Urdhrin nr. 378, datë 26.10.2022 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit. - Është likuiduar vlera prej <b>818,400 lekë me tvsh.</b>
--	--

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.***

Me shkresën nr. 749 prot., datë 22.08.2022, Drejtoria e Projektimit, Zbatimit dhe Monitorimit i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve dhe Përgjegjësit të Sektorit të Planifikimit Financiar, kërkesën për blerje malli me objekt “Dyer të brendshme”. Në shkresë citohet se “*Sektori i Projektimit, Zbatimit e Monitorimit parashtron kërkesën për blerjen e mallrave me objekt Dyer të brendshme, përkatësisht 39 copë dyer të brendshme me kasë 1 kanatesh, dhe 1 copë dyer të brendshme me kasë 2 kanatesh*”.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 291, datë 22.08.2022 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.I. dhe E.Ç.

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 292, datë 22.08.2022 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

**Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:**

A.D.

Sh.I.

A.C.

Në procesverbalin e datës 25.08.2022, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, si dhe sasitë që do të prokurohen, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Nj/ matëse	OE-N	OE- K.H	OE-P.	Sasia	Çmimi mesatar për njësi	Vlera (lekë pa tvsh)
1	Dyer të brendshme me kasë 1 kanatesh	Copë	30,000	32,000	31,000	39	31,000	1,209,000
2	Dyer të brendshme me kasë 2 kanatesh	Copë	57,000	52,000	60,000	1	56,333	56,333
<b>Totali</b>						<b>40</b>	<b>Fondi limit</b>	<b>1,265,333</b>

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 305, datë 01.09.2022 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit për blerje e mallrave në formën e marrëveshjes kuadër me objekt “Dyer të brendshme”, lloji i procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fond limit 1,265,333 lekë pa tvsh.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 05.09.2022, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

Dhe me anë të procesverbalit nr. 3 të datës 06.09.2022, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit.

**Gjetje:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nga grupi, kanë disa parregullsi si mëposhtë:

Sa i përket aftësisë teknike e profesionale, AK kërkon:

- OE ofertues duhet të disponojë të paktën një mjet në pronësi apo të marrë me qira me kontratë noteriale për transportin e mallrave.

Njësia e prokurimit argumenton nevojën e këtij kriteri për të garantuar se AK do të kryejë furnizimin / vendosjen e mallrave në kohën e kërkuar dhe sipas kushteve të kontratës, pa shkakuar vonesa. Grupi i auditimit gjykon se, në këtë rast, duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, e jo punë/ shërbim, në të cilat automjeti do të ishte i nevojshëm në çdo kohë, njësia e prokurimit nuk duhej të kufizonte vetëm këto dy mundësi për OE, por duhet të mjaftohej duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave. Kjo pasi, OE mund të zgjidhte nën kontraktimin për të kryer

transportin e mallrave, pa qenë i detyruar të hyjë paraprakisht në marrëdhënie kontraktuale qiramarrje, në rast se nuk do të shpallej fitues. Sa më sipër, grupi i auditimit gjykon se ky kriter nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasën e kontratës që do të prokurohet.

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 306, datë 01.09.2022 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga S.H., G.V. dhe I.B.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 6, datë 19.09.2022 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 7, datë 19.09.2022 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura, me anë të procesverbalit nr. 8, date 19.09.2022 dokumentoi administrimin e mostrave dhe me anë të procesverbalit nr. 9, datë 26.09.2022 shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentacionin dhe ofertat e paraqitura, nga ku rezultoi, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	K.	0	Jo	Nuk është paraqitur ofertë ekonomike
2	D.	1,252,000	Po	

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE D., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej **1,252,000 lekë pa tvsh** ose **1,502,400 lekë me tvsh**.

**Gjetje:** Nga auditimi i realizimit të procedurës në sistemin elektronik të APP sipas vlerësimit të KVO, konstatohet se:

- KVO ka kualifikuar OE, i cili nuk ka dorëzuar dokumentacionin për një inxhinier përpunim druri/inxhinier pyjesh. Ky vlerësim është në kundërshtim me pikën 2.3.4 Kapaciteti teknik, ku citohet: "...2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës: 1 (një) inxhinier përpunim druri/inxhinier pyjesh, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës dhe diplomë përkatëse...".

Sa i përket dokumentacionit mbi punonjësit marangozë, referuar listë pagesave të vëna në dispozicion nga OE, është lehtësisht e verifikueshme që, në organikën e shoqërisë nuk bëjnë pjesë asnjë marangozë në çdo muaj, referuar Kodit 7115.14 "Marangoz", sipas VKM nr. 514, datë 20.09.2017 "Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar". OE fitues ka paraqitur kontratat e punës për 2 marangoz dhe 2 montator, si më poshtë:

KQ, në muajin gusht 2022 figuron në listë pagesë si ndihmës në kuzhinë me kodin 9412.02. Certifikimi i paraqitur figuron nga subjekti certifikues "H.", i cili certifikon punonjësit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

EH, në muajin gusht 2022 figuron në listë pagesë si ndihmës në kuzhinë me kodin 9412.02. Certifikimi i paraqitur figuron nga subjekti certifikues "H.", i cili certifikon punonjësit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

EB, në muajin gusht 2022 figuron në listë pagesë si ndihmës në kuzhinë me kodin 9412.02.

OL, në muajin gusht 2022 figuron në listë pagesë si shofer me kodin 8322.01.

- KVO ka kualifikuar OE, i cili si punë të ngjashme ka dorëzuar Rikonstruksionin e një shkolle të mesme, por referuar kontratës së bashkimit të përkohshëm të shoqërive për punën e dorëzuar OE nuk i ka kryer ai punimet për dyer dritare.

- KVO ka kualifikuar OE, i cili nuk plotësuar kriterin 2.3.6 të DST, nuk ka dorëzuar dokumentin e titulluar Ofertë Teknike.

***-Lidhja e kontratës***

Midis AK DSHTD dhe OE D. është lidhur marrëveshja kuadër me nr.794/5 prot., datë 17.10.2022, me kohëzgjatje 12 muaj, me vlerë kontrate 1,252,000 lekë pa tvsh/1,502,400 lekë me tvsh.

Midis AK DSHTD dhe OE D. është lidhur kontrata me nr.996/3 prot., datë 25.10.2022, me kohëzgjatje 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës, me vlerë kontrate 682,000 lekë pa tvsh/818,400 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 81,840 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

**-Zbatimi i kontratës.**

Sektori i Zbatimit në DSHTD më shkresën nr.996 prot., datë 21.10.2022 i ka kërkuar titullarit kërkesën për furnizimin me 22 dyer të brendshme me kasë 1 kanatesh.

DSHTD i ka dërguar me shkresën nr.996/1 prot., datë 24.10.2022, ftesën për ofertë për furnizimin dhe vendosjen e 22 dyer të brendshme në pronat nën administrimin e DSHTD-së në rr. Skënderbej.

Me Urdhrin nr. 377, datë 26.10.2022, urdhërohet Sh.I., përgjegjës i Sektorit të Projektim Monitorimit në DSHTD, si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e kontratës. Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 378, datë 26.10.2022 është krijuar komisioni për pritjen dhe marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga E.I., A.C. dhe M.H. Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 18.11.2022, ku shprehet se ka marrë në dorëzim mallin sipas sasisë, cilësisë dhe llojit të parashikuar në DST, të cilët janë vendosur në apartamentin 5/pallati 6 dhe apartamentet 26,39,40 / pallati 8.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 22.12.2022 është kryer likuidimi i vlerës 818,400 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 488/2022, datë 18.11.2022 me vlerë 818,400 lekë me tvsh.

Mungon njoftimi i dorëzimit të mallit në kundërshtim me pikën e të nenit 4 të KVK, *Dorëzimi ku citohet: Furnizuesi do të njoftojë Blerësin një ditë para dorëzimit të mallrave.*

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Procedura e prokurimit “ Dyer të brendshme”, me fond limit 1,265,333 lekë pa tvsh**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

- Vendosja e kriterit për automjetin është në përpjesëtim dhe lidhet ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës nga OE, si dhe duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë e klientëve të DSHTD (diplomatë), ekzekutimi në kohë dhe pa vonesa i punimeve është shumë i rëndësishëm për DSHTD, si dhe realizimin me sukses të objektit të veprimtarisë së saj.

Konstatimet lidhur me realizimit e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:

- KVO i ka vlerësuar mangësitë si devijime të vogla, të cilat nuk çenojnë ekzekutimin e kontratës.

Konstatimet lidhur me zbatimin e kontratës:

- Subjekti ka sjellë korrespondencën elektronike me OE.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**1. Procedura e prokurimit “Dyer të brendshme”:**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

- Vendosja e kriterit për automjetin vetëm për siguri të AK për realizimin me sukses të kontratës e cila është detyrim kontraktual i OE, nuk qëndron. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Konstatimet lidhur me realizimit e procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues:

- Në proces verbalin e mbajtur nga KVO nuk është evidentuar si devijim i vogël. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Konstatimet lidhur me zbatimin e kontratës:

- Njoftimet nuk janë sipas përcaktimeve të kontratës. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**2. Procedura e prokurimit “Pllaka të ndryshme”, me fond limit 1,737,896 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2022, i parashikuar**

në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2022, me fond 1,757,096 lekë pa TVSH.

**B. Të dhëna mbi objektin**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Pllaka të ndryshme”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur e thjeshtuar” (marrëveshje kuadër) <b>REF-35914-07-08-2022</b> Urdhri nr. 179, datë 31.05.2022	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 144, datë 04.05.2022 D.H. E.I. B.K.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr.143, datë 04.05.2022 / nr.227, datë 08.07.2022 D.B. E.I. E.Ç.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 180, datë 31.05.2022 S.H. G.V. I.B.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 1,737,896 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 1,587,890 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 150,006 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 18.07.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD		<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>4 OE;</b> b) Skualifikuar 2 OE: A.K. V. c) Kualifikuar 2 OE G.H. D.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 12 muaj			
<b>12. Ankimim</b> Jo	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b>		<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Marrëveshja kuadër me nr. 487/5 prot., datë 12.08.2022, Kontrata me nr. 790/3 prot., datë 12.09.2022	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrin nr. 317, datë 12.09.2022 është caktuar E.I. si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratave. - Me Urdhrin nr. 318, datë 12.09.2022 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit. - Është likuiduar vlera prej <b>1,549,356 lekë me tvsh.</b>		

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Me shkresën nr. 385 prot., datë 27.04.2022, Drejtorja e Projektimit, Zbatimit dhe Monitorimit i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Drejtorisë Juridike dhe të Prokurimeve, kërkesën për blerje malli me objekt “Pllaka të ndryshme”. Në shkresë citohet se “*Spektori i Zbatimit pranë Drejtorisë së Projektimit, Zbatimit e Monitorimit parashtron kërkesën për blerjen e mallrave me objekt Pllaka të ndryshme, përkatësisht 268 m2 pllaka shtimi porcelanat, 50 m2 pllaka shtrimi wc, 268 m2 pllaka veshje wc, 19 m2 pllaka veshje kuzhine, 12 m2 mozaik për pllaka dushi*”.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 143, datë 04.05.2022 është ngritur njësi e prokurimit, e përbërë nga D.B., D.H. dhe E.Ç.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 144, datë 04.05.2022 janë ngritur grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, si më poshtë:

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

D.H.

E.I.

B.K.

Në procesverbalin e datës 16.05.2022, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, si dhe sasi të që do të prokurohen, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Nj/matëse	OE-E	OE-B	OE-H	Sasia	Çmimi mesatar për njësi	Vlera (lekë pa tvsh)
1	Pllaka shtimi porcelanat	m2	2,500	2,700	2,600	268	2,600	696,800

2	Pllaka shtrimi wc	m2	2,500	2,700	2,600	50	2,600	130,000
3	Pllaka veshje wc	m2	2,500	2,700	2,600	268	2,600	696,800
4	Pllaka veshje kuzhine	m2	3,200	3,400	3,300	19	3,300	62,700
5	Mozaik për pllaka dushi	m2	12,000	13,000	12,900	12	12,633	151,596
							<b>Fondi limit</b>	<b>1,737,896</b>

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 179, datë 31.05.2022 Titullari i AK ka urdhëruar kryerjen e prokurimit për blerje e mallrave në formën e marrëveshjes kuadër me objekt “Pllaka të ndryshme”, lloji i procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fond limit 1,737,896 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 227, datë 08.07.2022 është ndryshuar anëtari i njësisë së prokurimit D.H. me anëtarin E.I.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 08.07.2022, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

Dhe me anë të procesverbalit nr. 3 të datës 08.07.2022, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit.

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 180, datë 31.05.2022 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga S.H., G.V. dhe I.B.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 5, datë 22.07.2022 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 6, datë 22.07.2022 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura, me anë të procesverbalit nr. 7, datë 22.07.2022 dokumentoi administrimin e mostrave dhe me anë të procesverbalit nr. 8, datë 29.07.2022 shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentacionin dhe ofertat e paraqitura, nga ku rezultoi, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	A.K.	1,584,000	Jo	Nuk ka paraqitur ofertën teknike; Nuk ka paraqitur autorizim nga Prodhuesi, ose distributori zyrtar i autorizuar; Nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara.
2	G.H.	1,587,890	Po	
3	V.	1,715,200	Jo	Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës; Nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara.
4	D.	1,720,000	Po	

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE G.H., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej **1,587,890 lekë pa tvsh** ose **1,905,468 lekë me tvsh**.

***-Lidhja e kontratës***

Midis AK DSHTD dhe OE G.H. është lidhur marrëveshja kuadër me nr. 487/5 prot., datë 12.08.2022, me kohëzgjatje 12 muaj, me vlerë kontrate 1,587,890 lekë pa tvsh/1,905,468 lekë me tvsh.

Midis AK DSHTD dhe OE G.H. është lidhur kontrata me nr. 790/3 prot., datë 12.09.2022, me kohëzgjatje 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës, me vlerë kontrate 1,291,130 lekë pa tvsh/1,549,356 lekë me tvsh

(Sigurimi i kontratës me vlerë 154,935.6 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

***-Zbatimi i kontratës.***

Spektori i Zbatimit në DSHTD më shkresën nr.790 prot., datë 01.09.2022 i ka kërkuar titullarit kërkesën për furnizimin me 210 m2 pllaka shtimi porcelanat, 50 m2 pllaka shtrimi wc, 200 m2 pllaka veshje wc, 19 m2 pllaka veshje kuzhine, 12 m2 mozaik për pllaka dushi.

DSHTD i ka dërguar me shkresën nr.790/1 prot., datë 06.09.2022, ftesën për ofertë për furnizimin dhe vendosjen e 210 m2 pllaka shtimi porcelanat, 50 m2 pllaka shtrimi wc, 200 m2 pllaka veshje wc, 19 m2 pllaka veshje kuzhine, 12 m2 mozaik për pllaka dushi në magazinat e DSHTD-së në rr. Skënderbej.

Me Urdhrin nr. 317, datë 12.09.2022, urdhërohet E.I., përgjegjës i Sektorit të Zbatimit në DSHTD, si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e kontratës. Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 318, datë 12.09.2022 është krijuar komisioni për pritjen dhe marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga Sh.I., K.T. dhe M.H. Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 354, datë 03.10.2022 është krijuar komisioni për kryerjen e veprimeve, hyrje dalje të aktiveve në magazinën e DSHTD i përbërë nga V.Sh., M.K. dhe I.B. Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim së mallit dhe komisioni për kryerjen e veprimeve hyrje dalje të aktiveve në magazinë kanë hartuar procesverbalin e datës 11.10.2022, ku shprehet se ka marrë në dorëzim mallin sipas sasisë, cilësisë dhe llojit të parashikuar në DST.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 28.10.2022 është kryer likuidimi i vlerës 1,549,356 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 44/2022, datë 11.10.2022 me vlerë 1,549,356 lekë me tvsh Mungon njoftimi i dorëzimit të mallit në kundërshtim me pikën e të nenit 4 të KVK, Dorëzimi ku citohet: *Furnizuesi do të njoftojë Blerësin një ditë para dorëzimit të mallrave.*

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Procedura e prokurimit “ Pllaka të ndryshme”, me fond limit 1,737,896 lekë pa tvsh**

*Konstatimet lidhur me zbatimin e kontratës:*

- Subjekti ka sjellë korrespondencën elektronike me OE.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Procedura e prokurimit “ Pllaka të ndryshme”:**

*Konstatimet lidhur me zbatimin e kontratës:*

- Njoftimet nuk janë sipas përcaktimeve të kontratës. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**3. Procedura e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje ashensori”, me fond limit 1,631,330 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2022, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2022.**

**C. Të dhëna mbi objektin**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje ashensori”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur e thjeshtuar” (marrëveshje kuadër) <b><u>REF-28120-05-10-2022</u></b> Urdhri nr. 152, datë 10.05.2022	<b>2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 131, datë 21.04.2022 E.Dh. Sh.I. A.S.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 130, datë 21.04.2022 D.B. E.Dh. E.Ç.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 153, datë 10.05.2022 S.H. G.V. I.B.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 1,631,330 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 1,499,355 lekë		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 131,975 lekë
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 16.05.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD		<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>3 OE;</b> b) Skualifikuar 2 OE: S. M. c) Kualifikuar 1 OE F.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 12 muaj			
<b>12. Ankimim</b> Po	<b>13. Përgjigje Ankesës AK</b> Po	<b>14. Përgjigje Ankesës nga KKP</b> Po	

<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>	
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Marrëveshja kuadër me nr. 420/5 prot., datë 05.07.2022, -Kontrata me nr. 652/3 prot., datë 22.07.2022 -Kontrata me nr. 725/3 prot., datë 01.09.2022 -Kontrata me nr. 59/3 prot., datë 25.01.2023	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Me Urdhrin nr. 255, datë 25.07.2022, Urdhri nr.303, datë 01.09.2022 dhe Urdhri nr.22, datë 26.01.2023 është caktuar E.Dh. si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratave. - Me Urdhrin nr. 256, datë 27.07.2022, Urdhri nr.304 datë 01.09.2022 dhe Urdhri nr.23 datë 26.01.2023 është ngritur Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit. - Është likuiduar vlera prej <b>754,560 lekë me tvsh dhe 359,733.66 lekë me tvsh.</b>

**-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.**

Me shkresën nr. 366 prot., datë 20.04.2022, Sektori i Burimeve njerëzore dhe Administrimit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse i dërgon Drejtorit të DSHTD dhe Drejtorisë Juridike, të Përputhshmërisë dhe të Prokurimeve, kërkesën për blerje shërbimi me objekt “Shërbime mirëmbajtje ashensori”. Në shkresë citohet se “*Sektori i Burimeve njerëzore dhe Administrimit, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse parashtron kërkesën për blerjen e (shërbimit/punës/mallit) me objekt Shërbim mirëmbajtje ashensori, 11 copë*”.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 130, datë 21.04.2022 është ngritur njësia e prokurimit, e përbërë nga D.B., E.Dh. dhe E.Ç.

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 131, datë 21.04.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, i përbërë nga E.Dh., Sh.I., A.S.

Në procesverbalin e datës 29.04.2022, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit ka paraqitur studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, si dhe sasitë që do të prokurohen, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Nj/ matëse	OE-F	OE-S.K	OE-H.E	Sasia	Çmimi mesatar për njësi	Vlera (lekë pa tvsh)
1	Shërbime mujore për 11 copë ashensor (15zëra punimesh)	muaj	80,900	7,500	69,515	12	52,633	631,596
<b>Totali</b>							<b>Fondi limit</b>	<b>631,596</b>

Nr.	Përshkrimi i mallit	Nj/matëse	OE-F	OE-S.K.	OE-H.E.	Vlera (lekë pa tvsh)
1	FV materiale të nevojshme për riparimin e defekteve që mund të lindin gjatë vitit për 11 ashensorë	Tot.	961,800	1,211,700	817,480	999,734
<b>Fondi limit</b>						<b>999,734</b>

Fondi limit total i kontratës është 1,631,330 lekë pa tvsh.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 152, datë 10.05.2022 Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e prokurimit për shërbimin në formën e marrëveshjes kuadër me objekt “Shërbim mirëmbajtje ashensori”, lloji i procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fond limit 1,631,330 lekë pa tvsh.

Me anë të procesverbalit nr. 1 të datës 10.05.2022, njësia e prokurimit ka paraqitur kriteret e veçanta për procedurën e prokurimit.

Dhe me anë të procesverbalit nr. 3 të datës 12.05.2022, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit.

Me Vendimin nr.2 datë 20.05.2022, njësia e prokurimit ka miratuar shtojcën nr.1 mbi disa ndryshime të DST.

OE F. ka dorëzuar ankesë DSHTD dhe KPP më datë 23.05.2022, protokolluar DSHTD nr.468 prot., datë 23.05.2022, në lidhje me kriteret e vendosura në DST, respektivisht mbi certifikatat e kërkuara.



Me anë të Urdhrit nr.176, datë 23.05.2022, AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe caktimin e kryetarit të KVO për shqyrtimin e ankesës.

DSHTD me shkresën nr.468/2 prot., datë 24.05.2022 i kthen përgjigje EO ankimues, dhe shkresa nr.468/3 prot., datë 24.05.2022 drejtuar KPP, mbi shqyrtimin e ankesës.

Urdhri nr.184, datë 31.05.2022, ndërpritet pezullimi i procedurës “Shërbim dhe mirëmbajtje ashensori”.

KPP me shkresën nr.1098/4 prot., datë 27.05.2022, protokolluar DSHTD nr.468/5 prot., datë 02.06.2022, dërgon Vendimin nr.507/2022, datë 27.05.2022 mbi ankesën e OE për kriteret e vendosura nga AK, me anë të të cilit refuzon pranimin e ankesës pasi është jashtë afateve.

Tabela me tipat e ashensorëve sipas certifikimeve të ISHMT, jepet në tabelën nr.5 Aneksi IV.

**Gjetje:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nga grupi, kanë disa parregullsi si më poshtë:

- Referuar specifikimeve teknike në DST citohet: “Emërtimi i shërbimit: Shërbim mirëmbajtje ashensorët pallati 4,6,8, Ambasada Greke dhe pallati nr.57, gjithsej 11 cope, tip B.” Sipas certifikatave të regjistrimit të ashensorëve pronësi e DSHTD-së ashensorët janë të tipave të ndryshme, vendosja në specifikime tip B. është në kundërshtim me parimet e LPP.

**-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.**

Me anë të Urdhrit të Titullarit të AK nr. 153, datë 10.05.2022 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga S.H., G.V. dhe I.B.

KVO, me anë të procesverbalit nr. 10, datë 08.06.2022 dokumentoi verifikimin e ofertave të dorëzuara, me anë të procesverbalit nr. 11, datë 08.06.2022 dokumentoi hapjen e ofertave të paraqitura dhe me anë të procesverbalit nr. 12, datë 13.06.2022 shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentacionin dhe ofertat e paraqitura, nga ku rezultoi, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Kualifikuar (po/jo)	Arsyeja
1	S.	1,372,000	Jo	Autorizimi i paraqitur nga ofertuesi, është dhënë nga “A.”, kompani e autorizuar të promovojë, të shesë, të instalojë ashensorë T. në territorin e Shqipërisë. Dhe jo për ashensorët B.
2	F.	1,499,355	Po	
3	M.	1,610,400	Jo	Autorizimi i paraqitur nga ofertuesi, është dhënë nga “K.”, kompani e cila mund të ofrojë pjesë këmbimi së bashku me mbështetjen teknike, për nënsistemet e ashensorëve të prodhuar nga K., dhe jo për ashensorët B.

Sa më sipër, oferta e shpallur fituese është OE F., me ofertën ekonomike më të ulët të kualifikuar, në vlerën prej 1,499,355 lekë pa tvsh ose 1,799,226 lekë me tvsh.

**-Lidhja e kontratës**

Midis AK DSHTD dhe OE F. është lidhur marrëveshja kuadër me nr. 420/5 prot., datë 05.07.2022, me kohëzgjatje 12 muaj, me kohëzgjatje 12 muaj, me vlerë kontrate 1,499,355 lekë pa tvsh/1,799,226 lekë me tvsh.

Midis AK DSHTD dhe OE F. është lidhur kontrata me nr.652/3 prot., datë 22.07.2022, me kohëzgjatje nga nënshkrimi i kontratës deri 31.12.2022, me vlerë kontrate 299,778 lekë pa tvsh/359,733.6 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 299,778 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

Midis AK DSHTD dhe OE F. është lidhur kontrata me nr.725/3 prot., datë 01.09.2022, me kohëzgjatje 5 ditë nga nënshkrimi i kontratës, me vlerë kontrate 628,800 lekë pa tvsh/754,560 lekë me tvsh.

(Sigurimi i kontratës me vlerë 75,456 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

Midis AK DSHTD dhe OE F. është lidhur kontrata me nr.59/3 prot., datë 25.01.2023, me

kohëzgjatje nga nënshkrimi i kontratës deri 30.06.2023, me vlerë kontrate 299,772 lekë pa tvsh/359,726 lekë me tvsh.  
(Sigurimi i kontratës me vlerë 359,733 lekë me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës).

#### ***-Zbatimi i kontratës.***

Spektori i Burimeve njerëzore dhe Administrimit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DSHTD më shkresën nr.652 prot., datë 19.07.2022 i ka kërkuar titullarit kërkesën për lidhje kontrate për shërbimin e mirëmbajtjes.

DSHTD i ka dërguar me shkresën nr.652/1 prot., datë 20.07.2022, ftesën për ofertë për shërbimin e mirëmbajtjes së 11 ashensorëve nën administrimin e DSHTD-së në pallatet 4,6,8, ambasada greke dhe pallati 57, çdo muaj deri 31.12.2022. Oferta me vlerë 299,778 lekë pa tvsh dorëzuar më datë 21.07.2022 sipas vlerës në MK.

Me Urdhrin nr. 255, datë 25.07.2022, urdhërohet E.Dh., specialist për pajisjet dhe instalimet në DSHTD, si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e kontratës. Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 256, datë 27.07.2022 është krijuar komisioni për pritjen dhe marrjen në dorëzim të shërbimit i përbërë nga E.Dh., A.S. dhe A.Q.

OE F. ka kryer një inspektim teknik të 11 ashensorëve, dhe më datë 29.07.2022 ka mbajtur akt inspektimin teknik me E.Dh. mbi riparimet që ka nevojë secili nga ashensorët.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DSHTD më shkresën nr.725 prot., datë 10.08.2022 i ka kërkuar Drejtorisë Juridike të Përputhshmërisë dhe Prokurimeve kërkesën për blerje materiale për riparimet e ashensorit.

DSHTD i ka dërguar me shkresën nr.725/1 prot., datë 11.08.2022, ftesën për ofertë për FV materiale për riparimin e 11 ashensorëve nën administrimin e DSHTD-së në pallatet 4,6,8, ambasada greke dhe pallati 57. Oferta me vlerë 628,800 lekë pa tvsh dorëzuar më datë 12.08.2022 sipas çmimeve të MK.

Me Urdhrin nr. 303, datë 01.09.2022, urdhërohet E.Dh., specialist për pajisjet dhe instalimet në DSHTD, si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e kontratës. Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 304, datë 01.09.2022 është krijuar komisioni për pritjen dhe marrjen në dorëzim të shërbimit i përbërë nga E.Dh., A.S. dhe A.Q.

Drejtoria e Projektimit, Zbatimit dhe Monitorimit në DSHTD më shkresën nr.759 prot., datë 23.01.2023 i ka kërkuar Drejtorisë Juridike të Përputhshmërisë dhe Prokurimeve i ka dërguar kërkesën për lidhje kontrate për shërbimin e mirëmbajtjes për muajt Janar-Qershor 2023.

DSHTD i ka dërguar me shkresën nr.59/1 prot., datë 24.01.2023, ftesën për ofertë për shërbimin e mirëmbajtjes së 11 ashensorëve nën administrimin e DSHTD-së në pallatet 4,6,8, ambasada greke dhe pallati 57, çdo muaj për muajt Janar-Qershor 2023. Oferta me vlerë 299,772 lekë pa tvsh dorëzuar më datë 25.01.2023 sipas vlerës në MK.

Me Urdhrin nr. 22, datë 26.01.2023, urdhërohet E.Dh., specialist për pajisjet dhe instalimet në DSHTD, si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e kontratës. Me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 23, datë 26.01.2023 është krijuar komisioni për pritjen dhe marrjen në dorëzim të shërbimit i përbërë nga E.Dh., A.S. dhe A.Q.

*Pagesat për kontratën me nr.725/3 prot., datë 01.09.2022, janë kryer si më poshtë:*

- Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 07.09.2022, ku shprehet se materialet e vendosur janë në sasi, cilësi sipas specifikimeve të kontratës, të gjithë ashensorët janë brenda kërkesave teknike dhe i është bërë prova me ngarkesë dhe pa ngarkesë.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 05.10.2022 është kryer likuidimi i vlerës 754,560 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 23/2022, datë 07.09.2022 me vlerë 754,560 lekë me tvsh.

*Pagesat për kontratën me nr. 652/3 prot., datë 22.07.2022, janë kryer si më poshtë:*

- Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 05.08.2022, mbi shërbimet e kryera në muajin korrik, OE ka lëshuar garancinë për riparimin dhe vënien në punë të ashensorëve për punimet e kryera në muajin korrik 2022.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 31.08.2022 është kryer likuidimi i vlerës 59,955.61 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 19/2022, datë 05.08.2022 me vlerë 59,955.61 lekë me tvsh.

- Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 06.09.2022, mbi shërbimet e kryera në muajin gusht 2022.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 28.09.2022 është kryer likuidimi i vlerës 59,955.61 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 22/2022, datë 06.09.2022 me vlerë 59,955.61 lekë me tvsh.

- Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 07.10.2022, mbi shërbimet e kryera në muajin shtator, OE ka lëshuar garancinë për riparimin dhe vënien në punë të ashensorëve për punimet e kryera në muajin shtator 2022.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 19.10.2022 është kryer likuidimi i vlerës 59,955.61 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 27/2022, datë 07.10.2022 me vlerë 59,955.61 lekë me tvsh.

- Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 26.10.2022, mbi shërbimet e kryera në muajin tetor, OE ka lëshuar garancinë për riparimin dhe vënien në punë të ashensorëve për punimet e kryera në muajin tetor 2022.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 14.11.2022 është kryer likuidimi i vlerës 59,955.61 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 29/2022, datë 26.10.2022 me vlerë 59,955.61 lekë me tvsh.

- Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 01.12.2022, mbi shërbimet e kryera në muajin nëntor, OE ka lëshuar garancinë për riparimin dhe vënien në punë të ashensorëve për punimet e kryera në muajin nëntor 2022.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 30.12.2022 është kryer likuidimi i vlerës 59,955.61 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 35/2022, datë 01.12.2022 me vlerë 59,955.61 lekë me tvsh.

- Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 29.12.2022, mbi shërbimet e kryera në muajin dhjetor, OE ka lëshuar garancinë për riparimin dhe vënien në punë të ashensorëve për punimet e kryera në muajin dhjetor 2022.

Me anë të Urdhër transfertës e datës 30.12.2022 është kryer likuidimi i vlerës 59,955.61 lekë me tvsh. Fatura e paraqitur nga OE nr. 37/2022, datë 29.12.2022 me vlerë 59,955.61 lekë me tvsh.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Procedura e prokurimit “ Shërbim mirëmbajtje ashensori”, me fond limit 1,631,330 lekë pa tvsh**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

- DSHTD ndër vite ka ndërruar kuadrin elektrik (i cili është gjithë funksioni dhe truri i punës së një ashensori) për të gjithë ashensorët, dhe janë vendosur tip B. Përjashtim këtu bën ashensori i instaluar në Ambasadën Greke. Duke qenë se kuadri elektrik është ai që përcakton gjithë punën dhe funksionin e një ashensori, markat që janë përmendur në certifikatë janë markat e blerjes fillestare të ashensorëve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Procedura e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje ashensori”:**

Konstatimet lidhur me hartimin e fondit limit dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST:

Grupi i auditimit nuk ka asnjë dokumentacion që verifikon ndryshimet e mësipërme. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

<b>Titulli i gjetjes:</b>	<i>Parregullsi në përcaktimin e kriterëve kualifikuese</i>
<b>Situata:</b>	<b>1. Për procedurën: “Dyer të brendshme”, 2020:</b> Njësia e prokurimit nuk argumenton nevojën për punësimin mesatar prej 8 punonjësish, kriteri për nevojën për 1 arkitekt, ky kriter nuk duhet të vendosej pasi modelet duhet

të jenë përcaktuar nga AK. Kriteri mbi disponimin e një mjet në pronësi apo të marrë me qira, kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, në të cilat automjeti nuk do të ishte i nevojshëm gjatë gjithë kohës, njësia e prokurimit duhet të mjaftojë duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave.

**2. Për procedurën: “Parkete e aksesore”, 2020:** Kriteri mbi të dhënave mbi xhiron e vitit 2019. Referuar nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme dhe e paraqet në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Sa më sipër, të dhënat mbi xhiron vjetore të vitit 2019 nuk duhej të ishin kërkuar në DST.

**3. Për procedurën: “Pllaka të ndryshme”, 2020:** Kriteri mbi disponimin e një mjet në pronësi apo të marrë me qira, kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, në të cilat automjeti nuk do të ishte i nevojshëm gjatë gjithë kohës, njësia e prokurimit duhet të mjaftojë duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave.

**4. Për procedurën: “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, 2020:** Referuar kriterëve të licencimit të OE, lidhur me licencën për kategorinë: NS-12 “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”. Kriteri i vendosur është në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Kriteri për inxhinier mekanik, të pajisur me licencë individuale (të vlefshme) me kategori 12/a, në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.1.2008.

**5. Për procedurën: “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, 2020:** Hartimin e fondit limit me analizat e çmimeve respektive, mungon në dokumentacionin e llogaritjes së fondit limit. Kriteri mbi certifikimin stafit teknik Inxhinier Ndërtimi, Specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, e vërtetuar me certifikatë përkatëse (të vlefshme), kriteri i vendosur diskriminues në kundërshtim me profilin arsimor sipas Nenit 10, pika 1a, të VKM nr.312, datë 5.5.2010. Kriteret mbi Ekspert zjarrfikës, Inxhinierin Mekanik dhe Inxhinierin elektrik, si dhe mbi disponimin e auto betoniere, auto pompë betoni, pompë suvatimi, helikopter nivelimi nuk përputhet me natyrën e punimeve, në kundërshtim me nenin 26, Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

**6. Për procedurën: “Hapje pusi uji + impiant klorifikimi te Ambasada Bullgare”, 2021:** Kriteri për Inxhinier Shpimi 1, kriteri diskriminues duhet të përfshiheshin profilet e diplomimit siç specifikohet në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar, lidhja 4, gjithashtu në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.1.2008. Kriteri mbi disponimin e Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, Autovinç, në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

**7. Për procedurën: “Pllaka të ndryshme”, 2022:** Kriteri mbi disponimin e një mjet në pronësi apo të marrë me qira, kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, në të cilat automjeti nuk do të ishte i nevojshëm gjatë gjithë kohës, njësia e prokurimit duhet të mjaftojë duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave.

**8. Për procedurën: “Shërbime mirëmbajtje ashensori”, 2022:** Vendosja në specifikime teknike e markave si tip B. është në kundërshtim me nenin

	36 të Ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik. VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” kreu I, pika 1. VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”” Nenin 10, pika 1a. VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar, lidhja 4.
<b>Ndikimi:</b>	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
<b>Shkaku</b>	Vlerësim i parregullt mbi llojin dhe sasinë e punës që kërkohet të prokurohet nga ana e njësisë së prokurimit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, të marrë masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mosfavorizuar operatorë ekonomik të caktuar.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit.*

<b>Titulli i gjetjes:</b>	<i>Parregullsi në vlerësimin e ofertave</i>
<b>Situata:</b>	<p><b>1. Procedura “Dyer të brendshme”, 2020</b> sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: OE fitues ka paraqitur kontratat e punës për 1 marangoz dhe 1 ndihmës marangoz, ndërkohë që DST kërkonte 2 marangozë si dhe në listpagesë nuk figurojnë si marangoz.</p> <p><b>2. Procedura “Parkete e aksesorë”, 2020</b> sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: OE fitues gjithashtu ka paraqitur një mostër të mallit dhe një katalog në gjuhë të huaj, duke mos paraqitur deklaratë konformiteti sipas kërkesave në DST.</p> <p><b>3. Procedura “Pllaka të ndryshme”, 2020</b> sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: OE fitues ka paraqitur një akt-marrëveshje me një palë të tretë të datës 23.02.2016, si dhe një deklaratë konformiteti në gjuhën spanjolle të pa përkthyer, me vlefshmëri deri në 08.04.2017, jo sipas kërkesave të DST.</p> <p><b>4. Procedura “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, 2020</b> sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar për punonjësit certifikatat të lëshuara nga një subjekt i pa akredituar për këtë lloj trajnimi. Secili nga OE të BOE fituese nuk ka stafin respektiv për kryerjen e punimeve sipas ndarjeve respektive në marrëveshjen e bashkëpunimit. OE fitues ka sjellë një certifikatë trajnimi e dhënë nga një organizëm certifikimi shqiptar i pa akredituar për këtë lloj certifikimi.</p> <p><b>5. Procedura “Dyer të brendshme”, 2022</b> sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: OE fitues nuk ka dorëzuar dokumentacionin për një inxhinier përpunim druri/inxhinier pyjesh. OE fitues si punë të ngjashme ka dorëzuar Rikonstruksionin e një shkolle të mesme, por referuar kontratës së bashkimit të përkohshëm të shoqërive për punën e dorëzuar OE nuk i ka</p>

	kryer ai punimet për dyer dritare.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
<b>Ndikimi:</b>	Risku që cilësia e mallit/punimeve të prokuruar të mos jetë me cilësinë e duhur sipas specifikimeve teknike.
<b>Shkaku</b>	Mosvlerësim i saktë i ofertave ekonomike.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, për të siguruar dobishmëri në përdorimin e fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të ofertave.*

#### **b. Investimet në objekte jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

Përgjatë periudhës së auditimit, DSHTD ka kryer investime në objekte jashtë territorit të RSH, me shpërndarje si më poshtë:

	2020		2021		2022	
	EURO	USD	EURO	USD	EURO	USD
<b>Romë</b>	6,000		13,770		44,332	
<b>Stokholm</b>	1,500		12,896			
<b>Bruksel</b>			14,029		14,000	
<b>Athinë</b>	28,498		9,955		49,093	
<b>OKB – Nju Jork</b>		49,450		18,200		11,100
<b>Uashington</b>						1,495

*Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë viteve 2020-2021 dhe gjysmës së parë të vitit 2022, DSHTD ka kryer procedurat e investimit jashtë territorit të RSH në mungesë të një procedure të miratuar. Referuar Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, njësitë publike, në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të tyre në mënyrën e duhur, duhet të mbështeten në akte ligjore dhe nënligjore specifike për proceset dhe procedurat përkatëse, duke miratuar rregulloret e tyre të brendshme (udhëzime, direktiva, dekrete) për të evidentuar më hollësisht procedurat, përcaktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë, si dhe procedurat e kontrollit. Mbështetja në këto procedura të shkruara do të ndihmojë njësinë në realizimin e objektivave dhe përdorimin e fondeve buxhetore në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficientë.

• Me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 4, datë 10.06.2022 është miratuar udhëzimi për kryerjen e procedurave për punimet jashtë vendit, që është një hap pozitiv drejt formalizimit të këtij procesi. Sidoqoftë, referuar nenit 29 të Ligjit nr. 90/2012 “Për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore” është ministri përgjegjës ai që miraton rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	<i>Mungesa e Udhëzimi të miratuar mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik jashtë territorit të RSH.</i>
<b>Situata:</b>	Me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 4, datë 10.06.2022 është miratuar udhëzimi për kryerjen e procedurave për punimet jashtë vendit, por referuar nenit 29 të Ligjit nr. 90/2012 “Për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore” është ministri përgjegjës ai që miraton rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës.
<b>Kriteri:</b>	Ligjit nr. 90/2012 “Për funksionimin dhe organizimin e administratës

	<i>shtetërore</i> ”, nenit 29. Manual i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
<b>Ndikimi:</b>	Mungesa e miratimit të procedurës nga ana e ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme ka sjellë vështirësi në kryerjen e këtyre procedurave, duke ndjekur standarde e procedura të ndryshme në raste të ndryshme, si dhe mbart riskun për realizimin me sukses të këtyre procedurave, ku palë të përfshira janë dhe ambasadat, të cilat kanë varësi institucionale nga MEPJ dhe jo nga DSHTD (pra pa detyrim për të zbatuar aktin e miratuar nga DSHTD).
<b>Shkaku</b>	Mungesa e miratimit të procedurës (pa përjashtuar mundësinë e hartimit të një akti të ri) nga ministri përgjegjës për punët e jashtme.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të dërgoje pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse, “Udhëzimin mbi realizimin e procedurave të prokurimit jashtë territorit të RSH”, me qëllim rishikimin dhe miratimin nga ministri të aktit, duke synuar formalizimin e procedurës dhe ndarjen e qartë të roleve e përgjegjësive për të gjithë aktorët në proces, që janë në varësi të MEPJ.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i DSHTD.*

Grupi i auditimit ka përzgjedhur investimet, si më poshtë:

Nr.	Ambasada e RSH jashtë vendit	Objekti	Vlera (Euro)	Vlera (USD)
2020				
1.	Ambasada në Romë	Rinovim tualeti dhe eliminim lagështie në zyrën e Ambasadores	2,900	
		Punime emergjente në zyrën e konsullores në godinën e Ambasadës	3,100	
2.	Ambasada në Athinë	Punime në godinën e Ambasadës	24,179	
3.	Misioni i përhershëm RSH-së pranë OKB-së New York	Shërbimi i konsulencës ligjore për kryerjen e procedurave në lidhje me investimin për zhvillimin e pronës shtetërore tokë truall dhe ndërtesë në New York.		40,000
		Riparimin e sistemit të ngrohjes në ndërtesën e Misionit		7,250
2021				
1.	Ambasada në Romë	Punime në apartamentin 22 të diplomateve	6,580	
		Punime në Ap. 13+15 të diplomateve	7,190	
2.	Ambasada në Bruksel	Punime në godinën e Misionit të R.SH në Bruksel	14,029	
3.	Ambasada në Athinë	Punime të nevojshme dhe të domosdoshme në godinën e Ambasadës së RSH-së në Athinë	9,955	
4.	Misioni i përhershëm RSH-së pranë OKB-së New York	Punime emergjente për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga ngrica në apartamentet e godinës në New York		10,050
2022				
1.	Ambasada në Romë	Punime në godinën e Ambasadës sipas Fazës së II të projektit	109,851	
2.	Ambasada në Athinë	Kryerje punimeve në godinën e Ambasadës së R.SH në Athinë	49,093	
3.	Misioni i përhershëm RSH-së pranë OKB-së New York	Kryerjes së riparimit në apartamentin 1A, në godinën e Misionit		3,800

### 1. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë, viti 2020:

**a. Punime për Rinovim tualeti dhe eliminim lagështie në zyrën e Ambasadores, me vlerë 2,900 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

Me anë të shkresës nr. 786 port., datë 05.05.2020, administruar në DSHTD me nr. 449 port., datë 08.06.2020, Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Itali ka dërguar kërkesën për kryerjen e

punimeve emergjente në selinë e Ambasadës në Romë, si pasojë e lagështirës së krijuar dhe verifikimit të kryer nga një shoqëri private, duke bashkëlidhur preventivin e punimeve të kërkuara, me vlerë totale të ofertuar 3,050 euro.

Me anë të shkresës nr. 816 port., datë 09.06.2020 Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Itali ka dërguar edhe dy oferta të tjera ekonomike për kryerjen e punimeve të kërkuara, një ofertë në vlerën 3,800 euro dhe një ofertë në vlerën 2,900 euro. Ofertat e paraqitura i referohen vlerës totale të punimeve, por nuk është e detajuar me zërat e punimeve specifike, që kanë sjellë këtë vlerë totale.

Me anë të procesverbalit të datës 11.06.2020, Komisioni i Blerjeve të Vogla në DSHTD ka përcaktuar ofertën fituese, bazuar në 3 ofertat e paraqitura, ofertën e OE N. në vlerën 2,900 euro.

Me anë të shkresës nr. 449/4 port., datë 15.06.2020, Shefi i Sektorit të Planifikimit dhe Financës i dërgon Këshillit Drejtues të DSHTD relacionin për kryerjen e punimeve në Ambasadën e RSH në Romë, ku specifikohet se, bazuar në 3 ofertat e administruara, është përzgjedhur oferta më e ulët, me vlerë 2,900 euro.

Likuidimi në vlerën 2,900 euro është kryer nëpërmjet mandat-pagesës së datës 08.10.2020, duke u bazuar në:

- Urdhrin e Drejtorit të DSHTD nr. 243, datë 08.10.2020 për pagesën e punimeve për eliminimin e lagështirës dhe rinovimin e tualetit në godinën e Ambasadës së RSH në Romë;
- Procesverbalin mbi kryerjen e punimeve urgjente, mbajtur në Romë, në datën 07.10.2020, nënshkruar nga Komisioni i përbërë nga J.Sh., A.P., T.K.;
- Faturën nr. 65, datë 11.09.2020, të paraqitur nga OE N. në vlerën 2,900 euro.

**Gjetje:** Nga auditimi i procedurës u konstatuan këto mangësi:

- Ofertat e paraqitura i referohen vlerës totale të punimeve, por nuk është e detajuar me zërat e punimeve specifike, që kanë sjellë një vlerë totale.

- Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, çka ka sjellë që, në 3 ofertat e administruara, zërat janë të ndryshëm.

- Dokumentacioni i administruar për marrjen në dorëzim të punimeve *nuk është në përputhje me pikën 35 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011*, ku specifikohet se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimet dhe të tjera të dhëna që i japin dokumentit forcën e një prove administrative. Në dokumentacion nuk përfshihet Urdhri i ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim, si dhe nuk ka informacion mbi profesionet e anëtarëve të komisionit, ku, nga natyra e punimeve të marra në dorëzim, duhet të kishte edhe specialistë të fushës.

**b. Punime emergjente në zyrën e konsullore në godinën e Ambasadës, me vlerë 3,100 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

Me anë të shkresës nr. 1387 prot., datë 23.10.2020, administruar në DSHTD me nr. 884/1 prot., datë 26.10.2020, Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Itali ka dërguar preventivat e tri operatorëve ekonomikë, për kryerjen e punimeve urgjente në Zyrën Konsullore dhe pagesën e tyre nga DSHTD, në vijim të miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm i MEPJ.

Me anë të shkresës nr. 884/3 prot., datë 29.10.2020, Shefi i Sektorit të Planifikimit dhe Financës i dërgon Këshillit Drejtues të DSHTD relacionin për kryerjen e punimeve në Ambasadën e RSH në Romë, ku specifikohet se, bazuar në 3 ofertat e administruara, është përzgjedhur oferta më e ulët, me vlerë 3,100 euro.

Likuidimi në vlerën 3,100 euro është kryer nëpërmjet mandat-pagesës së datës 27.11.2020, duke u bazuar në:

- Urdhrin e Drejtorit të DSHTD nr. 273, datë 27.11.2020 për pagesën e punimeve emergjente;
- Procesverbalin mbi kryerjen e punimeve urgjente, mbajtur në Romë, në datën 25.11.2020, nënshkruar nga Komisioni i përbërë nga A.M., A.B., T. K.;
- Faturën nr. 115B/2020 të datës 16.11.2020, të paraqitur nga OE E. në vlerën 3,100 euro.

**Gjetje:** Nga auditimi i procedurës u konstatuan këto mangësi:

- *Në analogji me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi*, për të argumentuar emergjencën, duhet të provohet, të justifikohet dhe të dokumentohet nevoja ekstreme ose situata emergjente dhe se kjo situatë nuk është pasojë e veprimet apo mosveprimet të autoritetit. Duke konsideruar zërat e kërkuar,



punimet konsistojnë në rregullim parketi, lysterje e vendosje karrigesh zyre, që nuk justifikojnë emergjencën.

- Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, çka ka sjellë që, në 3 ofertat e administruara, zërat janë të ndryshëm.
- Dokumentacioni i administruar për marrjen në dorëzim të punimeve *nuk është në përputhje me pikën 35 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011*, ku specifikohet se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimet dhe të tjera të dhëna që i japin dokumentit forcën e një prove administrative. Në dokumentacion nuk përfshihet Urdhri i ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim, si dhe nuk ka informacion mbi profesionet e anëtarëve të komisionit, ku, nga natyra e punimeve të marra në dorëzim, duhet të kishte edhe specialistë të fushës.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë, viti 2020:**

- Punime emergjente në zyrën e konsulltores në godinën e Ambasadës Romë me vlerë 3,100 euro pa përfshirë taksat, ka mbërritur në DSHTD emaili nga MEPJ “Mbi kryerjen e punimeve urgjente në zyrën konsullore”, dhe këto punime emergjente janë miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MEPJ, dhe se duhet të paguhet nga ana e DSHTD.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë, viti 2020:**

Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**2. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, viti 2020:**

**Punime në godinën e Ambasadës, me vlerë 24,179 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

Sipas planifikimit të DSHTD, me VKD nr.1, datë 06.01.2020, investimi i planifikuar për Ambasadën e RSH-së për vitin 2020, është në shumën 25,000 euro.

Urdhri nr. 78, datë 19.02.2020, “Për dërgim me shërbim jashtë shtetit”, grupi i punës me përbërje A.S., E.Th., B.K. dhe N.Gj., dërgohen me shërbim në Ambasadën e RSH-së në Athinë, me qëllim kontrollin e nevojave për kryerjen e riparimeve në godinë, testimin e tregut dhe hartimin e preventivave për të realizuar riparimet dhe rikonstruksionet.

Më datë 27.02.2020 me nr.335 të Ambasadës së RSH-së në Athinë, protokolluar në DSHTD nr. 194/5 prot., datë 02.03.2020, është mbajtur Akt Rakordimi midis grupit të punës të DSHTD-së dhe Ambasadores u dakordësua mbi listën e investimeve të nevojshme në godinë. Më datë 28.02.2020, grupi i punës së DSHTD-së, ka bërë testimin e tregut dhe ka marrë oferta me çmime njësi nga 3 subjekte të ndryshme që kryejnë veprimtari në shtetin grek, për mallrat kryesore për kryerjen e punimeve.

Spektori i Planifikimit dhe Financës i DSHTD-së, me shkresën nr. 194/7 prot., datë 04.03.2020, drejtuar Këshillit drejtues të DSHTD-së, i dërgon relacionin mbi llogaritjen paraprake të investimit në godinën e ambasadës së RSH-së në Athinë, i cili me VKD nr. 6 datë 04.03.2020, shkresa nr. 236/2 prot., datë 04.03.2020, ka miratuar vlerën e investimit që do të kryhet në Ambasadën e RSH-së, në Athinë për vitin 2020, me vlerë 24,652.2 euro.

Me Urdhrin nr. 93, datë 05.03.2020, “Për dërgim me shërbim jashtë shtetit”, shkresa nr. 241 prot., datë 05.03.2020, ngrihet grupi për ndjekjen e punimeve në Ambasadën e RSH-së në Athinë, me përbërje E.Th., E.Dh. dhe A.Th., grupi i marrjes në dorëzim ka ndryshuar me Urdhrin nr. 108, datë 14.03.2020, shkresa nr. 270 prot., datë 14.03.2020, grupi i punës me përbërje E.Dh. dhe A.Th.

Me Urdhrin nr. 109 datë 14.03.2020, shkresa nr. 270/1 prot., datë 14.03.2020, urdhëron krijimin e

komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për kryerjen e punimeve në godinën e Ambasadës së RSH-së në Athinë, me përbërje E.Dh. dhe A.Th.

Me shkresën nr. 270/2 prot., datë 17.03.2020, drejtori i DSHTD autorizon E.Dh. të tërheq fondin me vlerë 19,720 euro për kryerjen e punimeve në Ambasadës së RSH-së në Athinë. Më datë 17.03.2020 me kod transaksioni nr. 40 / 2053§AAA 000047, është tërhequr vlera 19,720 euro.

Janë kryer 15 procedura prokurimi me blerje të vogël. Tabela e prokurimeve të vogla jepet në tabelën nr.6 Aneksi IV.

Akti i marrjes në dorëzim të punimeve mbajtur në ambasadën e Athinës datë 21.03.2020, protokolluar në DSHTD nr. 241/9 prot., datë 06.04.2020, midis grupit të punë së DSHTD përfaqësuar nga E.Dh., A.Th. dhe Ambasadorja A.H., ku dakordësojnë që të gjitha punimet janë kryer me cilësi të larte dhe konform kërkesave të Ambasadës.

Gjithashtu është mbajtur procesverbali mbi mos arritjen e realizimit të procedurave për F.V. Pemë dekorative rrethimi dhe F.V. Vazo të mëdha lulesh, për arsye të situatës së koronavirus, fondi prej 770 euro i lihet ambasadës ta kryej procedurën në një moment të dytë.

**Gjetje:** Nga auditimi i procedurës u konstatuan këto mangësi:

- Për procedurat nr. 15 dhe 16, mungon urdhri i ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim. Dokumentacioni i administruar për marrjen në dorëzim të punimeve *nuk është në përputhje me pikën 35 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011*, ku specifikohet se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimet dhe të tjera të dhëna që i japin dokumentit forcën e një prove administrative. Në dokumentacion nuk përfshihet Urdhri i ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim, si dhe nuk ka informacion mbi profesionet e anëtarëve të komisionit, ku, nga natyra e punimeve të marra në dorëzim, duhet të kishte edhe specialistë të fushës.

- Fatura tatimore me vlerë 222.58-euro pa tvsh/276 euro me tvsh dhe fatura 494.2 euro nuk kanë elementët kryesore të faturave *në kundërshtim nenin 9 të ligjit 87/2019*.

- Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë *në analogji me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi*.

- Në lidhje me rimbursimin e tvsh nuk është kryer rimbursimi i vlerës prej 835.40 euro, në *kundërshtim me nenin 23 të konventës së Vjenës*.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, ka paraqitur observacionin nr. 1310/27 prot., datë 14.06.2023, protokolluar KLSH nr.1176/5 prot., datë 15.06.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, viti 2020:**

- Të dyja këto fatura të cilat nuk kanë elementët kryesorë të faturave janë verifikuar dhe marrë në dorëzim nga Ambasadorja dhe shefja e Financës së Ambasadës.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, viti 2020:**

Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**3. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë, viti 2021:**

**a. Punime në apartamentin 22 të diplomatëve, Romë, me vlerë 6,850 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

Ambasada e RSH-së në Romë me shkresën nr. 1570 prot., datë 15.12.2020, protokolluar në DSHTD nr. 844/1 prot., datë 17.12.2020, në vijim të shkresës nr.1300 prot., datë 1.10.2020 të Ambasadës, kërkojnë dhe njëherë kryerjen e punimeve emergjente në apartamentin nr. 22, apartament ku do të akomodohet diplomati i ri i emëruar, gjithashtu ka sjellë 3 oferta për punime në apartamentin nr.22.

Shkresa e mësipërme i është vënë në dijeni edhe Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë MEPJ.

Më datë 17.12.2020, nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga B.K., E.A. dhe A.N., është mbajtur procesverbalin “Mbi përcaktimin e ofertës fituese për kryerjen e punimeve emergjente në apartamentin nr.22, në Ambasadën e RSH-së në Romë”.

Nr.	OE	Çmimi i ofertuar pa tvsh (euro)
1	N.	6,850
2	E.	7,780
3	M.	9,760

Komisioni ka vlerësuar ofertat e ardhura, dhe bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, vlerëson se oferta fituese është ajo e paraqitur nga OE N., me ofertë 6,850 euro pa përfshirë taksat.

Me shkresën nr. 844/2 prot., datë 17.12.2020, komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, i jep informacion titullarit mbi realizimin e procedurës, shpalljen e fituesit dhe bashkëlidhur procesverbalin mbi vlerësimin e ofertave dhe shkresa e ardhur nga ambasadorja e RSH-së në Romë, nr. 1570 prot., datë 15.12.2020.

Komisioni i marrjes në dorëzim të punimeve i përbërë nga F.F., J.A. dhe T.K., ka mbajtur procesverbalin më datë 14.01.2021, protokolluar në DSHTD nr. 844/8 datë 15.01.2021, mbi punimet urgjente të kryera në apartamentin nr.22 dhe janë në përputhje me faturën e dërguar nga operatori ekonomik. (Bashkëlidhur fatura e OE nr. 27/2020 datë 22.12.2020).

Me Urdhrin nr. 13, datë 15.01.2021, me shkresën nr. 37 prot., datë 15.01.2021, urdhërohet kryerja e pagesës me shumën, prej 6,580 EUR, për llogari të kompanisë N. për punimet emergjente të kryera në apartamentet nr.22, ku do të akomodohet diplomati në detyrë i Ambasadës së RSH-së në Romë.

Pagesa e kryer me urdhër transfertën e datës 15.01.2021 me vlerë 6,580 EUR, operatorit N.

**b. Punime në apartamentet 13+15 të diplomateve, Romë, me vlerë 7,190 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

Bazuar në shkresën nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Itali, me nr. prot., 54 datë 22.01.2021, protokolluar DSHTD me nr. 81 prot., datë 25.01.2021, DSHTD i kërkohet të kryhen punime mbi lyerjen e apartamenteve nr. 13 dhe nr.15, apartamente ku do të akomodohen diplomatët e rinj, L.H., dhe Sh.Sh.. Shkresa e mësipërme i është vënë në dijeni edhe Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë MEPJ.

Ambasada e RSH-së në Romë në vijim të kërkesës së DSHTD-së, për dërgimin e 3 ofertave, me shkresën nr. 83 prot., datë 27.01.2021, ka sjellë 3 oferta për lyerjen e apartamenteve nr.13 dhe nr.15.

Më datë 28.01.2021, nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga B.K., E.A. dhe A.N., është mbajtur procesverbalin “Mbi përcaktimin e ofertës fituese për kryerjen e shërbimit për “Lyerjen e apartamenteve nr.13 dhe nr.15, në Ambasadën e RSH-së në Romë”.

Nr.	OE	Çmimi i ofertuar pa tvsh (euro)
1	D.	9,000
2	E.	6,340
3	P.	11,100

Komisioni ka vlerësuar ofertat e ardhura, dhe bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, vlerëson se oferta fituese është ajo e paraqitur nga OE E., me ofertë 6,340 euro pa përfshirë taksat.

Spektori i administratës dhe zbatimit dhe Spektori i planifikimit dhe financës në DSHTD, i ka dërguar Këshillit Drejtues të DSHTD, me shkresën nr.81/4 prot., datë 28.01.2021, relacionin lidhur me një shtesë fondi me vlerë 6,340 euro në planin ekonomik-financiar 2021, për kryerjen e punimeve në apartamentit nr.13 dhe nr.15, në Romë.

Me shkresën nr. 81/5 prot., datë 28.01.2021, DSHTD ka autorizuar Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë për kryerjen e punimeve të kërkuara në apartamentet nr. 13 dhe nr. 15 ku do të akomodohen diplomatët e rinj në detyrë dhe në përfundim të punimeve dërgimi i dokumentacionit të nevojshëm DSHTD-së për kryerjen e pagesës.

Me shkresën nr. 135 prot., datë 17.02.2021, protokolluar DSHTD nr. 81/7 prot., datë 17.02.2021, Ambasada e RSH-së në Romë ka vënë në dijeni se gjatë kryerjeve të punimeve në apartamentin

nr.13, në tualet nga lavamani i thyer pati rrjedhje uji dhe tubat e shkarkimit në tualet dhe aneks kishin nevojë për ndërhyrje urgjente. Këto punime emergjente u kryen nga OE E. dhe u morën në dorëzim nga komisioni. Komisioni i marrjes në dorëzim të punimeve i përbërë nga L.H., Sh.Sh., J.A. dhe T.K., ka mbajtur procesverbalin më datë 10.02.2021, mbi punimet e kryera në apartamentet nr.13 dhe nr.15, të cilat janë në përputhje me faturën e dërguar nga operatori ekonomik. (Bashkëlidhur fatura e OE nr. 15B/2021 datë 08.02.2021, me vlerë 6,340 euro, për lyerjen e apartamenteve dhe nr. 16B/2021 datë 08.02.2021, me vlerë 850 euro, për punimet emergjente). Me Urdhrin nr. 81, datë 24.02.2021, me shkresën nr. 169 prot., datë 24.02.2021, urdhërohet kryerja e pagesës me shumën, prej 6,340 euro dhe me Urdhrin nr. 82, datë 24.02.2021, me shkresën nr. 170 prot., datë 24.02.2021, urdhërohet kryerja e pagesës me shumën, prej 850 euro, për llogari të firmës E. për punimet e kryera në apartamentet nr.13 dhe nr.15. Pagesa e kryer me transfertën e datës 24.02.2021 me vlerë 7,190 euro.

**Gjetje:** Nga auditimi i procedurës u konstatuan këto mangësi:

- Ofertat e paraqitura i referohen vlerës totale të punimeve, por nuk është e detajuar me zërat e punimeve specifike, në kundërshtim nënin 9 të ligjit 87/2019.
- Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë në analogji me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi.

#### **4. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, viti 2021:**

**Punime të nevojshme dhe të domosdoshme në godinën e Ambasadës, me vlerë 9,955 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

Sipas planifikimit të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik, me VKD nr.28, datë 28.12.2020, ka planifikuar investime për Ambasadën e RSH-së në Athinë në shumën 10,000 euro.

Sipas Akt-Rakordimit mbajtur në Ambasadën e RSH-së në Athinë me shkresën nr. 1724 prot., datë 05.11.2021, protokolluar në DSHTD nr. 937/3 prot., datë 08.11.2021, midis grupit të punës të DSHTD-së i përbërë nga A.S., B.K., E.D. dhe Ambasadores L.H., lidhur me verifikimin e nevojave për investim-mirëmbajtje në godinën e ambasadës në kuadër të planit për vitin 2022. Në akt rakordim pas verifikimeve u vendos që disa punime emergjente të realizoheshin gjatë vitit 2021 dhe punimet e parashikuara për vitin 2022 sipas nevojave.

Ambasada e RSH-së në Athinë në vijim të Akt-Rakordimit të mësipërm, me shkresën nr. 1724/1 prot., datë 11.11.2021, protokolluar në DSHTD nr. 937/8 prot., datë 12.11.2021, ka përcjellë ofertat e marrë nga firmat që operojnë në tregun grek, që të vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në DSHTD.

Më datë 12.11.2021, nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga B.K., E.A. dhe A.N., është mbajtur procesverbalin “Mbi përcaktimin e ofertës fituese për kryerjen e punimeve emergjente në godinën e Ambasadës së RSH-së në Athinë”.

Nr.	OE	Çmimi i ofertuar përfshirë detyrimet fiskale (euro)	Data e ofertës
1	A.M.	9,954.72	10.11.2021
2	R.D.	10,339.12	11.11.2021
3	A.B.	10,661.52	09.11.2021

Komisioni ka vlerësuar ofertat e ardhura, dhe bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, vlerëson se oferta fituese është ajo e paraqitur nga OE A.M., me ofertë 9,954.72 euro përfshirë detyrimet fiskale.

Me shkresën nr. 937/10 prot., datë 15.11.2021, komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, i jep informacion titullarit mbi realizimin e procedurës, shpalljen e fituesit dhe bashkëlidhur procesverbalin mbi vlerësimin e ofertave dhe shkresa e ardhur nga ambasadorja e RSH-së në Athinë, nr. 1724/1 prot., datë 11.11.2021.

Ambasadorja e RSH-së në Athinë L.H., me anë të Urdhrit të brendshëm të datës 05.11.2021, urdhëron ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve të mirëmbajtjes së godinës, me përbërje: R.B., S.V., J.Zh., A.P., E.V., M.Q.

DSHTD me shkresën nr. 937/12 prot., datë 15.11.2021, autorizon Ambasadën e RSH-së në Athinë,

për kryerjen e punimeve të nevojshme dhe të domosdoshme në godinën e Ambasadës, me OE A.M., i shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Ambasada e RSH-së në Athinë me shkresën nr. 1886 prot., datë 26.11.2021, protokolluar në DSHTD nr. 937/13 prot., datë 06.12.2021, përcjell praktikën e punimeve emergjente të kryera në godinën e Ambasadës së RSH-së në Athinë, dhe me shkresën nr. 1886/1 prot., datë 16.12.2021, protokolluar në DSHTD nr. 937/15 prot., datë 16.12.2021, dërgon dokumentacionin plotësues të punimeve emergjente të kryera.

Të dhënat mbi punimet e kryera sipas situacioneve dhe faturave jepen në tabelën nr.7 Aneksi IV.

Komisioni i marrjes në dorëzim të punimeve dhe ambasadorja, kanë mbajtur procesverbalin nr. 18 prot., datë 26.11.2021, mbi marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në godinën e Ambasadës së RSH-së në Athinë, të kryera nga OE A.M. Kompania e cila ka kryer punimet ka dorëzuar dhe një garanci 6 mujore mbi punimet e realizuara.

Pagesa e kryer me urdhër trasfertën e datës 22.12.2021 me vlerë 9,954.72 euro, transferim fondesh Ambasadës së RSH-së në Athinë për punime në godinën e ambasadës.

**Gjetje:** Nga auditimi i procedurës u konstatuan këto mangësi:

Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë në analogji me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi.

## **5. Misioni i përhershëm RSH-së pranë OKB-së New York, viti 2021:**

**Punime emergjente për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga ngrica në apartamentet e godinës, me vlerë 10,050 usd pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

Misioni i RSH-së në New York me shkresën nr. 43 prot., datë 18.02.2021, protokolluar në DSHTD nr. 111/2 prot., datë 24.02.2021, vënë në dijeni se në kushtet e emergjencës dhe në vijim të shkresës së DSHTD-së nr. 111/1 prot., datë 04.02.2021 për autorizimin e kryerjes së punimeve, për arsye të çarjes së tubave në bodrumin e godinës së Misionit për shkak të temperaturave të ulta, u përgjigj vetëm kompania L. për kryerjen e punimeve.

Më datë 17.02.2021, u mbajt procesverbali mbi punimet e realizuara në kushtet e emergjencës - Punimet emergjente hidraulike dhe elektrike, izolim i çarjes së tubave të ujit dhe zëvendësimi i tyre me tuba të rinj, riparim i ngrohësit të bodrumit, vlera e punimeve 4,750 USD.

Dhe punime hidraulike në 4 apartamentet e Misionit, zëvendësim mishilatorësh të amortizuar, bllokim i rrjedhjes së ujit të ngrohtë, zëvendësim i tubave të dëmtuar dhe zëvendësim bolieri, vlera e punimeve 5,300 USD. Ky procesverbal u mbajt në prani të anëtarëve të misionit, E.L., A.B., A.C., A.K., N.B., E.K.

Spektori i planifikimit dhe financës në DSHTD, i ka dërguar Këshillit Drejtues të DSHTD, me shkresën nr.111/3 prot., datë 25.02.2021, relacionin lidhur me punimet e kryera në kushtet e emergjencës për riparimin e dëmtimit të shkaktuara nga ngrica në tubacionin e ujit dhe në disa nga ambientet e godinës së Misionit të përhershëm të RSH-së pranë OKB-së, në New York. Në relacion jepet informacion mbi punimet e kryera dhe kërkohet miratimi i punimeve me vlerë 10,050 USD pa taksat e cila do të përballohet nga fondi prej 100,000 USD i parashikuar për New York-un në planin ekonomik-financiar 2021, miratuar me VKD nr.28, datë 28.12.2020.

Me Urdhrin nr. 87, datë 01.03.2021, me shkresën nr. 183 prot., datë 01.03.2021, urdhërohet kryerja e pagesës me shumën, prej 10,050 USD, për llogari të Misionit të përhershëm të RSH-së pranë OKB-së New York për punimet emergjente hidraulike dhe elektrike në ndërtesën e misionit.

Pagesa e kryer me urdhër trasfertën e datës 01.03.2021 me vlerë 10,050 USD, Misionit të përhershëm të RSH-së pranë OKB-së New York, për pagesën e faturave nr. 1110, datë 12.02.2021 dhe 16.02.2021 kundrejt kompanisë L., për kryerjen e punimeve emergjente në godinën e misionit.

**Gjetje:** Nga auditimi i procedurës u konstatuan këto mangësi:

- Ofertat e paraqitura i referohen vlerës totale të punimeve, por nuk është e detajuar me zërat e punimeve specifike, që kanë sjellë një vlerë totale.

- Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë në analogji me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi.
- Vlera prej 2,500 USD është likuiduar në mungesë të faturës, por referuar një oferte projekt propozim.

## 6. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë, viti 2022:

**Punime ne godinën e Ambasadës sipas Fazës se II te projektit, me vlerë 109,851 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

### A. *Të dhëna mbi objektin*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Faza e dytë e projektit të Ambasadës së RSH-së në Romë</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e kufizuar” Urdhri nr. 367, datë 12.10.2022	<b>2. Hartimi kritereve specifike, përlogaritja e fondit limit:</b> E.I.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 366, datë 12.10.2022 E.I. D.B. E.Ç.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 373, datë 24.10.2022 E.Ç. S.H. I.B.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 109,851 euro	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 109,851 euro		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 0 euro
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 12.10.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD		<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>2 OE</b> ; b) Skualifikuar 1 OE: M. c) Kualifikuar 1 OE N.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 60 ditë			
<b>12. Ankimime</b> s’ka;	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> s’ka;	<b>14. Përgjigje Ankesës nga</b> APP-s’ka; KPP-s’ka;	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 961/3 prot., datë 11.11.2022	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Situacioni pjesor nr.1 është likuiduar me urdhër transfertën e datës 05.01.2023 me shumën 34,991 euro.		
<b>16. Mbikëqyrësi i punimeve</b> A.C., specialist në DSHTD-së			<b>Urdhër</b> nr.441 prot., datë 14.12.2022

### **-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.**

Projekti “Rikonstruksion e rikompozim i zyrave të seksionit konsullor dhe ambientit të hyrjes në godinën e Ambasadës së RSH-së në Romë” është kryer nga Studio A., dhe dorëzuar në DSHTD me nr. 166/6 prot., datë 15.04.2019.

Sipas relacionit nr. 166/9 prot., datë 18.04.2019, drejtuar KD-së DSHTD mbi miratimin e Projekt preventivi me vlerë 176,273.53 euro, nga të cilat punime të brendshme janë në vlerën 126,162.41 euro dhe punime të jashtme me vlerë 50,111.12 euro.

Punimet e brendshme janë parashikuar të realizohet me 2 faza, faza e parë (2019) përfshin punimeve të parashikuar në preventiv 50,910 Euro dhe punime në apartamente e diplomatëve vlera totale 58,551 euro, situacionuar vlera 58,163 euro, faza e dytë përfshin punimeve të parashikuar në preventiv vlera 71,820 euro dhe punime shtesë në katin e parë 12,580 euro.

DSHTD me VKD nr.25 datë 16.11.2021, shkresa nr. 1019 prot., datë 16.11.2021, ka anuluar fondin prej 120,000 EUR, të parashikuar në planin ekonomik financiar 2021 dhe miratoi rialokimin e këtij fondi për vitin 2022.

Me Urdhrin nr. 163, datë 18.05.2022, me shkresën nr. 448 prot., datë 18.05.2022 është ngritur grupi i punës i përbërë nga E.P., E.Ç., I.B., S.H., për verifikimin e nevojave, studimin e tregut, përcaktimi

i procedurave të prokurimit dhe verifikimin e apartamenteve në Romë. Grupi i punës ka hartuar relacionin mbi vizitën e kryer në Ambasadën në Romë, çështjet e diskutuara dhe të dakordësuara.

Urdhri nr. 366 datë 12.10.2022, shkresa nr. 961 prot., datë 12.10.2022, ka urdhëruar ngritjen e njësisë së prokurimit për procedurën me objekt “Faza e II e projektit të ambasadës së RSH-së në Romë, Itali”, me përbërje E.I., D.B. dhe E.Ç. Urdhër prokurimi nr. 367, datë 12.10.2022, urdhëron kryerjen e prokurimit, procedurë e kufizuar, me fond limit 109,851 Euro pa përfshirë taksat dhe tvsh dhe njësi prokurimi sipas Urdhrit nr.366 datë 12.10.2022.

Njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbali nr.1, datë 12.10.2022, mbi përgatitjen e preventivit të punimeve si dhe kriteret e veçanta për kualifikim për procedurat e prokurimit me objekt: “Faza e II e projektit të ambasadës së RSH-së në Romë, Itali”.

Njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin nr.2, datë 12.10.2022, mbi hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, përfshirë preventivin e punimeve dhe grafikun e punimeve sipas procesverbalit nr.1. Si dhe njësia e prokurimit ka vendosur të ftojë për të marrë pjesë OE, të cilët kanë bashkëpunuar në punimet e kryera më parë: N., M., E.

DSHTD në muajin tetor 2022 ka publikuar në faqen e saj të web-it njoftimin për dorëzimin e shprehjes së interesit për pjesëmarrjen në procedurën e kufizuar me objekt “Faza e II e projektit të ambasadës së RSH-së në Romë, Itali”, si dhe më datë 14.10.2022 ka dërguar me postë elektronike ftesat 3 OE sipas PV nr.2, datë 12.10.2022.

#### ***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Me Urdhrin nr. 373, datë 24.10.2022, shkresa nr. 1003 prot., datë 24.10.2022, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave, me përbërje E.Ç., S.H. dhe I.B.

M. ka dorëzuar me postë shprehjen e interesit, protokolluar DSHTD nr. 1003/1 prot., datë 24.10.2022, përkatësisht ofertën për Fazën e II të projektit të Ambasadës Shqiptare në Romë me vlerë 135,325.69 Euro dhe ofertën e punimeve që do kryhen në godinën e Ambasadës së RSH-së, në Romë me vlerë 48,380 Euro, në total 183,705.69 Euro.

N. ka dorëzuar me postë shprehjen e interesit, protokolluar DSHTD nr. 1003/2 prot., datë 24.10.2022, dokumentacionin e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka mbajtur procesverbalin nr.3 datë 24.10.2022, për verifikimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe dokumentacionin e dorëzuar, ku ishin pjesëmarrës 2 OE, përkatësisht N. dhe M. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, KVO ka mbajtur procesverbalin nr.4, datë 25.10.2022, ku vendosi kualifikimin për në fazën e dytë të procedurës OE N. dhe të skualifikojë për dorëzim dokumentacioni jo të rregullt OE M.

DSHTD i ka dërguar me postë elektronike, më datë 25.10.2022, OE N. ftesën për ofertë për fazën e dytë. Më datë 27.10.2022, OE ka dërguar ofertën me anë të shkresës shoqëruese për Fazën e II të projektit të Ambasadës Shqiptare në Romë me vlerë 86,800.83 Euro dhe ofertën e punimeve që do kryhen në godinën e Ambasadës së RSH-së, në Romë me vlerë 23,050.17 Euro, në total 109,851 Euro. Në shkresën shoqëruese të ofertës është specifikuar se në lidhje me zërin nr.5 në preventivin e punimeve që do kryhen në godinën e Ambasadës së RSH-së, në Romë, “Kontrolli dhe riparimi i sistemit të ajrit të kondicionuar të zyrave të përfaqësive dhe eliminimi i kondensimeve që kullojnë në muret e brendshme dhe jashtme të ndërtesës”, në rast të ndërhyrjeve shtesë të mirëmbajtjes së impiantit do vlerësohet teknikisht dhe ekonomikisht.

Procesverbali nr.5, datë 27.10.2022, mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës të OE të kualifikuar për në fazën e dytë, oferta e paraqitur me vlerë 109,851 euro është vlerësuar nga Komisioni si ofertë e rregullt dhe ka vendosur kualifikimin e OE N.

#### ***-Lidhja e kontratës***

Është lidhur kontrata me nr.961/3, datë 11.11.2022 midis AK DSHTD dhe OE N., me afat realizimi punimesh 60 ditë kalendarike nga dita që kontraktorit i dorëzohet sheshi i punës, me vlerë kontrate 109,851euro pa përfshirë taksat dhe tvsh.

Sigurimi i kontratës është marrë me vlerë 10,985.1 euro.

DSHTD me shkresën nr. 961/4 prot., datë 14.11.2022, ka njoftuar Ambasadën e RSH-së në Romë për nënshkrimin e kontratës dhe i kërkohet vënia në dispozicion e sheshit të ndërtimit kontraktorit të

punimeve.

Titullari i DSHTD-së me Urdhrin nr. 441, datë 14.12.2022, shkresa nr.1234 prot., datë 14.12.2022, urdhëron caktimin e Mbikëqyrësit të punimeve A.C., specialist pranë Drejtorisë së Projektimit, zbatimit e monitorimit të DSHTD-së.

#### ***-Zbatimi i kontratës.***

OE ka sjellë me postë elektronike më datë 07.12.2022, situacionin dhe faturën për punimet e realizuara, me vlerë 36,833.10 euro.

Urdhri nr. 443, datë 16.12.2022, shkresa 1239 prot., darë 16.12.2022, për dërgim me shërbim të mbikëqyrësit të punimeve me qëllim mbikëqyrjen e ecurisë së punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën nr.1234/2 prot., datë 23.12.2022, jep informacion mbi ecurinë e punimeve dhe verifikimin e punimeve sipas situacionit pjesor nr.1. Situacioni pjesor nr.1, periudha 23.11.2022-30.11.2022, me vlerë 36,883.1 euro nga të cilat vlera e pagueshme 34,991.44 euro dhe garancia e mbajtur 1,841.66 euro.

Pagesa e kryer me urdhër transfertën e datës 05.01.2023 me vlerë 34,991 euro, operatorit N. sipas faturës nr.41, datë 06.12.2022.

#### ***Zbatimi i kontratës duhet të auditohet në auditimin e ardhshëm.***

**Gjetje:** Nga auditimi i procedurës u konstatuan këto mangësi:

- Mungon publikimi i njoftimit në vendin e origjinës ku do të kryhen punimet në analogji me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi.
- Në DST është kërkuar që dokumentacioni të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe, OE i ka dorëzuar një pjesë të dokumentacionit të marrë nga institucionet e vendit të origjinës në gjuhën italiane pa u noterizuar siç kërkohet në DST.

### **7. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, viti 2022:**

**Kryerje e punimeve në godinën e ambasadës, me vlerë 49,093 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

#### ***B. Të dhëna mbi objektin***

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Kryerje e punimeve në godinën e ambasadës së RSH-së në Athinë, Greqi</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e kufizuar” Urdhri nr. 202, datë 20.06.2022	<b>2. Hartimi kritereve specifike, përlogaritja e fondit limit:</b> Sh.I.	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 203, datë 20.06.2022 Sh.I. D.B. E.Ç.	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 217, datë 04.07.2022 E.Ç. S.H. I.B.
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 49,556 euro	<b>6. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 49,093 euro		<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 463 euro
<b>8/1 Data e publikimit të tenderit</b> Data 20.06.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Fondet e DSHTD		<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>1 OE;</b> b) Kualifikuar 1 OE A.M.
<b>8/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 63 ditë			
<b>12. Ankimime</b> s’ka;	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> s’ka;		<b>14. Përgjigje Ankesës nga</b> APP-s’ka; KPP-s’ka;
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>15. Lidhja e kontratës</b> Kontrata me nr. 594/6 prot., datë 15.08.2022	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Situacionet janë likuiduar me urdhër transfertën e dhjetorit 2022 me shumën 32,067.52 euro, me urdhër transfertën e datës 16.01.2023 me vlerë 1,472.79 euro, dhe me urdhër transfertën e datës 16.01.2023 me vlerë 11,634.3 euro		
<b>16. Mbikëqyrësi i punimeve A.D.</b>	<b>Urdhër</b> nr.323 prot., datë 19.09.2022		



17. Përgjegjës për marrjen në dorëzim të Punimeve Sh.I.		
---	--	--

***-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.***

Grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 260, datë 27.10.2021, i përbërë nga A.S., B.K. dhe E.D., ka shkuar me shërbim me qëllim verifikimin e nevojave dhe investimeve të kërkuara nga Ambasada e RSH-së në Athinë. Grupi i punës ka mbajtur Akt-rakordimin me ambasadën me nr. 1724 prot., datë 05.11.2021, protokolluar në DSHTD nr. 937/7 prot., datë 08.11.2021, ku u dakordësuar për punimet e parashikuara për 2022.

DSHTD ka planifikuar një fond për vitin 2022, në vlerën 65,000 euro.

Grupi i punës i DSHTD-së i përbërë nga E.P., E.Ç., G.V., S.H. i ngritur për verifikimin e nevojave të parashikuara në planin e vitit 2022 dhe defektet dhe punimet e parashikuara që kërkojnë marrjen e masave emergjente.

Grupi i punës dhe Ambasadorja e RSH-së në Athinë ka mbajtur akt rakordimin me shkresën nr. 650 prot., datë 13.05.2022, në Ambasadën e Athinës, protokolluar DSHTD nr. 397/4 prot., datë 16.05.2022, ka krahas punimeve të parashikuara për vitin 2022 u pa e nevojshme si emergjente punimet për riparimin e filtrit të ujit në hapësirën e arkivës, vendosja e një rack-u të ri, sistemi i kabllimit dhe sistemi i ajrimit në hapësirën ku ndodhet rack.

DSHTD me VKD nr.5 datë 16.06.2022, shkresa nr. 547/2 prot., datë 16.06.2022, ka miratuar vlerën e investimit në Athinë për vitin 2022 prej 49,556 euro, e cila përballohet nga vlera e parashikuar në planin ekonomik financiar 2022.

Urdhër prokurimi nr. 202, datë 20.06.2022, shkresa 556 prot., datë 20.06.2022, urdhëron kryerjen e prokurimit me objekt kryerjen e punimeve në godinën e ambasadës së RSH-së në Athinë, Greqi, procedurë e kufizuar, me fond limit 49,556 Euro pa tvsh dhe njësi prokurimi me përbërje Sh.I., D.B. dhe E.Ç.

Njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin nr.1, datë 20.06.2022, mbi përgatitjen e preventivit të punimeve si dhe kriteret e veçanta për kualifikim për procedurat e prokurimit me objekt: “Kryerje e punimeve në godinën e ambasadës së RSH-së në Athinë, Greqi”, ka hartuar kriteret e veçanta për kualifikim, specifikimet teknike dhe grafikun e punimeve.

Njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin nr.2, datë 20.06.2022, mbi hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, përfshirë preventivin e punimeve dhe grafikun e punimeve sipas procesverbalit nr.1. Si dhe njësia e prokurimit ka vendosur të ftojë për të marrë pjesë OE, të cilët kanë bashkëpunuar në punimet e kryera më parë: R.D., A.M., J.B.

DSHTD në muajin qershor 2022 ka publikuar në faqen e saj të web-it njoftimin për dorëzimin e shprehjes së interesit për pjesëmarrjen në procedurën e kufizuar me objekt “Kryerje e punimeve në godinën e ambasadës së RSH-së në Athinë, Greqi”, si dhe më datë 23.06.2022 ka dërguar me postë elektronike ftesat 3 OE sipas PV nr.2, datë 20.06.2022.

***-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.***

Me Urdhrin nr. 217, datë 04.07.2022, shkresa nr. 594 prot., datë 04.07.2022, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave, me përbërje E.Ç., S.H. dhe I.B.

A.M. ka dorëzuar me postë shprehjen e interesit, protokolluar DSHTD nr. 594/1 prot., datë 04.07.2022, dokumentacionin e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit të përkthyer në gjuhën shqipe.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka mbajtur procesverbalin nr.3 datë 04.07.2022, mbi hapjen dhe pranimin e ofertave, ku ishin pjesëmarrës 1 OE, A.M. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të

dorëzuar, KVO ka mbajtur procesverbalin nr.4, datë 08.07.2022, ku vendosi kualifikimin për në fazën e dytë të procedurës OE A.M.

DSHTD i ka dërguar me postë elektronike, më datë 08.07.2022, OE ftesën për ofertë për fazën e dytë. OE ka dërguar ofertën me postë, protokolluar DSHTD nr. 594/2 prot., datë 14.07.2022, me vlerë 49,093 Euro pa tvsh dhe pa taksa.

Procesverbali nr.5, datë 18.07.2022, mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës të OE të kualifikuar për në fazën e dytë, oferta e paraqitur me vlerë 49,093 euro është vlerësuar nga Komisioni si ofertë e rregullt dhe ka vendosur kualifikimin e OE A.M..

Me shkresën nr. 594/4 prot., datë 25.07.2022, komisioni i vlerësimit të ofertave, i dërgon titullarit raportin përmbledhës mbi realizimin e procedurave për të dy fazat, shpalljen e fituesit OE A M., dhe është miratuar nga titullari i DSHTD-së E.P.

#### ***-Lidhja e kontratës***

Është lidhur kontrata me nr.594/6, datë 15.08.2022 midis AK DSHTD dhe OE A.M., me afat realizimi punimesh 63 ditë kalendarike nga dita që kontraktorit i dorëzohet sheshi i punës, me vlerë kontrate 49,093 euro pa përfshirë taksat dhe tvsh.

Sigurimi i kontratës është marrë me vlerë 4,909 euro (sigurim nga banka).

Titullari i DSHTD-së me Urdhrin nr. 323, datë 19.09.2022, shkresa nr.846 prot., datë 19.09.2022, urdhëron caktimin e Mbikëqyrësit të punimeve A.D. dhe personin përgjegjës për marrjen në dorëzim të punimeve Sh.I.

#### ***-Zbatimi i kontratës.***

OE ka sjellë me postë elektronike më datë 19.09.2022, njoftimin për fillimin e punimeve. OE ka sjellë me postë elektronike më datë 21.11.2022, njoftimin për përfundimin e punimeve më datë 20.11.2022, brenda afatit kontraktual.

Situacioni përfundimtar me shume totale akumulative të punimeve është 45,165.56 euro e certifikuar nga kontraktori i punimeve dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe miratuar nga zv. Drejtori dhe Drejtori i DSHTD-së.

Pagesa e kryer me urdhër trasfertën e dhjetorit 2022 me vlerë 32,067.52 euro, Ambasadës së RSH-së në Athinë sipas faturave. Me urdhër trasfertën e datës 16.01.2023 me vlerë 1,472.79 euro, Ambasadës së RSH-së në Athinë sipas faturave. Me urdhër trasfertën e datës 16.01.2023 me vlerë 11,634.3 euro, Ambasadës së RSH-së në Athinë sipas faturave.

Të dhënat mbi punimet e kryera sipas situacioneve dhe faturave jepen në tabelën nr.8 Aneksi IV.

Akti i marrjes në dorëzim të punimeve të objektit “Punime në godinën e Ambasadës së RSH-së Athinë, Greqi”, i mbajtur më datë 12.12.2022, në prani të komisionit të marrjes në dorëzim të DSHTD-së E.Ç., Sh.I., Kontraktorit të punimeve A.M. dhe Ambasadores së RSH në Athinë L.H., ku pranon që punimet janë realizuar konform kontratës dhe komisioni i merr në dorëzim punimet.

**Gjetje:** Nga auditimi i procedurës u konstatuan këto mangësi:

- Mungon publikimi i njoftimit në vendin e origjinës ku do të kryhen punimet në analogji me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi.
- Në dokumentacionin e dorëzuar nga OE i kualifikuar mungojnë të dhëna për disponimin e një mjeti për transport me kapacitet jo më të vogël se 2.5 ton, në kundërshtim me pikën 2.6 kriteret e veçanta të DST.
- Kontraktori i punimeve ka dorëzuar dy fatura pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve në proces verbalin e marrjes në dorëzim.
- Punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim në kantier paraqiten nga sipërmarrësi në situacione pjesore, sipas periudhave progresive të zhvillimit të punimeve, dhe në atë përfundimtar, punimet e certifikuara në situacionit përfundimtar nuk kanë periudhën progresive të zhvillimit të tyre në kundërshtim Udhëzimin nr.2, datë 13.05.2005 Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, gjithashtu mungesa e datës së miratimit të situacionit përfundimtar si dokumenti që konfirmon miratimin e pagesës sjell dhe mos kontrollin mbi zbatimin e pikës 4.1 të kontratës Kushtet e pagesës.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	<i>Parregullsi në realizimin e procedurave të Investimeve jashtë territorit të RSH-se:</i>
<b>Situata:</b>	<p><b>1. Investime Roma 2020:</b> Ofertat nuk janë të detajuara me zërat e punimeve specifike, por një vlerë totale. Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë. Dokumentacioni për marrjen në dorëzim të punimeve nuk përfshihet Urdhri i ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim. Janë konsideruar punime emergjente rregullim parketi, lysterje e vendosje karrigesh zyre, që nuk justifikojnë emergjencën.</p> <p><b>2. Investime Athina 2020:</b> Për dy procedura mungon urdhri i ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim. Fatura tatimore me vlerë 222.58 euro dhe fatura 494.2 euro nuk kanë elementët kryesore të faturave në kundërshtim nenin 9 të ligjit 87/2019. Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë.</p> <p><b>3. Investime Roma 2021:</b> Ofertat nuk janë të detajuara me zërat e punimeve specifike, por një vlerë totale. Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë.</p> <p><b>4. Investime Misioni i përhershëm RSH-së pranë OKB-së New York, 2021:</b> Ofertat nuk janë të detajuara me zërat e punimeve specifike, por një vlerë totale. Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë. Vlera prej 2,500 USD është likuiduar në mungesë të faturës, por sipas një oferte projekt propozim.</p> <p><b>5. Investime Roma 2022:</b> Mungon publikimi i njoftimit në vendin e origjinës ku do të kryhen punimet, KVO nuk e ka evidentuar si devijim të vogël që OE i ka dorëzuar një pjesë të dokumentacionit të marrë nga institucionet e vendit të origjinës në gjuhën italiane pa u noterizuar siç kërkohet në DST.</p> <p><b>6. Investime Athina 2022:</b> Mungon publikimi i njoftimit në vendin e origjinës ku do të kryhen punimet, KVO ka kualifikuar OE në mungesë të të dhënave për disponimin e një mjeti për transport me kapacitet jo më të vogël se 2.5 ton, në kundërshtim me DST. Kontraktori i punimeve ka dorëzuar dy fatura pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim. Punimet e certifikuar në situacionit përfundimtar nuk kanë periudhën progresive të zhvillimit të tyre në kundërshtim Udhëzimin nr.2, datë 13.05.2005.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligjit 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011. Udhëzimin nr.2, datë 13.05.2005 Për zbatimin e punimeve të ndërtimi.
<b>Ndikimi:</b>	Mungesë e dokumentacionit të rregullt dhe mos transparencë në realizimin e procedurave të prokurimit.
<b>Shkaku</b>	Mungesa e aktit të miratuar nga ministri, ka shkaktuar problematika në realizimin e procedurave me transparencën, marrjen e ofertave sipas punimeve specifike dhe mos vlerësimin e saktë të ofertave.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>1. Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në bashkëpunim me Ambasadat e RSH jashtë territorit, të cilat kanë në përdorim pronat e DSHTD-së, për procedurat e realizuara për këto ambiente të realizohen me transparencë duke publikuar njoftimet për të nxitur konkurrencën dhe ngritjen e grupeve të marrjes në dorëzim sipas Urdhrave të Titullarëve

	respektivë dhe marrjen e ofertave me zëra specifik.
<b>2. Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, të marrë masa për verifikimin e faturave për kryerjen e investimeve në mënyre që të kenë të gjitha elementët kryesore që e bëjnë një faturë të rregullt, para kryerjes së pagesës dhe të jenë brenda afateve kontraktuale ose marrjes në dorëzim.
<b>3. Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurat e investimeve jashtë territorit të RSH, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, për të siguruar dobishmëri në përdorimin e fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Sektori i Financës, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.*

## **2.5. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR**

Në zbatim të programit të auditimit vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit është trajtuar sipas komponentëve përkatës si vijon:

Titullarët e njësisë të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

### **1. Mjedisi i kontrollit**

Grupi i parë i komponentëve të kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli (brendshëm) në një njësi të caktuar. Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy aspekte: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale; dhe të dy duhet të ndërveprojnë. Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

### **Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit**

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik është person juridik publik, në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe e ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje të ligjit nr. 7582, date 13.7.1992 "Për Ndërmarrjet Shtetërore", VKM nr. 840 date 17.12.2004 "Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik", i ndryshuar, DSHTD funksionon me status të veçantë. Organizimi, struktura dhe mënyra e funksionimit të saj rregullohet bazuar në rregulloren e saj dhe statutin e miratuar nga MEPJ në zbatim të pikës 10 të VKM nr. 840 ku është përcaktuar se: "Mënyra e organizimit dhe e ushtrimit të veprimtarisë së DSHTD-se, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre, përcaktohen në statutin, që miratohet nga Ministri i Punëve të Jashtme".

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me respektimin e strukturave të DSHTD për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2022, u konstatua se DSHTD ka pësuar ndryshime në strukturë dhe organikë, në bazë të miratimit të Këshillit Drejtues në fillim të çdo viti.

Për çdo vit nga DSHTD janë dërguar për miratim struktura dhe pagat pranë MEPJ (si më poshtë vijon:)

(1) Për vitin 2019 është marrë miratimi nga MEPJ për strukturën dhe pagat me shkresa me nr. prot. 391/1 datë 01.01.2019 dhe numri total i punonjësve është 57 persona.

(2) Për vitin 2020 është dërguar shkresa me nr. prot. 38 datë 13.01.2020 për miratim nga MEPJ për strukturën dhe pagat dhe numri total i punonjësve është 58 persona.

(3) Për vitin 2021 është dërguar shkresa me nr. prot. 11 datë 07.01.2021 për miratimi nga MEPJ për strukturën dhe pagat dhe numri total i punonjësve është 60 persona.

(3) Për vitin 2022 është marrë miratimi nga MEPJ për strukturën dhe pagat me shkresën me nr. prot. 56/2 datë 08.02.2022 dhe numri total i punonjësve është 70 persona.

### **Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore**

Institucioni në rregulloren e brendshme, Kreu XI “Marrëdhëniet e Punës dhe Disiplina në Punë” ka të përcaktuar procedurat për organizimin, funksionimin dhe përsëkrimet e punës, rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, procedurat e rekrutimit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës.

**Gjetje 1:** Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 nga Këshilli Drejtues është shtuar 1 punonjës më shumë në krahasim me strukturën e miratuar nga MEPJ të vitit 2019, ndërsa për vitin 2021 janë shtuar 2 me shumë punonjës në krahasim me strukturën e miratuar nga MEPJ të vitit 2019. Këto ndryshime nuk kanë marrë me parë miratimin e MEPJ pavarësisht së nga DSHTD janë dërguar shkresat për marrjen e dakordësisë. Këto veprime janë në kundërshtim me statutin e DSHTD miratuar me shkresë nr. prot. 1842 datë 17.02.2011, pika 15 ku citohet “*Struktura organizative e DSHTD bëhet me propozim të drejtorit dhe me miratim të Këshillit Drejtues. Vendimi i Këshillit Drejtues dërgohet për aprovim Ministrisë së punëve të jashtme dhe merr fuqi ligjore vetëm pas nënshkrimit*”.

**Gjetje 2:** Nga auditimi u konstatua se në zbatim të strukturës dhe organikës së re të DSHTD të miratuar nga MEPJ me shkresë nr. 56/2 datë 08.02.2022 e cila nga 57 bëhet 70 punonjës, nga DSHTD nuk është përditësuar rregullorja e brendshme ku të përcaktohen detyrat funksionale që ka çdo Drejtori, sektor dhe punonjës i DSHTD por në fuqi është rregullorja e miratuar nga VKD nr.12 datë 29.06.2018. Veprime të tilla janë në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” Neni 20, pika c ku citohet se: “*strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit*”.

### **Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;**

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se ‘Kudri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje’. Baza ligjore për etikën është e përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të DSHTD miratuar me VKD nr. 12, dt. 29.06.2018, Kreu X “*Marrëdhëniet e Punës dhe Disiplina në Punë*”, neni 46 “*Etika për Punonjësit e DSHTD*”.

-Deklarimi i konfliktit të interesit bëhet në përputhje me ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 për “*Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar. Në çdo procedure prokurimi është bashkëlidhur “*Formulari i deklarimit*” i plotësuar nga anëtarët e komisionit të cilat kanë deklaruar nëse ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit apo jo.

### **Politikat menaxheriale dhe stili i punës;**

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth

mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxiti kompetencën dhe sjelljen etike. Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale.

Gjithashtu, në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se ‘Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike’. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se ‘Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave’.

Grupit të auditimit i është paraqitur Urdhri i Titullarit të DSHTD nr. prot. 971/1, dt. 01.10.2019 për ngritjen e komisionit të planifikimit të planit ekonomik – financiar afatmesëm për periudhën 2020 – 2022 dhe me Vendim të KD nr. 1, dt. 06.1.2020 është miratuar plani ekonomik – financiar afatmesëm për periudhën 2020 – 2022. Gjithashtu me urdhër të Titullarit të DSHTD nr. prot. 1316/1, dt. 30.12.2022 për ngritjen e komisionit të planifikimit të planit ekonomik – financiar afatmesëm për periudhën 2023 – 2025, i cili nuk është miratuar ende.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike’, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se ‘GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë.

Komisioni strategjik i ngritur për përpilimin e planit ekonomik – financiar afatmesëm për periudhën 2020 – 2022 ka realizuar mbledhje për diskutimin e ecurisë së punës së tyre, por nuk ka dokumentacion që konfirmon se takimet janë zhvilluar.

**Gjetje 3:** Grupi i auditimit konstatoi se Komisioni strategjik i planifikimit nuk ka dokumentuar procesverbalet e mbledhjeve të kryera, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”.

## 2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.’ Për sa më sipër, DSHTD ka hartuar regjistrin e riskut dhe e ka përditësuar atë vit pas viti. Konkretisht:

- Me shkresën nr. 119/26 prot., datë 31.12.2019 është hartuar strategjia e riskut për vitin 2020
- Me shkresën nr. 70/26 prot., datë 31.12.2020 është hartuar strategjia e riskut për vitin 2021
- Me shkresën nr. 595 prot., datë 04.07.2022 është hartuar strategjia e riskut për vitin 2022

Strategjia e riskut përfshin identifikimin, vlerësimin e risqeve për proceset e punës të secilit sektor, janë përcaktuar kontrollet ekzistuese dhe veprimet për të adresuar boshllëqet.

## 3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve.

-Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 22/3 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se veprimtaritë e kontrollit përmbajnë minimalisht ndër të tjera edhe sistemin e dy nënshkrimeve i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë. Aktualisht, sistemi i dy nënshkrimeve aplikohet në DSHTD përmes titullarit të institucionit dhe shefes së sektorit të financës.

-Institucioni disponon një rregullore të brendshme të miratuar mbi organizimin dhe funksionimin e DSHTD miratuar me VKD nr. 12, dt. 29.06.2018. Rregullorja ka patur dy amendime miratuar nga Këshilli drejtues me vendimin e KD nr. 12, dt. 29.06.2018 dhe me vendimin nr. 1, dt. 15.01.2019.

**Gjetje 4:** Grupi i auditimit konstatoi se DSHTD operon me rregulloren e miratuar me VKD nr. 12, dt. 29.06.2018, pavarësisht se me shkresën nr. 56/2 datë 08.02.2022 është miratuar nga MEPJ ristrukturimi dhe ndryshimi i organigramës së institucionit, veprim ky në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t’i verifikuar këto transaksione dhe operacione. DSHTD ka përgatitur gjurmët e auditimit për proceset kryesore të punës në përputhje me nenin 16 të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

#### **4. Informacioni dhe komunikimi**

Nga auditimi u konstatua se, Institucioni komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

Nëpërmjet drejtorive, linjat e komunikimit, bazuar në nevojat procedurale dhe administrative zyrtare, janë në formë shkresore dhe elektronike në përputhje me kodin e procedurave administrative dhe akteve të tjera që rregullojnë komunikimin e brendshëm të strukturave. Në komunikim ndiqen procedurat e firmosjes dhe kundërfirmosjes sipas rendit hierarkik të vendimmarrjes për të gjitha aktet shkresore që prodhohen për të gjitha çështjet që lidhen me menaxhimin financiar të Institucionit. Gjithashtu, si komunikimet e brendshme shkresore ndërmjet sektorëve, ashtu edhe për komunikimin me institucione të tjera informacioni kalohet përmes protokollit në përputhje me përcaktimet e udhëzimeve për arkivën.

#### **5. Monitorimi**

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime.

Nga auditimi u konstatua se në përputhje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 18, pika ku citohet se “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësive publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësive publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik në funksion të ngritjes së një sistemi efektiv monitorimi ka vepruar si më poshtë vijon :

- Për vitin 2020 Titullari ka miratuar me shkresën nr. Prot. 70, dt. 22.01.2020 planin vjetor të kontrollit të brendshëm të DSHTD – së për vitin 2020, ku janë përcaktuar tematikat e kontrollit, persona përgjegjës për të raportuar dhe afatet e raportimit. Në vijim personat përgjegjës kanë

raportuar në afatet e caktuar në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të departamentit të tyre me bazën ligjore në fuqi.

- Për vitin 2021 Titullari ka miratuar me shkresën nr. Prot. 13, dt. 07.01.2021 planin vjetor të kontrollit të brendshëm të DSHTD – së për vitin 2021, ku janë përcaktuar tematikat e kontrollit, persona përgjegjës për të raportuar dhe afatet e raportimit. Në vijim personat përgjegjës kanë raportuar në afatet e caktuar në lidhje me ecurinë dhe problematikat të aktivitetit të departamentit të tyre.

- Për vitin 2020 DSHTD ka raportuar në MEPJ me shkresën nr. prot. 776, dt. 22.09.2021 mbi realizimin e treguesve ekonomik – financiar dhe pasqyrave financiare; dhe për vitin 2021 DSHTD ka raportuar në MEPJ me shkresën nr. prot. 936, dt. 06.10.2022 mbi realizimin e treguesve ekonomik – financiar dhe pasqyrave financiare.

- Përsa i përket auditit të brendshëm, DSHTD nuk ka njësi auditit të brendshëm në organikën institucionale pasi është institucion në varësi të MEPJ dhe kontrollohet nga departamenti i Auditit të Brendshëm të saj.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mbi Vlerësimin e Funksionimit të Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit
<b>Situata:</b>	<p>1. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2020 nga Këshilli Drejtues është shtuar 1 punonjës më shumë në krahasim me strukturën e miratuar nga MEPJ të vitit 2019, ndërsa për vitin 2021 janë shtuar 2 me shumë punonjës në krahasim me strukturën e miratuar nga MEPJ të vitit 2019. Këto ndryshime nuk kanë marrë me parë miratimin e MEPJ pavarësisht së nga DSHTD janë dërguar shkresat për marrjen e dakordësisë. Këto veprime janë në kundërshtim me statutin e DSHTD miratuar me shkresë nr. prot. 1842 datë 17.02.2011, pika 15 ku citohet “<i>Struktura organizative e DSHTD bëhet me propozim të drejtorit dhe me miratim të Këshillit Drejtues. Vendimi i Këshillit Drejtues dërgohet për aprovim Ministrisë së punëve të jashtme dhe merr fuqi ligjore vetëm pas nënshkrimit</i>”.</p> <p>2: Grupi i auditimit rezultoi se Komisioni strategjik i planifikimit nuk ka dokumentuar procesverbalet e mbledhjeve të kryera, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p> <p>-Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike’.</p> <p>-Manuali i menaxhimit financiar dhe kontrollit”</p> <p>-Ligji nr.7582, datë 13.7.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”</p> <p>-VKM nr. 840 dt. 17.12.2004 dhe VKM nr. 631 dt. 15.09.2006 " Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit Diplomatik</p> <p>-Udhëzim nr. 6, datë 3.9.1992 “Për Zbatimin e Ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”</p> <p>- Statuti i miratuar nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme në Janar 2011 sipas shkresës me nr. prot. 1842, datë 17.02.2011</p> <p>-Rregullore e Brendshme miratuar me VKD nr. 12, dt. 29.06.2018</p>
<b>Ndikimi:</b>	Institucioni nuk ka formalizur plotësisht procedurat që duhet të ndërmerren në kuadër të menaxhimit financiar dhe kontrollit
<b>Shkaku:</b>	Mangësi në formalizimin e procedurave të MFK
<b>Rëndësia:</b>	E ulët
<b>1. Rekomandimi:</b>	DSHTD të ndërmarrë një rol proaktiv në raport me MEPJ me qëllim respektimin e afateve të kthim përgjigjeve dhe marrjen e miratimeve përkatëse për vijimin e procedurave.



<b>2. Rekomandimi:</b>	DSHTD të marrë masa për dokumentimin e procesverbaleve të mbledhjeve të kryera të GMS, në përputhje me nenin 27 të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”.
<b>Afati zbatimit</b>	Menjëherë dhe në vijimësi

## **2.6. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorin e Shërbimeve të trupit diplomatik, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për periudhën 01.07.2018 deri më 31.11.2019 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën 970/7, datë 23.03.2020 dhe “Mbi zbatimin e rekomandimeve” të lëna nga grupi i mëparshëm i zbatimit të rekomandimeve dërguar me shkresën nr.242/23, datë 13.04.2021 se:

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:  
janë rekomanduar gjithsej:

- a. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë 3 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 3 rekomandimet.
- b. Masa disiplinore e administrative është lënë 1 rekomandime, nga të cilat është zbatuar rekomandimi.

### **A. MASA PËR ELEMIMININ E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Kontrata KQSV - 10.2018-Sh.-010, e nënshkruar me DSHTD- me objekt dhënien me qira te ambientit ne katin përdhe, i cili ndodhet në adresën Rruga "Skenderbej", Pall. Nr.8, seksioni. Nr.3 me sipërfaqe 108 m 3 qe do te përdoret për tregti të ndryshme ushqimore dhe industriale, është tarifuar me një çmim qiraje prej 6 €/ m2, dhe qira mujore 648 euro/muaj pra një çmim më i ulët se ai i miratuar për këtë zonë me VKD dhe konkretisht 1 euro/ m<sup>2</sup> më pak, veprim që ka sjellë një fitim të munguar prej 108 euro/muaj ose 1296 euro ne vit. Rinovimi i kontratës QSV-10.2019- Sh.-012 për të njëjtin objekt është kryer në të njëjtat kushte duke sjellë edhe për vitin 2019 një fitim të munguar prej 1296 euro në vit. Pra në total një fitim i munguar prej 2,592 euro për periudhën në auditim. (Më hollësisht trajtuar ne piken 1.2. të program auditimit, faqe 32-33, të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** DSHTD, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën 2,592 euro.

Përgjigja e Institucionit: Drejtorja e Shërbimit te Trupit Diplomatik ka ngritur një grup pune me anë të Urdhrit Nr.112 Dt.24.03.2020 me Nr.Prot.243 Dt.24.03.2021 të Drejtorit të DSHTD-së. Grupi i punës ka marrë në analize situatën lidhur me mungesën e pretenduar të të ardhurave në vlerën 2,592 euro dhe me anë të informacionit Nr. Prot.243/1 Dt.26.03.2021 ka informuar titullarin e institucionit për konkluzionet e arritura pas punës se tij (bashkëlidhur gjeni Urdhrit Nr. 112 Dt. 24.03.2021 dhe Informacionin Nr. Prot. 243/1 Dt. 26.03.2021).

#### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

**2. Gjetje nga auditimi :** Nga auditimi u konstatua se ne kontratën e lidhur KOSV-12.2018 M.-012, ndërmjet subjektit privat M. dhe DSHTD-së për periudhën në auditim, me objekt ambientin në katin përdhe 77,7 m2 + lulishte funksionale me sip. 120,21 m2, i cili ndodhet në adresën Rruga "Skënderbej", Pall. Nr.4 u konstatua se çmimi i tarifimit të qirasë është 4 €/ m2 për ambientin përdhe, dhe 150 lekë/m2 për lulishten funksionale e bazuar në nenin 8 të VKM nr.840, datë

17.12.2004, i ndryshuar "Për veprimtarinë e DSHTD-së". Pra ky subjekt privat është trajtuar si përfaqësi diplomatike dhe çmimi për m<sup>2</sup>, është në dukje më i ulët se sa ai i miratuar me VKD, për këtë zonë. Trajtimi si rast përjashtimorë është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira", ku përcaktohet se çmimet favorizuese do të bëhen për shkak të planeve të investimeve në rastet e kontratave mbi 200 m<sup>2</sup>. Konkretisht sipërfaqja prej 77,7m<sup>2</sup> duhej të tarifohej me 7 €/ m<sup>2</sup>, dhe si rrjedhim do të kishim një vlerë më të madhe në të ardhurat e këtij institucioni Konkretisht  $77,7 * 3€/m^2 = 233$  euro/muaj \* 12 = 2796 euro në vit fitim i munguar për DSHTD-në si dhe për periudhën në auditim  $2796 * 2 = 5592$  euro të ardhura të munguara, pasi në vazhdimësi është lidhur kontrata me këtë subjekt për vitin 2020, me nr. prot. 1096/2, date 22.10.2019, me të njëjtën bazë ligjore dhe me të njëjtën tarife qiraje.

**2.1 Rekomandimi:** DSHTD, të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën 5,592 euro.

Përgjigja e Institucionit: Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik ka ngritur një grup pune me anë të Urdhrit Nr. 112 Dt.24.03.2020 me Nr.Prot.243 Dt.24.03.2021 të Drejtorit të DSHTD-së. Grupi i punës ka marrë në analizë situatën lidhur me mungesën e pretenduar të të ardhurave në vlerën 2,592 euro dhe me anë të informacionit Nr. Prot. 243/1 Dt.26.03.2021 ka informuar titullarin e institucionit për konkluzionet e arritura pas punës së tij (bashkëlidhur gjeni Urdhrit Nr. 112 Dt. 24.03.2021 dhe Informacionin Nr. Prot. 243/1 Dt. 26.03.2021)

#### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucionit dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Na auditimi me përzgjedhje i disa kontratave të qirasë me shoqërinë G. për periudhën në auditim u konstatua se: a) Në Kontratën KQPH-10.2018 të nënshkruar ndërmjet DSHTD dhe shoqërisë G., me objekt dhënien me qira të apart.nr. 8.2.7, i cili ndodhet në adresën Rruga Skënderbej, Pall.nr.8, shkalla nr.2, rezultoi se tarifimi i qirase është kryer me çmim 6,03 €/ m<sup>2</sup>, për një sipërfaqe 265m<sup>2</sup> dhe afat 11-mujor. Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 01.10.2018-31.08.2019.(11 muaj). Ajo që konstatohet është se kemi një ulje prej 0.97 euro.m<sup>2</sup> në llogaritjen dhe tarifimin e qirasë pasi çmimi i miratuar sipas VKD për vitin 2018 është 7€/ m<sup>2</sup>, dhe si rrjedhim kemi një fitim të munguar prej 255 euro/muaj dhe rreth 2805 euro të munguara për 11 muaj, për vitin 2019. b) Në Kontratën KQPH-01.2018-G.-004 të nënshkruar ndërmjet DSHTD dhe shoqërisë G., me objekt apart.nr. 4.1.4, i cili ndodhet në adresën Rruga Skënderbej, Pall.nr.4, shkalla nr. 1, me një afat të kësaj kontrate prej 01.01.2018-31.12.2018.(12-muaj). Ajo që konstatohet është se kemi një ulje prej 0.5 euro m<sup>2</sup> në llogaritjen dhe tarifimin e qirasë pasi çmimi i miratuar sipas VKD për vitin 2018 është 7€/ m<sup>2</sup>, dhe si rrjedhim kemi një fitim të munguar prej 47,66 euro/muaj ose 572 euro të munguara për një vit, për vitin 2018. (Me hollësisht trajtuar në pikën 1.2. të program auditimit, faqe 34-37 të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** DSHTD, të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën 3,377 euro.

Përgjigja e Institucionit: Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik ka ngritur një grup pune me anë të Urdhrit Nr. 113 Dt.24.03.2021 me Nr.Prot.244 Dt.24.03.2021 të Drejtorit të DSHTD-së. Grupi i punës ka marrë në analizë situatën lidhur me mungesën e pretenduar të ardhurave në vlerën 3,377 euro dhe me anë të informacionit Nr. Prot.244/1 Dt.26.03.2021 ka informuar titullarin e institucionit për konkluzionet e arritura pas punës së tij (bashkëlidhur gjeni Urdhrit Nr.113 Dt.24.03.2021 dhe Informacionin Nr. Prot.244/1 Dt.26.03.2021).

#### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucionit dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

## **B. MASA DISIPLINORE E ADMINISTRATIVE**

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, të vlerësojë në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Përgjigja e Institucionit: Në vijim të rekomandimit tuaj lidhur me vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për secilin punonjës, DSHTD-ja pasi ka analizuar me grup të veçantë pune gjetjet e mësipërme dhe në përputhje me ligjin nr.7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore" i ndryshuar dhe VKM nr.840, date 17.12.2004 "Për veprimtarinë e DSHTD -së", vlerëson se nuk është në kushtet e pranisë së të ardhurave të munguara dhe për rrjedhojë nuk ka vend për vlerësim të shkallës së përgjegjësisë apo dhënies së masave disiplinore.

### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e masave disiplinore ngritur me urdhër nr. 243 prot datë 24.03.2021, verën se **rekomandimi është zbatuar.**

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi rezultoi se për procedurat e prokurimit të realizuara jashtë territorit të RSH-së, mungon një bazë ligjore rregullatore e miratuar mbi realizimin e tyre. Me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 4, datë 10.06.2022 është miratuar udhëzimi për kryerjen e procedurave për punimet jashtë vendit, por referuar nenit 29 të Ligjit nr. 90/2012 "Për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore" është ministri përgjegjës ai që miraton rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 158-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të dërgojë pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse, "Udhëzimin mbi realizimin e procedurave të prokurimit jashtë territorit të RSH", me qëllim rishikimin dhe miratimin nga ministri të aktit, duke synuar formalizimin e procedurës dhe ndarjen e qartë të roleve e përgjegjësive për të gjithë aktoret në proces, që janë në varësi të MEPJ.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga Auditimi:** Mbi hartimin, planifikimin dhe realizimin e Buxhetit të DSHTD:

**1.** Grupi i auditimit rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022, DSHTD nuk i është drejtuar Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së New Yorku dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Uashington me kërkesa mbi nevojat e tyre për investime në godinat ku ushtrojnë veprimtarinë. DSHTD ka planifikuar fonde për këto godina duke u bazuar në historikun e tyre dhe jo në nevojat reale për investime dhe mirëmbajtje.

**2.** Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Itali me shkresën 1228/1, dt. 27.12.2019 ka depozituar në DSHTD kërkesën për punime shpesh në godinën e Ambasadës dhe apartamentet e diplomatëve. Kjo kërkesë është bërë pas përfundimit të procesit të planifikimit të planit ekonomik financiar për vitin 2020, duke krijuar vështirësi për DSHTD – në kryerjen e procedurave verifikuese nga institucioni mbi nevojën për këto investime si dhe koston e tyre.

**3.** Grupi i auditimit rezultoi se kryesisht për objektet jashtë vendit parashikohen fonde për punime të cilat cilësohen si të paparashikuara ose emergjente duke u bazuar në historikun e godinave, fonde të cilat në pjesën më të madhe të rasteve nuk realizohen në nivelin e plotë të tyre. Kjo metodë planifikimi krijon pengesa në përdorimin eficient dhe efektiv të fondeve pasi i ngurtëson ato në punime të cilat nuk kanë probabilitet të lartë realizimi.

4. Grupi i auditimit rezultoi se për vitet 2020 dhe 2021 realizimi i të ardhurave nga përdorimi i aktiveve afatgjata materiale paraqitet në nivele mesatare për shkak të prokurimit të materialeve në vlera më të vogla se sa ishin planifikuar. Ky argumentim për këtë kategori të ardhurash përsëritet vit pas viti në DSHTD. Gjithashtu në raportin e fundit të auditimit të KLSH-së është evidentuar se për vitin 2018 dhe 2019 mosrealizimi i të ardhurat nga AAM është ndikuar nga fakti se vlerat e materialeve janë parashikuar në nivele më të ulëta se fakti.

5. Grupi i auditimit rezultoi se për vitet 2020 dhe 2021 një pjesë e madhe e zërave të shpenzimeve kanë një realizim më të ulët se planifikimi për të njëjtën arsye, konkretisht për shkak të prokurimit të materialeve të zërave të këtij grupi në vlerë më të ulët se fondi limit i parashikuar. Pavarësisht se janë ngritur grupet e punës për testimin e tregut, përllogaritjen fondin limit për çdo grup malli dhe përcaktimin e procedurave të prokurimit publik, konstatohet se vit pas viti zërat e shpenzimeve nuk realizohen në nivelin e parashikuar.

6. Grupi i auditimit rezultoi se për vitin 2021 shuma e ndryshimeve buxhetore në planifikimin e të ardhurave nga prodhimi i AAM brenda vendit, nuk përputhet me vlerën e paraqitur në planin përfundimtar të vitit 2021. Kjo për arsye se DSHTD në muajt e fundit të vitit ka kryer rishikime të planit buxhetor duke pakësuar nivelin e investimeve të cilat nuk priten të realizohen, dhe duke ulur në këtë mënyrë diferencën ndërmjet planifikimit dhe realizimit të zërave të buxhetit.

7. Për vitin 2022 grupi i auditimit rezultoi se në planifikimin e investimeve për disa prej godinave jashtë vendit në administrim të DSHTD – së, parashikohen të njëjtat nivele fondesh pavarësisht se nga ana e Ambasadeve nuk paraqiten kërkesa konkrete në lidhje me nevojat e tyre. Konkretisht Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian në Bruksel, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Stokholm, Misioni i Republikës së Shqipërisë në New York dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Uashington nuk kanë paraqitur kërkesa sa i përket investimeve apo punimeve që nevojitet të kryhen në këto godina përgjatë vitit 2022. Pavarësisht kësaj situate DSHTD ka alokuar vlera të caktuara për t'i paraprirë çdo lloj rasti apo nevoje emergjente që mund të lind gjatë vitit 2022, duke marrë parasysh historikun e investimeve të viteve të fundit, por pa pasur evidenca të mjaftueshme për të argumentuar përllogaritjen e këtyre fondeve për godinat respektive.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 16-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** DSHTD të bashkërendojë veprimet dhe koordinojë veprimtarinë me misionet diplomatike jashtë vendit të cilat ushtrojnë veprimtarinë në godinat në administrim të DSHTD-së, me qëllim hartimin dhe zbatimin e një buxheti të argumentuar e realist në drejtim të për investime apo punime mirëmbajtje në përputhje me afatet kohore të planifikimit të buxhetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.2 Rekomandimi:** Institucioni të marrë masa për krijimin e një fondi të veçantë, për të gjitha godinat jashtë vendit, për punime emergjente apo të paparashikuara duke rritur në këtë mënyrë efikasitetin e procedurës së planifikimit të buxhetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.3 Rekomandimi:** DSHTD të marrë masa për të kryer një planifikim efektiv të nivelit të fondeve të cilat do të përdoren për prokurime të materialeve, me qëllim të përdorimit sa më eficient të tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.4 Rekomandimi:** DSHTD të marrë masa që gjatë planifikimit buxhetor të parashikojë fonde për investime të cilat kanë probabilitet të lartë realizimi duke shmangur në këtë mënyrë praktikën e kryerjes së ndryshimeve buxhetore në fund të vitit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga Auditimi:** - Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022 DSHTD nuk ka kryer pasqyrimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e aktiveve afatshkurtra aktive të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti. Njësia ekonomike nuk ka klasifikuar të gjithë aktivet e tjera si afatgjata

në përputhje me SKK 2, pika 39 dhe 40.

- Gjithashtu nga auditimit rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022, DSHTD nuk ka kryer pasqyrimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Pozicionit Financiar pasi paraqet në llogarinë e detyrimeve afatshkurtra detyrime të cilat rezultojnë se janë të mbartura vit pas viti. Njësia ekonomike nuk i ka klasifikuar të gjithë detyrimet e tjera si afatgjata në përputhje me SKK 2, pika, 41 dhe 42.

- Nga auditimit rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022, DSHTD nuk ka kryer klasifikimin e saktë të llogarive në Pasqyrën e Performancës. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit janë klasifikuar në të ardhura të shfrytëzimit kur duhej të klasifikoheshin në llogarinë të ardhurat dhe shpenzimet financiare. Në përputhje me SKK 2, shtojca 2.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 37-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** DSHTD të marrë masa për klasifikimin e zërave të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe bazën ligjore në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga Auditimi:** 1. Gjatë vitit 2020 është regjistruar në aktivet afatgjata vlera prej 125,184,658 lekë e cila i korrespondon 10 apartamenteve në R., të cilat kanë kaluar nga MEPJ në administrim të DSHTD – së, sipas urdhrin të përbashkët nr. 613 datë 21.12.2020 të MEPJ dhe nr. 529/5 datë 21.12.2020 të DSHTD. Nga dokumentacioni u evidentua se gjatë viteve të kaluara në këto apartamente janë kryer punime ndërtimi duke ndryshuar konfigurimin dhe sipërfaqen e tyre. Nga auditimi rezultoi se grupi i punës i ngritur nga DSHTD gjatë vitit 2022, për kryerjen e vlerësimeve dhe verifikimeve fizike të këtyre apartamenteve, ka kryer vlerësime vetëm për pesë nga dhjetë apartamentet e kaluara në administrim.

2. Rezultoi se për vitin 2020, 2021 dhe 2022 institucioni nuk disponon inventar të detajuar të godinave të cilat ndodhen jashtë Shqipërisë. DSHTD ka regjistruar vlerën fillestarë të godinës, por pa specifikuar elementët specifik të cilët janë pjesë e saj. Gjithashtu investimet e kryera në këto godina i janë shtuar godinës vetëm në vlerë totale dhe jo sipas zërave të punimeve të kryera. Kjo situatë krijon problematika në përcaktimin e pjesëve takuese të godinës që i përkasin DSHTD dhe ato që i përkasin trupave diplomatik. Gjithashtu për shkak të mungesës së një detajimi të saktë krijohen vështirësi në përcaktimin e investimeve apo punimeve të mirëmbajtjes të cilat janë detyrim i DSHTD – së.

3. Gjatë vitit 2020 DSHTD ka kryer rivlerësime të objekteve. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka zgjedhur metodën e rivlerësimit për të matur vlerën e kategorisë së “ndërtesave”, dhe ka kryer rivlerësimin e disa prej tyre, por jo për të gjitha aktivet e përfshira në këtë kategori. Konkretisht janë rivlerësuar objektet me nr. pasurie 6/a; 6/b; 6/c; 6/d; 6/e dhe 6/f. Kjo mënyrë rivlerësimi nuk është në përputhje me SKK 5: Aktive Afatgjata Materiale, pika 24 dhe 25 i cili kërkon që nëse një aktiv afatgjatë rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e aktiveve afatgjata materiale të cilës ai i përket”. Bazuar në sa më sipër, sqarojmë se DSHTD-ja nuk ka bërë rivlerësim tërësor për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale, por vetëm për një pjesë të tyre, për arsye të pamundësisë ekonomike dhe logjistike (një pjesë e ndërtesave janë Ambasadat e RSH jashtë vendit).

4. Grupi i auditimit rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022, norma e amortizimit për kategorinë e aktiveve nuk është aplikuar në përputhje me normat e përcaktuara. DSHTD ka llogaritur amortizim për ndërtesat në masën 2% të vlerës së asetit në fillim të vitit ushtrimor, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar i cili përcakton se kosto e ndërtesave amortizohet me normën 5%.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 37-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** DSHTD të marrë masa për kryerjen e vlerësimeve fizike për të gjitha apartamentet në R., të cilat kanë kaluar nga MEPJ në administrim të DSHTD – së me qëllim përcaktimin e vlerës së saktë të tyre.

*Menjëherë*

**4.2 Rekomandimi:** DSHTD të marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit për të gjitha godinat të cilat janë në administrim të saj.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.3 Rekomandimi:** Institucioni të marrë masa për kryerjen e rivlerësimit të objekteve në përputhje me SKK 5: Aktive Afatgjata Materiale.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.4 Rekomandimi:** DSHTD të marrë masa për hartimin e një analize të mirë strukturuar kosto – përfitimit për argumentimin e përlllogaritjes së amortizimit të ndërtesave në nivelin 2% dhe jo në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998, i ndryshuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit në procedurat, si më poshtë:

**Procedura Blerje materiale izoluese 2020:** Në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë në disa zëra është përdorur emri i markës "M." përmendja e markës është një kriter kufizues, për arsye se nuk janë përdorur fjalët "ose ekuivalent".

**Procedura Përkthim përpunim relacioni për Project ndërtimi për Ambasadës Bullgare 2021:** Kriteret e vendosura nga KPVV janë kriterë kufizuesë pasi kërkohen licenca të cilat janë në fushën e projektimit dhe nuk kanë objektin e prokurimit i cili është Përkthim.

Licencat e kërkuara janë si më poshtë:

3/a: Projektme objekteve civile- industriale –turistike prej muraturë e skelet beton arme në 5 kate.

4/a: Projektim të instalimeve hidro-termosantare. 4/c: Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. 4/j: Projektim të rrjeteve të telefonisë citofonisë, fonisë, internet, tv, acces kontrolli, cctv, sisteme alarmi, sisteme dedektimi të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.

**Procedura FV Kondicionerë 2022:** Vendosja e kriterit "Sigurimin e kontratës në shumën 10% të vlerës së kontratës me TVSh" është në kundërshtim me Ligj nr.162/2020 për prokurimin publik neni 83 pika 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

**Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar** të prokuruar nga Institucioni për vitin 2020 dhe 2021, KPVV ka vendoset si kriter "OE duhet të ketë në staf 3 punonjës të pajisur me certifikata I." kriteri i mësipërm është një kriter i sforcuar dhe ka ngushtuar konkurrencën e OE për pasoj në të gjithë procedurat e audituar rezulton fitues i njëjti OE.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 74-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandimi 5.1:** Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël të marrë masa për hartimin e kriterëve në mënyre jo diskriminuese apo orientuese, në mënyrë që të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të OE, si dhe të nxitë pjesëmarrjen dhe konkurrencën ndërmjet tyre .

*Në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Në 13 procedura me vlerë të vogël për vitin 2020, 9 procedura me vlerë të vogël për vitin 2021 dhe 7 procedura me vlerë të vogël për vitin 2022 rezulton se KPVV nuk ka respektuar afatin minimal për hapjen dhe pranimin e procedurave i cili duhet të jete minimalisht 24 orë nga momenti i publikimit në sistemi e prokurimit publik. Në të gjitha procedurat e sipër përmendura afati i publikimit dhe i hapjes është nga 20 orë deri në 23 orë.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 74-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandimi 6.1:** Komisioni i prokurimit me vlere te vogël të marrë masa për respektimi e afatit minimal duke i siguruar operatoreve ekonomike të paktën 24 orë kohë për përgatitjen e oferta.

*Në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar të prokuruar nga Institucioni për vitin 2020 dhe 2021, realizohen në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjellë si pasojë, mungesë të studimit të tregut si rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, pasi biletat e avionit blihen në datën të afërta me nisjen, ku edhe çmimet kapin vlerën me të lartë të tyre.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 74-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandimi 7.1:** Titullari i Institucionit, të marrë masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit ose për planifikimet e udhëtimeve jashtë vendit të nxjerrë menjëherë autorizimin e pjesëmarrësve në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.

**Në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet vendase nga DSHTD, për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qirave nuk janë vendosur kamatëvonesat përkatëse. Kamate vonesat e llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vlerës së qirasë është 959.22 Euro.

Me date 06.01.2020 subjekti qiramarrësi G. ka derdhur pranë bankës R. në Llogarinë e DSHTD vlerën 1,827.14 € sipas faturën nr.668 date 02.12.2019 të lëshuar nga DSHTD për pagesën e muajt dhjetor të apartamenteve 6/1/1 dhe 6/1/2.

Nga auditimi rezultoi se subjekti G. nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni nuk ka marrë masë për të aplikuar penaltetin për kamatëvonesat. Penaliteti i pavendosur llogaritur nga grupi i auditimit është në vlerën 548.14 €.

Subjekti S. dhe DSHTD kanë lidhur Kontrata me nr.180/3 datë 07.03.2019, KQSV-03.2019- S.-007 dhe Kontrata me nr.283/4 datë 15.04.2019, KQSV-05.2019-S.-008 dhe Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimit është në vlerën 411.08 €.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandimi 8.1:** Sektori i Financës të marrë masa ku të monitorojë çdo fund muaji vlerën e arkëtuar të qirave sipas mandat-pagesave në respektimin e afatit kontraktor si për subjektet vendase dhe ato të huaja si dhe në rastet e vonesave në likuidimin e këtyre qirave të vendosë dhe të arkëtohen kamatëvonesat përkatëse.

**Në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës me nr.1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019-S.-059 rezultoi se nuk është kryer procedura e konkurrimit për dhënien me qira të vilës nr. 49. Nuk rezulton të jetë njoftuar MEPJ për dhënien e Vilës me qira. Qiramarrësi është një fondacion privat ndërkombëtar që nuk gëzon privilegje apo status diplomatik dhe si i tillë duhet të ishte zhvilluar garë, në kundërshtim me VKM nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera te pasurisë shtetërore " kapitullin II "procedura e dhënies me qira dhe enfiteoze e pasurive shtetërore, dhe domosdoshmërinë e hartimit dokumentacionit përkatës, për dhënien me qira te këtyre pronave. Gjithashtu ky akt parashikon edhe tagrin e organit Ministria e Financës dhe Ekonomisë i cili ka të drejtë të lidh kontratën e qirasë mbi 200m2.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandimi 9.1:** Këshilli Drejtues të marrë miratimin nga MEPJ, para lidhjes së kontratave të qirasë për objekte sipërfaqja e të cilëve është mbi 200 m2, në përputhje me VKM nr.54 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata, të tjera të pasurisë shtetërore".

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se DSHTD ka aplikuar derdhjen e 30% të të ardhurave të krijuar nga qiraja vetëm nga “subjektet vendase”, me pretendimin se, meqenëse procedura e dhënies me qira e parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk mund të aplikohet për trupin diplomatik apo organizatat e tjera ndërkombëtare, rrjedhimisht, as derdhja e detyrimit 30% nuk duhet të aplikohet.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk e parashikon konceptin e subjektit vendas apo subjektit të huaj, kjo ndarje është bërë nga vetë DSHTD për efekt lehtësie në administrimin e procedurave. DSHTD nuk rezulton të ketë kërkuar asnjëherë rishikimin e këtij akti, me qëllim përjashtimin nga detyrimi për zbatim të procedurave të qiradhënies, në rastet kur pala qiramarrëse është pjesë e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandimi 10.1:** Titullari i DSHTD të marrë masat për ngritjen e një grupi pune për hartimin dhe propozimin për miratim të një akti nënligjor që do të formalizojë procedurat e qiradhënies kur pala qiramarrëse është trup diplomatik i akredituar/ organizatë ndërkombëtare, ku të standardizohen ndër të tjera edhe (i) komunikimi periodik me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi nevojat e akomodimit të trupit diplomatik, si dhe (ii) detyrimet e DSHTD përgjatë kohëzgjatjes së kontratës (monitorimi i kontratës, ngrohja nëpërmjet kaldajës, punimet e ndryshme mirëmbajtëse, etj.).

#### **Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik, rezultuan parregullsi në përcaktimin e kriterëve për kualifikim, dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të cilat kanë kufizuar konkurrencën, duke mos nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, si më poshtë.

**a. Për procedurën: “Dyer të brendshme”, 2020:** Njësia e prokurimit nuk argumenton nevojën për punësimin mesatar prej 8 punonjësish, kriteri për nevojën për 1 arkitekt, ky kriter nuk duhet të vendosej pasi modelet duhet të jenë përcaktuar nga AK. Kriteri mbi disponimin e një mjet në pronësi apo të marrë me qira, kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, në të cilat automjeti nuk do të ishte i nevojshëm gjatë gjithë kohës, njësia e prokurimit duhet të mjaftohej duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave.

**b. Për procedurën: “Parkete e aksesorë”, 2020:** Kriteri mbi të dhënave mbi xhiron e vitit 2019. Referuar nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme dhe e paraqet në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Sa më sipër, të dhënat mbi xhiron vjetore të vitit 2019 nuk duhet të ishin kërkuar në DST.

**c. Për procedurën: “Pllaka të ndryshme”, 2020:** Kriteri mbi disponimin e një mjet në pronësi apo të marrë me qira, kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, në të cilat automjeti nuk do të ishte i nevojshëm gjatë gjithë kohës, njësia e prokurimit duhet të mjaftohej duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave.

**d. Për procedurën: “Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3”, 2020:** Referuar kriterëve të licencimit të OE, lidhur me licencën për kategorinë: NS-12 “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”. Kriteri i vendosur është në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Kriteri për inxhinier mekanik, të pajisur me licencë individuale (të vlefshme) me kategori 12/a, në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.1.2008.

**e. Për procedurën: “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, 2020:** Hartimin e fondit limit me analizat e çmimeve respektive, mungon në dokumentacionin e llogaritjes



së fondit limit. Kriteri mbi certifikimin stafit teknik Inxhinier Ndërtimi, Specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, e vërtetuar me certifikatë përkatëse (të vlefshme), kriter i vendosur diskriminues në kundërshtim me profilin arsimor sipas Nenit 10, pika 1a, të VKM nr.312, datë 5.5.2010. Kriteret mbi Ekspert zjarrfikës, Inxhinierin Mekanik dhe Inxhinierin elektrik, si dhe mbi disponimin e auto betoniere, auto pompë betoni, pompë suvatimi, helikopter nivelimi nuk përputhet me natyrën e punimeve, në kundërshtim me nenin 26, Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

**f. Për procedurën: “Hapje pusi uji + impiant klorifikimi te Ambasada Bullgare”, 2021:** Kriteri për Inxhinier Shpimi 1, kriteri diskriminues duhet të përfshiheshin profilet e diplomimit sic specifikohet në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar, lidhja 4, gjithashtu në kundërshtim me VKM Nr.42, datë 16.1.2008. Kriteri mbi disponimin e Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, Autovinç, në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

**g. Për procedurën: “Pllaka të ndryshme”, 2022:** Kriteri mbi disponimin e një mjet në pronësi apo të marrë me qira, kemi të bëjmë me procedurë prokurimi për blerje malli, në të cilat automjeti nuk do të ishte i nevojshëm gjatë gjithë kohës, njësia e prokurimit duhet të mjaftohej duke e paraqitur në DST dhe kontratë detyrimin e OE për të kryer edhe transportin e këtyre mallrave.

**h. Për procedurën: “Shërbime mirëmbajtje ashensori”, 2022:** Vendosja në specifikime teknike e markave si tip B. është në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 105-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1.Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, të marrë masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mosfavorizuar operatorë ekonomik të caktuar.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi në SPE i procedurave të prokurimit Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik rezultoi se në disa procedura rezultuan pasaktësi në kualifikim e OE të cilat nuk plotësonin të gjitha kriteret për kualifikim.

**a. Procedura “Dyer të brendshme”, 2020** sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: OE fitues ka paraqitur kontratat e punës për 1 marangoz dhe 1 ndihmës marangoz, ndërkohë që DST kërkonte 2 marangozë si dhe në listpagesë nuk figurojnë si marangoz.

**b. Procedura “Parkete e aksesore”, 2020** sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: OE fitues gjithashtu ka paraqitur një mostër të mallit dhe një katalog në gjuhë të huaj, duke mos paraqitur deklaratë konformiteti sipas kërkesave në DST.

**c. Procedura “Pllaka të ndryshme”, 2020** sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: OE fitues ka paraqitur një akt-marrëveshje me një palë të tretë të datës 23.02.2016, si dhe një deklaratë konformiteti në gjuhën spanjolle të pa përkthyer, me vlefshmëri deri në 08.04.2017, jo sipas kërkesave të DST.

**d. Procedura “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, 2020** sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: KVO ka kualifikuar OE, i cili ka dorëzuar për punonjësit certifikatat të lëshuara nga një subjekt i pa akredituar për këtë lloj trajnimi. Secili nga OE të BOE fituese nuk ka stafin respektiv për kryerjen e punimeve sipas ndarjeve respektive në marrëveshjen e bashkëpunimit. OE fitues ka sjellë një certifikatë trajnimi e dhënë nga një organizëm certifikimi shqiptar i pa akredituar për këtë lloj certifikimi.

**e. Procedura “Dyer të brendshme”, 2022** sipas vlerësimit të KVO, rezultoi: OE fitues nuk ka dorëzuar dokumentacionin për një inxhinier përpunim druri/inxhinier pyjesh. OE fitues si punë të ngjashme ka dorëzuar Rikonstruksionin e një shkollë të mesme, por referuar kontratës së bashkimit të përkohshëm të shoqërive për punën e dorëzuar OE nuk i ka kryer ai punimet për dyer dritare.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 105-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelle ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, për të siguruar dobishmëri në përdorimin e fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga Auditimi:** Në procedurën “Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës” nga auditimi i dokumentacionit u verifikuan mangësi në verifikimin e produktit final të dorëzuar. Vetëm në 3 faturat të likuiduara, OE ka paraqitur një certifikatë cilësie (në gjuhë të huaj) ku përcaktohet densiteti në vlerën 0.9559 g/ml. Në të gjitha faturat e tjera të likuiduara, densiteti është marrë apriori në vlerën 0.97-0.975 g/ml, pa analizat e nevojshme për përcaktimin e tij, çka ka ndikuar në përlllogaritjen e çmimit për litër. Për verifikimin e sasisë së marrë në dorëzim, Komisioni i Marrjes në Dorëzim bazohet te kapaciteti i automjetit transportues, i cili ka një vëllim të përgjithshëm të botit prej 14,000 litra, referuar pasaportës së automjetit. Kjo mënyrë përlllogaritje nuk ofron garanci për verifikimin fizik të sasisë.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 105-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1.Rekomandimi:** Komisioni i marrjes në dorëzim të lëndës djegëse të kryejë likuidimet e faturave të lëndës djegëse duke administruar dokumentacion vërtetues, ndër të tjera, mbi (i) sasinë faktike të lëndës djegëse të marrë në dorëzim dhe (ii) densitetin e lëndës, me qëllim dokumentimin e saktë të përlllogaritjes së vlerës së likuiduar.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të investimeve në godinat pronësi e DSHTD, jashtë territorit të RSH-së rezultuan parregullsi në realizimin e tyre.

**a. Investime Roma 2020:** Ofertat nuk janë të detajuara me zërat e punimeve specifike, por një vlerë totale. Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë. Dokumentacioni për marrjen në dorëzim të punimeve nuk përfshihet Urdhri i ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim. Janë konsideruar punime emergjente rregullim parketi, lysterje e vendosje karrigesh zyre, që nuk justifikojnë emergjencën.

**b. Investime Athina 2020:** Për dy procedura mungon urdhri i ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim. Fatura tatimore me vlerë 222.58 euro dhe fatura 494.2 euro nuk kanë elementët kryesore të faturave në kundërshtim nenin 9 të ligjit 87/2019. Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë.

**c. Investime Roma 2021:** Ofertat nuk janë të detajuara me zërat e punimeve specifike, por një vlerë totale. Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë.

**d. Investime Misioni i përhershëm RSH-së pranë OKB-së New York, 2021:** Ofertat nuk janë të detajuara me zërat e punimeve specifike, por një vlerë totale. Në dokumentacion mungon ftesa paraprake për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë ose publikimi për pjesëmarrje në procedurë. Vlera prej 2,500 USD është likuiduar në mungesë të faturës, por sipas një oferte projekt propozim.

**e. Investime Roma 2022:** Mungon publikimi i njoftimit në vendin e origjinës ku do të kryhen punimet, KVO nuk e ka evidentuar si devijim të vogël që OE i ka dorëzuar një pjesë të dokumentacionit të marrë nga institucionet e vendit të origjinës në gjuhën italiane pa u noterizuar siç kërkohet në DST.

**f. Investime Athina 2022:** Mungon publikimi i njoftimit në vendin e origjinës ku do të kryhen punimet, KVO ka kualifikuar OE në mungesë të dhënave për disponimin e një mjeti për transport me kapacitet jo më të vogël se 2.5 ton, në kundërshtim me DST. Kontraktori i punimeve ka dorëzuar dy fatura pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim. Punimet e certifikuar në situacionit përfundimtar nuk kanë periudhën progresive të zhvillimit të tyre në kundërshtim Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 158-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**14.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në bashkëpunim me Ambasadat e RSH jashtë territorit, të cilat kanë në përdorim pronat e DSHTD-së, për procedurat e realizuara për këto ambiente të realizohen me transparencë duke publikuar njoftimet për të nxitur konkurrencën dhe ngritjen e grupeve të marrjes në dorëzim sipas Urdhrave të Titullarëve respektivë dhe marrjen e ofertave me zëra specifik.

**Në vijimësi**

**14.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, të marrë masa për verifikimin e faturave për kryerjen e investimeve të kenë të gjitha elementët kryesore që e bëjnë një faturë të rregullt, para kryerjes së pagesës dhe të jenë brenda afateve kontraktuale ose marrjes në dorëzim.

**Në vijimësi**

**14.3.Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurat e investimeve jashtë territorit të RSH, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, për të siguruar dobishmëri në përdorimin e fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.

**Në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi: 1.** Nga auditimi rezultoi se për vitin 2020 nga Këshilli Drejtues është shtuar 1 punonjës më shumë në krahasim me strukturën e miratuar nga MEPJ të vitit 2019, ndërsa për vitin 2021 janë shtuar 2 me shumë punonjës në krahasim me strukturën e miratuar nga MEPJ të vitit 2019. Këto ndryshime nuk kanë marrë me parë miratimin e MEPJ pavarësisht së nga DSHTD janë dërguar shkresat për marrjen e dakordësisë. Këto veprime janë në kundërshtim me statutin e DSHTD miratuar me shkresë nr. prot. 1842 datë 17.02.2011, pika 15 ku citohet “*Struktura organizative e DSHTD behet me propozim të drejtorit dhe me miratim të Këshillit Drejtues. Vendimi i Këshillit Drejtues dërgohet për aprovim Ministrisë së punëve të jashtme dhe merr fuqi ligjore vetëm pas nënshkrimit*”.

**2:** Grupi i auditimit rezultoi se Komisioni strategjik i planifikimit nuk ka dokumentuar procesverbalet e mbledhjeve të kryera, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 172-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**15.1.Rekomandimi:** DSHTD të ndërmarrë një rol proaktiv në raport me MEPJ me qëllim respektimin e afateve të kthim përgjigjeve dhe marrjen e miratimeve përkatëse për vijimin e procedurave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**15.2.Rekomandimi:** DSHTD të marrë masa për dokumentimin e procesverbaleve të mbledhjeve të kryera të GMS, në përputhje me nenin 27 të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Në objektin “*Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare*” nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **132,906 lekë me tvsh**, veprime në kundërshtim me kontratën me nr. 697/3, datë 08.09.2020 lidhur midis DSHTD dhe BOE D.& H.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 105-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **132,906 lekë me tvsh** nga BOE D.&H., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës

me nr. 697/3, datë 08.09.2020, me objekt “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të DSHTD.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga Auditimi:** Në objektin “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **130,818 lekë me tvsh**, veprime në kundërshtim me kontratën me nr. 300/3, datë 05.05.2021 lidhur midis DSHTD dhe OE H.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 105-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **130,818 lekë me tvsh** nga OE H., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 300/3, datë 05.05.2021, me objekt “Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të DSHTD.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadës Bullgare 2021. Përkthimi i projektit nuk është në veprimtarinë e DSHTD pasi në VKM Nr.840, datë 17.12.2004 Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik. Pika 2/a citon: Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 74-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Rekomandimi 1.1:** Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të fondeve të buxhetit të Institucionit në vlerën **294,000 lekë me TVSh** për procedurën “Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadës Bullgare”.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Vendosija e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit në dhe skualifikimi i tyre në procedurën: **Procedura FV Kondicionerë 2022.**

Nga auditimi rezultoi se KPVV ka skualifikuar OE P. i renditur në vendin e dytë pasi në dokumentet e dorëzuar nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, KPVV nuk duhet të s’kualifikonte OE pasi në procedurat e blerjeve të vogla AK nuk duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës. Diferenca e OE të shpallur fituese K. dhe skualifikimi i OE P. me ofertë me të ulët, janë fonde të përdorura pa ekonomikitet në vlerën **64,372 lekë me TVSH.**

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 74-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Rekomandimi 2.1:** Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të fondeve të buxhetit të Institucionit në vlerën **64,372 lekë** në Procedurën “FV Kondicionerë 2022”.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se DSHTD ka aplikuar derdhjen e 30% të të ardhurave të krijuar nga qiraja vetëm nga “subjektet vendase”, me pretendimin se, meqenëse procedura e dhënies me qira e parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk mund të aplikohet për trupin diplomatik apo organizatat e tjera ndërkombëtare, rrjedhimisht, as derdhja e detyrimit 30% nuk duhet të aplikohet. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk e parashikon konceptin e subjektit vendas apo subjektit të huaj, kjo ndarje është bërë nga vetë DSHTD për efekt lehtësie në administrimin e procedurave. DSHTD nuk rezulton të ketë kërkuar asnjëherë rishikimin e këtij akti, me qëllim përjashtimin nga detyrimi për zbatim të procedurave të qiradhënies, në rastet kur pala qiramarrëse është pjesë e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë. Pavarësisht sa më sipër, për sa kohë DSHTD është një ndërmarrje shtetërore dhe objektet që po jep me qira janë pasuri shtetërore, pavarësisht palës qiramarrëse, DSHTD ka detyrimin të derdhë 30% të të ardhurave në buxhetin e shtetit, për sa kohë nuk përjashtohet shprehimisht në VKM nr. 54, datë 5.2.2014. Vlera prej 161,871,535 lekë është diferenca ndërmjet 30% të të ardhurave totale nga qiratë dhe vlerës së derdhur në buxhetin e shtetit për vitet 2020-2022.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Rekomandimi 3.1:** Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave të munguar për Buxhetin e Shtetit në vlerën **161,871,535 lekë**.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga Auditimi i kontratës me nr. 1096/2 datë 22.11.2019 KQSV-12.2019-M. – 014, tarifa e qirasë e vendosur është më e ulët se sa ai i miratuar me VKD për këtë zonë. Për ambientin përdhe prej 77.7m<sup>2</sup> çmimi është 4€ dhe nuk ka ndryshuar ndërsa për truallin prej 120.12 m<sup>2</sup> çmimi është 150lek/m<sup>2</sup> dhe nuk janë aplikuar çmimet e reja të vendosura nga VKD që duhet të ishte 1.5€/m<sup>2</sup>. Favorizimi i subjektit është në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira”, ku përcaktohet se çmimet favorizuese do të bëhen për shkak të planeve të investimeve në rastet e kontratave mbi 200 m<sup>2</sup>. Konkretisht sipërfaqja prej 77,7m<sup>2</sup> duhet të tarifohej me 7 €/ m<sup>2</sup>, dhe 77,7 \* 3€/ m<sup>2</sup>=233 euro/muaj \* 12= 2796 euro në vit të ardhura të munguara për Institucionin. Gjithashtu rezultoi se për subjektin e mësipërm tarifa e qirasë është vendosur sipas çmimeve të miratuara nga VKD për vitin 2019 pavarësisht se kontrata me subjektin është lidhur 2 dite mbasi Këshilli Drejtues miratoj tarifat e dhënies me qira për vitin 2020 me VKD nr. 29, datë 20.11.2019. Konkretisht sipërfaqja e lulishtes prej 120.12 duhet të tarifohej 1.5€/m<sup>2</sup> pasi kontrata është firmosur me datë 22.11.2019 dy ditë mbas miratimit të çmimeve të vendosura nga VKD dhe afati i kontratës është nga data 26.12.2019-25.12.2020. Sipërfaqja prej 120,12 \* 150lek \* 12 muaj = 216,216 lekë në vit sipas kontratë, por duhet të ishte 120.12m<sup>2</sup> \* 1.5€ \* 12muaj = 2162,16€ euro në vit sipas VKD. 2162,16€ \* 122.44€ (çmimi mesatar i kursit të këmbimit sipas bankës së Shqipërisë) = 264,648 leke, 264,648 leke - 216,216 leke të përfituara sipas kontratës = 48,432. Si përfundim në total vlera prej 2796 € dhe 48,432 lekë janë ardhura të munguara për Institucionin.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Rekomandimi 4.1:** Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën **2,796 euro dhe 48,432 lekë**.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet vendase nga DSHTD, për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qirave nuk janë vendosur kamatëvonesat përkatëse. Kamatë vonesat e llogaritura nga

grupi i auditimit për mos pagimin ne kohë të vlerës së qirasë është 959.22 Euro.

Me date 06.01.2020 subjekti qiramarrësi G. ka derdhur pranë bankës R. në Llogarinë e DSHTD vlerën 1,827.14 € sipas faturën nr.668 datë 02.12.2019 te lëshuar nga DSHTD për pagesën e muajt dhjetor të apartamenteve 6/1/1 dhe 6/1/2.

Nga auditimi rezultoi se subjekti G. nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni nuk ka marrë masë për të aplikuar penalitetin për kamatëvonesat. Penaliteti i pavendosur llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 548.14 €.

Subjekti S. dhe DSHTD kanë lidhur Kontrata me nr.180/3 datë 07.03.2019, KQSV-03.2019- S.-007 dhe Kontrata me nr.283/4 datë 15.04.2019, KQSV-05.2019-S.-008 dhe Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 411.08 €.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Rekomandimi 5.1:** Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën **959.22 Euro**.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet e huaja (trupi diplomatik/ organizatave ndërkombëtare), për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qirave nuk janë vendosur kamatëvonesat përkatëse. Kamatëvonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin ne kohë të vlerës së qirasë është 29,700.39 Euro.

Kontrata me nr.1182/1 prot datë 17.12.2019, KQPH/V-01.2020- A.R.F.Gj-001. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **29,105.87 €**.

Kontrata me nr. 1067/1 datë 04.11.2019, KQPH-12.2019- A.R.F.Gj-059. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **314 €**.

Kontrata KQPH/V-05.2020-A.R.F. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën **280.52 €**.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Rekomandimi 6.1:** Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën **29,700.39 Euro**.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës me nr.1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019-S.-059. rezultoi se subjekti nuk kryer pagesën brenda 5 ditëve nga data e faturimit dhe Institucioni i ka vendosur penalitetin vetëm për muajin gusht me shkresë nr. 834 prot 02.10.2020 në vlerën 98€ penalitete. Ndërsa për muaj e tjerë nuk janë marrë masa për të aplikuar penalitetet për kamatëvonesat. Penaliteti i pavendosur i llogaritur nga grupi i auditimi është në vlerën 294.29 €, të cilat për Institucionin janë të ardhura te munguara. Në kundërshtim me kontratën nr. 1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019- S.-059 neni 4 pika 1 citon: Qiramarrësi duhet ti paguaj qiradhënësit qiranë mujore brenda 5(pesë) ditëve, nga data e faturimit, përgjatë gjithë zgjatjes së kontratës.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Rekomandimi 7.1:** Titullari i DSHTD të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet, personat përgjegjës dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën **294.29 Euro**.

*Menjëherë*

## D. MASA DISIPLINORE

**D.I.** Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe neni 10 të statusit të “Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik” nr.1842 prot. datë 17.02.2011, i rekomandojmë Ministrit të Evropës dhe Punëve të Jashtme si titullar i organit qendror të analizojë parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH për Titullarin e Drejtorisë Së Shërbimit Të Trupit Diplomatik të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore.

**D.II.** Mbështetur në nenin 15, shkronja c dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që, në përputhje me nenin 37 të ligjit nr.7961 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore nga “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 6 – mujore”, “vërejtje” deri në “largim”, për punonjësit si më poshtë:

**1. Znj. T.T.**, në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të financës për mangësitë e konstatuara në procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit dhe hartimit të Pasqyrave Financiare.

Në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të financës për mangësitë e konstatuara, për mangësitë e konstatuara: për mos aplikimin për trupin diplomatik apo organizatat e tjera ndërkombëtare, detyrimin e derdhjes 30%, penaltetet e pavendosura për Kontratën me nr. 1020/1 datë 11.12.2019, KQPH/V-11.2019- S.-059, me objekt vilen nr. 49, Kontratën me nr. 1182/1 datë 17.12.2019, KQPH/V-01.2020- A.R.F.Gj-001, me objekt vilen nr.8 dhe nr.2, Kontratën me nr. 1067/1 datë 04.11.2019, KQPH-12.2019- A.R.F.Gj-059, Kontratën KQPH/V-05.2020- A.R.F. -004, me objekt vilën nr.14.

Në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të financës për mangësitë e konstatuara, për mungesën e dokumentacionit financiar në procedurat e prokurimit jashtë Republikës së Shqipërisë.

**2. Znj. V.B.**, në cilësinë e specialistit të sektorit të financës për mangësitë e konstatuara në procesin hartimit të Pasqyrave Financiare.

**3. Z. B.K.** në cilësinë e Kryetarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël, për mangësitë e konstatuara: Mosrespektim i afateve kohore; përlllogaritja e fondit limit dhe vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit në procedurat, si më poshtë: *Procedura Blerje materiale izoluese 2020, Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadën Bullgare 2021, Procedura FV Kondicionerë 2022, Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.*

Në cilësinë e anëtarit të komisioni i Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, për mangësitë e konstatuara: Mangësi në verifikimin e produktit final të dorëzuar në objektin “Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”.

**4. Z. E.A.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlere të vogël, për mangësitë e konstatuara: Mosrespektim i afateve kohore; përlllogaritja e fondit limit dhe vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit në procedurat, si më poshtë: *Procedura Blerje materiale izoluese 2020, Procedura Përkthim përpunim relacioni për Project ndërtimi për Ambasadën Bullgare 2021, Procedura FV Kondicionerë 2022, Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.*

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat si më poshtë: *Parkete e aksesore 2020.*

**5. Znj. A.N.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël, për mangësitë e konstatuara: Mosrespektim i afateve kohore; përlllogaritja e fondit limit dhe vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit në procedurat, si më poshtë: *Procedura Blerje materiale izoluese 2020, Procedura Përkthim përpunim relacioni për Projekt ndërtimi për Ambasadën*

*Bullgare 2021, Procedura FV Kondicionerë 2022, Në 9 procedura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.*

*Në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: Parkete e Aksesorë 2020, Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare 2020.*

**6. Znj. E.K. (I.)** në cilësinë e anëtarit të komisionit për monitorimin e kontratave me subjektet vendase i ngritur me urdhër të titullarit të Institucionit nr.316 prot, datë 28.03.2019 për mangësitë e konstatuara: penalitete të pavendosura për subjektin G., Subjekti S. përkatësisht Kontrata me nr.180/3 datë 07.03.2019, KQSV-03.2019- S.-007 dhe Kontrata me nr.283/4 datë 15.04.2019, KQSV-05.2019-S.-008.

*Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit, vendosjen e kriterëve teknike për procedurat si më poshtë: Dyer të brendshme 2020, Dyer të brendshme 2022,*

*Në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: Parkete e Aksesorë 2020, Pllaka të ndryshme 2020, Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare 2020,*

**7. Z. E.D.** në cilësinë e anëtarit të komisionit për monitorimin e kontratave me subjektet vendase i ngritur me urdhër të titullarit të Institucionit nr.316 prot, datë 28.03.2019 për mangësitë e konstatuara: penalitete të pavendosura për subjektin G., Subjekti S. përkatësisht Kontrata me nr.180/3 datë 07.03.2019, KQSV-03.2019- S.-007 dhe Kontrata me nr.283/4 datë 15.04.2019, KQSV-05.2019-S.-008.

**8. Znj. M.Gj.** në cilësinë e anëtarit të komisionit për monitorimin e kontratave me subjektet vendase i ngritur me urdhër të titullarit të Institucionit nr.316 prot, datë 28.03.2019 për mangësitë e konstatuara: penalitete të pavendosura për subjektin G., Subjekti S. përkatësisht Kontrata me nr.180/3 datë 07.03.2019, KQSV-03.2019- S.-007 dhe Kontrata me nr.283/4 datë 15.04.2019, KQSV-05.2019-S.-008.

*Në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: Dyer të brendshme 2020.*

**9. Znj. D.B.** në cilësinë e kryetarit të njësisë së prokurimit, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat si më poshtë: Parkete e aksesorë 2020.

**10. Znj. D.M.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: Pllaka të ndryshme 2020.

**11. Znj. E.Dh.** në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit, vendosjen e kriterëve teknike për procedurat si më poshtë: Rikonstruksioni i ashensorit në pallatin nr.8/2, 8/3 2020, Ambasada Bullgare- Hapje pus uji + impiant klorifikimi 2021, Shërbim mirëmbajtje ashensori 2022.

**12. Z. K.Sh.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, për mangësitë e konstatuara: Mangësi në verifikimin e produktit final të dorëzuar në objektin “Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”.

**13. Znj. V.Sh.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, për mangësitë e konstatuara: Mangësi në verifikimin e produktit final të dorëzuar në objektin “Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”.

**14. Znj. M.K.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, për mangësitë e konstatuara: Mangësi në verifikimin e produktit final të dorëzuar në objektin “Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”.

**15. Z. I.B.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të Pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, për mangësitë e konstatuara: Mangësi në verifikimin e produktit final të dorëzuar në objektin “Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”.

**16. Z. S.H.** në cilësinë e kryetarit/anëtarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave, për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: Dyer të brendshme 2022, Kryerje e punimeve në godinën e ambasadës së RSH-së në Athinë, Greqi 2022.



**17. Znj. G.V. në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave,** për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: *Dyer të brendshme 2022.*

**18. Znj. I.B. në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave,** për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: *Dyer të brendshme 2022, Kryerje e punimeve në godinën e ambasadës së RSH-së në Athinë, Greqi 2022.*

**19. Z. E.Ç. në cilësinë e kryetarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave,** për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: *Kryerje e punimeve në godinën e ambasadës së RSH-së në Athinë, Greqi 2022.*

### **D.III. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësit e konstatuar me shkelje të natyrës administrative nuk rekomandojmë masa disiplinore, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 6 – mujore”, “vërejtje” deri në “largim” përkatësisht:

**1. Për Z. A. S., në cilësinë e ish- Drejtorit** për mangësitë e konstatuara: Për kryerjen e procedurës jashtë fushës së veprimtarisë së Institucionit, dhe parregullsi në dhënien me qira të objekteve në pronësi të Institucionit.

**2. Për Znj. G.V. në cilësinë e kryetarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave,** për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: *Dyer të brendshme 2020, Parkete e aksesore 2020, Pllaka të ndryshme 2020, Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare 2020.*

**3. Për Z. E. Th. në cilësinë e anëtarit të komisionit të Vlerësimit të ofertave,** për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në vlerësimin e ofertave për procedurat si më poshtë: *Dyer të brendshme 2020.*

*Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit,* për mangësitë e konstatuara: Parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit, vendosjen e kriterëve teknike për procedurat si më poshtë: *Pllaka të ndryshme 2020, Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare 2020.*

### **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarre veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

## **V. ANEKSE**

Anekset japin informacion mbi:

Aneksi 1. Sqarim rreth llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga KLSH;

Aneksi 2. Analiza e risqeve;

Aneksi 3. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të DSHTD;

Aneksi 4. Mbi realizimin e procedurave te prokurimit dhe investimeve jashtë territorit të RSH.

## **VI. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT**

Pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur, si më poshtë:

### **a. Akt konstatime:**

Akt Konstatimi nr.1, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.2, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.3, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.4, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.5, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.6, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.7, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.8, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.9, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.10, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.11, datë 14.04.2022;

Akt Konstatimi nr.12, datë 14.04.2022.

### **b. Akt verifikime:**

Akt Verifikimi nr.1;

Akt Verifikimi nr.2.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

## **ANEKSI I - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.**

### **Llojet e opinioneve të aplikuara nga KLSH.**

#### **a. OPINIONI I PAMODIFIKUAR:**

Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Audituesi duhet të tërheq vëmendjen e përdoruesit për një ose disa çështje të paraqitura ose të evidentuara në pasqyrat financiare, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Përdoruesit e pasqyrave financiare në sektorin publik janë ligjvënësit, Parlamenti, komitetet mbikëqyrëse, komisione të ndryshëm dhe qytetarët, të cilët janë përdoruesit e fundit.

#### **Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.**

Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si “theksimi i çështjes” përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5).

#### **b. OPINIONET E MODIFIKUARA:**

Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur:

- Bazuar në evidencat e auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë anomali materiale; ose
- Nuk është në gjendje të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditin. (ISSAI 1700.4;6;17)
- Evidentohet që njësia ekonomike nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i raportimit financiar për:
  - Prezantimin e drejtë të informacionit financiar.
  - Mos plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të raportimit financiar. (ISSAI 1700.18;19)
- Evidentohen raste që lidhe me mosrespektimin e legjislacionit ose dobësi të kontrollit të brendshëm, të cilat ka një efekt material ose të përhapur në pasqyrat financiare. (ISSAI 1705 P4; P5; P6)

Përhapja është një term i përdorur për të përshkruar efektet në pasqyrat financiare të anomalive ose efektet të mundshme nëse ka, që nuk zbulohen për shkak të pa mundësisë për të marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit. Përhapja e gjetjes do të përcaktojë llojin e opinionit të modifikuar të auditimit i cili do të jepet.

Efektet e përhapjes në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të audituesit: Nuk kufizohen në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare; Mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose janë të rëndësime për përdoruesit e pasqyrave financiare. (ISSAI 1700.5)

Audituesi duhet të zgjedhë opinionin më të përshtatshëm të modifikuar nga 3 opsionet e përshkruara më poshtë:

**Opinion i modifikuar.** Opinioni i modifikuar do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e modifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse

nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

**Opinion negativ (kundërshtues).** Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion i modifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion i qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe e praktikueshme, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

**Refuzim i opinionit.** Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion i kualifikuar në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

## ANEKSI II:

### ANALIZA E RISQEVË:

#### **1. Risku i brendshëm (i trashëgueshëm) IR për DSHTD:**

Risku i brendshëm i shmangies nga përputhshmëria, ose gabimi, është analizuar nga grupi i auditimit duke përdorur gjykimin në vlerësimin e një sërë faktorësh, (në referencë të kreut 4.3.2 të MAP të KLSH, fq. 28- 30), që përfshijnë:

*Shkallëzimi IR:*

Risku i ulët: ngjyrë jeshile, deri në 0,5

Risku i moderuar: ngjyrë verdhë, 0.6 deri në 0,9

Risku i lartë: ngjyrë kuqe, 1

- kompleksitetin e strukturave menaxhuese: verdhe, vlerësuar **0,6**
- kompleksitetin e kuadrit normues dhe ligjor: jeshile, vlerësuar **0.4**
- hyrjen në zbatim të dispozitave të reja ligjore ose ndryshimet në rregullat ekzistuese: verdhë, vlerësuar **0,7**
- shërbime dhe programe të realizuara nga palë të treta: jeshile deri tek e verdhë në pak raste, vlerësuar **0,8**
- pagesa dhe fatura të kryera mbi baza pretendimesh ose deklarimesh: (nuk janë vërtetuar raste të tilla nga testimi), jeshile, vlerësuar **0,3**
- numrin dhe shumë llojshmërinë e përfituesve: verdhë, vlerësuar **0,8**.

*Mesatarja për 6 zërat e listuar më sipër:  $3,6/6 = 0,6$  d.m.th ngjyrës te verdhë, risk i mesëm.*

#### **2. Risku i kontrollit (CR) për institucionin DSHTD-së:**

Risku i kontrollit është risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigojohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Kur audituesi parashikon të mbështetet në vlerësimin e riskut të kontrollit për të zvogëluar shkallën e përdorimit të procedurave thelbësore (substantivë) sa i takon përputhshmërisë, ai kryen gjithashtu vlerësime paraprake të riskut të kontrollit dhe planifikon e kryen teste të kontrollit, në mënyrë që të mbështesë këtë vlerësim. (Shiko fq. 29 të manualit)

Statusi i kontrollit te brendshëm	Risku i kontrollit	Përshkrimi	Risku i kontrollit për DSHTD-në
<b>Shumë i mirë</b>	<b>I ulët</b>	Në rrethanat kur informacioni disponibël vjen nga auditimet e fundit në të njëjtën fushë, çka tregon se kontrolli i brendshëm është projektuar shumë mirë dhe funksionon si duhet në hartim dhe zbatim.	
<b>I mirë</b>	<b>I mesëm</b>	Kontrolli i brendshëm ekziston dhe është i projektuar si duhet, pra ka të ngjarë të funksionojë në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës nën shqyrtim.	<b>I mesëm</b>
<b>dobët</b>	<b>I lartë</b>	Kontrolli i brendshëm nuk ekziston, ose është i projektuar dobët apo zbatohet dobët.	

#### **3. Risku i moszbulimit (DR) për institucionin DSHTD-së:**

Risku i moszbulimit është risku që grupi i auditimit të mos zbulojë gabime materiale të cilat kanë ndodhur dhe nuk janë parandaluar ose zbuluar dhe korrigjuar në kohë nga sistemi i kontrollit të brendshëm.

*“Kontrolli i Lartë i Shtetit kërkon një nivel sigurie 95% nga testet e kryera, që mund të vijnë nga kontrollet ose tërësisht nga procedurat thelbësore, në varësi të vlerësimit të audituesit sa i takon riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit” (faqe 35). Për institucionin e KLSH risku i auditimit*

është pranuar 5 %. Pra **AR= 5%**.

Risku i auditimit AR:

$$AR = IR \times CR \times DR$$

$$5\% = 0.63 \times 0.23 \times DR$$

$$0.05 = 0.63 \times 0.23 \times DR$$

$$DR = 0.05 / 0.126 = 0.39 < 5\%.$$

### **PERZGJEDHJA E KAMPIONIT TË AUDITIMIT:**

Tre mënyrat e përzgjedhjes së kampioneve: Statistikore dhe Jo statistikore:

- Përzgjedhja e 100% të artikujve,
- Përzgjedhja e artikujve të veçantë;
- Testimi i kampionëve
- *Pasqyrat financiare te bilancit: audituar 100 % llogaritë e bilancit për vitin 2020-2022, për të cilin jepet opinion; transaksionet financiare janë audituar me zgjedhje dhe sondazhe llogaritë e tjera (aktivit dhe pasivit);*
- *Prokurimet publike e audituara 62,27 % e fondeve të prokuruar mbuluar me auditim .*
- *Procedurat e MFK audituar 100 % për gjithë periudhën objekt auditimi;*

## ANEKSI III: 2.1 MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË DSHTD

Tabela 1:

Nr.	DREJTORIA E SHERBIMIT TE TRUPIT DIPLOMATIK	Vendodhja	Kontrata të lidhura		Numri i të punësuarve	Siperfaqe e dhene Funksional e	Detyrimi (kontrata) per periudhen Korrik- Dhjetor 2020		Te ardhura nga qiraja per periudhen Korrik-Dhjetor 2020		Derdhur detyrimi ne zbatim te VKM nr.54 (shperndarja e te ardhurave per llogari te buxhetit te shtetit) per periudhen janar- qershor 2020		Derdhur detyrimi ne zbatim te VKM nr.54 (shperndarja e te ardhurave per llogari te buxhetit te shtetit) per periudhen ne fjale	Derdhur detyrimi ne zbatim te VKM nr.54 (shperndarja e te ardhurave per llogari te MFE) per periudhen ne fjale
			Nr	m2			Euro	Lekë	Euro	Lekë	buxheti	ministra		
<b>Kontrata qiraje nen 200 m<sup>2</sup></b>														
1	Sh.	Rr.Skënd.PII.8,shk1 & shk.2	KQSV-10.2019-SH.-012 & KQSV-10.2019 SH- 013	108+15.93	3		€ 4,758		€ 4,758		165,298	-	178,129	
2	D.	Rr.Skënd.PII8, shk. 3	KQSV- 03.2020- D.- 004	47.3	8		€ 1,987		€ 1,987		73,634	-	73,892	
3	A.	Rr.Skënd.PII. 8,shk.3	KQSV- 07.2020- A. - 0014	26.64	1		€ 1,119		€ 1,119		41,459	-	41,834	
4	S.	Rr.Skënd.PII.8,shk.3	KQSV- 10.2020 – 006	58	2		€ 1,502		€ 1,502		7,668	-	55,851	
5	A.A.Sh.	Bul."Zogu I l"PII.57, bodrum	KQSV- 02.2020- A.- 003	56.7	2		€ -	101,880	€ -	101,880	30,564	-	30,564	
6	S.	Bul."Zogu I l"PII.57, bodrum	KQSV- 05.2020 - 006	159	1		€ 3,816	-	€ 3,816	-	141,383	-	142,158	
7	M.	Rr.Skënd.PII. 4	KQSV-12.2019-M.-014	197	8 deri 10	120.12	€ 1,865	108,108	€ 1,865	108,108	101,523	-	103,688	
8	S.	Bul."Zogu I l"PII.57, shk.1, ap 1'+2'	KQSV- 03.2020 - S. - 005	177.3	20		€ 5,319	-	€ 5,319	-	197,069	-	197,814	
9	A.L.	Bul."Zogu I l"PII.57, shk.2,ap.20	KQSV-07,2020-A.L.-012	59.6	Banim		€ 1,430	-	€ 1,430	-	27,080	-	53,181	
10	A.A.	Bul."Zogu I l"PII.57, shk.2,ap.24	KQSV-07,2020-A.A.-013	59.6	Banim		€ 1,430	-	€ 1,430	-	3,659	-	44,296	
11	A.T.	Bul."Zogu I l"PII.57, shk.2,ap.14	KQSV-02,2020-A.T.-002	59.6	Banim		€ 1,430	-	€ 1,430	-	52,996	-	53,180	
12	B.I.	Rr.Skënd.PII.8,shk1 kati përdhe, njesia 3 & 4	KQSV- 09.2019-P.- 010	50.6	2		€ 2,039		€ 2,039		67,490	-	75,809	-
13	E.T.C.	Rr.Skënd.PII.8,shk1 apart 1	KQSV- 07.2020-E.- 011	96.71	2		€ 4,062		€ 4,062				152,155	
<b>Kontrata qiraje mbi 200 m<sup>2</sup></b>														
1	W.	Rr. Skënd. PII. 6, shk 1+2	Kontrate nr. 3241 prot, dt. 23.05.2013	348 (259 + 89)	13-15	89	€ -	873,258	€ -	873,258	-	174,652	-	261,977
							<b>€ 30,759</b>	<b>1,083,246</b>	<b>€ 30,759</b>	<b>1,083,246</b>	<b>909,823</b>	<b>174,652</b>	<b>1,202,551</b>	<b>261,977</b>

**Tabela 2**

Nr.	DREJTORIA E SHERBIMIT TE TRUPIT DIPLOMATIK	Vendodhja	Kontrata të lidhura		Numri i të punës uarve	Siperfaqe e dhene me qera			Detyrimi (kontrata) per periudhen Janar- Dhjetor 2021		Te ardhura nga qiraja per periudhen Janar-Dhjetor 2021		Derdhur detyrimi ne zbatim te VKM nr.54 (shpernda rja e te ardhurave per llogari te buxhetit te shtetit) per Janar- Qershor 2021	Derdhur detyrimi ne zbatim te VKM nr.54 (shpernda rja e te ardhurave per llogari te MFE) per Janar- Qershor 2021	Derdhur detyrimi ne zbatim te VKM nr.54 (shpernda rja e te ardhurave per llogari te buxhetit te shtetit) per Korrik- Dhjetor 2021	Derdhur detyrimi ne zbatim te VKM nr.54 (shpernda rja e te ardhurave per llogari te MFE) per Korrik- Dhjetor 2021
			Nr	m2		Gjithsej	Objekt	Funksionale	Euro	Lekë	Euro	Lekë	buxheti	ministra	buxheti	ministra
<b>Kontrata qiraje nen 200 m<sup>2</sup></b>																
1	Sh.	Rr.Skënd.PII.8,shk1 & shk.2	KQSV-10.2021-SH.-062 & KQSV-10.2021 SH.-061	108	3	108	108		10218.96		10218.96		189,069	0	186,887	-
2	D.	Rr.Skënd.PII.8, shk. 3	KQSV- 03.2021- D.- 028	47.3	8	47.3	47.3		3974.88		3974.88		73,542	0	72,694	-
3	A.	Rr.Skënd.PII. 8,shk.3	KQSV- 07.2020- A.- 014	26.64	1	26.64	26.64		2238		2238		42,427	0	0	0
4	S.	Rr.Skënd.PII.8,shk.3	KQSV- 09.2021 – 006	58	2	58	58		4872		4872		90,140	0	89,100	-
5	A.A.Sh.	Bul."Zogu I l"PII.57, bodrum	KQSV- 02.2021- A.- 027	56.7	2	56.7	56.7		2339.37	28,502	2339.37	28,502	44,710	0	49,686	-
6	S.	Bul."Zogu I l"PII.57, bodrum	KQSV- 05.2021 - 037	159	1	159	159		7632		7632	-	141,205	0	139,576	-
7	M.	Rr.Skënd.PII. 4	KQSV-12.2021-M.-075	(77,7 dhe	8 deri 10	197.82	77.7	120.12	8690.4		8690.4		162,561	0	159,171	-
8	S.	Bul."Zogu I l"PII.57, shk.1, ap 1'+2'	KQSV- 03.2021 - S. - 030	177.3	20	177.3	177.3		10638	-	10638	-	196,822	0	194,550	-
9	A.L.	Bul."Zogu I l"PII.57, shk.2,ap.20	KQSV-07.2021-A.L.-046	59.6	Banim	59.6	59.6		2860.8	-	2860.8	-	52,930	0	52,502	-
10	A.A.	Bul."Zogu I l"PII.57, shk.2,ap.24	KQSV-08.2021-A.A.-049	59.6	Banim	59.6	59.6		2860.8	-	2860.8	-	52,930	0	52,319	-
11	L.H.	Bul."Zogu I l"PII.57, shk.2,ap.14	KQSV-05.2021 L.H. -038	59.6	Banim	59.6	59.6		2384.6	-	2384.6	-	35,284	0	52,501	-
12	B.I.	Rr.Skënd.PII.8,shk1 kati përdhe, njesia 3 & 4	KQSV- 09.2021-B.I.- 054	50.6	Zyrë				4,250.40		4,250.40		78,640	0	77,732	-
13	E.T.C.	Rr.Skënd.PII.8,shk1 apart 1	KQSV- 07.2021-E.- 047	96.71	2				8,239.00		8,239.00		155,012	0	152,762	-
<b>Kontrata qiraje mbi 200 m<sup>2</sup></b>									0		0		-	0	-	-
1	W.	Rr. Skënd. PII. 6, shk 1+2	Kontrate nr. 3241 prot. dt. 23.05.2013	348 (259 +	12 deri 15	348	259	89	-	1746516	-	1746516	-	349,303	-	261,977
<b>Totali</b>									-	<b>1,775,018</b>	<b>71,199</b>	<b>1,775,018</b>	<b>1,315,272</b>	<b>349,303</b>	<b>1,279,480</b>	<b>261,977</b>
<b>3,206,032</b>																



## ANEKSI IV:

### 2.4 MBI REALIZIMIN E PROCEDURAVE TE PROKURIMIT DHE INVESTIMEVE JASHTË TERRITORIT TË RSH

**2.4.1. Procedura e prokurimit “Rikonstruksion në fasadën e jashtme të Ambasadës Bullgare”,** me fond limit **5,352,818 pa TVSH**, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2020, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2020.  
Zbatimi i kontratës: Volumet e llogaritjes të sipërfaqeve të shpatullimit.

*Tabela nr.3: Dritare dhe vetrata:*

Nr.	Përshkrimi	Nr. Dritareve (copë)	Gjatësia-1 (m)	Gjatësia-2 (m)	Gjatësia totale (m)	Koment
<b>1. Bodrumi</b>						
1	Dritare 1 (2x0.60) m	3	2	0.60	15.6	Perimetër dritare x 3 copë
2	Dritare 2 (1.5x0.70) m	2	1.5	0.7	8.8	Perimetër dritare x 2 copë
<b>2. Kati përdhe</b>						
3	Dritare D1 (0.8x1.3) m	2	0.8	1.3	8.4	Perimetër dritare x 2 copë
4	Dritare D2 (0.9x1.3) m	1	0.9	1.3	4.4	Perimetër dritare
5	Dritare kafazi i shkallës (2x0.5) m	3	2	0.5	15	Perimetër dritare x 3 copë
6	Dritare D4 (2x1.3) m	1	2	1.3	6.6	Perimetër dritare
7	Dritare D6 (2x1.3) m	4	2	1.3	26.4	Perimetër dritare x 4 copë
8	Dritare tualeti (0.6x0.6) m	2	0.6	0.6	4.8	Perimetër dritare x 2 copë
9	Vetrata jashtme (3.5x2.7) m	3	3.5	2.7	26.7	Perimetër muri x 3 copë
10	Vetratë brenda (4.4x3.8) m	1	4.4	3.8	12	Perimetër muri
11	Vetratë brenda (4.4x2.9) m	1	4.4	2.9	10.2	Perimetër muri
12	Derë kryesore (1.8x3.4) m	1	1.8	3.4	8.6	Perimetër muri
13	Derë kryesore brenda (2x2.6) m	1	2	2.6	7.2	Perimetër muri
<b>3. Kati i parë</b>						
14	Dritare D1 (0.8x1.3) m	2	0.8	1.3	8.4	Perimetër dritare x 2 copë
15	Dritare kafazi i shkallës (2x0.5) m	3	2	0.5	15	Perimetër dritare x 3 copë
16	Dritare D2 (0.9x1.3) m	1	0.9	1.3	4.4	Perimetër dritare
17	Dritare D4 (2x1.3) m	1	2	1.3	6.6	Perimetër dritare
18	Dritare D6 (2x1.3) m	3	2	1.3	19.8	Perimetër dritare x 3 copë
19	Vetrata jashtme	1	11.8	1.5	26.6	Perimetër vetratë

	(11.8x1.5) m					
<b>4. Kati i dytë</b>						
20	Dritare D1 (0.8x1.3) m	2	0.8	1.3	8.4	Perimetër dritare x 2 copë
21	Dritare kafazi i shkallës (2x0.5) m	3	2	0.5	15	Perimetër dritare x 3 copë
22	Dritare D4 (2x1.3) m	2	2	1.3	13.2	Perimetër dritare x 2 copë
23	Dritare D6 (2x1.3) m	3	2	1.3	19.8	Perimetër dritare x 3 copë
<b>Gjatësia totale</b>					<b>291.9</b>	<b>m</b>
<b>Trashësia murit</b>					<b>0.45</b>	<b>m</b>
<b>Sipërfaqe shpatullim dritare</b>					<b>131.4</b>	<b>m2</b>

Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit.

Zbatimi i kontratës: Volumet e llogaritjes të diferencës së sipërfaqeve të suvatimit dhe lyerjes.

Tabela nr.4: Suvatim me grafiato dhe lyerje fasade me bojë:

Nr.	Përshkrimi	Nr. Elementëve (copë)	Gjatësia (m)	Lartësia (m)	Sipërfaqja (m2)	Sipërfaqja sipas LM (m2)	Koment
<b>1. Fasada Jugu</b>							
1	Mure Kati i parë	1	10.7	5.15	55.10	72.60	Dimensionet janë 10.70 x5.15 dhe jo 13.2x5.5
<b>2. Fasada Lindore</b>							
1	Mure	1	4.5	5.15	23.18	24.75	Dimensionet janë 4.5x5.15 dhe jo 4.5x5.5
2	Mure	1	13.8	11.5	158.7	172.50	Dimensionet janë 13.8x11.5dhe jo 13.8x12.5
<b>3. Fasada Veriore</b>							
1	Mure	1	6	11.5	69	344.85	Dimensionet janë 6x11.5 dhe jo 6x12.5
<b>Sipërfaqja</b>					<b>305.98</b>	<b>486.3</b>	<b>m2</b>
<b>Diferenca</b>					<b>38.87</b>		<b>m2</b>

Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit.

**2.4.2. Procedura e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje ashensori”, me fond limit 1,631,330 lekë pa TVSH,** vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së, për nevoja të DSHTD-së, për vitin 2022, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2022.

Ashensorët në pronësi të DSHTD, sipas certifikimeve ISHMT.

Tabela nr.5: Objekti mirëmbajtje ashensorësh viti 2022/ Emërtimet e ashensorëve sipas certifikimit.

Nr.	Ashensori / Vendndodhja	Marka	Certifikata e regjistrimit ISHMT	Data e regjistrimit
1	Ambasada Greke	M.	001282 TR	28.01.2022
2	Godina 8/3 (Ashensori Majtas)	Z.	001283 TR	28.01.2022
3	Godina 8/3 (Ashensori Djathtas)	A.	001284 TR	28.01.2022
4	Godina 8/2 (Ashensori Majtas)	Z.	001285 TR	28.01.2022
5	Godina 8/2 (Ashensori Djathtas)	A.	001286 TR	28.01.2022
6	Godina 8/1	A.	001287 TR	28.01.2022
7	Godina 6/1	S.	001288 TR	28.01.2022
8	Godina 6/2	A.	001289 TR	28.01.2022
9	Godina 4 (Ashensori Majtas)	Z.	001290 TR	28.01.2022
10	Godina 4 (Ashensori Djathtas)	A.	001291 TR	28.01.2022
11	Pallati nr.57	E.	001294 TR	01.02.2022

Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit.

### 2.4.3. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, viti 2020:

**Punime në godinën e Ambasadës, me vlerë 24,179 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

*Tabela nr.6: Procedurat e prokurimit për investimin në Ambasadën e Athinës 2020:.*

Nr.	Urdhër prokurimi	Përshkrimi	Fondi limit (euro)	Data e realizimi të procedurës	OE-1 (euro)	OE-2 (euro)	OE-3 (euro)	OE fitues (euro)	Diferenca fond limit OE fitues (euro)	Fatura e pagesës
1	Nr.1, datë 10.03.2020	Materiale lysterje	1,084	12.03.2020	379.69	443.1	477.95	363.43 /450.66	56.14	Fatura nr.0013345 Datë 12.03.2020
				15.03.2020	543	621.4	674.7	543		Fatura nr.0011342 Datë 15.03.2020
				16.03.2020	34.2	41	45.2	34.2		Fatura nr.0011369 Datë 16.03.2020
2	Nr.2, datë 10.03.2020	F.V. Mbrojtëse muri plastike 50mlx30cm	800	15.03.2020	800	880	930	800	0	Fatura nr.0011343 Datë 15.03.2020
3	Nr.3, datë 10.03.2020	F.V. Parket laminat ish konsullorja	1,400	15.03.2020	1,400	1,700	1,800	1,400	0	Fatura nr.0011421 Datë 18.03.2020
4	Nr.4, datë 10.03.2020	F.V. Inverter 12000 btu+pastrimi e riparimi i dy të tjerëve	950	16.03.2020	950	1,080	1,120	950	0	Fatura nr.0010442 Datë 16.03.2020
5	Nr.5, datë 10.03.2020	F.V. Dritare durali skorevel+zëvendësimi i xhamave të djegur	900	16.03.2020	900	1,000	1,080	900	0	Fatura nr.0011384 Datë 17.03.2020
6	Nr.6, datë 10.03.2020	F.V. Tabelë në hyrje të ambasadës	350	15.03.2020	350	390	450	350	0	Fatura nr.0011388 Datë 17.03.2020
7	Nr.7, datë 10.03.2020	Veshje xhamash me letër adezivi	981	16.03.2020	981	1,000	1,150	981	0	Fatura nr.0011389 Datë 17.03.2020
8	Nr.8, datë 10.03.2020	Pastrim i rrugës së hyrjes së konsullores me rërë kuarci	1,250	15.03.2020	1,250	1,320	1,400	1,250	0	Fatura nr.0011350 Datë 16.03.2020
9	Nr.9, datë 10.03.2020	F.V. linjë elektrike, UPS, UTP4, kategoria 6, në ish konsullore	1,350	15.03.2020	1,350	1,400	1,460	1,350	0	Fatura nr.0010493 Datë 19.03.2020
10	Nr.10, datë 10.03.2020	Pastrim gjeneral i të gjithë ambienteve të ambasadës	1,700	17.03.2020	1,700	1,750	1,820	1,700	0	Fatura nr.0011494 Datë 19.03.2020
11	Nr.11, datë 10.03.2020	F.V. Motor i ri në derën lëvizëse	630	16.03.2020	630	650	710	630	0	Fatura nr.0010453 Datë 17.03.2020
12	Nr.12, datë 10.03.2020	Zëvendësimi i të gjitha kabllave të kamerave komplet	4,750	16.03.2020	4,750	4,840	5,100	4,750	0	Fatura nr.0010498 Datë 19.03.2020

13	Nr.13, datë 10.03.2020	F.V. Polikarbonat mbulesa e pandusit 45m2, përfshirë prishjen si dhe vendosjen e skelave 15m2	1,680	15.03.2020	1,680	1,900	2,050	1,680	0	Fatura nr.0011422 Datë 18.03.2020
14	Nr.14, datë 10.03.2020	F.V. Perde tip roler	1,125	16.03.2020	1,125	1,300	1,460	1,125	0	Fatura nr.0011451 Datë 20.03.2020
15	Nr.15, datë 10.03.2020	F.V. Pemë dekorative rrethimi	320							Fatura nr.0912 Datë 20.03.2020
16	Nr.16, datë 10.03.2020	F.V. Vazo të mëdha lulesh	450							Fatura datë 24.03.2020

Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit.

#### 2.4.4. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, viti 2021:

**Punime të nevojshme dhe të domosdoshme në godinën e Ambasadës, me vlerë 9,955 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

*Tabela nr.7: Punimet e kryera në godinën e ambasadës Athinës sipas situacionit përfundimtar datë 25.11.2021:*

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (euro)	Vlera pa tvsh (euro)	Fatura	Shënime
<b>I. Kati përdhe</b>							
1	Lyerje me bojë plastike (e brendshme)	m2	280	8	2,240	Nr.07, datë 10.12.2021, me vlerë 2,770 euro pa tvsh	Sipas Sit.1
2	Zëvendësimi i mekanizmit të derës kryesore	copë	1	170	170		
3	F.V. davancale mermeri te dritarja e zyrës së shpërndarjes (160x43cm)	copë	1	200	200		
4	Zëvendësimi i mekanizmit të dritares te zyra e shpërndarjes	copë	1	160	160		
5	F.V. Spote dhe llampa LED	copë	52	24	1,248	Nr.08, datë 13.12.2021, me vlerë 2,448 euro pa tvsh	Sipas Sit.2
6	F.V. Pllafonier 60x60cm me ndriçim LED	copë	6	180	1,080		
<b>II. Banjë në hyrje të zyrës konsullore</b>							
1	F.V. Ventilatori	copë	1	120	120		
2	F.V. durali (79x196 cm)	copë	1	680	680		
<b>III. Zyra konsullore</b>							
1	Regjistrimi i dritareve, zëvendësimi i gominave (123x126cm)	copë	1	120	120	Nr.09, datë 15.12.2021 me vlerë 2,810 euro pa tvsh	Sipas Sit.3
2	Zëvendësimi i mekanizmit të dritares te zyra konsullore	copë	1	160	160		
<b>IV. Bodrumi-1</b>							
1	Zëvendësim i bravës së derës	copë	1	130	130		
2	F.V. Qepen te zyra konsullore (290x250cm)	copë	1	1,480	1,480		
<b>V. Të përgjithshme</b>							
1	Riparim dhe lyerje me bojë akrilik të murit të jashtëm të godinës së ambasadës	m2	12	20	240		
Vlera pa detyrime fiskale					8,028		
Detyrime fiskale 24%					1,926.72		
Shuma totale					9,954.72		

Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit.

**2.4.5. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë, viti 2022:**

**Kryerje e punimeve në godinën e ambasadës, me vlerë 49,093 euro pa përfshirë taksat, vënë në dispozicion nga të ardhurat e DSHTD-së.**

*Tabela nr.8: Vlerat e Punimeve të kryera në godinën e ambasadës Athinës sipas situacioneve 2022:*

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Vlera pa zbritje (euro)	Vlera e zbritur Tatimi në burim 3% dhe ngurtësimi 5% (euro)	Vlera për tu paguar (euro)	Faturat
1	Situacioni pjesor nr.1 Periudha 19.09.2022-30.09.2022	7,873	629.84	7,243.16	Nr.48, datë 27.09.2022 (3,965 euro); Nr.49, datë 30.09.2022 (3,908 euro);
2	Situacioni pjesor nr.2 Periudha 1.10.2022-31.10.2022	14,783	1,182.64	13,600.36	Nr.50, datë 05.10.2022 (3,120 euro); Nr.52, datë 14.10.2022 (3,646 euro); Nr.53, datë 20.10.2022 (2,112 euro); Nr.54, datë 25.10.2022 (3,500 euro); Nr.57, datë 31.10.2022 (2,405 euro);
3	Situacioni pjesor nr.3 Periudha 1.11.2022-20.11.2022	12,200	976	11,224	Nr.58, datë 04.11.2022 (3,720 euro); Nr.59, datë 08.11.2022 (1,980 euro); Nr.60, datë 14.11.2022 (3,808 euro); Nr.61, datë 16.11.2022 (2,692 euro);
4	Situacioni pjesor nr.4 Përfundimtar	14,237	1,138.96	13,098.04	Nr.65, datë 03.12.2022 (3,736 euro); Nr.67, datë 09.12.2022 (1,991.4euro); Nr.68, datë 10.12.2022 (1,350 euro); Nr.69, datë 12.12.2022 (3,190 euro); Nr.70, datë 14.12.2022 (790 euro); Nr.71, datë 16.12.2022 (3,180 euro);
	<b>TOTALI</b>	<b>49,093</b>	<b>3,927.44</b>	<b>45,165.56</b>	

*Burimi: DSHTD, përpunuar nga grupi i auditimit.*